

**RISITË NË FUSHËN E SIGURIMIT VULLNETAR SIPAS  
LIGJIT NR. 52/2014: VËSHTRIM I KRAHASUAR ME TË DREJTËN  
E BASHKIMIT EVROPIAN DHE LIGJIN NR. 9267/2004**

**HERALDA JAHOLLARI**

Dorëzuar  
Universitetit Europian të Tiranës  
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në  
Shkenca Juridike, me profil “E drejtë biznesi”, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor:  
**Prof. Asoc. Dr. HEMION BRAHO**

Numri i fjalëve: 50 700

Tiranë, mars 2017

*« E nesërmja është e pasigurt. E nesërmja mund të shkatërrojë atë që është fituar deri sot. E nesërmja është dera e hapur për goditjet e fatit. E nesërmja është përkthimi i dy të këqijave, që njeriu nuk ka rreshtur së luftuari, pa arritur t'i mundë. Plotësuese të njëra-tjetrës e megjithatë të ndryshme, ato mishërojnë frikën jetike të njeriut: pasigurinë e së ardhmes së afërt dhe të të qenit i përjetshëm. Kundër së dytës, ekziston një zgjidhje: feja. Kundër së parës, një qetësues: sigurimi. »*

*Veronique Nicolas*

## **DEKLARATA E AUTORËSISË**

Nën përgjegjësi time personale deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar prej meje.

Pjesë të tij janë përdorur për përgatitjen e artikujve shkencorë, të prezantuar me qëllim përmbushjen e detyrimeve doktorale për botimin e artikujve dhe pjesëmarrjen në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare, të realizuara prej meje.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

## **ABSTRAKTI**

### **RISITË NË FUSHËN E SIGURIMIT VULLNETAR SIPAS LIGJIT NR. 52/2014: VËSHTRIM I KRAHASUAR ME TË DREJTËN E BASHKIMIT EVROPIAN DHE LIGJIN NR. 9267/2004**

Aktiviteti i sigurimit vullnetar në Shqipëri, ka marrë një zhvillim të konsiderueshëm, këto vitet e fundit. Ajo që vihet re është rritja e numrit të shoqërive, që operojnë në treg dhe llojshmëria e sigurimeve të ofruara. Sot, aktiviteti i sigurimit vullnetar i le një vend më të gjerë vullnetit të palëve, të cilat, në disa raste, mund të parashikojnë në kontratë rregulla të ndryshme. Ligji i miratuar në vitin 2014 është ndikuar nga zhvillimet e fundit të shoqërisë shqiptare, nga përpjekjet e saj për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian, për të garantuar të drejtat e konsumatorit dhe për të shmangur përdorimin e aktivitetit të sigurimit për veprimtari kriminale, siç janë pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit.

Ky punim ka për qëllim analizimin e risive të ligjit nr. 52/2014, i cili është përpjekur të sjellë në legjislacionin e brendshëm parimet kryesore, që udhëheqin rregullat e caktuara në nivelin e Bashkimit Evropian si dhe të plotësojë boshllëqet, që ekzistonin në ligjin e mëparshëm. Punimi trajton gjithashtu edhe aspekte të ndryshme teorike, të cilat kanë të bëjnë me mënyrën sesi perceptohet ekzistenca e rrezikut nga autorë të ndryshëm në fushën e sigurimit të jetës dhe të jojetës..

Hipoteza bazë mbi të cilën është mbështetur ky punim është se Ligji nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, garanton zhvillimin e një aktiviteti më të qëndrueshëm, nëpërmjet realizimit të një mbrojtjeje efikase të konsumatorëve (hipoteza 1) si dhe shmangies së rrezikut të përdorimit të aktivitetit të sigurimit vullnetar për qëllime kriminale, nëpërmjet pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (hipoteza 2).

Punimi është mbështetur në disa metodologji të ndryshme. Kështu dy metodat, që janë përdorur kryesisht gjatë punimit janë ajo përshkruese dhe ajo krahasimore. Këto metoda kanë plotësuar metodën hulumtuese. Së fundi, përdorimi i metodës historike ka mundësuar realizimin e një pjese të punimit

## **ABSTRACT**

### **INNOVATIONS IN THE FIELD OF VOLUNTARY INSURANCE UNDER LAW NO. 52/2014: COMPARATIVE OVERVIEW WITH EUROPEAN UNION RULES AND THE LAW NO. 9267/2004**

Voluntary insurance activity in Albania has had a significant development, in the past few years. What is very noticeable is the increasing number of companies, operating in the insurance market, and the variety of insurance options that are offered. Today, the activity of voluntary insurance allows a broader role for the will of the parties, which, in some cases, may provide different rules in the contract. The law approved in 2014 is impacted by the recent developments of the Albanian society, by its efforts to join the European Union, to guarantee consumer rights and to avoid the use of insurance activity for criminal activities, such as money laundering and terrorism financing.

This paper aims to analyze the innovations of Law no. 52/2014, which attempts to bring into the domestic legislation the main principles governing the rules set at the level of the European Union, as well as filling in the gaps that existed in the previous law. The paper also addresses different theoretical aspects that have to do with how the existence of risk is perceived by various authors in the field of life and non-life insurance.

The base hypothesis of this paper is that the Law nr. 52/2014 "On the insurance and reinsurance" guarantees the development of a more sustainable activity, through the implementation of effective protection of consumers (hypothesis 1) and avoidance of the risk of using the voluntary insurance activity for criminal purposes, through money laundering and terrorist financing (hypothesis 2).

The paper is based on several different methodologies. The two main methods used are comparative and descriptive. These methods have completed the research method. Finally, the use of the historical method enabled the completion of a part of the paper.

## **FALENDERIME**

*Ky punim është rezultati i një pune individuale disavjeçare, e cila ka kërkuar një angazhim të plotë nga ana ime, por jo vetëm. Realizimi i këtij punimi nuk do ishte bërë i mundur, pa ndihmën dhe mbështetjen e disa njerëzve, të cilët gjej rastin t'i falenderoj.*

*Së pari, respekt dhe mirënjohje për përkrahjen dhe ndihmën shkencore të udhëheqësit tim, Prof.Asoc.Dr. Hemion Braho.*

*Shpreh vlerësim dhe falenderoj kolegët e mi, në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, si dhe studentët e tjerë, të cilët kanë ndjekur këtë cikël doktorature së bashku me mua, për mbështetjen dhe ndihmën e dhënë, në gjetjen e materialeve, që më kanë shërbyer për të realizuar këtë temë.*

*Së fundi, dëshiroj të falenderoj familjen time për kohën, ndihmën dhe këshillat e dhëna, si dhe për durimin e treguar.*

## **PËRMBAJTJA E LËNDËS:**

|                                                                                                                     |           |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>KAPITULLI 1: PARATHËNIE .....</b>                                                                                | <b>10</b> |
| Qëllimi dhe objektivat e punimit.....                                                                               | 10        |
| Metodologjia e përdorur .....                                                                                       | 17        |
| Struktura e punimit .....                                                                                           | 18        |
| Kufizimet .....                                                                                                     | 20        |
| <b>KAPITULLI 2: ASPEKTE TEORIKE MBI SIGURIMIN VULLNETAR DHE PRISHMËRITË E PALËVE NË KONTRATAT E SIGURIMIT .....</b> | <b>21</b> |
| 2.1. Llojet e rrezikut .....                                                                                        | 21        |
| 2.2. Karakteristikat e rrezikut.....                                                                                | 28        |
| 2.3. Elementët e administrimit të rrezikut .....                                                                    | 35        |
| 2.4. Karakteristikat e kontratës së sigurimit .....                                                                 | 41        |
| 2.5. Kontrata e sigurimit sipas sistemit anglo-sakson .....                                                         | 45        |
| 2.6. Konceptimi i jetës si një element që mund të sigurohet .....                                                   | 47        |
| 2.7. Rreziku në kontratat e sigurimit për jetën .....                                                               | 55        |
| 2.8. Prishmëritë e palëve në kontratën e sigurimit.....                                                             | 57        |
| <b>KAPITULLI 3: ASPEKTE HISTORIKE TË LINDJES DHE ZHVILLIMIT TË SIGURIMIT VULLNETAR .....</b>                        | <b>64</b> |
| 3.1. Lindja e aktivitetit të sigurimeve në Evropë: vështrim i përgjithshëm .....                                    | 64        |
| 3.2. Fillesat e zhvillimit të një kuadri ligjor.....                                                                | 69        |
| 3.3. Rasti i Lloyd's: angazhimi i personave fizikë në aktivitetin e sigurimit.....                                  | 77        |
| 3.4. Zhvillimi i sigurimeve në Shqipëri pas Luftës së dytë Botërore .....                                           | 84        |
| 3.4.1. Sigurimi i jetës .....                                                                                       | 85        |
| 3.4.2. Sigurimi vullnetar i pasurisë private .....                                                                  | 90        |
| - Rregullorja për sigurimin vullnetar të pasurisë.....                                                              | 90        |
| - Rregullorja për sigurimin e pasurisë private .....                                                                | 94        |
| 3.4.3. Rregullorja për sigurimin vullnetar të sendeve shtëpiake .....                                               | 94        |
| 3.4.4. Sigurimi i gjësë së gjallë .....                                                                             | 96        |
| 3.4.5. Sigurimi i kulturave bujqësore .....                                                                         | 103       |
| 3.4.6. Sigurimi sipas Kodit Civil të vitit 1981 .....                                                               | 106       |

|                                                                                                                            |            |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| <b>KAPITULLI 4: FINANCIMI I TERRORIZMIT DHE PASTRIMI I PARAVE NË FUSHËN E SIGURIMEVE VULLNETARE.....</b>                   | <b>109</b> |
| 4.1. Ekzistenca e rrezikut dhe përkufizimi i tij .....                                                                     | 109        |
| 4.2. Lufta kundër pastrimit të parave në dhënien dhe revokimin e licencës.....                                             | 120        |
| 4.2.1. Dhënia e licencës .....                                                                                             | 120        |
| 4.2.2. Revokimi i licencës.....                                                                                            | 124        |
| 4.3. Përzgjedhja e personave në funksione drejtuese dhe vendimmarrëse .....                                                | 126        |
| 4.4. Zgjerimi i aktivitetit në një shoqëri jashtë territorit shqiptar .....                                                | 128        |
| 4.5. Auditimi i shoqërisë së sigurimit.....                                                                                | 129        |
| 4.6. Përdorimi i informacionit personal të klientit.....                                                                   | 131        |
| 4.7. Marrja e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit .....                                                           | 135        |
| 4.8. Sanksionet që mund të merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ndaj subjekteve ..... | 146        |
| <b>KAPITULLI 5: MBROJTJA DHE TË DREJTAT E KONSUMATORËVE .....</b>                                                          | <b>154</b> |
| 5.1. Aspekte të mbrojtjes së konsumatorit .....                                                                            | 154        |
| 5.2. Risetë e ligjit nr. 52/2014.....                                                                                      | 159        |
| 5.3. Situata e konsumatorit përballë zhvillimit të teknologjive të reja të informacionit .....                             | 164        |
| 5.4. Veprimtaria promociionale e kompanive të sigurimit .....                                                              | 169        |
| 5.5. Trajtimi i ankesave të paraqitura nga konsumatorët .....                                                              | 173        |
| 5.6. Zhvillimet e reja në nivelin e Bashkimit Evropian .....                                                               | 178        |
| <b>KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....</b>                                                                                    | <b>196</b> |
| <b>BIBLIOGRAFIA.....</b>                                                                                                   | <b>203</b> |



## **SHKURTIME:**

AMF/Autoriteti – Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

CAMCA – Caisse Assurance Mutuelle Crédit Agricole

DPPPP – Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave

NIPT – Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm

TVSH – Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

AKSSH – Arkat e Kursimeve dhe Sigurimeve Shtetërore

VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

# KAPITULLI I: PARATHËNIE

## **Qëllimi dhe objektivat e punimit**

Përballimi i një rreziku të mundshëm dhe gjetja e rrugëve për të zvogëluar masën e dëmit, kanë qënë prej kohësh pikësnyime të njerëzimit, i cili ka kuptuar shumë shpejt që puna e përditshme dhe kursimet, nuk mjaftonin për të mbuluar humbjet, që mund të shkaktoheshin nga një ngjarje e papritur. Fillimet e sigurimit, edhe pse në forma shumë të ndryshme nga ato që njohim sot, datojnë që përpara lindjes së Krishtit. Sigurimi shfaqej më shumë në formën e ndihmës, që njerëzit i ofronin njëri-tjetrit, për të shmangur ardhjen e një dëmi apo për të bërë të mundur që zëvendësimi i të mirave të shkatërruara ose të humbura, të mos bëhej tërësisht nga tregtari i dëmtuar. Natyrshëm, zhvillimet e para në sigurime, i gjejmë në fushën e tregtisë nëpërmjet rrugëve ujore, lumenjve apo deteve, pasi transporti ujor ka qënë për një kohë shumë të gjatë mjeti më i përdorur për transportin e mallrave.

Në Evropë, perceptimi i sigurimit si një aktivitet i ligjshëm dhe formalizimi i tij nëpërmjet akteve të shkruara është bërë në një kohë më të vonë, pasi për një periudhë relativisht të gjatë, sigurimi është parë si një veprimtari spekulative, të cilën feja e krishterë e ndalonte. Kontratat e para, që përmbanin elementë të kontratave të sigurimit, janë lidhur në Itali, në vitin 1347, në zonën e Gjenovës. Më pas, këto kontrata u bënë të njohura edhe në zonën e Anglisë, e cila filloi të përdorte të njëjtat formulime si në kontratat e lidhura në Itali. Përdorimi i modelit italian të kontratave edhe në vende të tjera, shpjegohet me faktin që, shpeshherë, tregtarët italianë, të shpërngulur në këto vende, vazhduan të merreshin me tregti. Ndërkohë që edhe Londra, për shkak të zjarrit të madh, që ra në vitin 1666, u detyrua t'i jepte përparësi sigurimit të të mirave materiale dhe të zhvillonte një sistem të mirëfilltë sigurimi, i cili çoi edhe në krijimin e njëres prej kompanive më të mëdha në botë “Lloyd’s”. Me kalimin e kohës dhe krijimin e strukturave të qëndrueshme në fushën e sigurimit, të cilat i dhanë shtysë zhvillimit të këtij aktiviteti ekonomik, shtete të ndryshme morën masa për të zgjeruar kuadrin ligjor, që rregullonte këtë

fushë dhe për t'ia nënshtruar atë legjislacionit fiskal, duke përfituar edhe një masë të ardhurash të konsiderueshme. Aktiviteti i sigurimit u bë, gjithashtu, edhe objekt i analizave me qëllim studimin e tregut dhe të popullsisë, gjë e cila lejoi krijimin e tabelave të vdekshmërisë apo përcaktimin e primeve të aplikuara mbi bazën e rregullave matematikore. Ndërkohë, që doktrina e ka trajtuar sigurimin duke pasur në qendër nocionin e rrezikut, mënyrën se si matet apo perceptohet ai dhe se si duhet analizuar në funksion të llojeve të ndryshme të kontratave.

Në Shqipëri, gjetja e të dhënave për periudhën para shpalljes së Pavarësisë është shumë e vështirë. Ndërs, studimi i legjislacionit të periudhës pas shpalljes së Pavarësisë lejon të kuptojmë, që sigurimi vullnetar i të mirave materiale, i veprimtarisë tregtare apo i jetës së njerëzve ka filluar të bëhet objekt i rregullimeve ligjore, relativisht, vonë. Kështu, Kodi Civil i vitit 1929 nuk përmban dispozita specifike për kontratën e sigurimit. Rregullat e para në këtë fushë, i gjejmë në Kodin Tregtar të vitit 1932. Ndërsa, në periudhën e regjimit socialist, rregullimet janë bërë në shumicën e rasteve me akte nënligjore, si: Vendim i Këshillit të Ministrave, Rregullore, Urdhëresë. Kodet Civile, të miratuara gjatë kësaj periudhe, kanë pasur në përmbajtje të tyre një numër të vogël dispozitash, lidhur me kontratën e sigurimit, të cilat trajtonin rregullat bazë. Megjithatë, aktet nënligjore, të miratuara në fushën e sigurimit, rregullonin aspekte të ndryshme të këtij aktiviteti dhe lejonin përdorimin e kontratave të sigurimit në mjaft fusha, përmendim këtu sigurimin e jetës, të pronës, të kafshëve shtëpiake apo të kulturave bujqësore. Duke qënë se pjesa më e madhe e mjeteve të prodhimit dhe objekteve ishin pronë shtetërore, legjislacioni i asaj kohe parashikonte edhe sigurimin e pronës shtetërore, i cili ishte një detyrim për çdo institucion. Ekzistenca e një sistemi të qendëruar bënte që edhe sigurimi të ofrohej nga një operator i vetëm, Instituti Shtetëror i Sigurimit (Instituti), i zëvendësuar më pas nga Arkat e Kursimeve dhe Sigurimeve Shtetërore, të cilat zotëroheshin tërësisht nga shteti.

Me ardhjen e demokracisë dhe zhvillimin e ekonomisë së tregut, aktiviteti i sigurimit në Shqipëri ka marrë një drejtim tjetër nga ai i periudhës së para viteve '90. Kështu, është rritur llojshmëria e sigurimeve të ofruara dhe numri i operatorëve, që veprojnë në treg. Aktualisht, sipas të dhënave të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), në Shqipëri veprojnë 11 kompani sigurimesh, prej të cilave 2 kompani janë të liçensuara për të vepruar në fushën e sigurimeve të jetës dhe 8 janë të liçensuara për të vepruar në fushën e sigurimeve të jojetës. Një prej kompanive ka dy liçenca. Ajo vepron njëherazi edhe në fushën e sigurimeve jetë edhe në atë të sigurimeve jojetë. Ekziston edhe një kompani, e cila zotëron një liçencë për aktivitetin e sigurimit dhe një tjetër për aktivitetin e risigurimit. Instituti i Sigurimeve (INSIG), i cili, prej më shumë së 20 vjet, njihet si e vetmja kompani sigurimesh me kapital shtetëror, është privatizuar gjatë vitit 2016. Pra, në tregun shqiptar, sot, veprojnë vetëm kompani sigurimesh me kapital privat dhe, kryesisht, të huaj. Kodi Civil, në fuqi, përmban një numër të vogël dispozitash mbi kontratën e sigurimit, të cilat vendosin rregullat bazë. Sigurimi i detyruar parashikohet vetëm në fushën e transportit dhe rregullohet me ligj të veçantë<sup>1</sup>. Ndërkohë që, të gjitha fushat e tjera, në të cilat mund të lidhet kontratë sigurimi, për jetën apo për të mira materiale, rregullohen me të njëjtin ligj. Ligji i parë, i miratuar në kushtet e zhvillimit të një aktiviteti tregtar të mirëfilltë në fushën e sigurimeve, është ai i vitit 2004, me nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime". Ky ligj ka gjetur zbatim për një periudhë gati dhjetëvjeçare, deri në shfuqizimin e tij në vitin 2014. Në maj të vitit 2014, Parlamenti shqiptar ka votuar ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", i cili sjell një sërë risish në legjislacionin vendas, që do të analizohen gjerësisht në këtë punim.

Analizimi i ligjit nr. 52/2014 dhe ndryshimeve që solli ai, është bërë duke mbajtur në konsideratë, objektivat që ka pasur Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në momentin kur ka filluar puna

---

<sup>1</sup> Si pasojë e përmytjeve të shpeshta dhe klasifikimit të Shqipërisë në vendet me rrezik sizmiologjik të lartë, nga ana e ligjvënësit po vlerësohet mundësia e përfshirjes së sigurimit të banesave në kategorinë e sigurimeve të detyrueshme.

për krijimin e një ligji të ri<sup>2</sup>. Këto objektiva, të diktuar nga misioni kryesor i AMF, që është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe garantimi i sigorisë së operatorëve dhe investitorëve që veprojnë në fushën e sigurimeve, kanë qënë:

- Përmirësimi i kuadrit ligjor, që rregullon sektorët e mbikëqyrur dhe realizimi i përafrimit të legjislacionit vendas me të drejtën e Bashkimit Evropian si dhe me kërkesat dhe nevojat e zhvillimit të shëndoshë të tregjeve<sup>3</sup>.
- Menaxhimi i kapitalit (nëpërmjet caktimit të pragjeve të detyrueshme dhe realizimit të testeve të stresit), si mjeti kryesor për përballimin e krizave të ardhshme.
- Propozimi i produkteve, të cilat i janë bërë të qarta konsumatorit dhe që ofrojnë përfitime reale për të, ndërkohë që shoqëritë e sigurimit kuptojnë implikimet, që kanë këto produkte në menaxhimin e riskut për biznesin e tyre.
- Intensifikimi i kontroleve të subjekteve siguruese, qoftë në terren, qoftë mbi bazë dokumentacioni dhe krijimi i mundësive për një raportim më të rregullt dhe më të thjeshtë nga ana e tyre, përta u takon problematikave të hasura, gjatë ushtrimit të aktivitetit.
- Ndërmarrja e politikave zhvilluese të tregut dhe orientimi i mbikëqyrjes drejt mbikëqyrjes me bazë risku, nëpërmjet përcaktimit të një metodologjie efikase për mbikëqyrjen dhe promovimit të një tregu të sigurt dhe të qëndrueshëm. (Gjoni dhe Dervishi, Pranverë 2010, fq. 52 - 53).

Përzgjedhja e metodologjisë së punimit, nëpërmjet së cilës janë studiuar rregullat e parashikuara nga ligji nr. 52/2014, është bërë duke iu referuar qëllimit të punimit, i cili është udhëhequr nga disa pyetje hulumtuese:

---

<sup>2</sup> Procesi për krijimin dhe miratimin e ligjit të ri (duke përfshirë diskutimet me subjektet e interesuara, shkëmbimet me Bankën Botërore dhe Ministrinë e linjës) ka zgjatur rreth dy vjet.

<sup>3</sup> Përmirësimi është menduar të realizohet jo vetëm në fushën e sigurimit vullnetar, por edhe në atë të sigurimit të detyrueshëm, dhe nga AMF dhe Ministria e Financave po punohet aktualisht për propozimin e një ligji të ri në fushën e sigurimit të detyrueshëm.

- Cilat janë risitë, që ka sjellë ligji nr. 52/2014, në legjislacionin shqiptar, në fushën e sigurimit vullnetar?
- A përmbajnë këto risi elemente, që futen për herë të parë në legjislacionin e sigurimeve në vendin tonë, apo, thjesht, plotësojnë boshllëqe, të cilat ekzistojnë në ligjin e mëparshëm?
- Sa është përafruar legjislacioni vendas me rregullat e vendosura nga Direktivat në nivelin e Bashkimit Evropian në fushën e sigurimit vullnetar?
- Në cilat aspekte ekzistojnë ende mundësi për përmirësim?

Miratimi i ligjit nr. 52/2014 ishte një rrjedhojë logjike e ndryshimeve në tregun shqiptar të sigurimeve, e rritjes së rreziqeve me të cilat përballen shoqëritë e sigurimit pas krizës ekonomike të vitit 2008, por edhe e hapave të ndërmarra nga Shqipëria për të integruar Bashkimin Evropian. Duke mbajtur në konsideratë zhvillimin e veprimtarive të paligjshme, kryesisht të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që mund të kryhen nëpërmjet aktivitetit të sigurimit, ligjvënësi ka shtuar në përmbajtjen e ligjit disa pika apo nene, që parashikojnë detyrime të ndryshme për kompanitë e sigurimit, për sa i takon ngritjes së strukturave të brendshme për menxhimin e riskut, apo verifikimit të dokumentacionit, me qëllim që aktiviteti i sigurimit të mos përdoret për të realizuar këto lloj veprimtarish kriminale<sup>4</sup>. Në këtë drejtim, përveç verifikimeve, që kryhen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, kompanitë e sigurimit u nënshtrohen edhe kontrolleve të ushtruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Fakt shumë i rëndësishëm, lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit përbën

---

<sup>4</sup> Kështu, në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 52/2014 dhe të "Rregullores për rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit", të miratuar nga AMF më 28 prill 2015, një shoqëri sigurimi duhet të krijojë sistemin e administrimit të rrezikut, i cili ka të bëjë me përcaktimin dhe kontrollin e rreziqeve, nëpërmjet politikave, procedurave të zbatimit dhe vendosjes së kufijve për monitorimin, kontrollin dhe, kur është e nevojshme, ndryshimin e cilësisë e të nivelit të veprimtarive, bazuar në strukturën e rreziqeve dhe të ardhurave, që bartet në flukset e ardhshme të parasë. Sistemi i administrimit të rrezikut shërben për të identifikuar, vlerësuar, mbikëqyrur, administruar dhe raportuar, në vijimësi, rreziqet, me të cilat është përballur ose mund të përballlet një shoqëri sigurimi në nivelin e saj, si dhe në nivel grupi. Politikat, procedurat e zbatimit, kufijtë dhe veprimtaritë, që lidhen me administrimin e rrezikut duhet të jenë të mjaftueshme për të administruar aspekte të ndryshme të rreziqeve, të cilat krijohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.

shkak, që kompanitë e sigurimit të mos respektojnë parimin e konfidencialitetit në trajtimin e informacionit të marrë nga klientët.

Një aspekt tjetër në të cilin ligji i ri sjell ndryshime, në krahasim me ligjin e shfuqizuar, është ai i trajtimit të pozitës së konsumatorëve dhe mbrojtjes së tyre, pasi të drejtat e klientëve trajtohen më gjerësisht në ligjin nr. 52/2014. Ligji trajton aspekte të ndryshme, që prekin fazën para lidhjes së kontratës (nëpërmjet dhënies së informacionit), fazën e ekzekutimit të saj (nëpërmjet llogaritjes dhe pagesës së primeve, dëmshpërblimit në afate të shkurtra etj.), si dhe fazën pas zgjidhjes së kontratës (mundësinë e konsumatorëve për t'u ankuar në rrugë administrative apo gjyqësore). Përveç kësaj, ligji parashikon një sërë rregullash për dhënien e informacionit nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, gjë që i jep konsumatorit mundësi për t'u njohur me atë që ai kërkon, pa pasur nevojë të kalojë në zyrat e një kompanie sigurimi.

Duke trajtuar këto tematika, punimi arrin t'u japë përgjigje disa pyetjeve:

- Si është perceptuar nga ligjvënësi shqiptar rreziku i financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave në aktivitetin e sigurimit?
- Cilat janë garancitë, që u ofrohen konsumatorëve në marrëdhëniet e tyre me kompanitë e sigurimit?
- Si paraqitet pozita e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare përsa u takon masave, që mund të marrë ai ndaj shoqërive të sigurimit, qofshin këto masa me karakter parandalues apo ndëshkues?
- Cili është qëndrimi i mbajtur nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë për problematikat, që lidhen me zhvillimin e aktivitetit të sigurimit vullnetar së fundmi?

Ligji, në tërësinë e tij, përcjell rregulla të vendosura në nivelin e Bashkimit Evropian, nëpërmjet 12 prej 13 direktivave, që rregullojnë fushën e sigurimit<sup>5</sup>. Në formulimin e çdo neni, ligjvënësi shqiptar është përpjekur të bëjë një përafrim të pjesshëm ose të plotë<sup>6</sup>, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimet, për përshtatjen e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, që rrjedhin nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit<sup>7</sup>. Përafrimi i legjislacionit vendas ka për qëllim gjithashtu të tërheqë investimet e huaja, pasi kompani të ndryshme, të vendosura në vendet e Bashkimit Evropian, do të jenë më të prirura të angazhohen në Shqipëri, nëse legjislacioni vendas nuk paraqet ndryshime të rëndësishme, në krahasim me legjislacionin e vendeve, ku këto kompani ushtrojnë aktivitetin e tyre. Me miratimin e ligjit nr. 52/2014, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka marrë mjaft kompetenca, një pjesë e të cilave nuk i njiheshin në ligjin e vjetër dhe që i lejojnë atij, kryesisht, të ndërhyjë duke kërkuar marrjen e masave nga kompanitë e sigurimit, që në momentin kur ato fillojnë të hasin vështirësitë e para, në respektimin e detyrimeve të tyre dhe jo më, pas deklarimit të pamundësisë së ekzekutimit të detyrimeve të kërkueshme, siç parashikohej nga ligji nr. 9267.

Duke vlerësuar në tërësi kontekstin ligjor në fushën e sigurimit vullnetar, vihet re se ligji i miratuar në vitin 2014 dhe aktet nënligjore, Rregullore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të miratuara në bazë dhe për zbatimin e tij, tentojnë të krijojnë një kuadër juridik të plotë, të qëndrueshëm dhe të lehtë për t'u zbatuar.

Pra, hipoteza bazë<sup>8</sup> e ngritur në këtë punim është: **Ligji nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, garanton zhvillimin e një aktiviteti më të qëndrueshëm, nëpërmjet**

---

<sup>5</sup> Direktivat, që rregullojnë fushën e sigurimeve janë tashmë 13, por ligji nr. 52/2014 ka realizuar përafrimin vetëm me 12 prej tyre, të cilat ishin miratuar nga Komisioni në momentin e hartimit të ligjit. Direktiva e 13 është miratuar në vitin 2015.

<sup>6</sup> Në momentin e dërgimit të draft-ligjit për mendim në Ministrinë e Linjës, AMF dhe Ministria e Financave kanë plotësuar tekstin e propozuar me relacionin shpjegues dhe me një tabelë përputhshmërie me *acquis communautaire*, në të cilën shpjegohen në detaje përafrimet e realizuara.

<sup>7</sup> Marrëveshja e Stabilizim Asocimit është nënshkruar nga Shqipëria dhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian më 27 korrik 2006. Më 5 shtator 2007, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 557, është miratuar Plan i Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit për periudhën 2007-2012. Ratifikimi i kësaj Marrëveshjeje nga vendet anëtare ka vazhduar deri në vitin 2008.

<sup>8</sup> Në doktoraturën e tij, “Konventa e Nju Jorkut dhe instrumentet juridikë të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar në Shqipëri”, doktoranti Artan Spahiu, bazuar në përkufizimin e dhënë nga Babbie në vitin 1986, e cilëson hipotezën si “një



**realizimit të një mbrojtjeje efikase të konsumatorëve (hipoteza 1) si dhe shmangies së rrezikut të përdorimit të aktivitetit të sigurimit vullnetar për qëllime kriminale, nëpërmjet pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (hipoteza 2).**

Trajtimi i hipotezës bazë do të bëhet duke analizuar hipotezat e caktuara për t'u vërtetuar si dhe duke mbajtur në konsideratë dy aspekte:

Së pari, do të studiohen risitë, që sjell ligji aktual, në krahasim me ligjin e mëparshëm, që u shfuqizua, nëpërmjet tematikave, që ligji nr. 9267 nuk i mbulonte, si për shembull luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Së dyti, do të verifikohet përafrimi i legjislacionit vendas me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe përshtatja me zhvillimet e teknologjisë, për t'i ofruar konsumatorit garanci më të mëdha si dhe për t'i dhënë atij mundësinë të përfitojë plotësisht nga të rejat në fushën e teknologjisë informative.

### **Metodologjia e përdorur**

Realizimi i këtij punimi voluminoz dhe të rëndësishëm, në aspektin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, nuk mund të arrihej pa ndjekur një metodologji të caktuar. Punimi mbështetet mbi një përjasje metodologjike të përzierë, e cila bazohet, së pari, te hulumtimi, që përfshin mbledhjen e materialeve doktrinale, shqiptare dhe të huaja. Studimi është përqëndruar në modelin anglosakson, si një ndër më të rëndësishmit në këtë fushë, por edhe më të veçantët, për sa u përket formave të ndryshme, në të cilat është zhvilluar sigurimi, në veçanti në Angli. Rëndësi i është kushtuar edhe modelit francez, i cili, në aspektin doktrinal, paraqet studime të spikatura në fushën e sigurimeve. Studimi dhe referimi i të drejtës franceze është bërë për arsye se Kodi Civil shqiptar, por edhe dispozita të tjera ligjore janë

---

pohim të shprehur në formën e një deklarami, si një premisë, që mund të përdoret si bazë për kërkimin shkencor”. Spahiu shprehet, gjithashtu, se hipoteza duhet konsideruar si version final i hamendësimit të studiuesit, i cili më pas ia nënshton atë një procedure të komplikuar dhe të hollësishme testimi.

formuluar mbi bazën e modelit francez dhe me ndihmën e ekspertëve francezë. Në një aspekt më personal, studimi i modelit francez më lejon gjithashtu të thelloj më tej njohuritë e mia për sistemin e vendit në të cilin unë kam kryer studimet e larta. Analizimi i doktrinës franceze dhe asaj angleze ka gjithashtu për qëllim ballafaqimin e dy sistemeve të ndryshme, atë të civil law dhe common law.

Hulumtimi është plotësuar me përdorimin e metodës historike, e cila ka shërbyer për realizimin e një pjese të punimit, pasi zhvillimet e sotme, në Shqipëri, por edhe në aspektin ndërkombëtar nuk mund të kuptohen pa u bërë, paraprakisht, një tablo prezantuese e fillimeve dhe hapave me të hershme në të drejtën e sigurimeve, të cilat kanë mundësuar arritjet e sotme.

Rëndësi u është dhënë gjithashtu metodave të analizës dhe sintezës, të cilat kanë ndihmuar gjatë përzgjedhjes së tematikave, që janë trajtuar dhe materialit, që ka shërbyer si bazë për këtë qëllim.

Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat e kërkimit, janë përdorur, gjithashtu, edhe metoda përshkruese dhe ajo krahasimore. Studimi i risive të ligjit nr. 52/2014 është bërë duke pasur parasysh dispozitat dhe parashikimet e ligjit nr. 9267/2004, i cili ka rregulluar fushën e sigurimeve për një periudhë prej rreth dhjetë vjetësh dhe ato të caktuara në nivelin e Bashkimit Evropian.

## **Struktura e punimit**

Kapitujt lidhen në mënyra të ndryshme me metodologjitë e përdorura për realizimin e punimit.

Në kapitullin e dytë janë trajtuar rrymat kryesore doktrinale, të cilat ekzistojnë në vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian (Franca dhe Anglia), dhe në disa raste, edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Trajtimi teorik është bërë së pari për elementët e sigurimit dhe mënyrën sesi konceptohet ai në kuadër të krijimit të një marrëdhënieje sigurimi. Është trajtuar gjithashtu kontrata e sigurimit dhe karakteristikat e saj, qoftë kjo në doktrinën shqiptare, qoftë në atë të huaj. Më pas, është trajtuar kontrata e sigurimit për jetën, si një element, i cili i ka dhënë shkas zhvillimit të një debati të gjerë doktrinar. Së

fundi, është trajtuar pozita e palëve, në veçanti ajo e konsumatorit dhe pritshmëritë e tyre në kontratën e sigurimit.

Në kapitullin e tretë është bërë një prezantim i zhvillimeve të sigurimit, në vende të ndryshme, prej periudhës para lindjes së Krishtit e deri në momentet, kur kanë marrë zhvillim format bashkëkohore të sigurimit. Historia e zhvillimit të sigurimeve është trajtuar gjithashtu përsa i takon vendit tonë, kryesisht gjatë periudhës pas Luftës së dytë Botërore deri në fillimin e viteve '90. Regjimi socialist, pavarësisht se e ndaloj pronën private dhe zhvillimin e aktiviteteve tregtare private, për nga vetë kohëzgjatja e tij, ze një vend të rëndësishëm në historinë e sigurimeve në Shqipëri, për sa i takon periudhës së ekzistencës së një shteti shqiptar, pra, që pas shpalljes së Pavarësisë e deri më sot.

Kapitulli i katërt dhe i pestë janë rezultat i përdorimit të metodologjisë krahasimore, por edhe i asaj të analizës interpretuese. Përdorimi i këtyre metodave lejon krahasimin e kuadrit ligjor vendas, në fuqi, me atë të shfuqizuar, por edhe me kuadrin rregullator në fuqi, në nivelin e Bashkimit Evropian. Kjo metodë ka për bazë studimin e legjislacionit shqiptar në fushën e sigurimeve, veçorive dhe karakteristikave të tij, duke u përpjekur të nxjerrë në pah ndryshimet e realizuara, përmirësimet dhe përshtatjet e arritura, por edhe drejtimet, në të cilat ka ende mundësi përmirësimi.

Në mënyrë të vazhdueshme, në punim analizohen raste të jurisprudencës, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel komunitar.

Në fund, gjejmë pjesën e konstatimeve dhe rekomandimeve, të paraqitur në formën e një kapitulli të veçantë. Gjetjet dhe përfundimet e kapitujve paraardhës paraqiten në këtë kapitull, të prezantuara në funksion të hipotezës dhe të pyetjeve kërkimore të parashtruara në fillim të punimit. Dhënia e rekomandimeve lejon që punimi të mos jetë vetëm me karakter teorik dhe përshkrues, por edhe analitik. Rekomandimet kanë për qëllim nxitjen e mendimit kritik dhe zhvillimin e një analize më të thellë, krahasuar me atë ekzistuesen, duke pasur në konsideratë problematikat e krijuara nga kuadri

ligjor dhe nënligjor i analizuar, me qëllim që zbatimi i tij të bëhet në një mënyrë sa më të qëndrueshme dhe të efektshme për të gjitha palët e përfshira në procesin e sigurimit vullnetar.

### **Kufizimet**

Nëpërmjet këtij punimi analizohen risitë e ligjit nr. 52/2014, duke pasur në konsideratë situatën, që ekzistonte përpara hyrjes në fuqi të tij dhe rrethanat, që ekzistojnë në nivelin e Bashkimit Evropian. Analizimi i jurisprudencës shqiptare mund të konsiderohet ndonjëherë i paplotë, kjo për faktin se, ligji nr. 52/2014 parashikon periudha përshtatjeje, relativisht, të gjata (nga 3 deri në 12 muaj), për kompanitë e sigurimit, çka sjell si pasojë, që konfliktet gjyqësore, të cilat janë mbyllur me një vendim të formës së prerë, të jenë mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 9267.

Trajtimi i koncepteve teorike është bërë shpeshherë duke u mbështetur në autorë të huaj dhe më pak në ata vendas. Ky fakt vjen si rrjedhojë e vështirësive të hasura në gjetjen e literaturës së mirëfilltë shqiptare. Në mjaft raste, botimet në gjuhën shqipe mbështeten në përkthime të punimeve të autorëve të huaj dhe jo në studimet e specialistëve shqiptarë të fushës.

Kufizim mund të konsiderohet edhe përzgjedhja e periudhës së pas Luftës së dytë Botërore, përse i takon paraqitjes së zhvillimeve historike në vendin tonë. Mungesa e trajtimit të periudhës së Mbretërisë shqiptare, është një zgjedhje e diktuar nga dy faktorë, burimet e pakta të informacionit, për këtë periudhë dhe dëshira për të mos i dhënë punimit një karakter të mirëfilltë historik.

Analizimi i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë është bërë në një këndvështrim kryesisht teorik për shkak të faktit që Shqipëria nuk është ende pjesë e Bashkimit Evropian dhe nuk ka një mekanizëm, që të lejojë referimin e drejtpërdrejtë të vendimeve të kësaj Gjykate në sistemin e saj të brendshëm gjyqësor, siç është rasti me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## **KAPITULLI II : ASPEKTE TEORIKE MBI SIGURIMIN VULLNETAR DHE PRITSHMËRITË E PALËVE NË KONTRATËN E SIGURIMIT**

### **2.1. Llojet e rrezikut**

Në kuptimin e përgjithshëm, fjala sigurim nënkupton besimin në diçka apo mbrojtjen (Qehaja Dhjetor 2014, fq. 537). Ky përkufizim i thjeshtë i marrëdhënies së sigurimit nxjerr në pah tre elementë përbërës të kësaj marrëdhënieje (Bakraçi 2007):

- Rreziqet, që sigurohen (ngjarjen e cila sjell dëm në interesat e të sigurvearit);
- Primet, që paguhen (shumat e paguara nga poseduesi i policës me qëllim sigurimin);
- Kompensimet nga sigurimet (shumat e paguara nga sigurveasi për dëmin e realizuar).

Pa rrezik nuk ekziston sigurimi. Nisur nga ky postulat, arrijmë në përfundimin se marrëdhënia e sigurimit mbështetet mbi paraqitjen e një ngjarjeje të dëmshme, që shkakton dëme të karakterit ekonomik, kompensimi i të cilave kërkohet të arrihet nëpërmjet sigurimit.

Rrezik mund të quhet edhe vetë ngjarja si e tillë, për shembull një fatkeqësi natyrore, (zjarr) e cila sjell detyrimin e kompanisë sigurorese t'i paguajë të sigurvearit një shumë të hollash, ose të bëjë pagimin për dëmin e shkaktuar, sipas kushteve të kontratës së sigurimit. Sigurimi mund të vështrohet në shumë aspekte, por më të rëndësishmet, janë:

- Rreziku në këndvështrimin e të sigurvearit;
- Rreziku në këndvështrimin e të drejtave dhe detyrave, që lindin për palët, në zbatim të kontratës;
- Rreziku në këndvështrimin e sigurveasit.

Rreziku mund të paraqitet në forma të ndryshme. Së pari, dallojmë rrezikun joekonomik nga rreziku ekonomik:

Rreziku joekonomik është, kryesisht, i natyrës objektive, edhe pse ndërhyrja e elementëve subjektivë nuk përjashtohet. Është i vështirë për t'u parashikuar, shoqërohet nga pasoja të rënda dhe mund të zgjasë për një kohë të gjatë. Përmendim fatkeqësitë natyrore, tensionet shoqërore ose politike.

Rreziku ekonomik shkaktohet nga faktorë ekonomikë, të cilët mund të ndahen në tre kategori:

- Rrezik teknik;
- Rrezik fizik;
- Rrezik financiar.

Rreziku teknik lidhet me teknologjinë e përdorur gjatë procesit të punës si dhe me teknikat e ndryshme, të përdorura gjatë veprimtarisë së biznesit, të cilat mund të sjellin pasoja të dëmshme.

Rreziku fizik lidhet me përmbajtjen materiale të elementëve, që përdoren gjatë procesit të punës.

Rreziku financiar lidhet me paraqitjen e dëmeve, si pasojë e kryerjes së veprimeve financiare në shoqëri, që sjellin ndryshimin e kushteve financiare, në të cilat kryhet veprimtaria.

Rreziqet ekonomike shkaktohen nga faktorë objektivë dhe subjektivë, të cilët mund të jenë të brendshëm ose të jashtëm në raport me aktivitetin e shoqërisë.

Së dyti, dallojmë rrezikun e pastër nga rreziku spekulativ.

Rreziku i pastër është ai rrezik, i cili është pasojë e ngjarjeve të rastit, dhe jo e ngjarjeve të kryera nga njeriu me vetëdije. Risku i pastër është një formë e riskut, ku ekziston mundësia vetëm për humbje të aseteve nga ngjarje të caktuara (Lito 2013, fq. 46).

Rreziku spekulativ është ai rrezik, tek i cili njeriu mund të ndikojë në ardhjen apo pasojat, nëpërmjet veprimeve të kryera prej tij me vetëdije. Ky lloj rreziku mund të ketë si rezultat humbjen ose fitimin (Guri, Gjoni dhe Dervishi, 2012, fq. 18-19).

Aktiviteti i sigurimit mbulon vetëm rreziqet e pastra. Rreziku spekulativ nuk përputhet me qëllimin e sigurimit, i cili është mbrojtja e pronës apo e personit, nga një ngjarje e rastësishme, e cila ka

për pasojë shkaktimin e një dëmi. Nuk ekzistojnë baza për përpunimin e informacioneve, që lidhen me rreziqet spekulative, të cilat do të lejonin nxjerrjen e të dhënave matematikore dhe statistikore, mbi bazën e të cilave do të llogariteshin primet e sigurimit.

Megjithatë, edhe rreziku i pastër, ndonjëherë, mund të mos mbulohej tërësisht nga sigurimi. Në raste katastrofash, për shembull, të shpërthimit të një centrali bërthamor, një sigurues i vetëm mund të refuzojë të sigurojë aktivitetin për arsye të vlerave shumë të mëdha të dëmeve, që mund të shkaktohen. Në këto raste, subjekti, që kërkon të sigurohet, mund të jetë i detyruar të bëjë disa sigurime të pjesshme, në sigurues të ndryshëm. Mund të ndodhë, gjithashtu, që, në rast se një sigurues i vetëm pranon të sigurojë tërësisht një rrezik me vlerë shumë të madhe, të transferojë një pjesë të rrezikut të siguar, te një subjekt tjetër, nëpërmjet risigurimit. Rreziqet e pastra, mund të ndahen në tre kategori:

- Rreziqe personale: janë rreziqet, të cilave u nënshtrohet njeriu në personin e tij, (dëmtim i shëndetit, vdekje, papunësi, fatkeqësi, etj.);
- Rreziqe, që lidhen me pronën: janë rreziqet, të cilave u nënshtrohet pasuria e personit;
- Rreziqe nga përgjegjësia: janë rreziqet, që lidhen me përgjegjësinë, që mban i siguruari ndaj të tretëve, për dëmet, që mund t'u shkaktojë atyre me veprimet e tij ose të personave për të cilët ai mban përgjegjësi. Kjo lloj përgjegjësie mund të jetë ligjore (si për shembull sigurimi i detyrueshëm në transportin rrugor), ose të mbështetet në një marrëdhënie kontratore.

Një tjetër kategorizim i rreziqeve është ai, që dallon rreziqet e përbashkëta (kolektive) nga rreziqet individuale. Ndarja e rreziqeve kolektive nga rreziqet individuale bëhet duke analizuar efektet e tyre. Rreziqet kolektive, për nga vetë emri, i shtrijnë pasojat mbi një grup të madh njerëzish. Përmendim, këtu, luftën, papunësinë, tërmetin etj. Pasojat e rreziqeve individuale janë më të kufizuara dhe prekin vetëm një ose disa individë, për shembull djegia e një banese prek të gjithë anëtarët e familjes, që banojnë në të.

Përgjithësisht, rreziqet kolektive trajtohen nga shteti, pra, përgjegjësia për riparimin e pasojave të tyre bie mbi shoqërinë, si për shembull, nëpërmjet krijimit të politikave të asistencës për të papunët apo të pensionit të pleqërisë, për personat, që nuk mund të ushtrojnë më një aktivitet profesional, për arsye të moshës. Sigurimi privat i fenomeneve masive të kësaj natyre, edhe pse praktikohet, është një mënyrë jotipike për sigurimin e rreziqeve të shumta të përbashkëta.

Rreziqe kolektive, apo rreziqe të shumta të përbashkëta, quhen ato rreziqe, për të cilat, gjendet një numër i madh rastesh, me vlera të mëdha, në një hapësirë të kufizuar. Rrezik kolektiv, i cili mbulohet rregullisht nga një shoqëri private sigurimi, është rreziku i aksidentit në punë. Ky rrezik, edhe pse prek një numër të konsiderueshëm njerëzish, në një hapësirë të kufizuar, është pranuar, tashmë, si një rrezik i sigurueshëm, i cili merret përsipër nga kompani të ndryshme, qoftë vetë, qoftë në bashkësigurim, apo edhe nëpërmjet risigurimit. Sigurisht që, një kompani sigurimi, e cila pranon të sigurojë një shoqëri nga rreziqet e aksidenteve, që mund të pësojnë punonjësit e saj gjatë kohës së punës, do t'i vendosë shoqërisë kritere të ndryshme, të cilat lidhen jo vetëm me primin e pagueshëm, por edhe me kushtet e punës. Kështu për shembull, shoqëria e sigurimit mund të kërkojë nga shoqëria e siguruar, që ajo të përdorë pajisje të teknologjisë së fundit dhe që punonjësit e saj të veshin sistematikisht uniforma, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e punonjësve dhe zvogëlimin e pasojave, që mund të vijnë nga aksidentet në ambientet e punës. Për sa i përket primit, kompania e sigurimit mund të kërkojë rritjen e tij, sa herë që ndodhin aksidente. Mund të ndodhë edhe që kompania e sigurimit, të ofrojë shërbimet e saj për një numër të caktuar aksidentesh, ose për një vlerë shpërblimi të caktuar.

Në varësi të ndikimit të njeriut në ardhjen e një rreziku apo në ndodhjen e një ngjarjeje të dëmshme, rreziqet mund të kategorizohen në rreziqe objektive dhe subjektive.



Rreziqet objektive, të cilat nuk varen nga veprimet e personit të siguruar, janë relativisht, të lehta për t'u matur. Cilësitë e lëndës së siguruar, në veçanti për sigurimet pronësore, ndikojnë ndjeshëm në masën dhe efektet e rrezikut dhe të ngjarjes së dëmshme.

Rreziqet subjektive janë ato rreziqe, realizimi i të cilave është i lidhur ndjeshëm me veprimet e njeriut dhe ndikimin e tij në rastin e siguruar.

Rreziku mund të jetë, objektivisht, i mirë, ose, objektivisht, i dobët, në varësi të cilësive të brendshme të objektit të siguruar. Rreziku mund të jetë, gjithashtu, subjektivisht i mirë dhe subjektivisht i dobët, në varësi të cilësive të subjektit të siguruar, ose të cilësive të pronarit të një objekti të siguruar (për shembull, të pronarit të një shtëpie banimi të siguruar, ose të drejtuesit të një automjeti).

Nga kombinimi i rreziqeve objektive dhe subjektive, mund të bëhet një kategorizim i kësaj forme:

- Rreziqe, objektivisht dhe subjektivisht, të mira;
- Rreziqe, objektivisht, të mira dhe subjektivisht, të dobëta;
- Rreziqe, objektivisht, të dobëta dhe subjektivisht, të mira;
- Rreziqe, objektivisht dhe subjektivisht, të dobëta.

Nëse u referohemi karakteristikave të rreziqeve, ato mund të ndahen në dy kategori të tjera:

- Rreziqe të pandryshueshme (konstante);
- Rreziqe të ndryshueshme.

Rreziqet e pandryshueshme kanë të njëjtën rrezikshmëri, përse i përket shpeshtësisë së paraqitjes së tyre. Ndërsa rreziqet e ndryshueshme kanë një shkallë rrezikshmërie paraqitjeje, që ndryshon me kalimin e kohës. Për shembull, jetëgjatësia e njerëzve ndryshon me kalimin e kohës. Ky fakt ndikon në sigurimet e jetës, që ofrohen nga kompanitë e sigurimit. Ndryshimet në madhësinë e rrezikut janë shumë të rëndësishme, pasi mund të kenë si pasojë ndryshimin e kushteve të policës së sigurimit, të primit dhe, madje, mund të çojnë edhe në prishjen e kontratës së sigurimit.

Së fundi, rreziqet ndahen në rreziqe të sigurueshme dhe rreziqe të pasigurueshme.

Rreziqet e sigurueshme janë ato rreziqe për të cilat ekzistojnë bazat teknike për përcaktimin e madhësisë së tyre dhe për mundësinë e mbulimit (Bakraçi, 2007, fq. 114). Në këtë kategori rreziqesh bëjnë pjesë:

- Rreziqet pronësore: nga realizimi i një rreziku pronësor, shkaktohen humbje financiare për shkak të dëmtimit të pronës, i cili mund të jetë një dëm direkt (shkatërrim, vjedhje etj.), ose indirekt (rritja e shpenzimeve për mirëmbajtjen e pronës etj.).
- Rreziqet personale: këto rreziqe sjellin humbjen ose zvogëlimin e sigurisë financiare, si pasojë e vdekjes, e përkeqësimit të shëndetit, e ndodhjes së një aksidenti.
- Rreziqet nga përgjegjësia: në këto rreziqe, dëmi nuk i shkaktohet personit të siguruar, por një personi të tretë. Në mjaft raste, për shkak të vlerave të mëdha të dëmeve, që mund të shkaktohen, sigurimi, për këto rreziqe, bëhet deri në një masë të caktuar. Rreziqet nga përgjegjësia mund të shkaktohen nga:
  - ✓ Përdorimi i një automjeti ose i pasurisë;
  - ✓ Ushtrimi i një profesioni;
  - ✓ Ushtrimi i një veprimtarie/procesi prodhues të një të mire;
  - ✓ Pasja e përgjegjësisë për veprimet e dikujt tjetër, (prindi për fëmijën, ose punëdhënësi për punëmarrësin).

Rreziqet e pasigurueshme janë ato rreziqe, për të cilat siguruesi nuk ka bazë reale për përcaktimin e primit, ose nuk ka mundësi për shpërndarjen e rrezikut (Bakraçi, 2007, fq. 114). Këtu përmendim:

- Rreziqet e tregut: janë rreziqet, që rrjedhin nga ndryshimi i çmimeve në treg, ndryshimi i shijes së konsumatorëve, konkurrencës së operatorëve të tjerë në treg, etj.

- Rreziqet politike: në këtë kategori bëjnë pjesë rreziqet, që lidhen me ndryshimet politike në një shtet, me kufizimet në tregti, me këmbimin e monedhave, me ndryshimet e politikave fiskale.
- Rreziqet në prodhim: këto rreziqe lidhen me faktorë të prodhimtarisë, siç janë faktori teknologjik, kur përdoret teknologji e vjetëruar, ose faktori njerëzor, në rast se punonjësit hyjnë në grevë.
- Rreziqe personale: kjo kategori përfshin rrezikun e humbjes së të ardhurave për shkaqe të ndryshme nga ato, që hyjnë në kategorinë e rreziqeve personale të sigurueshme, si për shembull, papunësia, mospasja e arsimit përkatës etj.

Disa prej rreziqeve të pasigurueshme, mund të mbulohen, pjesërisht, në kuadër të kontratave të sigurimit, që përdoren në sektorë të ndryshëm aktiviteti, ose për disa lloje specifike sigurimesh. Së fundi, këto rreziqe mbulohen nga shtetet, nëpërmjet garancive ose nga shoqata siguruesish, të krijuara enkas për këtë qëllim.

Kur bëhet fjalë për sigurimin e jetës, ekzistojnë forma të ndryshme klasifikimi, në varësi të kriterit, që merret për bazë (Qehaja, Dhjetor 2014, fq. 542 – 545):

- Sigurimi i jetës klasifikohet në varësi të rrezikut të përfshirë në aksident (rrezik i përkohshëm apo i përhershëm);
  - Sigurimi i jetës klasifikohet në varësi të mënyrës së lidhjes së kontratës (kontratë individuale ose kolektive);
  - Sigurimi i jetës klasifikohet në varësi të mënyrës së pagimit të primit (më keste ose jo);
  - Sigurimi i jetës klasifikohet duke pasur parasysh numrin e të siguruarve;
  - Sigurimi i jetës klasifikohet në funksion të ndryshimit të shumës së sigurimit dhe të primit.
- Llojshmëria e kombinimit të tarifave për sigurimin e jetës ka për qëllim, që të kombinojë në mënyrë të suksesshme sigurimin dhe kursimin.

## 2.2. Karakteristikat e rrezikut

Pavarësisht llojshmërisë së rreziqeve, që hasen në jetën e përditshme, është e mundur të përcaktohen disa karakteristika të përbashkëta të rreziqeve (Bakraçi, 2007, fq. 116 - 117).

Së pari: rreziqet prekin një numër shumë të madh objektesh, në të njëjtën mënyrë. Pra, një rrezik i dhënë prek një numër të konsiderueshëm objektesh duke krijuar kështu një bashkësi rreziku. Ekzistenca e një numri të madh rastesh, është një faktor i nevojshëm dhe shumë i rëndësishëm pasi lejon që, nga kompanitë e sigurimit të mblidhen të dhëna, të cilat më pas përpunohen sipas teorive matematikore dhe statistikore, që gjejnë zbatim në fushën e sigurimeve. Falë përpunimit të të dhënave, siguruesi arrin të krijojë një mendim për shpenzimet, që do t'i duhet të përballojë për një kategori të caktuar rreziqesh dhe të llogarisë, më pas, edhe primin. Ekzistenca e një numri të madh rastesh, bën që mundësitë e shmangies nga e papritura të jenë më të mëdha dhe që siguruesi të priret të ofrojë sigurim në një fushë të caktuar.

Së dyti: rreziqet ngjajnë me njëri-tjetrin për sa i takon madhësisë dhe llojit. Rreziqe të krijuara në rrethana të njëjta ose të ngjashme, kanë pasoja të njëjta ose të ngjashme. Homogjeniteti i rrezikut ndihmon shoqëritë e sigurimit në përpunimin e të dhënave dhe llogaritjen e përafërt të shpenzimeve, që do t'u duhet të përballojnë. Mbulimi i rreziqeve heterogjene e bën më të vështirë për siguruesin të përcaktojë madhësinë dhe koston e tyre. Prandaj, një praktikë e këshillueshme për siguruesin, është të risigurojë pjesërisht, rreziqet e panjohura, kryesisht për atë pjesë, që nuk përafron me rreziqet, që mbulon në përgjithësi shoqëria. Kështu, siguruesi mban për veten e tij vetëm atë pjesë të sigurimit, që ai mund ta kategorizojë në njërën prej kategorive të sigurimit, që ofron, duke bërë të mundur edhe përpunimin e të dhënave të këtij rasti së bashku me rastet e tjera. Homogjenizimi i rreziqeve realizohet nëpërmjet kategorizimit të tyre, në funksion të klasave dhe veprimtarisë së shoqërisë. Pra, shoqëria mund të krijojë një grup me rreziqet e pronës dhe, brenda këtij grupi, të dallojë rreziqet, që lidhen me pronat industriale nga rreziqet, që lidhen me shtëpitë e banimit.

Sipas Bakraçi, teoria e sigurimit përcakton disa elemente, që e bëjnë një rrezik të sigureshëm:

- Ekziston mundësia, që rreziku i siguruar të realizohet ;
- Nga ky rrezik duhet të shkaktohet një dëm ekonomik;
- Rreziku duhet të jetë i rastësishëm, i papritur;
- Rreziku duhet të jetë i pavarur nga vullneti i të siguruarit ose i personit të tretë;
- Rreziku duhet të ketë karakter përsëritës dhe nuk duhet të jetë i izoluar;
- Rreziku duhet të jetë i përcaktuar, ose i përcaktueshëm dhe i matshëm;
- Rreziku duhet të jetë i shpërndarë në hapësirë dhe në kohë;
- Primi duhet të jetë ekonomikisht i pranueshëm, në përputhje me rrezikun e siguruar;
- Rreziku i siguruar duhet të jetë një veprimtari e ligjshme dhe e moralshme;
- Realizimi i rrezikut të siguruar duhet të sjellë dëme të konsiderueshme financiare.

Karakter i rastësor ose i papritur është, mbase, elementi më i rëndësishëm, në cilësimin e një rreziku, pasi kontrata e sigurimit mund të lidhet nga palët vetëm nëse rreziku, për të cilin kërkohet sigurim, nuk është realizuar ende. Një kontratë sigurimi nuk mund të ketë kurrësi për objekt një rrezik të realizuar tashmë. Pasiguria në ndodhjen e rrezikut eviton sigurimin e rreziqeve të qëllimshme, të shkaktuara nga vetë përfituesit e sigurimit dhe lejon përpunimin e statistikave, sipas ligjit të numrave të mëdhenj. Koncepti i pasigurisë nënkupton dyshim për të ardhmen dhe bazohet në mungesën e njohurisë, apo në njohuri joperfekte. Baza e riskut është mungesa e njohurisë (Guri et al., 2012, fq. 16). Përrjashtimi nga sigurimi i dëmeve të qëllimshme dhe njohja e mundësive, që një dëm të realizohet, i lejon siguresit të përcaktojë prime të përshtatshme dhe shmang rritjen artificiale të tyre, gjë e cila do të sillte si pasojë të fundit zvogëlimin në total të rreziqeve të siguruara.

Pasiguria mund të jetë e dy llojeve, absolute dhe relative (Bakraçi, 2007, fq. 118 - 119).

Pasiguria absolute ekziston në atë rast kur, nuk ekziston asnjë bindje se ngjarja e siguruar do të ndodhë gjatë periudhës së mbuluar me sigurim, për shembull, nëse një pronë do të përfshihet nga flakët gjatë periudhës, që ajo është e siguruar kundër zjarrit.

Pasiguria relative ekziston atëherë kur, dihet që ngjarja e siguruar do të ndodhë në një moment të caktuar, por ky moment është i panjohur, për shembull vdekja e personit, i cili ka një kontratë sigurimi për jetën.

Kompensimi i dëmeve, që janë pasojë e rreziqeve, të cilat nuk varen nga vullneti i njeriut, pengon spekulimin me aktivitetin e sigurimit. Në mënyrë të përgjithshme, sigurimet nuk vlejné, nëse i siguruari ose përfituesi është shkaktuesi i dëmit, ose nëse, rezulton që, i siguruari nuk i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të penguar realizimin e dëmit, ose për të zvogëluar pasojat e tij.

Në lidhje me karakterin përsëritës të rrezikut, vlejné të theksohen dy momente:

Së pari: nëse rasti nuk përsëritet, nuk ka nevojë ekonomike për sigurimin e pasojave të dëmshme. Edhe në rastet kur rreziku përsëritet, por kjo ndodh në një hark kohor shumë të gjatë, sigurimi është i pamundur, pasi nuk mund të identifikohet bashkësia e subjekteve të rrezikuara dhe nuk ekzistojné mundësi teknike për ndarjen e dëmit midis anëtarëve të bashkësisë. Përmendim këtu, rastin e rreziqeve të shkaktuara nga shpërthimi i një vullkani, i cili edhe mund të përsëritet, pas një periudhe kohore shumë të gjatë, çka bën që kompanitë e sigurimit të mos ofrojnë sigurime në këtë fushë. Nga praktika e deritanishme në vendin tonë, rezulton se kontratat e sigurimit të personit nuk i përfshijnë në përgjithësi rreziqet, që lidhen me shpërthimet nga vullkani (Hasneziri, 2011, fq. 56). Në rastin e Shqipërisë, një qëndrim i tillë i shoqërive siguroese nuk është shumë problematik, pasi Shqipëria është relativisht pak e ekspozuar ndaj këtij lloji rreziku.

Së dyti: nëse rasti përsëritet, atëherë është e mundur të matet shpeshtësia e dëmit, intensiteti i veprimeve, pasojat e tij, pra është e mundur që të mblidhen të dhëna statistikore. Përsëritja e

vazhdueshme e një ngjarjeje krijon mundësi që të përcaktohen me përafërsi ngjarjet e ardhshme, gjë që lejon edhe parashikimin e mjeteve të nevojshme për kompensimin e dëmeve të pritshme.

Sipas Bakraçit (fq. 120 – 121), përcaktueshmëria e rrezikut matet duke analizuar katër elementë:

- Shkakun: shkaku, që ka çuar në realizimin e dëmit, duhet të jetë i mundur për t'u përcaktuar dhe duhet të bëjë pjesë në kategorinë e shkaqeve të parashikuara për t'u mbuluar nga kontrata e sigurimit. Për shembull, në rastin e sigurimit të pronës, shkaku i shkatërrimit të saj, nuk mund të jetë zjarrvënia e qëllimshme;
- Kohën: rreziku duhet të ndodhë brenda afatit të vlefshmërisë së kontratës së sigurimit, në një moment, që mund të përcaktohet lehtë nëpërmjet disa faktorëve;
- Vendin: rreziku duhet të realizohet në një vend të përcaktuar saktë, për nga koordinatat dhe që është pjesë e territorit, në të cilin shtrin efektet e saj kontrata e sigurimit. Për shembull, në qoftë se një sigurim nga aksidentet vlen vetëm për territorin shqiptar, atëherë siguruesi nuk mban përgjegjësi në rast se i siguruari aksidentohet jashtë vendit;
- Shumën: në momentin e lidhjes së kontratës, siguruesi duhet të marrë informacion të mjaftueshëm për të krijuar një ide rreth shumës së dëmit, që mund t'i shkaktohet të siguarit nga realizimi i rrezikut. Shuma mund të përcaktohet, që në fillim të kontratës, për shembull, në kontratat për sigurimin e jetës ose kur vlera e rimbursueshme nga sigurimi parashikohet që në fillim në kontratë dhe nuk ndryshon, pavarësisht se dëmi mund të jetë më i rëndësishëm. Në mjaft raste, masa e dëmit përcaktohet me saktësi vetëm pasi dëmi ka ndodhur, për shembull, në rastin e sigurimit të personit kundër aksidenteve, dëmi mund të matet vetëm pasi ka ndodhur aksidenti dhe është përcaktuar shkalla e invaliditetit të personit.

Përcaktueshmëria e rrezikut, ndihmon siguruesin, që të caktojë masën e primit sa më drejt të jetë e mundur. Shtrirja e rrezikut në hapësirë dhe në kohë, nënkupton që rreziqet e siguruara nga një shoqëri,

për një klasë apo lloj rreziku të dhënë, të mos realizohen të gjitha në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend. Nëse të gjitha rreziqet realizohen në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën hapësirë, atëherë do të ishte i pamundur zbatimi i parimit të solidaritetit, që karakterizon aktivitetin e sigurimit, sipas të cilit siguruesi arrin të përballojë shpërblimin e dëmit të disa prej të siguruarve, falë mbledhjes së primeve të të siguruarve të tjerë, të cilët nuk pësojnë dëmtime dhe mbartin, kështu, një pjesë të dëmit, që u është shkaktuar të siguruarve të prekur nga realizimi i rrezikut.

Primi ekonomikisht i pranueshëm nënkupton që, nëse rreziku i ardhjes së dëmit për të një siguruar është më i vogël se sa për një tjetër, atëherë edhe primi, që ky i siguruar do të paguajë, duhet të jetë më i vogël. Kështu për shembull, nuk mund të paguajnë të njëjtin prim dy të siguruar, të cilët kanë lidhur një kontratë për sigurimin e pronës, ndërkohë që prona e njërit mbulon dyfishin e sipërfaqes, që mbulon prona e tjetrit.

Sigurimi nuk mund të mbulojë veprimtari të paligjshme, ose në kundërshtim me moralin si dhe me rendin publik. Dëmi, që i shkaktohet të siguruarit, duhet të jetë i konsiderueshëm, i rëndësishëm në atë masë sa i siguruari të mos ketë mundësi ta përballojë vetë, në të kundërt, subjekti nuk do të kishte interes të lidhte një kontratë sigurimi, me një shoqëri të specializuar në këtë veprimtari.

Që kontrata e sigurimit të lidhet, duhet të përcaktohet madhësia e rrezikut. Ky përcaktim përfshin njëherazi lëndën, që sigurohet dhe detyrimet e palëve. Vlera e detyrimit, për të cilin angazhohet siguruesi është ngushtësisht e lidhur me sjelljen e të siguruarit dhe respektimin prej tij, të të gjitha detyrimeve, detyrime që lidhen jo vetëm me pagimin e primeve, por edhe me sjelljen e të siguruarit në parandalimin e realizimit të rrezikut ose në zvogëlimin e pasojave të tij.

Vlerësimi real i rrezikut, madhësisë ose peshës, nëpërmjet marrëdhënies kontratore, e lejon siguruesin të bëjë parashikimet e nevojshme dhe të mbulojë në mënyrën e duhur shpenzimet, qoftë përsa i takon të siguruarit, qoftë përsa i takon nevojës për siguruesin, të risigurojë një pjesë të rrezikut.



Madhësia e rrezikut lidhet me karakterin dhe llojin e tij, me vendndodhjen e objektit të siguruar, me masat e marra nga i siguruarit etj. I siguruari ka detyrimin t'i japë siguruesit të gjitha informacionet e nevojshme, që lidhen me kontratën dhe me objektin e sigurimit. Përveç informacionit të dhënë, me iniciativën e vet, i siguruari duhet, gjithashtu, t'u përgjigjet plotësisht dhe qartësisht të gjitha pyetjeve, që mund t'i bëhen nga siguruesi, përpara lidhjes së kontratës, ose në momentin e ripërtëritjes së saj. Ky detyrim vlen edhe për informacione personale dhe të karakterit privat, nëse marrja e tyre është e nevojshme për lidhjen dhe zbatimin e kontratës<sup>9</sup>. Refuzimi i të siguruarit për të dhënë informacionin e nevojshëm dhe të kërkuar nga siguruesi, ose fshehja e këtij informacioni, mund të përbëjë shkak për prishjen e kontratës ose për zvogëlimin e masës së shpërblimit të paguar nga siguruesi.

Masa e dëmshpërblimit të parashikuar në kontratë është, në parim, një kufi maksimal, por dëmshpërblimi i paguar nga siguruesi mund të jetë edhe më i vogël, në varësi të kombinimit të disa faktorëve, ndër të cilët përmendim (Bakraçi, 2007, fq. 122 – 125):

1. Vlerën e sigurimit: sikundër e thamë edhe më sipër, vlera e objektit të siguruar është thelbësore për të përcaktuar masën e dëmshpërblimit, për të cilën siguruesi angazhohet kundrejt të siguruarit. Rrjedhimisht, nëse vlera e objektit të siguruar nuk është e përcaktuar materialisht, atëherë edhe vlera e rrezikut nuk mund të përcaktohet si duhet. Nëse vlerësimi i rrezikut është i pamundur, atëherë realizimi i veprimtarisë së sigurimit është, gjithashtu, i pamundur.
2. Kohëzgjatjen e sigurimit: nëse kontrata mbulon një periudhë kohore të gjatë, atëherë mundësitë, që rreziku të realizohet dhe siguruesi të paguajë shumën e parashikuar në kontratë, janë më të mëdha. Në përgjithësi, kontratat për të cilat vlera e dëmshpërblimit është shumë e madhe lidhen për afate të shkurtra. Përjashtim bëjnë kontratat për sigurimin e jetës dhe të shëndetit, kohëzgjatja

---

<sup>9</sup> Në rast se kërkohet të lidhet një kontratë sigurimi për jetën, atëherë, siguruesi ka të drejtë t'i kërkojë informacione të siguruarit për gjendjen e tij shëndetësore dhe për sëmundjet e ndryshme nga të cilat i siguruari mund të vuajë.

e të cilave është më e madhe, për arsye të përdorimit të dëmshpërblimit, për të përmbushur nevojat jetike të personit të siguruar ose të personave të tretë përfitues.

3. Shpeshtësinë e dëmit: shpeshtësia e përsëritjes së një rreziku në një periudhë kohore të caktuar, llogaritet duke pasur parasysh raportin e numrit të objekteve të dëmtuara me numrin e objekteve të siguruara. Ky raport, i cili shifrohet në përqindje, llogaritet duke marrë në konsideratë kontratat e sigurimit të të njëjtit lloj.
4. Forcën mesatare të dëmit: pasuritë e siguruara, në varësi të masës së vëllimit të tyre, e përballojnë rrezikun në mënyra të ndryshme. Megjithatë, është e mundur të llogaritet një mesatare dëmi, falë përpunimit statistikor të të gjitha rreziqeve. Në këtë mënyrë, është e mundur që, për një lloj pasurie, të përcaktohet me përafërsi masa e dëmit, që mund të pësohet, në qoftë se realizohet një rrezik i caktuar. Sa më e madhe të jetë forca e rrezikut, aq më i madh është dëmi. Pra, dëmi nuk mund të jetë i njëjtë në të gjitha rastet, pasi edhe rreziku i realizuar nuk është i njëjtë. Madhësia e dëmit paraqitet në përqindjen e dëmtimit të lëndës së siguruar.
5. Dëmin më të madh të mundshëm: në momentin e lidhjes së kontratës, siguruesi duhet të përcaktojë dëmin maksimal të mundshëm, i cili është i barabartë me vlerën maksimale të objektit të siguruar. Ky do të jetë edhe kufiri më i lartë i angazhimit të siguruesit. Në varësi të objektit të siguruar, përcaktimi me saktësi i vlerës së dëmit, që mund të shkaktohet, mund të jetë më i lehtë ose më i vështirë. Përcaktimi i vlerës së dëmit më të madh të mundshëm, është një element shumë i rëndësishëm për siguruesin, për të vendosur nëse do ta nënshkruajë apo jo kontratën, nëse do ta mbajë vetë të gjithë rrezikun, apo do të risigurojë ose bashkësigurojë një pjesë të tij.

### 2.3. Elementët e administrimit të rrezikut

Zhvillimi i aktivitetit të sigurimit nuk do të kishte interes, për një operator ekonomik, në qoftë se ai nuk do të mund të merrte masat e nevojshme për të menaxhuar, në mënyrën e duhur, rrezikun e siguruar. Një përkufizim i dhënë nga doktrina për menaxhimin e rrezikut, do të ishte: “Menaxhimi i rrezikut është procesi i identifikimit, matjeve dhe kontrollit ekonomik të rreziqeve, të cilat rrezikojnë pasuritë, të ardhurat, jetën njerëzore ose ndërmarrjet tregtare (Bakraçi, 2007, fq. 161 - 163).”

Ligjvënësi shqiptar, nga ana e tij, e ka përkufizuar menaxhimin e rrezikut si “tërësinë e metodave dhe e rregullave, që përdoren nga shoqëria e sigurimit për identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe administrimin e rreziqeve të mundshme, me qëllim shmangien e humbjeve financiare.<sup>10</sup>”

Menaxhimi i riskut nënkupton menaxhimin e ekspozimit ndaj dëmeve aksidentale, me qëllim minimizimin e efekteve negative të ekspozimit ndaj tyre, duke reduktuar madhësinë dhe frekuencën, me të cilën ato ndodhin (Guri et al., 2012, fq. 28). Aubert (Janar 2013, fq. 61) do të shprehej se nga këndvështrimi i siguresit, menaxhimi i riskut nënkupton:

- Vlerësimin e riskut.
- Parandalimin e tij.
- Zvogëlimin e tij ose zvogëlimin e pasojave financiare, që sjell ai.
- Tarifimin te klientët.
- Transferimin e asaj pjese të riskut, që nuk mund të përballohet prej siguresit.

Ndërsa, sipas Bakraçit, për të menaxhuar, në mënyrën e duhur, rrezikun e mbuluar me sigurim, një kompani duhet të ndjekë këto etapa.

Së pari: Operatori sigures duhet të identifikojë rreziqet ekzistuese. Ky identifikim vlen, si për subjektin (individin ose shoqërinë), që kërkon të sigurohet, ashtu edhe për objektin e siguruar. Kështu

---

<sup>10</sup> Neni 4 i ligjit nr. 52/2014 “Përkufizime”

për shembull, në qoftë se një kompani sigurimi ofron sigurim të jetës në rast aksidenti, atëherë, rreziku për të paguar do të jetë më i lartë për një person, i cili kryen shumë udhëtime me automjet, për arsye profesionale (për shembull, punonjësi i një picerie, që shpërndan pica me motor), se sa për një inxhinier informatike, i cili mund të punojë kryesisht në zyrë ose në shtëpi, duke reduktuar ndjeshëm kohën e kaluar në rrugë.

Po kështu, identifikimi i rrezikut duhet bërë edhe në këndvështrim të objektit të siguruar. Nëse një kompani ofron sigurim për një pronë (shtëpi, biznes etj.), situata nuk paraqitet njëloj për një pronë, e cila ndodhet në katet e ulëta të një godine dhe për një pronë, e cila ndodhet në katet e sipërme të saj. Apartamenti i ndodhur në katin e parë, ka më tepër mundësi të dëmtohet nga një përmbytje, sesa ai që ndodhet në katin e pestë, për shembull.

Identifikimi i rreziqeve i lejon operatorit të përshtatë ofertën e tij me kërkesat e tregut dhe me nevojat e subjekteve. Për subjektin, që kërkon të sigurohet, identifikimi i rrezikut është thelbësor, pasi, nga saktësia në identifikimin e rrezikut, varen edhe masat, që ai do të marrë për ta përballuar atë, si psh. të vendosë të sigurohet pranë një kompanie të specializuar ose të kursejë, apo krijojë një fond, që do të shërbejë për të përballuar rrezikun e ndodhur.

Në rastin kur rreziku ka ndodhur dhe kanë ardhur pasojat, nevojitet të analizohen shkaqet e tij. Analiza e shkaqeve të rrezikut është e nevojshme për operatorin siguries, për të parë nëse kushtet përmbushen, që ai të paguajë, apo nëse dëmi ka ardhur si rezultat i një shkakut tjetër të pambuluar nga sigurimi. Identifikimi i shkakut të rrezikut e ndihmon subjektin e siguruar, që të marrë masat e nevojshme që, rreziku, i ndodhur një herë, të mos përsëritet më.

Kompania siguruese mund t'i bëjë një sërë pyetjesh subjektit të siguruar dhe të kërkojë të marrë të dhëna për gjendjen e të mirave të siguruara, apo për situatën e vetë personit. Siguruesi mund të kërkojë që i siguruari t'i nënshtrohet një kontrolli mjekësor. Këto informacione e ndihmojnë kompaninë

për të krijuar një ide paraprake rreth masës së dëmit, që mund të shkaktohet (psh. nëse një shtëpi e siguruar ka brenda mobilje të shtrenjta). Falë këtyre informacioneve, operatori përcakton edhe masën e primit, që i siguruari duhet të paguajë. Siguruesi mund të ofrojë sigurim të pjesshëm, ose, në rastin më ekstrem, të refuzojë sigurimin e klientit, nëse rreziku është i asaj natyre dhe i atyre përmasave, që e lejojnë siguruesin të mendojë se ai do të ndodhë me siguri dhe se veprimi do t'i shkaktojë më tepër humbje sesa përfitime.

Në rastin e kompanive shqiptare të sigurimit, është konstatuar se ato kanë pasur vështirësi në realizimin e llogaritjeve të sakta, në veçanti për shkak të mungesës së njohurive të plota për tregjet. Një gjë e tillë ka sjellë si pasojë që, në mjaft raste, rezervat për dëmet e raportuara ose të ndodhura por jo të raportuara, të jenë përlllogaritje hamendësuese, dhe jo gjithmonë në përputhje me situatën reale (Kodra, 2009).

Së dyti: Operatori duhet të vlerësojë probabilitetin dhe humbjet e mundshme, në rast se ndodh rreziku i siguruar. Është e nevojshme të njihet dinamika e rreziqeve, madhësia dhe serioziteti i dëmeve të shkaktuara. Kështu për shembull, rreziqet, që mund të shkaktohen nga rënia e një zjarri, nuk janë të njëjta, nëse krahasohet një fabrikë tullash me një fabrikë, e cila prodhon plastmas apo fishekzjarrë. Siguruesi mund të pranojë të sigurojë një rrezik, i cili ka probabilitet të lartë të ndodhë, sepse dëmet e mundshme janë të kufizuara dhe humbjet në vlera jo të larta.

Vlerësimi i intensitetit të dëmit të mundshëm është i nevojshëm, sepse mënyra e trajtimit të dëmeve të vogla, të cilat paraqiten më shpesh dhe dëmeve të mëdha, nuk është e njëjtë. Një subjekt duhet të vlerësojë me kujdes dëmet e mundshme, që mund të shkaktohen nga kategori të ndryshme rreziqesh, për të vendosur se cilin lloj dëmi duhet të sigurojë, si dhe në çfarë mase apo për cilin lloj dëmi mund t'i përballojë vetë shpenzimet e shkaktuara. Nga ana e saj, edhe shoqëria siguruese, bën vlerësimin e

rrezikut, duke analizuar cilësitë e objektit të siguruar, ose gjendjen e individit, (moshën, profesionin, gjininë etj.), kur vendos të sigurojë jetën e një subjekti.

Sjellja e të sigurvearit është një element shumë i rëndësishëm për vlerësimin e një rreziku. Një tjetër element, që ndikon në vlerësimin e rrezikut dhe zgjedhjen e një kompanie siguruese nga ana e subjekteve, është mundësia për të ndryshuar kushtet e kontratës, ose për të hequr dorë prej saj. Një person do të jetë më i prirë të lidhë një kontratë sigurimi, nëse siguruesi garanton që ecuria e mirë gjatë një periudhe të caktuar, do të lejojë uljen e primit për periudhën në vijim. Si shembull të ecurisë së mirë të një kontrate mund të përmendim mungesën e aksidenteve në rast të sigurimit në transport.

Së treti: Siguruesi duhet të aplikojë metodat dhe të përzgjedhë mjetet më efikase, për të mbuluar rrezikun e siguruar. Kështu për shembull, nëse masa e shpërblimit, që do të paguhet në rast dëmi, është shumë e madhe, operatori sigurues mund të vendosë të mbulojë me risigurim një pjesë të kontratës. Operatori mund, gjithashtu, të parashikojë në kontratë që, një pjesë e dëmit do të përballohet nga vetë subjekti dhe që, sigurimi do të funksionojë vetëm, nëse dëmtimi kap vlera më të larta se sa kjo shumë.

Ndër metodat e menaxhimit të rrezikut, gjejmë dy kategori kryesore (Bakraçi, 2007, fq. 167 – 169):

- atë të kontrollit fizik;
- atë të kontrollit financiar.

Metodat e kontrollit fizik janë më të kapshme për të sigurvearin, pasi ato kanë të bëjnë me veprimet dhe masat, që i siguruari mund të marrë për të shmangur apo për të zvogëluar rrezikun. Jo çdo lloj rreziku mund të shmanget, për shembull, në rastin e sigurimit të jetës, është e sigurt që personi i siguruar do të vdesë një ditë. Rreziku mund të zvogëlohet, nëse subjekti i siguruar ndërmerr disa hapa, për shembull, nëse një punëdhënës siguron kushte të përshtatshme pune, ai mund të zvogëlojë rrezikun e aksidentimit të punonjësve. Masat e kontrollit mund të zvogëlojnë shpeshtësinë e dëmit ose madhësinë e tij.

Kontrolli financiar i rrezikut lidhet me sigurimin e mjeteve financiare të nevojshme për të përballuar pasojat e krijuara nga ardhja e dëmit. Ai mund të bëhet duke e vetëmbajtur rrezikun, duke e siguruar atë te një shoqëri e specializuar në sigurime, ose duke e transferuar. Si rast transferimi të rrezikut mund të përmendimin marrëveshjen, që mund të lidhet midis prodhuesit të një sendi dhe blerësit të tij, në të cilën parashikohet që prodhuesi merr përsipër të riparojë produktin e prishur.

Subjekti, i cili përballlet me një rrezik, bën një analizë të situatës për të parë nëse ai duhet të sigurohet pranë një kompanie sigurimi dhe për cilat rreziqe. Ofrimi i një sigurimi nga një shoqëri e specializuar në këtë fushë është, ngushtësisht, i lidhur me mjetet, që ka në dispozicion një subjekt, person fizik apo juridik, për të përballuar vetë shpenzimet, që rrjedhin nga ardhja e një rreziku të mundshëm. Në mjaft raste, nënshkrimi i një kontrate sigurimi është kusht thelbësor për të marrë një kredi apo për të përfutur nga një investim. Kështu, në rast se një person vendos të marrë një kredi për të blerë një apartament, banka, përveç kërkesës për të regjistruar një garanci hipotekore në favor të saj, mund t'i kërkojë individit të nënshkruajë një kontratë sigurimi për jetën ose për banesën, që do të blihet me kredinë e dhënë.

Kompani të ndryshme mund të gjykojnë më të përshtatshëm krijimin e një fondi rezervë për rastet e rrezikut, ose ngritjen e një mekanizmi siguries të brendshëm. Ky sistem sigurimi është më tepër i praktikuar nga grupet e mëdha, të cilat kanë, njëherazi, shumë elementë për të siguruar dhe disponojnë fonde të nevojshme për të përballuar një aktivitet sigurimi. Përmendim këtu shembullin e bankës Cr  dit Agricole, e cila ka krijuar brenda p  r brenda saj n  j struktur   sigurimi, q   mbulon kredit   e k  qija, p  r t   cilat klient  t paraqesin rrezikshm  ri p  r t   mos q  n   n   gjendje t   respektojn   afatet dhe kushtet e shlyerjes<sup>11</sup>. N   rastin e Cr  dit Agricole, banka ka krijuar n  j filial t   saj, objekti i aktivitetit t   s   cil  s   sht   sigurimi i kredive t   dh  na nga strukturat e ndryshme t   bank  s. Krahasuar me bankat e tjerat n  

---

<sup>11</sup> Marr   nga [www.credit-agricole.fr](http://www.credit-agricole.fr)

vende të ndryshme të Evropës, Crédit Agricole paraqet një veçanti, e cila ka të bëjë me strukturën organizative të saj, pasi ajo është e organizuar në disa nivele, të cilat kanë një lloj varësie njëra nga tjetra duke qënë, njëherazi, edhe të pavarura. Këto banka lokale zotërojnë, secila, një pjesë të kapitalit të Shoqërisë Aksionare Crédit Agricole, e cila është struktura qendrore më e lartë dhe që federon të gjitha bankat lokale. Krijimi i strukturës qendrore i jep aktivitetit qëndrueshmëri, pasi është kjo strukturë, që koordinon aktivitetin e bankave lokale midis tyre dhe që shërben edhe si pikë kontakti dhe përfaqësimi ndaj strukturave të jashtme dhe ndaj të tretëve.

Filiali i krijuar nga Credit Agricole në Francë, për ushtrimin e aktivitetit të sigurimit të kredive të dhëna nga kjo bankë, quhet CAMCA. Funksionimi i sigurimit CAMCA u nënshtrohet disa kriterëve. CAMCA zbatohet për ata kreditorë, të cilët mund të kërkojnë kredi personale, apo për aktivitet biznesi dhe që kanë aftësi paguese relativisht të mira. Në këtë pikë gjen zbatim një prej parimeve, që rregullojnë aktivitetin e sigurimeve, sipas të cilit kompanitë zgjedhin të sigurojnë ato objekte apo ato subjekte, për të cilat probabiliteti i realizimit të rrezikut të siguruar nuk është shumë i lartë. Për të përcaktuar nëse një kredi do të hyjë apo jo në kategorinë e kredive të siguruara nga CAMCA, banka bën një analizë të thelluar të disa faktorëve, ndër të cilët, më i rëndësishmi, është raporti i të ardhurave dhe pasurive, që ka subjekti, me detyrimet, që duhet të përballojë ai, në një hark kohor të caktuar (kryesisht periudha njëvjeçare). Ndër këto detyrime hyjnë kreditë e tjera, që janë marrë dhe janë duke u shlyer nga klientët, detyrimet fiskale, pensionet në favor të personave në ngarkim etj. CAMCA siguron shlyerjen e një kredie në masën 100% të detyrimit të papaguar nga klienti. Pra, nuk ka asnjë prag, nën të cilin banka duhet të përballojë humbjen me fondet e saj.

Por, nga ana tjetër, CAMCA paguan, për pjesën e pashlyer të kredisë, vetëm në rast se nuk ka më asnjë garanci, që mund të përdoret nga banka. Si rregull, në çdo rast, kur një person apo një shoqëri merr një kredi pranë Crédit Agricole, ai i paraqet bankës garanci të ndryshme, të cilat mund të jenë garanci



personale (nëpërmjet një të treti), ose pasurore (në formë garancie hipotekore etj.). Në rast se, për një arsye apo për një tjetër, përdorimi i këtyre garancive nuk mjafton për të mbuluar pjesën e kredisë, që nuk është shlyer ende, atëherë banka i drejtohet filialit të saj CAMCA për të paguar këtë shumë në kuadër të ekzekutimit të kontratës së sigurimit.

Së katërti: Siguruesi duhet të bëjë hulumtime të vazhdueshme, për sa i takon paraqitjes së rrezikut dhe efekteve të ardhura si pasojë e tyre. Duhet gjithashtu, që ai të bëjë vlerësimet e nevojshme, për të marrë vendimet e mëtejshme, për llojin e sigurimit, që mund të ofrojë, për sasinë e sigurimeve, që do të pranojë, për risigurim e pjesshëm të tyre. Nga ana tjetër, edhe i siguruari duhet të bëjë kërkime, pasi sigurues të ndryshëm ofrojnë tarifa dhe kombinime sigurimesh të ndryshme (Bakraçi, 2007, fq. 161).

## **2.4. Karakteristikat e kontratës së sigurimit**

Kontrata e sigurimit, është një kontratë, nëpërmjet së cilës një ose disa persona, marrin përsipër, për një periudhë të caktuar, rrezikun e një ose disa ngjarjeve të rastësishme, ndaj të cilave mund të ekspozohet një send, kundrejt një çmimi, që pala tjetër në kontratë detyrohet të paguajë (Grun dhe Joliat, 1828, fq. 14). Kontrata është ligji i shkëmbimit, një akt i cili rrjedh nga përputhja e vullnetit të palëve. Çdo kontratë ka të bëjë me mbrojtjen e arsyeshme, të interesave, që presin të realizojnë palët në të, pa qënë e nevojshme të parashikohen kushte rënduese, në mungesë të vullnetit të palëve për të bërë një gjë të tillë. Përputhja e vullneteve duhet të jetë diçka konkrete dhe jo empirike (Tutulani – Semini, 2006, fq. 37 – 39). Përputhja e vullnetit të palëve, shihet si një element thelbësor në marrëdhënien kontratore në vende të ndryshme të botës (Tian, Korrik – Shtator 1998, fq. 890). Teoria e autonomisë së vullnetit ka lindur në shekullin e XIX<sup>të</sup> dhe e trajton këtë koncept në tre drejtime kryesore (Tutulani – Semini, 2006, fq. 40 – 41):

- Drejtimi filozofik: sipas këtij drejtimi, njeriu është një qenie e lirë nga natyra dhe, si e tillë, duhet të ketë mundësinë të krijojë çdo lloj marrëdhënieje juridike.
- Drejtimi moral: kontrata duhet të jetë e drejtë, në interes të të dyja palëve. Nëpërmjet hyrjes në marrëdhënien juridike, palët plotësojnë diçka në favor të tyre.
- Drejtimi ekonomik: autonomia e vullnetit duhet të përputhet me realizimin e interesave ekonomike (pasurore ose jopasurore) të palëve në kontratë.

Autonomia e vullnetit është vërtet e plotë vetëm në rast se të treja këto drejtime realizohen në të njëjtën kohë.

Objekti i kontratës së sigurimit janë të gjitha veprimet në lidhje me pagimin e primit nga i siguruari dhe të shpërblimit të dëmit nga siguruesi, si dhe vetë pagimi i shumave të primit dhe të shpërblimit (Semini – Tutulani 2, 2006, fq. 178). Kontrata e sigurimit bën pjesë në kategorinë e kontratave të dyanshme, pasi mbi bazën e kësaj kontrate, të dyja palët marrin detyrime kundrejt njëra-tjetrës (Semini – Tutulani, 2006, fq. 96). Njëra palë nuk mund t'i kërkojë palës tjetër të përmbushë një detyrim, ndërkohë që ajo nuk ka përmbushur detyrimin e saj. Radha e përmbushjes së detyrimeve, në rastin e kontratës së sigurimit është qartësisht e përcaktuar, pasi siguruesi përgjigjet për dëmin e shkaktuar, vetëm nëse i siguruari ka përmbushur detyrimin e tij për pagimin e primit dhe ka provuar dëmin e pësuar.

Përveç karakteristikave të përgjithshme, që i gjejmë në çdo lloj kontrate (si për shembull kapaciteti i palëve për të kontratuar, ekzistenca e një shkaku të ligjshëm etj.), kontrata e sigurimit paraqet disa karakteristika të veçanta, që lidhen, në mënyrë specifike, me marrëdhënien juridike, që ajo rregullon. Një policë sigurimi është (Guri et al., 2012, fq. 181):

- Kontratë dëmshpërblimi;
- Kontratë e kushtëzuar;

- Kontratë që përfshin ngjarje të papritura dhe shkëmbim të pabarabartë;
- Kontratë e patransferueshme;
- Kontratë në mirëbesim;
- Kontratë detyruese (ose thënë ndryshe kontratë adezioni).

Lidhja e Kontratës së sigurimit, e cila është një kontratë formale, nuk varet vetëm nga natyra dhe karakteristikat e angazhimeve, që marrin palët kundrejt njëra-tjetrës, por edhe nga cilësitë personale të të sigurvearit. Pra kontrata e sigurimit është një kontratë *intuitu personae*. Një kontratë quhet e tillë, kur konsiderata/vlerësimi për personin, me të cilin lidhet kontrata, përbën një element thelbësor të angazhimit (Moore, Janar 1998, fq. 383).

Kontrata e sigurimit konsiderohet si një kontratë adezioni ose kontratë aderimi, për arsye se termat e saj hartohen, në pjesën më të madhe të rasteve, nga sigurveasi, i cili ia paraqet ato të sigurvearit. Kodi Civil shqiptar, në nenin 1114 të tij, e ka trajtuar kontratën e sigurimit si kontratë adezioni, pasi ka parashikuar që kontrata e sigurimit hartohet nëpërmjet policës së sigurimit, që sigurveasi i lëshon të sigurvearit.

Kontrata e sigurimit është kategorizuar nga doktrina si kontratë adezioni, pavarësisht se doktrina nuk ka dhënë një përkufizim të pranuar në mënyrë unanime të termat “kontratë adezioni” dhe pavarësisht se kjo kontratë është personalizuar si rrjedhojë e karakterit të saj *intuitu personae* (Moore, Janar 1998, fq. 385). Ky fakt ka bërë, që kjo kontratë të preket pashmangshmërisht nga debate, që lidhen me cënimin e autonomisë së vullnetit të të sigurvearit. Kur bëhet fjalë për të parë nëse autonomia e vullnetit të njëjës palë cënohet apo jo në një kontratë adezioni, studiuesit nuk janë të gjithë të të njëjtit mendim.

Grupi i parë mendon që autonomia e vullnetit të palës, që nuk merr pjesë në redaktimin e kontratës, cënohet pasi kjo palë nuk e shfaq vullnetin e saj, në zgjedhjen e termave të kontratës, por

pranon kushtet e vendosura nga pala tjetër. Rrjedhimisht, palët në kontratë nuk janë në pozitë të barabartë.

Grupi i dytë mendon që autonomia e vullnetit të palës, që nuk merr pjesë në redaktimin e kontratës nuk çënohet, pasi kjo palë gëzon lirinë e të zgjedhurit, nëse do ta nënshkruajë apo jo kontratën. Në mungesë të këtij vullneti kontrata nuk lidhet dhe marrëdhënia juridike nuk krijohet (Hasneziri, 2011, fq. 15).

Vetë Hasneziri është i mendimit se, në mënyrë që autonomia e vullnetit të palës, që nuk merr pjesë në hartimin e kontratës (autonomia e vullnetit të të sigurvearit në rastin tonë), të mos çënohet, duhet që të ekzistojë konkurrenca e lirë në treg dhe të mos ndodhemi në kushtet e monopolit.

Për mendimin tim, fakti që pala, e cila nuk merr pjesë në redaktimin e kontratës, zgjedh në mënyrë të pavarur nëse do ta lidhë kontratën apo jo, nuk mjafton për të konsideruar, që vullneti i saj nuk çënohet. Ekzistenca e konkurrencës së lirë dhe mungesa e monopolit është padyshim një kusht, që ndihmon në respektimin e autonomisë së vullnetit të palës johartuese të kontratës. Ky kusht, në vlerësimin tim, do të kategorizohet si objektiv, pasi nuk ka lidhje me situatën specifike të një individi. Por, të tjerë faktorë, të karakterit subjektiv, mund të ndikojnë në sjelljen dhe vendimmarrjen e palës, që nuk merr pjesë në hartimin e kontratës, dhe të çënojnë në një farë mase autonominë e vullnetit të saj. Kështu për shembull, në rast se një individ kërkon të marrë një kredi bankare, për të realizuar një investim të nevojshëm dhe të rëndësishëm për të, banka, e cila jep kredinë, do të kërkojë që kredimarrësi të lidhë një kontratë për sigurimin e kredisë së marrë ose të pronës së blerë me shumën e kredisë. Duke qënë se, kontrata e sigurimit është e lidhur ngushtësisht me marrjen e kredisë, autonomia e vullnetit të palës jopjesëmarrëse në hartimin e kontratës do të jetë më e kufizuar. Një gjë e tillë, është edhe më e theksuar në rast se organizmi kredidhënës është njëherazi edhe siguruesi.

Mbrojtja e autonomisë së vullnetit të palëve në kontratë, është gjithashtu një argument, i cili është përdorur nga autorë të ndryshëm për të kundërshtuar krijimin e një Kodi Civil evropian (Lequette, Nëntor 2003, fq.101 – 102). Këta autorë, mendojnë që krijimi i një Kodi Civil, të njëjtë për të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, do të çenojë të drejtën e palës, që lidh një kontratë sigurimi, për të zgjedhur lirisht ligjin, të cilit do t'i nënshtrohet kontrata, në veçanti në rastet kur palët nuk ndodhen në të njëjtin shtet.

## **2.5. Kontrata e sigurimit sipas sistemit anglo-sakson**

Sistemi common law, e shikon kontratën e sigurimit në kuptimin juridik dhe në atë ekonomik. Ai e përkufizon sigurimin si transferim, në mënyrë të barabartë të riskut dhe humbjeve, në këmbim të pagesës. Në mënyrë që risku të jetë i sigureshëm dhe që kontrata të lidhet në vendet anglo-saksone, ai duhet të paraqesë disa karakteristika (Hasneziri, 2011, fq. 68 – 70):

- Duhet të ekzistojë një numër i madh rastesh, si ai ndaj të cilit është i ekspozuar subjekti, që kërkon të sigurohet.
- Humbjet duhet të jenë të përcaktuara saktë.
- Humbjet duhet të jenë aksidentale ose rastësore.
- Humbjet duhet të jenë të dukshme.
- Çmimi i primit të sigurimit duhet të jetë i përballueshëm.
- Humbjet duhet të jenë të llogaritshme.
- Rastet/rreziqet e sigurimit duhet të jenë të kufizuara.

Ekzistojnë gjithashtu, edhe disa kushte ligjore, për lidhjen e kontratës sipas sistemit common law.

- Duhet të ekzistojë interesi i sigureshëm.
- Rasti i sigurimit duhet të jetë i përcaktuar qartë.

- Palët duhet të jenë në mirëbesim.
- I siguruari duhet të paguajë primin.
- Siguruesi duhet të paguajë dëmshpërblimin, në rast se rreziku realizohet.

Shihet qartë se, karakteristikat e kontratës së sigurimit dhe kushtet për lidhjen e saj janë të njëjtat si në sistemin civil law ashtu edhe në atë common law.

Doktrina angleze ka përcaktuar një sërë parimesh, të cilat prej vitesh janë pjesë e sistemit juridik anglez dhe ndikojnë në mënyrën e rregullimit të marrëdhënieve midis palëve (Grun dhe Joliat, 1828, fq. 23 – 25):

- Kontrata e sigurimit nuk është një veprimtari basti, rrjedhimisht kontrata është e pavlefshme dhe konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar ndonjëherë, në qoftë se i siguruari nuk provon interesin, që ka për sendin e siguruar.
- Kontrata e sigurimit nuk është një kontratë blerjeje. Ky fakt shpjegon pamundësinë e të siguarit për të siguruar një të mirë, për një shumë më të madhe se sa vlera e saj reale si dhe pamundësinë, për të përfituar, në momentin e realizimit të rrezikut, një shumë më të madhe se sa vlera reale e dëmit të shkaktuar. I siguruari mund të sigurojë vetëm atë çka ai rrezikon të humbasë, nëse ngjarja e siguruar realizohet, por jo më shumë. Për këtë arsye, edhe në rast se ekzistojnë disa kontrata sigurimi për të njëjtin send, shuma e sigurimit e pagueshme nga siguruesit, nuk mund të tejkalojë vlerën reale të objektit të siguruar.
- Kontrata e sigurimit është një kontratë e personalizuar, në të cilën personaliteti i të siguarit luan një rol kyç (Hasson, Dhjetor 1985, fq. 418).

Disa autorë kanë konsideruar që funksioni dhe dobia e kontratës së sigurimit mund të cënohen për shkak të të drejtës së siguruesit, që ka dëmshpërblyer personin e siguruar, t'i kërkojnë personit përgjegjës për shkaktimin e dëmit t'i kthejë atij shumën e paguar në formën e dëmshpërblimit (Hasson,

Dhjetor 1985, fq. 428). Kërkimi i kthimit të shumës, nëpërmjet kësaj rruge, është cilësuar si një mënyrë e tërthortë me anë të së cilës një sigurues (siguruesi i personit të dëmtuar) shpërblehet nga një tjetër sigurues (siguruesi i përgjegjës për shkaktimin e dëmit).

Një mënyrë tjetër e konceptimit të kontratës së sigurimit mund të ishte kontrata e kredisë. Kontrata e sigurimit ka disa elementë të përbashkët me kontratën e kredisë, përsa i takon vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimit, mënyrës së pagimit të primit me këste, zgjatjes së kohës së vlefshmërisë së kontratës nëpërmjet rritjes së numrit të kësteve dhe shtyrjes së afatit të pagimit të tyre apo përsa i takon shumës së paracaktuar, që siguruesi i derdh të siguruarit në rastet e kontratës së sigurimit të jetës. Megjithatë, ligjvënësi komunitar ka përcaktuar se kontrata të tilla ofrojnë kushte kontratore, modalitete dhe sjellje të palëve të ndryshme nga kreditë konsumatore të rregulluara nga Direktiva 2008/48/CE (Teliti, 2013, fq. 66).

## **2.6. Konceptimi i jetës si një element që mund të sigurohet**

Zhvillimi i shoqërisë moderne, ka sjellë me vete rritjen e jetëgjatësisë mesatare të njerëzve dhe shtimin e kërkesave për të bërë të mundur ruajtjen e një standarti të lartë jetese, për veten dhe të afërmit e tyre. Kështu, zgjatja e jetës së njeriut ka diktuar gjetjen e rrugëve të ndryshme për të garantuar të ardhura të mjaftueshme, në mënyrë, që niveli i jetesës të mos ndryshojë pavarësisht faktit nëse një individ është i aftë apo jo të punojë, qoftë kjo për arsye shëndetësore, arsye moshe etj. Gjithashtu, individët janë përpjekur vazhdimisht të gjejnë mekanizma të ndryshëm, në mënyrë që të trashëgojnë pasurinë e tyre tek të afërmit, duke paguar sa më pak detyrime në favor të Shtetit. Ndekja dhe plotësimi i këtyre objektivave, është arritur të realizohet nëpërmjet lidhjes dhe ekzekutimit të një kontrate sigurimi mbi jetën.

Fillesat e sigurimit të jetës janë më të vona, sesa ato të sigurimit të aktivitetit tregtar. Nëse sigurimi i një të mire materiale ishte diçka lehtësisht e konceptueshme dhe që u pranua pa shumë vështirësi nga shoqëria, si pasojë e shkaktimit të dëmeve të rëndësishme nga fatkeqësi natyrore, sigurimi i jetës ka qënë një hap, që shoqëritë e zhvilluara kanë hezituuar ta hedhin. Franca paraqet në këtë drejtim, një model interesant për t'u studiuar pasi hezitimet përse i takon mundësisë së sigurimit të jetës së një personi kanë zgjatur për një periudhë relativisht të gjatë dhe kjo situatë ka qënë e vlefshme si përse i takon ligjvënësit ashtu edhe përse u takon studiuesve, që kanë trajtuar fushën e sigurimeve.

Rastet e para të sigurimit për jetën i gjejmë më tepër në formën e ndihmës midis anëtarëve të një shoqate, sesa si aktivitet sigurimi të mirëfilltë. Kështu, në rast se anëtari i një shoqate vdiste, pjesëtarët e tjerë i paguanin familjes së tij një shumë të caktuar në formë ndihme. Shuma e paguar përcaktohej nga nevojat e familjes dhe mundësitë e shoqatës.

Zhvillimi i tregtisë nëpërmjet rrugëve ujore i ka dhënë gjithashtu shtysë sigurimit për jetën. Kontratat e para për sigurimin e jetës janë lidhur nga detarë, të cilët rrezikonin të bëheshin robër në duart e piratëve, që sulmonin anijen. Në këtë mënyrë, detarët ishin të sigurt që, në rast se, për lirim të tyre, kërkohej pagimi i një shume, atëherë, kjo shumë do të shlyhej në kuadër të zbatimit të kontratës së sigurimit. Duke qënë se pagesa për këto kontrata nuk lidhej me karakteristika të vetë personit (si për shembull mosha), por me llojin e udhëtimit, nuk ekzistonin statistika për rrezikun e vdekshmërisë.

Kontrata e parë e sigurimit të jetës rezulton të jetë lidhur më 18 qershor 1536, në Britaninë e Madhe, nga William Gibbons (Bakraçi, 2007, fq. 38). Kjo ka qënë një kontratë me afat 1 vjeçar dhe me tarifë prej 400 funtash (rreth 2000\$), e nënshkruar nga 15 siguries. Gibbons vdiq më 29 maj 1537, pra rreth tre javë para përfundimit të kontratës. Siguriesit u detyruan të paguanin shumën e premtuar.

Fillimisht, kontratat e sigurimit të jetës lidheshin lehtë, pavarësisht karakteristikave të personave (moshës, gjinisë, profesionit). Duke parë që shumat e paguara ishin të konsiderueshme dhe që kushtet



për pagesë mund të plotësoheshin në çdo moment, siguruesit filluan të kërkojnë që, personat, të cilët lidhnin një kontratë për sigurimin e jetës së dikujt, të kishin një lidhje me personin e siguruar, pra të provonin ekzistencën e një interesi të sigurueshëm. Megjithatë, pavarësisht se kontrata nuk mund të lidhej pa u provuar ekzistenca e një interesi të ligjshëm, nuk ekzistonin rregulla të mirëfillta, të cilat të parashikonin ndërprerjen automatike të zbatimit të kontratës, në rast se në një moment të caktuar të vlefshmërisë së saj, i siguruari nuk arrinte më të provonte interesin e ligjshëm, që kishte ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës (Wright, Gusht 1886, fq. 145).

Duke qënë se nuk ekzistonin tabela vdekshmërie, fillimisht, primet e sigurimit për jetën nuk llogariteshin mbi bazën e një kriteri matematik. Tabela e parë e vdekshmërisë është përpiluar nga shkencëtari Edmond Halley në vitin 1693, në bazë të statistikave të mbledhura në qytetin Wroclaw të Polonisë, gjatë viteve 1687-1691. Në fakt, Edmond Halley nuk është studiuesi i parë që interesohet për shkaqet dhe numrin e vdekjeve në këtë periudhë. Fenomeni i vdekshmërisë është analizuar së pari, në Britaninë e Madhe, nga John Graunt, i cili ka bërë studime dhe ka mbledhur të dhëna mbi vdekshmërinë e popullsisë në Londër, të dhëna të cilat i ka pasqyruar në botimin me titull “Vëzhgime”, edicioni i parë i të cilit është botuar në vitin 1662. Graunt ka pasqyruar në përmbledhjen e tij të dhëna nga më të ndryshmet, si për shembull numrin e personave të cilët kishin vdekur për të njëjtën arsye, brenda një periudhe të caktuar, raportin e lindjes së bebeve meshkuj dhe femra për një periudhë të dhënë, raportin e meshkujve dhe të femrave në popullsinë e Londrës, numrin e personave, që lëviznin nga provincat në drejtim të Londrës. Të dhënat e mbledhura nga John Graunt janë një burim i çmuar informacioni për të kuptuar zhvillimin e shoqërisë dhe të aktivitetit tregtar në Londër gjatë shekullit të XVII.

Edmond Halley, nga ana e tij, konsideronte që Londra ishte një qytet shumë i madh dhe me një popullsi të paqëndrueshme, si pasojë e tendencës së banorëve të zonave përreth për t’u shpërngulur aty, për t’u marrë si shembull në kuadër të një studimi mbi vdekshmërinë. Ai vendosi atëherë të krijonte

tabelën e vdekshmërisë së një qyteti më të qetë, për sa i takon shpërnguljes së popullsisë dhe me një numër më të vogël banorësh, dhe zgjodhi qytetin Wroclaw të Polonisë. Halley konsideronte që të dhënat e tij do të ishin më të sakta, nëse ato nxirreshin nga studimi i popullsisë së një qyteti, ku ndryshimet ishin rezultat vetëm i faktorëve natyrorë (lindjes dhe vdekjes së banorëve). Wroclaw paraqiste gjithashtu edhe përparësinë e të pasurit të një dokumentacioni të rregullt dhe të plotë, për sa u takonte akteve të lindjes dhe të vdekjes së banorëve.

Tabelat e vdekshmërisë janë përpunuar dhe përmirësuar edhe më tej nga kompanitë e sigurimit, me zhvillimin në masë të veprimtarisë së sigurimit. Mbledhja e të dhënave, për një periudhë kohore më të gjatë, ka qënë një element thelbësor, që ka lejuar arritjen e rezultateve më të mira. Për krijimin e një tabele vdekshmërie të saktë, të dhënat duhet të mbulojnë një periudhë prej rreth 100 vitesh.

Në Angli, shoqata e parë e sigurimit të jetës u krijua më 1699 dhe mbante emrin “Society for the Insurance of Widows and Orphants”. Ndërsa siguruesi i parë, i cili ka filluar të marrë parasysh moshën e të sigurve për të caktuar masën e policës, që duhet të paguajë i siguruari, është shoqata me emrin “Equitable Society for the Assurance of Life and Survivorship” (Bakraçi, 2007, fq. 38).

Në vitin 1756, James Dodson ka publikuar një shkrim në lidhje me rregullat kryesore, të cilave duhet t’u përmbahet një kompani, për të ushtruar një aktivitet të qëndrueshëm dhe fitimprurës, në fushën e sigurimit të jetës. Ai ka nxjerrë në pah disa elementë, si për shembull, gjendjen shëndetësore të personit të sigurve, pagimin e një police fikse, pagimin e shumës pas vdekjes së të sigurve, ose pas konstatimit të një aksidenti, etj.

Ndryshe nga Anglia, Franca i shihte, në këtë periudhë, sigurimet për jetën si një aktivitet të dëmshëm dhe spekulues. Kështu, një Urdhër i Kolbertit, që ishte atëherë Sekretar i Shtetit për Marinën dhe Kontrollor i Përgjithshëm i Financave, e ndaloi aktivitetin e sigurimit për jetën në vitin 1681, për

arsye se konsiderohej si një veprimtari, që spekulonte mbi jetën e njeriut (Thérond, Qershor 2007, fq. 4).

Robert Joseph Pothier shprehej në punimet e tij se kontrata e sigurimit ishte një prej më të veçantave dhe më interesanteve, që kishte krijuar mendja e njeriut. Sipas tij, për shkak se ishte krijuar shumë më vonë sesa kontratat e tjera detare, kjo kontratë ishte ngritur menjëherë mbi këto kontrata dhe kishte tërhequr vëmendjen për nga thellësia e kombinimeve të përdorura, rëndësia e shërbimeve të ofruara, bukuria e rregullave, që përmbante dhe llojshmëria e pafundme e rasteve në të cilat ajo gjente zbatim (Elhabbouli, 2015, fq. 8).

Megjithatë, kur bëhej fjalë për sigurimin e jetës, po ky autor shprehej se, për shkak se funksioni i kontratës së sigurimit ishte që siguruesi të paguante vlerën e sendit të siguruar dhe se jeta e një njeriu të lirë nuk mund kurrsesi të vlerësohej materialisht, ajo nuk mund as të ishte objekt i një kontrate sigurimi<sup>12</sup>.

Me një vendim të Këshillit të Shtetit (ekuivalenti i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë), të datës 1787, në Francë u lejua zhvillimi i aktivitetit të sigurimit të jetës. Mund të themi që, në këtë periudhë lindi siguri i jetës në Francë. Kjo e drejtë nuk u ushtrua për një kohë të gjatë, pasi aktiviteti i sigurimit për jetën u ndalua sërish pas revolucionit të vitit 1789, nëpërmjet një dekreti të 24 gushtit 1793 (Thérond, Qershor 2007, fq. 4).

Për analogji, mund të themi se edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës zhvillimi i aktivitetit të sigurimit të jetës, është bërë me vështirësi, pasi policat e para të sigurimit në këtë fushë, të cilat ishin rezultati i zhvillimit të një aktiviteti të mirëfilltë sigurimi jete (i quajtur edhe siguri industrial), janë redaktuar në vitet 1875 – 1879. Siguri për jetën do të konsiderohej si siguri industrial në rast se tërësia e veprimeve, që çonin në lidhjen e kontratës, përmbushte njëherazi 4 kritere:

---

<sup>12</sup> Hicham Elhabbouli, “Le contrat d’assurance vie en droit comparé franco-marocain”, faqe 7. Këto qëndrime, Pothier i ka shprehur në shkrimin e tij “Traité du contrat d’assurance”, i cili është ribotuar në vitin 1810.

- mbështetëj në prime, të cilat paguheshin rregullisht;
- primet arkëtoheshin nga kompania ose një agjent i caktuar prej saj;
- shuma e sigurimit caktohej në varësi të primeve, që i siguruari ishte i gatshëm të paguante;
- sigurimi i ofrohej çdo anëtar të familjes, të marrë me vete, pa qënë e nevojshme, që të lidhej një kontratë sigurimi në emër të kryefamiljarit. (Hoffman, Shtator 1905, fq. 284 - 292).

Ligjvënësi francez e konsideronte kontratën për sigurimin e jetës si një kontratë shpërblimi, objekti i së cilës ishte të garantonte jetën e njeriut. Në këtë këndvështrim, jeta e njeriut konsiderohej se ishte një send, një objekt i çfarëdoshëm, të cilit mund t'i vihej një çmim dhe të cilit i kanosej rreziku i vdekjes. Filozofi i së drejtës franceze, Jean-Etienne-Marie Portalis, në ekspozenë e bërë për të paraqitur pjesën e kontratave të shitjes, të përfshirë në Kodin Civil francez, të miratuar në vitin 1804, do të shprehej në këtë mënyrë:

*“Ne e dimë që ekzistojnë disa vende, në të cilat, idetë e moralit të shëndoshë, janë nxirë dhe mbuluar kaq shumë nga një shpirt i ulët tregtar, sa lejojnë sigurimet për jetën e njerëzve... Njeriu nuk ka çmim: jeta e tij nuk mund të jetë objekt tregtie, vdekja e tij nuk mund të bëhet lëndë për spekulime tregtare. Këto lloj paktesh, për jetën apo vdekjen e një njeriu, janë të urryeshme dhe nuk mund të mos jenë të rrezikshme. Lakmia, që spekulon mbi ditët e një qytetari, është, shpesh, e afërt me krimin, që mund t'i shkurtojë këto ditë.”* (Justancia, 2005, fq. 5).

Si pasojë e një mentaliteti të tillë, Franca mori një vonesë të konsiderueshme në zhvillimin e sigurimit për jetën. Aktiviteti i sigurimit për jetën filloi të zhvillohej në mënyrë të qëndrueshme pas vitit 1818, kur Këshilli i Shtetit autorizoi lidhjen e kontratave për sigurimin e jetës. Kompania e Përgjithshme (Compagnie Générale) mori autorizimin për të ushtruar aktivitetin e sigurimit të jetës më 22 dhjetor 1819. Kodi Civil i vitit 1804, i cilësuar edhe si “Kushtetuta civile e Francës” (Lequette, Nëntor 2003, fq. 104) edhe pse fliste për sigurimin, e trajtonte kontratën e sigurimit në pjesën e kontratave me një

element rastësor dhe jo si kategori më vete<sup>13</sup>. Si rrjedhojë edhe e luftërave të shumta të zhvilluara nga Napoleoni, gjatë kohës që ai drejtonte shtetin francez, dëmet e shkaktuara nga veprimet luftarake u konsideruan si element, që mund të siguroheshin. Jo vetëm kaq, por Kodi tregtar francez, i miratuar më 1807, përmbante një klauzolë e cila parashikonte detyrimin për siguruesit të përfshinin luftën në kategorinë e risqeve të mbuluara nga sigurimi (Pouilloux, 2011, fq. 16).

Franca do të plotësojë legjislacionin e saj me një ligj për sigurimet më 13 korrik 1930, pra, pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Ligji i vitit 1930 ka transpozuar në të vërtetë rregullat e vendosura nga Këshilli i Shtetit me dy vendime gjyqësore të vitit 1888 dhe 1896, në të cilat ai shprehej se kreditorët e personit, që kishte lidhur kontratën e sigurimit, nuk kishin asnjë të drejtë mbi shumën e caktuar të paguhej si prim, që prej ditës kur ishte nënshkruar kontrata, pavarësisht se pagesa mund të realizohej në një moment më të vonë. Këshilli i Shtetit ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e sigurimit të jetës në Francë, pasi nëpërmjet vendimeve të sipërcituara ka interpretuar gjerësisht dispozitat e Kodit Civil të vitit 1804 (Elhabbouli, 2015, fq. 13), duke i hapur kështu rrugën një praktike që do të konsolidohej edhe në teprër në vitet në vijim. Ndërsa Kodi i Sigurimeve, në versionin që ekziston edhe sot, u miratua në vitin 1976<sup>14</sup>.

Zhvillimi me ritme të ndryshme i sigurimit të jetës, në të njëjtën periudhë, në vende me nivel ekonomik të përafërt, tregon që niveli i jetesës dhe mentaliteti janë elementë shumë të rëndësishëm dhe përcaktues për nënshkrimin e një kontrate sigurimi për jetën. Mbajtja e qëndrimeve në favor të zhvillimit të sigurimit të jetës është ndihmuar pashmangshmërisht edhe nga humbja e influencës së Kishës

---

<sup>13</sup> Kontrata e sigurimit trajtohej në nenin 1964 të Kodit. Në versionin e miratuar në vitin 1804, neni 1964 i Kodit Civil kishte këtë përmbajtje:

“Kontrata e rastësishme është një marrëveshje e përbashkët, efektet e së cilës, përsa u takon humbjeve dhe përfitimeve, janë, për të gjitha palët, për njërën ose disa prej tyre, të varura nga një ndodhi e pasigurt. Të tilla janë :

- Kontrata e sigurimit;
- Huaja për aventurën e madhe;
- Loja dhe basti
- Kontrata e rentës së përjetshme.

Dy kontratat e para rregullohen nga ligjet detare” ([www.legifrance.gouv.fr](http://www.legifrance.gouv.fr))

<sup>14</sup> Ligji i miratuar në vitin 1930, është integruar në pjesën e parë të Kodit të Sigurimeve të vitit 1976.

katolike, në Shtetin francez, humbje e cila u finalizua në vitin 1905 kur Franca, nëpërmjet një ligji të miratuar më 9 dhjetor, shpalli ndarjen përfundimtare të Kishës nga Shteti.

Në qëndrimet, që do të mbante pas miratimit të ligjit për sigurimet në vitin 1930, doktrina (Picard dhe Besson, 1938)<sup>15</sup> do të përkufizonte sigurimin për jetën si një “kontratë nëpërmjet së cilës, në shkëmbim të një primi, të vetëm ose periodik, siguruesi merr angazhimin t’i derdhë nënshkruesit të sigurimit, ose një personi të tretë të përcaktuar prej tij, një shumë në formë kapitali ose rente, në rast se personi i siguruar vdes ose nëse ai mbijeton tej një date të caktuar.” Është për t’u theksuar që as ligji i miratuar në vitin 1930 dhe as Kodi i Sigurimeve, nuk përmbajnë përkufizim të sigurimit për jetën.

Në analizë të kontratës së sigurimit për jetën, do të shprehesha se, në mendimin tim, caktimi i një shpërblimi në një kontratë sigurimi për jetën nuk është një çmim, që i vendoset jetës së të siguarit, por një shifër që i siguruari e cakton/ose e pranon<sup>16</sup>, nisur nga mendimi që kjo shumë do ta lejojë atë të jetojë në një nivel të lartë, ose në nivelin e jetesës së dëshiruar për përfituesit e shumës, kur bëhet fjalë për persona të tretë, në rast se të siguarit i ndodh diçka, pra në rast se rreziku i siguruar realizohet.

Megjithatë, kontrata e sigurimit të jetës, paraqet për mendimin tim, një karakter spekulues të dëmshëm dhe të kritikueshëm në rastet kur, lidhja e saj vjen si pasojë e marrjes së një huaje pranë një subjekti kredidhënës, i cili i imponon huamarrësit të lidhë një kontratë sigurimi për jetën në masën e kredisë së marrë, në mënyrë që në rast se rreziku realizohet huadhënësi të rimbursohet. Në këto raste, duket se jeta e të siguarit vlen aq sa është shuma e kredisë së marrë.

Pavarësisht se kontrata e sigurimit të jetës u bë pjesë e regjimit juridik francez, nocioni i rrezikut, në këto lloje kontratash është bërë objekt debatesh të vazhdueshme.

---

<sup>15</sup> Maurice Picard dhe André Besson, kanë trajtuar sigurimin e jetës në veprën e tyre “Les assurances terrestres en droit français”, vepër e cila është botuar disa herë, pjesë-pjesë ose e plotë, prej vitit 1938 e në vijim. I njëjti përkufizim është dhënë edhe nga Prof. Xhevat Bakraçi në veprën e tij “Menaxhmenti i rrezikut në sigurime”, faqe 56.

<sup>16</sup> Dallimi bëhet për rastet kur shuma e sigurimit kërkohet paraprakisht nga i siguruari, i cili pranon të paguajë çfarëdo lloj primi (rasti kur sigurimi përdoret për të transmetuar pasurinë nga i siguruari tek trashëgimtarët, me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore), nga rastet kur shuma e përfituar kushtëzohet nga primi maksimal, që i siguruari është i gatshëm të paguajë dhe llogaritet e propozohet nga shoqëria e sigurimit.

## 2.7. Rreziku në kontratat e sigurimit për jetën

Në kohët moderne, sigurimi i jetës konsiderohet sjellje e mençur e një ekonomisti të mirë të familjes, pasi një veprim i tillë, edhe pse kërkon një shpenzim fillestar, me kalimin e kohës kthehet në një përfitim të shumëfishtë (Qehaja, Dhjetor 2014, fq. 542). Pavarësisht se interesi i kontratës së sigurimit për jetën është pranuar gjerësisht, ekzistenca e një rreziku ose, ndryshe, e një mundësie për të ndodhur një veprim, që sjell rrezikun e siguruar, është një problematikë, e cila ka ngjallur shumë debat. Si mundet një kontratë e sigurimit për jetën të paraqesë elementë rreziku dhe pasigurie, sikundër i paraqet një kontratë tjetër sigurimi, kur dihet që personi i siguruar do të vdesë në një moment, qoftë ky moment i afërt apo i largët. Debati është bërë më i mprehtë me zhvillimin e formave të reja të sigurimit për jetën, që parashikojnë investimin e shumës së derdhur në formë primi, nga kompania e sigurimit, në një aktivitet tregtar dhe derdhjen e shpërblimit për të siguruarin, në funksion të investimit të kryer. Kodi Civil francez jep një përkufizim shumë të gjerë të kontratave me risk në nenin 1964<sup>17</sup>.

Një pjesë e doktrinës, kundërshton klasifikimin e kontratave të sigurimit për jetën në kategorinë e kontratave me element rreziku (Grimaldi, Aulagnier, Courtieu dhe Lambert-Faivre). Këta autorë, konsiderojnë që nuk ka rrezik në kontratën e sigurimit për jetën, veçanërisht, kur ajo shfaqet në formën e një investimi të bërë nga kompania e sigurimit, pasi të dyja palët e njohin masën e detyrimit, që do t'i derdhin njëra-tjetrës. Kështu, sipas tyre, siguruesi e di cila është shuma, që do të marrë nga i siguruari, pasi është vetë ai, që ka caktuar masën e primit. Por, edhe i siguruari, njeh masën e shpërblimit, që do të derdhet me mbarimin e kontratës, pasi kjo shumë lidhet ngushtë me primet e paguara dhe është e përcaktueshme që në fillim. Sipas këtyre autorëve, kontrata e sigurimit të jetës afron më tepër me një kontratë investimi, e ngjashme me depozitën bankare, se sa me një kontratë sigurimi.

---

<sup>17</sup> Në ndryshim nga formulimi i vitit 1804, neni 1964, në versionin që ekziston sot në Kodin Civil francez, nuk përmend më “huanë për aventurën e madhe”, e cila nuk ekziston më si institut juridik si dhe nuk përmban më parashikimin sipas të cilit kjo kontratë dhe kontrata e sigurimit i nënshtrohen ligjit detar.

Më konkretisht, Profesor Grimaldi shprehet se “i siguruari e di, që ai do të marrë mbrapsh shumën e primeve të paguara, dhe në mënyrë korrelative, siguruesi e di që do të derdhë shumën e primeve të përfituara. Thënë ndryshe, i siguruari është i sigurt që do të përftojë vlerën e fituar të kursimeve të tij, të gjithë këtë vlerë dhe vetëm këtë vlerë. Në një veprim të tillë nuk e shohim garancinë e siguruesit që lidhet me kohëzgjatjen e jetës së njeriut dhe as rastësinë, që është elementi thelbësor i një kontrate sigurimi.<sup>18</sup>” Grimaldi është gjithashtu i mendimit që, pasiguria që rrjedh nga identiteti i personit, në duart e të cilit debitori (siguruesi) do të ekzekutojë detyrimin e tij, nuk e bën aspak kontratën e sigurimit të rastësishme, sepse ky element nuk e prek ekuilibrin e kontratës (Justancia, 2005, fq. 19 - 21).

Aulagnier, nga ana e tij, konsideron që elementi rastësor nuk ekziston pasi në momentin e lidhjes së kontratës, palët e dinë sa është shuma, që do të paguajë siguruesi në momentin e mbarimit të kontratës. Nga ana tjetër, edhe i siguruari e di që shuma e caktuar në kontratë do të paguhet domosdoshmërisht nga siguruesi, ajo çka nuk dihet është vetëm se cili do të jetë personi përfitues. Në rast se i siguruari është ende gjallë kur mbaron kontrata, shuma do t’i paguhet atij personalisht, nëse ai vdes, shuma do të paguhet në favor të përfituesve të tjerë (trashëgimtarëve). Në këtë mënyrë, kontrata e sigurimit nuk është tërheqëse për të siguarin, sepse i lejon atij të mbrohet vetë, apo të mbrojë dikë tjetër nga pasojat e një ngjarjeje të rastësishme, por sepse ajo lejon të nxirret një fitim, në momentin kur ndodh, ose jo, veprimi i siguar. Kontrata e sigurimit i ngjan mjaft veprimtarisë së basteve (Justancia, 2005, fq. 37).

Ekziston gjithashtu edhe një grup i dytë studiuesish, i cili mban një qëndrim krejt ndryshe nga i pari dhe mjaft kritik, duke konsideruar, që analizimi i pasigurisë dhe riskut, që paraqet një kontratë sigurimi, vetëm në këndvështrimin e shumave të derdhura është një konceptim shumë ekonomik i kontratës së sigurimit, që nuk i jep rëndësinë e duhur aspektit juridik të marrëdhënies (Jacques Ghestin, Jean Bigot, Jerome Kullmann, Luc Mayaux dhe Véronique Nicolas).

---

<sup>18</sup> Shprehja e plotë është referuar nga Michel Justancia, në punimin e tij me titull “La requalification des contrats d'assurance vie” (2005) dhe është shkëputur nga vepra “Réflexions sur l'assurance vie et le droit patrimonial de la famille” e botuar nga Prof. Grimaldi në vitin 1994.



Sipas Profesorëve Ghestin dhe Billiau, pasiguria në një kontratë sigurimi, gjen zbatim për sa i takon ngjarjes së zgjedhur nga palët, pa qënë e nevojshme, që kjo ngjarje të ketë për pasojë fitimin apo humbjen e një shume, nga njëra palë. Pasiguria ka të bëjë vetëm me veprimin e siguruar, nëse ai është i njohur apo i panjohur nga palët në ditën e lidhjes së kontratës, fakt nga i cili varet edhe ekzekutimi i shërbimit të ofruar nga siguruesi në favor të personit të siguruar, apo të një të treti. Në një kontratë sigurimi, ky element është i lidhur ngushtë me kohëzgjatjen e jetës së të siguruarit, pasi vdekja e personit të siguruar, edhe pse është një veprim i sigurt në realizimin e tij, është i pasigurt për sa i takon datës se kur do të ndodhë (Justancia, 2005, fq. 21 - 25).<sup>19</sup>

Këta autorë shprehen, gjithashtu, se nga kohëzgjatja e jetës së të siguruarit rrjedhin disa pasoja mjaft të rëndësishme, të cilat e bëjnë kontratën e sigurimit të paraqesë elementë të mjaftueshëm pasigurie. Kështu për shembull, momenti i vdekjes së personit të siguruar, mund të ndikojë në shumën, që do të paguhet nga siguruesi ose në identitetin e personit, që do të përfitojë shumën e derdhur nga siguruesi. Këta elementë mjaftojnë për ta bërë kontratën e sigurimit një kontratë me elementë pasigurie.

Si përfundim, kjo rrymë e doktrinës shprehet se, përderisa jeta e një personi është element përbërës i një kontrate, kjo kontratë ka mjaftueshëm faktorë pasigurie dhe bën pjesë në kategorinë e kontratave të sigurimit. Argumentet e kësaj pjese të doktrinës janë ndjekur gjerësisht nga jurisprudenca, në vende të ndryshme të Evropës.

## **2.8. Pritshmëritë e palëve në kontratën e sigurimit**

Kontrata e sigurimit vullnetar, si të gjitha kontratat, është një marrëveshje e lidhur midis dy palëve, të cilat kanë pritshmëri të ndryshme lidhur me atë ç'ka ato do të përfitojnë nga e ekzekutimi i saj.

---

<sup>19</sup> Michel Justancia në studimin e tij me titull “La requalification des contrats d'assurance vie”, shprehet se ky qëndrim është mbajtur nga autorët Jacques Ghestin et Marc Billiau në punimin e tyre me titull “Contre la requalification des contrats d'assurance vie en contrats de capitalisation”, botuar në vitin 2001.

Përcaktimi i pritshmërive të palëve dhe vlerësimi i tyre, në veçanti në rast konfliktit, është element, i cili ka qënë objekt i shumë debateve në të drejtën amerikane të sigurimeve edhe më gjerë në sistemin anglo - sakson.

Robert E. Keaton (1970), shprehet se doktrina e pritshmërive të arsyeshme mbështetet në një arsyetim të përbërë nga dy drejtime:

- Siguruesit i duhet mohuar çdo avantazh i paarsyeshëm në një marrëdhënie sigurimi;
- Pritshmëritë e arsyeshme të aplikuesve për sigurim dhe të përfituesve të sigurimit, të parashikuara në një kontratë sigurimi, duhen respektuar, pavarësisht se një lexim i saktë i kontratës së sigurimit do të kishte për pasojë përjashtimin e këtyre pritshmërive (Swicher, 2000, fq. 733 – 735)<sup>20</sup>.

Keaton shprehet gjithashtu se, për të përcaktuar qëllimin e palëve, detyrimet e tyre dhe kuptimin e termave, që qëndrojnë në themel të mosmarrëveshjes, duhen përdorur disa rregulla interpretimi, të cilat prekin:

- Paqartësitë e kontratës;
- Elementët e paarsyeshëm të kontratës dhe problematikat, që lidhen me interesin publik;
- Zbatimin e zgjidhjeve të drejta, të cilat lejojnë edhe heqjen dorë nga kontrata, në fazën e lidhjes apo gjatë ekzekutimit të saj si dhe ndryshimin e termave të kontratës;
- Përdorimin e rregullave të tjera interpretuese, me qëllim standartizimin e kontratave të sigurimit.

Marc C. Rahdert (1998 – 1999), kundërshton qëndrimin e Keaton duke u shprehur se ky formulim sugjeron që palët mund të kenë pritshmëri, të cilat rrjedhin nga burime të tjera përveç tekstit dhe gjuhës së kontratës, të cilat mund të anashkalojnë parashkimet, për të cilat është rënë dakord në momentin e nënshkrimit të kontratës. Në këtë mënyrë, anashkalohej qëndrimi tradicional, përse i takon interpretimit

---

<sup>20</sup> Robert E. Keaton, “Insurance Law Rights”, 1970, sipas prezantimit që i është bërë kësaj vepre nga Peter N. Swisher në studimin e tij me titull “A realistic consensus approach of the Insurance Law Doctrine of Reasonable Expectations”, 2000, faqe 733 - 735.

të kontratave, sipas të cilit, të drejtat dhe detyrimet e palëve në një kontratë përcaktohen nga ajo çfarë ata kanë dakordësuar me shkrim (Swicher, 2000, fq. 733)<sup>21</sup>.

Një qëndrim të ngjashëm mban edhe Holmes (1996)<sup>22</sup>, i cili shprehet se teksti i shkruar, për të cilin palët kanë rënë dakord, presupozohet të shprehë qëllimin dhe dakordësinë e tyre të përbashkët, për të gjitha pikat dhe të ketë forcën e ligjit, për palët në kontratë. Nuk është funksioni i gjykatës të rishkruajë atë çka është thënë në kontratë, por të interpretojë kontratën në tërësinë e saj, në mënyrë të qartë dhe sipas kuptimit më të logjikshëm.

Holmes shprehet gjithashtu se pavarësisht rregullave të përgjithshme, që mund të përdoren për interpretimin e një kontrate sigurimi, në rast se një policë mund të lexohet në dy mënyra të ndryshme, në zbatim të doktrinë *contra preferentem*, paqartësia që rrjedh nga gjuha e përdorur, duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë dhe në disfavor të interesave të asaj pale, që ka redaktuar kontratën, pra në disfavor të siguresit. Ky qëndrim është përdorur shpeshherë nga gjykatat amerikane, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, edhe pse është ruajtur si mundësia e fundit, pas dështimit të përpjekjeve të gjykatave për të eliminuar paqartësitë. Megjithatë, Holmes nuk shprehet nëse i njëjti qëndrim duhet mbajtur apo jo në rast se pala, e cila nuk ka redaktuar kontratën, është profesionist i fushës (për shembull, në rast se bëhet fjalë për një kontratë risigurimi), ose në rast se i siguruari kishte mbështetje dhe ndihmë të mjaftueshme teknike dhe juridike, për të kuptuar drejt implikimet dhe pasojat e neneve dhe formulimeve të përdorura nga siguruesi në kontratë (Swicher, 200, fq. 736)<sup>23</sup>.

Sipas Carl A. Salisbury (1991), nëse bëhet një dallim midis palëve, që nuk marrin pjesë në redaktimin e kontratës, në varësi të aktivitetit, që ato ushtrojnë apo të madhësisë së strukturave të tyre, pasoja do të ishte që kompanitë më të mëdha, të cilat disponojnë struktura më të fuqishme, të paguhen

---

<sup>21</sup> Marc C. Rahdert "Reasonable expectations reconsidered", 1998-1999, sipas prezantimit që i është bërë kësaj vepre nga Peter N. Swisher në studimin e tij me titull "A realistic consensus approach of the Insurance Law Doctrine of Reasonable Expectations", 2000, faqe 733.

<sup>22</sup> Eric Holmes, "Holmes appleman on insurance law", 1996.

<sup>23</sup> Eric Holmes, "Restatement of contracts", 1932, sipas prezantimit që i është bërë kësaj vepre nga Peter N. Swisher në studimin e tij me titull "A realistic consensus approach of the Insurance Law Doctrine of Reasonable Expectations", 2000, faqe 736.

më pak sesa ato më të vogla, të cilat nuk kanë të njëjtat burime dhe mundësi, pavarësisht se kontratat e lidhura nga strukturat e mëdha trajtojnë zakonisht dëme dhe rreziqe më të rëndësishme, për të cilat paguhen prime me vlerë më të madhe. Ai parashtrohet gjithashtu se nuk ekzistojnë në kontratat e sigurimit, klauzola që të bëjnë dallimin midis klientëve të ndryshëm, dhe se një gjë e tillë nuk konsiderohet si objektiv nga kompanitë e sigurimit, edhe pse nuk është e ndaluar me ligj. Salisbury është i mendimit që ekzistenca e një strukture të madhe në një shoqëri, nuk e bën detyruesisht atë më të predispozuar për të kuptuar drejt të gjitha elementet e një kontrate sigurimi, për shkak të teknikitetit të kontratave të këtij lloji. Në përfundim ai shprehet se dallimi i klientëve, në varësi të madhësisë së tyre, për të përcaktuar nëse duhet apo jo të zbatohet për ta parimi *contra preferentem*, është një veprim i gabuar, i cili do të kishte për pasojë krijimin e ndarjeve artificiale, që do të dëmtonin qëllimin e aktivitetit të sigurimit. Të njëjtin pozicion ai e mban edhe për personat fizikë, duke u shprehur se fakti që një konsumator ka mbaruar studimet për drejtësi, nuk e bën atë njohës më të mirë të specifikave të veprimtarisë dhe kontratave të sigurimit, sesa një shtetas tjetër që ka studiuar një fushë të ndryshme (Swicher, 2000, fq. 739)<sup>24</sup>.

Jeffrey Stempel sugjeron disa kritere, që mund të përdoren nga gjykata, në rast se gjatë gjykimit të një çështjeje vendoset të pranohet qëndrimi mbrojtës i siguruesit, sipas të cilit, policëmbajtësi hyn në kategorinë e njohësve të fushës dhe të “klientëve të sofistikuar” (Swicher, 2000, fq. 739 – 740).

- Së pari: gjykata duhet të përcaktojë më saktësi identitetin e subjektit, që ka draftuar kontratën, nëse bëhet fjalë për një kontratë standarte, që siguruesi e propozon rregullisht, apo për një kontratë të personalizuar, në të cilën disa nene janë përpiluar në funksion të nevojave dhe situatës specifike të klientit dhe me pjesëmarrjen e tij.

---

<sup>24</sup> Peter N. Swisher, “A realistic consensus approach of the Insurance Law Doctrine of Reasonable Expectations”, 2000, faqe 739, sipas pozicionit të mbajtur nga Carl A. Salisbury në punimin e tij, “Pollution liability insurance coverage, the standard-form pollution exclusion, and the insurance industry: A case study in a collective amnesia”.

- Së dyti: gjykata duhet të vlerësojë përshtatjen e kontratës me situatën e të sigurvearit, për të arritur në konkluzionin nëse kontrata e lidhur është e personalizuar apo standarte.
- Së treti: gjykata duhet të marrë informacion nëse policëmbajtësi ka pasur ose jo asistencën e një avokati në momentin e negocimit dhe lidhjes së kontratës.
- Së katërti: gjykata duhet të marrë në konsideratë praninë ose jo të brokerit në procedurën e lidhjes së kontratës.
- Së pesti: gjykata duhet të vlerësojë kontratën në tërësi për të parë nëse termat, mbi bazën e të cilave ka lindur mosmarrëveshja, janë vërtet të paqartë.
- Së gjashti: gjykata duhet të vlerësojë nëse kontrata dhe angazhimet, që rrjedhin prej saj, janë kuptuar ose jo drejt nga palët, duke analizuar sjelljen e tyre dhe qëndrimin e mbajtur si me gojë ashtu edhe nëpërmjet dokumentave të shkruara.
- Së shtati: gjykata duhet të analizojë pritshmëritë që do të kishte policëmbajtësi, në situatën ku nga ana e tij nuk është kryer asnjë veprim me faj, i cili të çenojë vlefshmërinë e pjesshme apo të plotë të angazhimeve të marra nga palët.
- Së teti: gjykata duhet të bëjë vlerësimet e veta duke konsideruar që midis palëve ka ekzistuar gjithmonë një marrëdhënie e vërtetë sigurimi, pra që nuk bëhet fjalë për një kontratë fiktive.
- Së nënti: gjykata nuk duhet të injorojë praninë e elementëve, që nuk janë karakteristikë në një marrëdhënie sigurimi.
- Së dhjeti: gjykata duhet të vlerësojë nëse, në mungesë të elementëve të tjerë provues, përdorimi i teorisë *contra preferentem* është diçka e drejtë ose jo.
- Së fundi: gjykata duhet të mbajë në konsideratë vendin që doktrina i jep faktit që policëmbajtësi ka njohuri nga fusha e sigurimit.

Mbi bazën e studimeve të doktrinės, por edhe nga praktika gjyqësore, është arritur në konkluzionin se, në zgjedhjen e tyre se cili pozicion duhet të prevalojë mbi tjetrin, ai i siguresit apo ai i të siguruarit, në rast mosmarrëveshjeje midis palëve, gjykatat u referohen këtyre parimeve (Swicher, 2000, fq. 740 - 741):

- Nëse duhet zgjedhur midis kuptimit, që iu duhet dhënë kushteve të kontratës sipas mënyrës së redaktimit të tyre apo një kuptimi të ndryshëm, që rrjedh nga një lexim tjetër, duhet preferuar kuptimi, që favorizon palën, që nuk e ka përpiluar kontratën.
- Fjalët dhe sjellja e palëve duhet të interpretohen nën dritën e të gjitha rrethanave, dhe nëse qëllimi parësor i palëve është i përcaktueshëm, atij i duhet dhënë më tepër rëndësi.
- Një dokument i shkruar duhet të interpretohet si një i tërë, dhe të gjitha dokumentat e shkruara, që janë pjesë e të njëjtit transaksion, duhet të interpretohen së bashku.
- Nëse nga mënyra sesi është shkruar kontrata kuptohet një qëndrim i qartë, kontrata duhet të interpretohet duke u mbajtur parasysh ky qëndrim.
- Termave teknike iu duhet dhënë kuptimi i tyre teknik, në rastet kur përdoren për një transaksion që bën pjesë në fushën teknike.
- Nëse kontrata përfshin veprime që përsëriten (si për shembull sigurimi i punëtorëve të një ndërmarrjeje nga aksidentet e punës), qëndrimin dhe interpretimin, që kanë mbajtur palët në veprimet e mëpashme iu jepet rëndësi më e madhe në interpretimin e kontratës, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes së lindur.
- Termat e kontratës duhet të interpretohen në tërësi, në lidhje njëri me tjetrin si dhe duke mbajtur në konsideratë zakonet e mira, që gjejnë zbatim në fushën e sigurimeve.

- Një interpretim, që u jep termave të kontratës një kuptim ligjor, logjik dhe të efektshëm duhet të preferohet ndaj një interpretimi, i cili nuk lejon zbatimin e plotë, logjik dhe ligjor të disa prej termave të kontratës.
- Termave specifike iu jepet një peshë më e madhe sesa termave të përgjithshëm, që mund të jenë shkëputur nga rregulla të ndryshme, pjesë e zakoneve të mira, sikundër detyrimit për të arritur një rezultat i jepet më tepër peshë sesa angazhimit për të marrë masa të ndryshme, të cilat nuk garantojnë detyrimsht arritjen e rezultatit.
- Klauzolat e negociuara veçmas ose termat e shtuara në një moment të dytë, kanë më tepër peshë sesa klauzolat standarte ose termat që janë negociuar bashkë, në mënyrë që nëse klauzola, që ndikojnë direkt në dhënien e dakordësisë së palëve për lidhjen e kontratës, bien në kundërshtim me klauzola standarde, të parat të prevalojnë në interpretimin e kontratës dhe zgjidhjen e konfliktit.
- Nëse duhet zgjedhur midis kuptimeve të arsyeshme të një premtimi ose marrëveshjeje apo të një termi të tij/saj, gjykata duhet të zgjedhë kuptimin, që i shërben interesit publik.

Duke analizuar kriteret e vendosura dhe të zbatuara nga gjykatat, mund të themi se këto të fundit kanë arritur të mbajnë në konsideratë të gjitha rrymat e doktrinës dhe llojshmërinë e qëndrimeve të shprehura nga autorë të ndryshëm.

## **KAPITULLI III: ASPEKTE HISTORIKE TË LINDJES DHE ZHVILLIMIT TË SIGURIMIT VULLNETAR**

Prezantimi i zhvillimeve historike në fushën e sigurimeve do të bëhet i ndarë në dy plane, në fillim në aspektin ndërkombëtar dhe më pas në atë vendas.

### **3.1. Lindja e aktivitetit të sigurimeve në Evropë: Vështrim i përgjithshëm**

Sigurimi është konsideruar si një fenomen qytetërimi dhe ka marrë një zhvillim shumë të madh dy shekujt e fundit. Megjithatë, që në kohët primitive, tre mijë vjet para lindjes së Krishtit, njerëzit janë përpjekur, me mënyra të ndryshme, të shmangin dëmet në të mirat materiale, që ata kishin. Kështu, tregtarët kinezë, në rastet e transportit të mallrave me rrugë detare, kur mbijetesa e anijes rrezikohej nga rrymat e mëdha apo shkëmbinjtë, ndanin ngarkesën e një anijeje të madhe në disa varka të vogla, derisa të kalonin vendin e rrezikshëm. Nëse një ose disa prej varkave të vogla fundosej, pronarët e mallrave, që kishin shpëtuar, u jepnin tregtarëve, mallrat e të cilëve ishin shkatërruar, një pjesë të mallit të tyre si shpërblim.

Në vitet 1700 – 1600 para Krishtit, në përmbledhjen e ligjeve të mbretit babilonas Hammurabi (v. 1729 – 1686 para Krishtit), gjenden dispozita mbi ndarjen e rrezikut. Këto dispozita parashikonin që, tregtarët, pjesëmarrës të karvanëve, të cilët mbartnin mall nëpër shkretëtirë, detyroheshin, në mënyrë solidare, të ndanin dëmin, që mund të pësonte ndonjë pjesëmarrës i karvanit, për shkak të sulmeve të shkretëtirave. Me interes ishte, gjithashtu, dispozita mbi përgjegjësinë e ndërtuesit të një godine, i cili ishte i detyruar të zhdëmtonte shfrytëzuesin e ndërtesës, nëse objekti, i cili nuk ishte ndërtuar në mënyrë cilësore, shëmbej duke shkaktuar dëme në njerëz (Bakraçi, 2007, fq. 26 – 30).

Në një periudhë më të vonë, në Babiloni, gjenden rregullime për sigurimin në fushën e tregtisë detare. Kështu, në periudhën e viteve 500 – 600 pas Krishtit, ekzistonte një rregull i tillë sipas të cilit,



detarët mund të binin dakord midis tyre që, në qoftë se njëri prej tyre humbiste anijen e tij, tregtarët e tjerë do t'i ndërtonin një anije të re. Në qoftë se tregtari e humbiste anijen për shkak të një veprimi të kryer prej tij me faj, atëherë ky rregull nuk zbatohet. Në kategorinë e veprimeve të kryera me faj nga tregtari, hynte edhe lundrimi në vende të panjohura ose në zona ujore, ku anijet nuk shkonin zakonisht.

Popujt e Mesdheut kanë vazhduar traditën e popujve lindorë duke krijuar një institut të sigurimit detar, i cili parashikonte detyrimin e të gjithë pjesëmarrësve në transportin detar, që të jepnin kontributin e tyre në rastet, kur një anije apo malli, që ajo transportonte, dëmtoheshin gjatë udhëtimit, në mënyrë që të pengohej përhapja e mëtejshme e dëmit. E drejta romake nuk e ka njohur institutin e sigurimit, ndërsa rreziqet detare i mbulonte me hua detare. Mendohet se institutin e huasë detare e kanë njohur edhe fenikasit, prej të cilëve e kanë marrë grekët, romakët dhe popujt e tjerë të Mesdheut.

Huanë detare e merrte pronari i anijes ose i mallit para nisjes për rrugë. Nëse anija dhe malli arrinin në destinacion të padëmtuara, pronari i anijes ose i mallit, duhej, detyrimisht, të kthente huanë e marrë me një kamatë të përcaktuar. Në të kundërt, huaja nuk kthehej, por i mbetej tregtarit si kompensim për dëmin e pësuar. Përqindja e kamatës së paguar ishte e lartë. Në kohën e perandorit Justinian, huatë për tregtinë detare jepeshin me interesa deri në 12%, ndërkohë që, në fusha të tjera, huaja jepej me interesa deri në 6%. Kjo mënyrë të vepruari, edhe pse shumë e ndryshme nga sigurimet, që njohin ne sot, mund të themi se ka mjaftuar për të përmbushur nevojat e zhvillimit të atëhershëm shoqëror dhe të tregtisë detare, pasi, deri në shekullin e XI para erës sonë, nuk ka pasur gjurmë për paraqitjen ose zhvillimin e formave të tjera të sigurimit (Govare, 1929, fq. 10).

Me krijimin e korporatave dhe formave të tjera të kastave paraqiten edhe idetë për ndihmë reciproke. Në statutet e këtyre organizatave, gjendeshin dispozita, të cilat rregullonin ndihmën që anëtarët e tyre, duhet t'i jepnin njëri-tjetrit në rast zjarri, vdekjeje apo fatkeqësie të një natyre tjetër. Këto grupime ishin të mbyllura dhe përbëheshin nga njerëz, të cilët kishin interesa të përbashkëta. Ndihma

jepej në formë bamirësie. Në disa raste, krijoheshin të ashtuquajturat vëllazëri, qëllimi i të cilave ishte vetëm mbartja e përbashkët e rreziqeve.

Zhvillimi i sigurimit ka kaluar në etapa të ndryshme dhe nuk është bërë paralelisht për të gjitha format dhe sektorët, që mbulohen prej tij. Si rrjedhojë e faktit që transporti i mallrave dhe personave, është bërë, fillimisht, nëpërmjet detit dhe lumenjve, shenjat e para të sigurimit i gjejmë, pikërisht, në këtë sektor, në transportin ujor. Kështu, ndër format e para të sigurimit njihet ajo e “huasë për aventurën e madhe” (Lambert – Faivre, 2011, fq. 2 – 5), në periudhën e Mesjetës, që ishte një formë e përzierë midis spekulimit dhe sigurimit. Nëpërmjet kësaj forme siguri, tregtari, që bënte transportimin e mallit nga një pikë në një tjetër, nuk merrte asnjë kompensim, në qoftë se, gjatë rrugëtimit, atij i ndodhte një aksident, që kishte për pasojë dëmtimin e anijes. Tregtari merrte një shumë të caktuar dhe kishte të drejtë të përfitonte nga rezultatet (fitimet) e biznesit të kryer, vetëm nëse ai kthehej me anijen e ngarkuar me mall.

Ky lloj siguri nuk zgjati për shumë kohë, ai u dënua fuqishëm nga Kisha. Në vitin 1234, Papa Gregori IX, me anë të një dekreti, të quajtur “Decretale Naviganti” ndaloi dhënien e huasë detare për shkak të interesave të larta. Për një periudhë kohe, pas daljes së këtij dekreti, tregtarët u përpoqën të gjenin rrugë të tjera për të siguruar veprimtarinë e tyre. Duke qenë se nevoja për siguri vinte në rritje të vazhdueshme dhe se Kisha ndalonte çdo lloj veprimtarie të karakterit sigures, tregtarët lidhnin kontrata shitjeje fiktive. Sipas këtyre kontratave, anija shitej së bashku me ngarkesën dhe çmimi i shitjes paguhej vetëm, në qoftë se anija shkatërrohej apo fundosej. Nëse anija e kryente rrugëtimin pa probleme, kontrata prishej (Pouilloux, 2011, fq. 11).

Dokumenti i parë, i njohur si kontratë shitblerjeje, i cili kishte të bënte me sigurimin, është përpiluar në formën e një dokumenti noterial, më 1347 në Gjenova të Italisë. Polica e parë e sigurimit është lëshuar në vitin 1384 në Piza (Bakraçi, 2007, fq. 31 – 39). Ndërkohë që, në zonën e Gjenevës,

fillimet e rregullimit në fushën e sigurimit datojnë më 1336, kur udhëheqësi i atëhershëm nxori dekretin për sigurimin në fushën e transportit detar. Nga Italia, siguri detar zgjerohet shpejt, kështu për shembull, në fund të shekullit të XIV, filloi të krijohet në Portugali kompania e parë e sigurimit detar reciprok. Paralelisht, fillojnë të krijohen edhe përmbledhjet e para të zakoneve të mira.

Si shembull përmendim « Ordonancin e Barcelonës » të 21 nëntorit 1435. Bëhet fjalë për një statut me 20 nene, i cili kishte për qëllim të çrrënjoste çdo mashtrim, dëmtim, diskutim apo debat, që mund të lindte në këtë qytet, me rastin e sigurimit të anijeve dhe ndërtimeve të tjera detare, si dhe për mallrat, të mirat dhe avantazhet, që lidheshin me këtë aktivitet. Ekzistenca e këtyre rregullave të shkruara tregon që, praktika e sigurimit në fushën e tregtisë detare ishte bërë një praktikë e zakonshme, në këtë periudhë, kjo pavarësisht faktit, që nuk ekzistojnë të dhëna të plota për zhvillimin e sigurimit gjatë periudhës së Mesjetës (Govare, 1929, fq. 15).

Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të XV, forma e kontratës së sigurimit ndryshoi. Kontrata e sigurimit filloi të përpilohej duke u marrë si model kontrata e shitjes. Analogjia u zhvillua duke e trajtuar mallin e siguruar, si mall që i shitej siguruesit, në rast se ai humbte ose dëmtohej gjatë udhëtimit. Kontrata konsiderohej e prishur, në qoftë se transportimi i mallit, nga njëra pikë në tjetrën, bëhej pa problem. Kështu, gjatë udhëtimit, malli konsiderohej se ishte nën përgjegjësinë e siguruesit, të cilit i jepej mundësia për të ndërhyrë, nëse diçka ndodhte gjatë kësaj kohe, me qëllim shpëtimin e mallit nga shkatërrimi. Nëse siguruesi i paguante tregtarit një shumë të caktuar për mallin e transportuar në rast aksidenti apo fatkeqësie, atëherë siguruesit i lindte e drejta të merrte për vete atë pjesë të mallit, që ishte shpëtuar.

Nga kjo mënyrë të vepruari lindi një nga parimet më të rëndësishme, që qëndrojnë sot në themel të aktivitetit të sigurimit. Bëhet fjalë për idenë, sipas të cilës, personi, që kërkon të sigurohet, duhet të ketë interes në sigurimin e mallit, pra të ketë të drejta mbi këtë mall, në mënyrë që të justifikohet

veprimi i tij. Personi, i cili lidhte kontratën e sigurimit duhet të jetë në një pozicion të tillë që ai të pësojë humbje financiare, nëse ndodh ngjarja e siguruar (Guri et al., 2012, fq. 183). Jo vetëm kaq, por, duke qënë se, nëpërmjet kontratës së sigurimit, siguruesi mund të fitonte të drejta pronësie mbi mallin e transportuar, për të cilin ai kishte paguar shpërblim, personi, që lidhte sigurimin, duhej të ishte pronar i mallit të siguruar. Përndryshe, në zbatim të parimit, sipas të cilit, një individ nuk mund t'i transmetojë një tjetri më tepër të drejta, se ato që ai disponon, kalimi i pronësisë së mallit, nëpërmjet kontratës së sigurimit, te siguruesi, do të ishte i pamundur (Holdsworth, Shkurt 1917, fq. 90).

Ekzistenca e këtij parimi e ka çuar doktrinën angleze, përmendim këto Park, John Weskett dhe Marschall, të shprehen se siguri detar mbi pronën e një armiku (qoftë ky armik në luftë apo pirat), është i paligjshëm. Këta autorë shpreheshin se interesi nuk ekzistonte përse kohë qëllimi i parë ishte shkatërrimi i armikut dhe rrjedhimisht edhe i pasurisë së tij (Grun dhe Joliat, 1828, fq. 149). Ky qëndrim u mbajt më pas edhe nga doktrina franceze. Në disa raste, zbatimi i parimit të interesit të të siguruarit, u bë në kundërshtim me qëllimin e krijimit të këtij parimi. Kështu, mund të ndodhte që siguruesit të kërkonin që, në kontratë të futej një klauzolë, sipas të cilës, siguruesi lirohej nga detyrimi për të paguar, në varësi të interesit, që tregtari kishte për mallin e transportuar. Ky qëndrim solli si pasojë faktin, që kontratat e sigurimit konsideroheshin, gjithnjë e më shumë, si kontrata bastesh, mbi sigurinë e anijeve dhe mallrave të siguruara. Kontratat, shpeshherë, në pjesën përshkruese të objektit të sigurimit, përveç të dhënave për mallin e siguruar, dërguesin ose pronarin e mallit dhe emrin e kapitenit, parashikonin edhe që, në mënyrë që siguri të bëhej i efektshëm, malli duhej të ngarkohej në një anije të caktuar (Bakraçi, 2007, fq. 31 – 39).

Në shekullin e XIV, filluan të bëhen pjesë e kontratave të sigurimit klauzola për kohëzgjatjen e kontratës, e cila, në përgjithësi, nuk mund të tejkalonte një vit. Rruga, që anija duhej të ndiqte për transportimin e mallit të siguruar, përcaktohej, sistematikisht, në kontratë. Devijimi nga trajektorja e

përcaktuar, me përjashtim kur kontrata e parashikonte një gjë të tillë, përbënte shkak të mjaftueshëm, që siguruesi të refuzonte pagesën në rast aksidenti.

Kontratat parashikonin gjithashtu edhe rreziqet, kundrejt të cilave siguroheshin anija dhe malli i transportuar. Kështu, thuajse sistematikisht, sigurimi nuk vlente, nëse rreziku ishte rrjedhojë e veprimeve të pamatura të kapitenit të anijes. Në disa raste, kontrata parashikonte që, anija do të konsiderohej e humbur, nëse gjatë një afati të caktuar, siguruesi nuk merrte informacion lidhur me ecurinë e saj dhe udhëtimin e kryer.

Situata paraqiste vështirësi interpretimi, lidhur me detyrimin e siguruesit për të paguar në rastet, kur anija dhe ekuipazhi merreshin peng dhe shpëtoheshin përsëri. Mendimi më i mirë ishte ai, që propozonte shkarkimin e siguruesit nga detyrimi për të paguar, në rast se, pas shpëtimit të anijes, siguruesi e blinte mallin dhe arrinte ta çonte atë në destinacionin fillestar. Kontrata parashikonte detyrimin për të siguruarin, që të paguante primin. Në disa raste, një klauzolë e kontratës parashikonte mundësinë e anulimit të saj dhe kthimin e primit, p.sh. në rast se udhëtimi nuk realizohej, ose, në rast se vërtetohej, që rreziku, për të cilin ishte lidhur kontrata, nuk kishte ekzistuar ndonjëherë.

### **3.2. Fillesat e zhvillimit të një kuadri ligjor**

Zhvillimi i aktivitetit të sigurimit në shekullin e XIV në Gjenovë dhe Firence ishte aq i madh sa, tregtarët e këtyre vendeve kishin filluar ta trajtonin tarifën për sigurimin e mallit, si pjesë përbërëse të çmimit, që paguhej për transportin e tij. Ky zhvillim, solli disa pasoja mjaft të rëndësishme:

- Shumat e siguruara rriteshin në mënyrë të vazhdueshme. Për rrjedhojë, në mjaft raste, për sigurimin e një ngarkese mund të ndërhnin disa sigurues, të cilët merrnin përsipër të siguronin nga një pjesë të saj secili.

- Kontrata e sigurimit po konkretizohej gjithnjë e më tepër në një akt të ndryshëm nga kontrata e huadhënies apo kontrata e shitjes.
- Kontratat e sigurimit përpiloheshin më thjesht, sepse tashmë aktiviteti njihej si i ligjshëm dhe nuk ishte e nevojshme të përpiloheshin montime të ndryshme juridike, për të fshehur një aktivitet sigurimi. Kontratat e sigurimit njiheshin si një lloj i veçantë i kategorisë së kontratave, zbatimi i të cilave i nënshtrohej parimit “I siguruari paguan një prim, në mënyrë që siguruesi të marrë përsipër një rrezik.” (Holdsworth, Shkurt 1917, fq. 91).

Gjenova ka qënë qendra e aktivitetit të sigurimit. Shoqëritë e para të specializuara në lidhjen e kontratave të sigurimit, (brokerët e sotëm) janë krijuar për herë të parë në Gjenovë. Rëndësia e zhvillimit të aktivitetit të sigurimit provohet edhe nga fakti që, në një ditë të vetme, në vitin 1393, në Gjenovë u lidhën 80 kontrata sigurimi (Holdsworth, Shkurt 1917, fq. 90). Krijimi dhe ndërhyrja e brokerave bëri që, hap pas hapi, të përpiloheshin forma standarte, të detyrueshme për kontratat e sigurimit, zhvillim ky, që kishte për qëllim t’u jepte fund praktikave të ndjekura deri atëherë<sup>25</sup> si dhe të krijonte rregulla të njëjta për t’u zbatuar në fushën e sigurimit detar, të cilat mund të mbaheshin mend më kollaj, si rezultat i përsëritjes së tyre nga një kontratë në tjetrën. Forma e kontratave, që u krijua nga brokerat në këtë periudhë, ka shërbyer si bazë, në mjaft raste, për krijimin e të drejtës së sigurimeve, që vende të ndryshme të Evropës, (si, p.sh. Britania e Madhe) përdorin sot.

Përdorimi i formave standarte të kontratave të sigurimit, përbënte avantazh edhe për shtetet, të cilat, duke parë zhvillimin e vullshëm të këtij aktiviteti, mendonin të krijonin rregulla të ndryshme me karakter fiskal, me qëllim rritjen e të ardhurave të tyre. Në mënyrë që të sigurohej ushtrimi i rregullt i aktivitetit të sigurimit, shtetet filluan të merrnin masa për adoptimin e rregullave dhe ligjeve, në këtë fushë.

---

<sup>25</sup> Kontrata e sigurimit mund të lidhej vetëm me gojë, gjatë një bisede midis palëve, veprim ky që ishte shumë i vështirë për t’u provuar në rast mosmarrëveshjeje.

Tentativat e para, për të rregulluar nëpërmjet dispozitave ligjore aktivitetin e sigurimit detar, i gjejmë po në Gjenovë, në gjysmën e dytë të shekullit të XIV. Këto dispozita synonin të ndalonin sigurimin e anijeve të huaja dhe caktonin disa kushte në lidhje me vlefshmërinë e kontratave. Si për shembull, kontrata e sigurimit nuk ishte asnjëherë e vlefshme, në qoftë se ajo lidhej, pasi ishte shkaktuar dëmi. Gjurmë rregullimesh të shkruara në fushën e sigurimeve gjejmë, gjithashtu, edhe në Republikën e Venecias, e cila ka miratuar në vitin 1468 disa rregulla, që njihen gjithashtu edhe si Ligjet e Republikës së Venecias në fushën e sigurimeve (Bakraçi, 2007, fq. 31 – 39).

Të tjera përkjekje u bënë për të krijuar ligje, të cilat tatonin aktivitetin e sigurimit dhe që parashikonin procedurat e ekzekutimit të kontratave, me qëllim që ato të ishin të shkurtra dhe efikase. Nga fundi i shekullit të XV, palët filluan të gëzonin një liri më të madhe në formulimin e kontratave, liri kjo që, në disa raste, u hapi rrugën abuzimeve dhe përdorimit të kontratave të sigurimit për qëllime spekulimi.

Ordonanci i Barcelonës, i miratuar në vitin 1435, u pasurua edhe më tej, me disa ligje të miratuara gjatë viteve 1435 – 1484. Këto statute (ligje), të kodifikuara në vitin 1484, ndikuan ndjeshëm të drejtën e sigurimeve në fushën detare, në mjaft vende të Evropës dhe kjo ndodhi për dy arsye:

- Së pari, statutet e Barcelonës u printuan dhe u shpërndanë së bashku me të ashtuquajturin “Consolato del Mare”, tërësi rregullash edhe zakonesh, që gjenin zbatim në fushën e aktivitetit detar, të mbledhura gjatë shekujve të XI, XII dhe të XIII, me iniciativën e mbretërve aragonas, të cilët kishin një influencë të konsiderueshme.
- Së dyti, statutet e Barcelonës, u krijuan në një periudhë më të vonë se sa ligjet gjenoveze dhe, në këtë mënyrë, ato ishin më të qëndrueshme dhe më të plota se sa ligjet italiane.

Statuti i vitit 1435 ishte një dokument i plotë, i cili trajtonte mjaft problematika, që ishin hasur gjatë aktivitetit detar, si psh:

- kapacitetin e palëve për të lidhur një kontratë,

- sigurimin e anijeve të huaja,
- vlerën e mallrave të siguruara, mbi bazën e së cilës llogaritej vlera e sigurimit,
- rastet kur anija duhet të konsiderohej e humbur,
- pagimin e primit,
- formën e kontratës, etj.

Statuti parashikonte, gjithashtu, që, të gjithë siguruesit e një rreziku të vetëm, duhej të kontribuonin në masë të njëjtë në humbjet e pësuar, pavarësisht se policat e tyre ishin të ndryshme. Rregullorja parashikonte që, klazuolat e përdorura duhej të përpiloheshin me terma të qartë dhe të saktë. Në rast aksidenti, personi i siguruar përballonte, detyrimisht, një pjesë të humbjeve, pjesë që mund të shkonte nga një e treta te një e katërta e vlerës së mallit të dëmtuar. Pagimi i dëmshpërblimit nga siguruesit, duhej të bëhej brenda katër muajve nga data e aksidentit, ose brenda gjashtë muajve nga rasti, kur ishin marrë për herë të fundit lajme nga një anije, që ishte zhdukur pa arritur në destinacion.

Statutet e mëvonshme, shpeshherë, kishin si objekt ndryshimin e rregullave të vendosura me statutin e vitit 1435, me qëllim përshtatjen ndaj situatave të krijuara rishtazi ose plotësimin e kuadrit ligjor të zbatueshëm. Kodifikimi i vitit 1484 solli si pasojë edhe heqjen e pengesave për sa i takonte sigurimit të anijeve të huaja. Megjithatë, për të evituar spekulimet, sigurimi i anijeve të huaja, edhe pse lejohej, gjente zbatim vetëm për anijet, që nuk udhëtonin më larg se sa ngushtica e Gjibraltarit<sup>26</sup>.

U krijuan, gjithashtu, rregulla specifike, që pengonin lidhjen e kontratave të sigurimit për ngarkesa fiktive, që presupozohej se do të transportoheshin nga një pikë në një tjetër. Përmendim këtu edhe Rregulloret e Firences, të vitit 1523, të cilat ishin një pëmbledhje e konsoliduar e rregullave, që gjenin zbatim në fushën e sigurimit detar (Bakraçi, 2007, fq. 31 – 39).

---

<sup>26</sup> Përrjashtime lejoheshin për anijet që udhëtonin në drejtim të Barcelonës.



Në këtë fushë, një rol të rëndësishëm ka luajtur Dubrovniku. Në Dubrovnik është miratuar, më 1568, ligji mbi sigurimin detar “Ordo super Assecuratoribus”<sup>27</sup>. Në këtë ligj, përfshiheshin të gjitha ato raste problemesh e fatkeqësish, që ishin hasur deri atëherë në praktikë dhe, për të cilat, praktika konsideronte shumë të nevojshëm krijimin e një sistemi sigurimi. E Drejta detare dubrovnikase dhe e Drejta e sigurimit, të krijuara në këtë vend, kaluan kufijtë e vendit të krijimit për t’u përdorur edhe me gjerë.

Në gjysmën e dytë të shekullit të XV, gjejmë në Angli tentativat e para të Këshillit të Ministrave për të regjistruar kontratat e lidhura në fushën e sigurimit, në zonën e Londrës. Përpjekje u bënë edhe për të fiksuar një listë tarifash për regjistrimin e policave të sigurimit. Në Angli, në fillim shekullin e XVI, aktiviteti i sigurimit detar, edhe pse kishte marrë një zhvillim të madh, rregullohej, për një pjesë të mirë të tij, nga ligji civil. E drejta detare italiane kishte ende një ndikim të fortë në Angli. Ky ndikim provohet edhe nga fakti që, polica e parë e sigurimit, e gjetur në një kontratë angleze, ishte shkruar në gjuhën italiane dhe me një stil shumë të ngjashëm me atë, që përdorej në Itali, në atë kohë (Holdsworth, Shkurt 1917, fq. 97). Ngjashmëria nuk kishte të bënte aq me gjatësinë apo termat e përdorur në policë, sa kishte të bënte me zgjidhjen, që ajo parashikonte për problematikat e trajtuara.

Palët, gjithnjë e më tepër, përfshinin në kontratë klauzola, që parashikonin se zbatimi i kontratës do t’u nënshtrohej rregullave të së drejtës tregtare dhe jo rregullave të së drejtës civile. Në këtë periudhë, kishte filluar të funksiononte edhe Dhoma Britanike e Sigurimeve, e cila ishte krijuar në vitin 1574.

Me krijimin e familjes paternaliste të strukturuar në shekujt e XVII – XVIII, mund të themi se ka lindur një lloj sigurimi i ri. Pjesëtarët e familjes, të cilët kishin mundësi të punonin dhe të rrisnin sasinë e të ardhurave apo të të mirave, që hynin në shtëpi, kujdeseshin që pjesëtarët më të dobët (fëmijët, të moshuarit apo të sëmurët), të mund të përfitonin nga arritjet e tyre, pra që, të ardhurat dhe të mirat e shpëna prej tyre, të shërbenin për mirëqënien e të gjithë anëtarëve të familjes. Krijimi i sistemeve të sigurimit për të mirat tokësore (mjete të transportit rrugor, banesa etj.), është shfaqur si pasojë e

---

<sup>27</sup> Ordo super Assecuratoribus mund të përkthehet sot “dispozita për sigurimin”.

civilizimit njerëzor. Civilizimi është i lidhur, pashmangshmërisht, me lëvizjen në masë të njerëzve drejt zonave urbane dhe me veprimet e tyre për të kryer investime të rëndësishme në vlerë monetare, ruajtja e të cilave përbënte një përparësi.

Një nxitës i rëndësishëm në zhvillimin e sigurimit, kryesisht kundër zjarrit, ka qënë zjarri i madh i Londrës i vitit 1666, i cili shkatërroi afërsisht 13 000 shtëpi. Kështu për shembull, në vitin 1680 janë krijuar në Angli, shoqëritë e para kundër zjarrit, të cilat duhet të siguronin shtëpitë, që po ndërtoheshin si pasojë e zjarrit të vitit 1666. Ndërsa në Paris, shoqëritë e para të sigurimit kundër zjarrit janë krijuar në vitin 1750 ( Lambert – Faivre, 2011, fq. 4).

Në vitin 1721 shfaqen fillesat e sigurimit edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bëhet fjalë për sigurimin detar, i cili ushtrohej në formë individuale. Në vitin 1792 është themeluar shoqata “The Insurance Company of North America” (Bakraçi, 2007, fq. 31 – 39). Megjithatë, një pjesë e mirë e aktivitetit të sigurimit kalonte nëpërmjet tregut londinez.

Shekulli i XIX dhe zhvillimi industrial kanë rritur nevojat e familjeve për sigurim. Kështu, familjet në zonat urbane, me të ardhurat dhe të mirat materiale, që siguronin, nuk mund të garantonin më mbijetesën dhe plotësimin e nevojave të një numri të madh anëtarësh, ndryshe nga zonat rurale, (që kishin mundësi të shfrytëzonin tokën), pasi burimi kryesor i të ardhurave të tyre ishte paga, që jepej në këmbim të punës së kryer në një uzinë apo fabrikë. Urbanizimi i shoqërisë ishte rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Njëherazi, me ndryshimin e kushteve ekonomike, ndryshoi edhe mentaliteti i njerëzve, të cilët, në një farë mase, nuk donin më të kujdeseshin për të afërm, të një shkalle të largët fisnore. Në këtë periudhë, në vendet e zhvilluara perëndimore, familjet po njihnin edhe ndryshime të tjera, të lidhura me dëshirën e të rinjve në moshë madhore, për të mos jetuar më me prindërit e tyre, veçanërisht pas

martese. Këto ndryshime, kanë sjellë si pasojë nevojën për të rinjtë, e shkëputur nga trangu familjar, të gjejnë mënyra të tjera për të siguruar të ardhura të mjaftueshme.

Rritja e industrializimit të shoqërisë, solli, gjithashtu, edhe rritjen e aksidenteve. Shoqëria, por edhe drejtuesit e shteteve të ndryshme, filluan të kuptojnë se, krijimi dhe pjesëmarrja në organizmat e sigurimeve, ishin një domosdoshmëri. Qytetarët nuk mund të përballonin dëmet e shkaktuara nga faktorë natyrorë (zjarr, stuhi, tërmet etj.), vetëm me kursimet e vëna mënjanë. Po ashtu, shtetet nuk mund të merrnin përsipër shpërblimin e banorëve për çdo lloj fatkeqësie, sikundër edhe nuk mund të neglizhonin nevojën e krijimit të mekanizmave të ndryshme për të siguruar këtë shpërblim. Në këtë mënyrë, iu hap rruga krijimit të sistemeve të sigurimit të detyrueshëm.

Krijimi i sigurimeve të detyrueshme shkoi paralel me ndryshimet në legjislacion, të cilat shfaqeshin në krijimin e institutit të “përgjegjësisë civile, për dëmin e shkaktuar”. Duke i njohur të drejtën një personi të kërkonte shpërblim nga një person tjetër, i cili me veprimet e tij i kishte shkaktuar atij një dëm, ligjvënësi krijonte një shtysë për shtetasit që të siguroheshin pranë një organizmi, pasi, në çdo moment, përgjegjësia e tyre mund të vihej në lojë, si rezultat i një veprimi të çfarëdoshëm (Lambert – Faivre, 2011, fq. 10 - 12).

Drejtimi i dytë, në të cilin gjeti zhvillim sigurimi i detyruar, ishte ai i sigurimeve shoqërore. Duke qënë se studimi i sistemit të sigurimeve shoqërore nuk është pjesë e temës së kësaj doktorature, trajtimi i tij do të bëhet vetëm për aq, sa është e nevojshme. Zhvillimi i sigurimeve shoqërore ka bërë të mundur krijimin e një sistemi, që paraqiste njëherazi dy përparësi:

- Atë të mbledhjes së fondeve të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e shkaktuara nga individët, që nuk kishin mundësi të ushtronin një aktivitet profesional dhe të përmbushnin vetë nevojat e tyre.

- Atë të ruajtjes së një lloj stabiliteti në kushtet e jetesës së individëve, të cilët do të vazhdonin të përfitonin të ardhura të qëndrueshme, për një periudhë të caktuar pavarësisht ndryshimeve në situatën e tyre profesionale.

Në disa raste, shtetet janë përpjekur të integrojnë në sistemin e sigurimit të detyrueshëm edhe sigurimin për aksidentet në punë, për të cilat punëdhënësi duhej të shpërblente punonjësin, në qoftë se ky i fundit dëmtohej, për shkak të punës së kryer.

Në sektorin privat të sigurimit, shekujt XIX – XX shënojnë zhvillime të rëndësishme. Gjatë kësaj periudhe, është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme kategoria e ngjarjeve apo të mirave, që mund të bëheshin objekt sigurimi (mjetet motorike, kreditë, rreziqet bërthamore). Rritja e mundësive të sigurimit nuk vlen vetëm për rreziqe të cilat janë shfaqur me vonë në jetën e njeriut, por edhe për kategori rreziqesh, që ekzistonin edhe më herët, për të cilat janë shtuar personat, që mund të përfitojnë nga sigurimi dhe rreziqet, që mund të sigurohen. Kështu, në rastin e sigurimit të rreziqeve të lundrimit detar, kontrata mund të lidhet nga pronari i anijes, armatori, qiramarrësi, transportuesi ose ngarkuesi. Mund të sigurohet anija, mallrat që transportohen në të, të ardhurat e shpresuara nga mallrat, qiraja e anijes dhe përgjegjësia civile. Sigurimi bëhet ndaj disa lloj rreziqeve, si për shembull furtuna, zjarri, përmbytja, stuhia etj (Galgano, 2006, fq. 720). Në shekullin e XIX gjejmë, gjithashtu, fillesat e risigurimit. Gjatë kësaj periudhe, shtete të ndryshme evropiane, kanë përforcuar dhe kompletuar kuadrin e tyre ligjor me dispozita, të cilat vazhdojnë të jenë edhe sot, pjesë e legjislacionit të brendshëm. Shpeshherë, dispozitat rregulluese të aktivitetit të sigurimit janë bërë pjesë e ligjeve tregtare (Itali, Spanjë, Gjermani, Hungari). Në disa raste, veprimtaria e sigurimit rregullohej me ligje të veçanta (Belgjikë) (Bakraçi, 2007, fq. 31 – 39).

Zhvillimi i madh i aktivitetit të sigurimit në shek. XIX – XX është favorizuar nga dy faktorë:

- Së pari, aktiviteti i sigurimit kishte integruar në masë shoqëritë e specializuara, duke lënë mënjanë personat fizikë. Përfshirje nga ky rregull bën rasti Lloyd's në Angli. Pjesëmarrja e shoqërive në aktivitetin e sigurimit solli, si pasojë, rritjen e fondeve, që qarkullonin në këtë fushë dhe rritjen edhe të rasteve, të cilat mund të siguroheshin nëpërmjet krijimit të policave të reja të sigurimit.
- Së dyti, aktiviteti i sigurimit menaxhohej duke përdorur rregulla matematikore si dhe teknikën e sigurimit. Siguruesit vepronin duke marrë në konsideratë një tërësi faktorësh dhe duke bërë gjithnjë e më tepër llogari të sofistikuara. Në këtë mënyrë, veprimtaria e sigurimit nuk ishte më një punë fati (e rastësishme), por diçka e mirorganizuar.

Me krijimin e strukturave të mëdha siguruese, aktiviteti i të cilave mbulonte shumë sektorë, u shfaq edhe nevoja për zhvillimin e hallkave të ndërmjetme të komunikimit, siç janë brokerat.

### **3.3. Rasti Lloyd's – Angazhimi i personave fizikë në aktivitetin e sigurimit**

Anglia është vendi, ku është krijuar për herë të parë bursa e sigurimeve. Zhvillimi i sigurimeve në Angli është rrjedhojë e faktorëve të ndryshëm historikë, ndër të cilët mund të përmendim:

- Zjarrin e madh, që ra në Londër, në vitin 1666;
- Rëndësinë dhe zhvillimin e transportit detar dhe të flotës angleze.

Lloyd's ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e sigurimit modern. Lloyd's është sot një nga tregjet më të rëndësishme në botë, për sa i takon aktivitetit të sigurimit. Është një korporatë e madhe siguruesish individuale, nga të cilët, çdonjëri lufton veç e veç për pjesën, që ka ndërmarrë mbi vete në sigurim (Bakraçi, 2007, fq. 35). Në mënyrë përjashtimore, Lloyd's mund të ndërhyjë për të paguar detyrimin e marrë përsipër nga një sigurues, i cili nuk ka fondet e nevojshme për të përmbushur angazhimin e kontratuar.

Lloyd's nuk mund të konsiderohet si kompani sigurimi. Lloyd's është një vend tregtimi (Bylykbashi, 2014, fq.12), një nga bursat më të mëdha në botë, ku zhvillohet aktiviteti i sigurimit (Bakraçi, 2007, fq. 35 – 39). Roli i Lloyd's mund të përmblihet në dy pika:

- Së pari, Lloyd's u lejon personave të interesuar të bëhen anëtarë të saj, për të ofruar sigurim, duke u bërë të mundur përdorimin e emrit (markës) Lloyd's, e cila gëzon prestigj, ofron garanci dhe është një mjet shumë i rëndësishëm për të tërhequr klientë.
- Së dyti, Lloyd's siguron një strukturë rregullatore si dhe një sërë lehtësirash në administrimin e veprimtarisë së anëtarëve të saj. Lloyd's vepron në tregun e sigurimeve prej 325 vjetësh, çka do të thotë se, pjesëmarrja në këtë korporatë, është garanci për organizimin e aktivitetit sipas rregullave të mirëpërcaktuara dhe të njohura gjerësisht.

Zanafilla e kompanisë Lloyd's daton më 1686, fill pas zjarrit të madh të vitit 1666. Tregtarë të ndryshëm, detarë, pronarë anijesh, siguries, ndërmjetës mbledheshin, gjatë shekullit të XVII, në një kafene londineze të quajtur Edward Lloyd, për të lidhur marrëveshje të ndryshme, që kishin të bënin me sigurimet. Kafeneja e Edward Lloyd nuk ishte e para dhe as vetmja kafene në Londrën e asaj kohe. Kafenetë, në këtë periudhë, ngjasonin mjaft, për nga struktura, me një institucion. Ato kishin secila klientelën e vet, klientelë, që ndodhej në të njëjtat kushte dhe kishte të njëjtat angazhime. Klientela e kafenesë së Edward Lloyd përbëhej nga tregtarë, të cilët zhvillonin aktivitetin e tyre nëpërmjet lumit Tamiz. Në kafenenë e Lloyd zhvilloheshin, gjithashtu, shitje të mallrave të ndryshme apo ankande.

Në vitin 1688, kafeneja e Edward Lloyd përmendet për herë të parë në Gazetën e Londrës. Edward Lloyd kishte nxjerrë një lajmërim për shpërblimin, që ofronte për cilindo, që do t'i jepte informacion lidhur me një kalë, që kishte humbur. Ky lajmërim, edhe pse nuk përbën një veprim të mirëfilltë sigurimi, por i ngjan më tepër shpërblimit, ishte një rast i përkryer për Edward Lloyd, që emri i tij të njihej gjerësisht.

Të dhënat e mbledhura për anijet, për lëvizjen e tyre dhe për shitblerjen e mallrave, gjatë bisedave, që tregtarët bënë në kafenenë e Edward Lloyd, shërbyen për të botuar në vitin 1696 një gazetë të quajtur “Lloyd’s news”, e cila u shpërndahej anijeve. Në vitin 1734, fillon të botohet “Lista e Lloyd” (Lloyd’s list), revistë e përvjetshme, e cila jepte informacionet më të fundit, që vinin nga portet më të rëndësishme, jo vetëm në Angli, por edhe më gjerë<sup>28</sup>.

Gjatë kësaj periudhe, në Londër, ekzistonin rreth 80 kafene, ku tregtarët mblidheshin dhe diskutonin për problemet e tyre. Lloyd u përpoq të ruante përparësinë duke u zhvendosur, në vitin 1692, në qendër të qytetit, në një nga lagjet më të rëndësishme të asaj kohe, “Lombard Street”. “Lombard Street” ishte, atëherë, një qendër tepër e rëndësishme për zhvillimin e tregtisë dhe veprimeve financiare, veprime këto që, shpeshherë, përafroheshin me veprimtarinë e sigurimit, pasi klauzola sigurorese gjendeshin në kontrata të ndryshme huaje apo shitjeje. Përparësia e Lloyd vihej re, gjithashtu, edhe te informacioni, që ai dispononte. Shumë shpejt, Lloyd’s do të ishte vendi ku tregtarët takoheshin dhe mund të nënshkruanin sigurime, për biznesin e tyre, me persona fizikë.

Funksionimi i Lloyd’s mbi bazën e angazhimeve të siguroresve persona fizikë, është një veçanti e kësaj strukture, që e dallon atë nga kompanitë e tjera të sigurimit dhe që vjen si rrjedhojë e qëndrimeve të mbajtura nga mbretëria angleze në vite. Në vitin 1721, tregu i sigurimeve në Angli u lëkund ndjeshëm. Shumë prej kompanive të krijuara u zhdukën me shpejtësi. Vetëm ato më të fuqishmet dhe më të mirorganizuarat, arritën të mbijetonin. Ishin dy kompani, “London Assurance Corporation” dhe “Royal Exchange Assurance Corporation”, të cilat ekzistojnë edhe sot, që arritën të krijonin një pozicion dominues në treg. Ky pozicion dominues, u përforcua së tepërmi nga mbreti Xhorxhi i I<sup>ri</sup>, i cili u dha këtyre kompanive monopolin e përvjetshëm, për të lidhur sigurime në fushën e tregtisë detare. Asnjë

---

<sup>28</sup> Në të vërtetë “Lista e Lloyd” është botuar për herë të parë nga Thomas Jamsen. Jamsen përdori emrin e Lloyd, sepse ai njihej gjerësisht nga tregtarët e saj kohe, dhe kjo i siguronte Jamsen klientelë të vazhdueshme dhe një numër të rëndësishëm të abonuarish. <https://www.lloyds.com/lloyds/about-us/history/corporate-history/the-early-days> (15 gusht 2015).

kompani tjetër, nuk mund të vepronte në fushën e sigurimit detar. Ekzistonte vetëm një përjashtim, personat fizikë mund të nënshkruanin siguracione në këtë fushë. Lloyd u përshtat me këtë rregull, duke funksionuar mbi bazën e angazhimeve të marra nga personat fizikë, të cilët shrytëzonin informacionet dhe ambjentet e Lloyd për të hyrë në kontakt me tregtarët (Bakraçi, 2007, fq. 35 – 39).

Më 1739, Lloyd's ishte qendra e informacionit për atë çka ndodhte në det. Kështu, qeveria angleze u informua nga drejtuesi i atëhershëm i Lloyd's, z. Richard Baker, për faktin se flota britanike doli fitimtare në betejën e Porto Bellos, që zhvillohej midis Britanisë së Madhe dhe Spanjës.

Viti 1764 shënon një nga proceset gjyqësore më të rëndësishme në fushën e sigurimeve, pjesë e të cilit ka qënë edhe Lloyd's. Kështu, Lloyd's ka pranuar të sigurojë Fregatën franceze Mills. Gjatë udhëtimit Fregata pësoi dëme të ndryshme. Çështja e shpërblimit të dëmit u zgjidh nga gjykata, e cila, me vendimin e saj, u shpreh se një anije, përpara se ajo të bëhet pjesë e një kontrate sigurimi, duhet të ishte në kushte të mira, për të udhëtuar. Kompania e sigurimit mund të mos paguante shumën e fiksuar në kontratën e sigurimit, nëse anija kishte një defekt të fshehur dhe të panjohur për të dyja palët në kontratë. Ky vendim pati një impakt shumë të rëndësishëm në fushën e sigurimit në Britaninë e Madhe dhe u bë pjesë e legjislacionit të brendshëm vendas<sup>29</sup>.

Si pasojë e rënies së të ardhurave, me përfundimin e luftës së shtatë vjetëve (1756 – 1763), aktiviteti i sigurimit të Lloyd's u shtri edhe në fusha të tjera. Gjatë viteve 1770 – 1800, Lloyd's filloi të shtrijë influencën e saj, dhe madje të dominojë sigurimin detar dhe të anijeve, në shkallë globale. Roli i sigurimit detar ishte rritur ndjeshëm me revolucionin amerikan të fundshekullit të XVIII dhe me betejat e Napoleonit. Dëmet e shkaktuara ishin gjithnjë e më të mëdha. Mbulimi i tyre nuk mund të realizohej veçse nga struktura të mirorganizuara. Në këtë periudhë, Lloyd's u nënshtrohet ndryshimeve të rëndësishme në organizimin e saj, duke filluar që nga ndryshimi i vendndodhjes së qendrës së shoqërisë, e duke vazhduar me përzgjedhjen e anëtarëve profesionistë e të specializuar në fushën e sigurimit.

---

<sup>29</sup> <https://www.lloyds.com/lloyds/about-us/history/corporate-history/the-early-days> (15 gusht 2015).



Lloyd's bashkëpunoi me Marinën Mbretërore të Britanisë së Madhe, për krijimin e «Fondit Patriotik», i cili, së bashku me strukturat bamirëse të forcave të armatosura, vepronte për të asistuar individët dhe familjet në nevojat e tyre urgjente për ndihmë dhe mbështetje. Lloyd's vazhdonte të ishte lider në fushën e grumbullimit të informacionit, sikundër u provua edhe në vitin 1794, kur Marina angleze u njoftua prej saj, që një prej anijeve të flotës angleze, ishte kapur nga një anije franceze, së bashku me të gjithë mallin, që ajo transportonte. Prestigji i Lloyd's u rrit edhe më shumë dhe, prej këtij momenti, Lloyd's filloi të përfitonte nga mbrojtja e Marinës angleze, në këmbim të informacioneve, që, kjo e fundit, merrte nga kompania siguruese.

Gjatë dhjetëvjeçarit të parë të shekullit të XIX, kompleksiteti i informacionit të përdorur në fushën e sigurimeve u rrit ndjeshëm. Krijimi i rrjetit të agjentëve Lloyd's ndikoi dukshëm në gjetjen dhe mbledhjen e informacionit të nevojshëm. Shtrirja e rrjetit të Lloyd's lejonte, që agjentët e saj të vepronin “si sytë dhe veshët e tregut”, duke zbuluar të vërtetën mbi problemet e hasura dhe duke propozuar zgjidhje.

Reputacioni i Lloyd's u mbështet dhe u përforcua vazhdimisht nga informacioni, që agjentët e saj, të cilët ndodheshin kudo, përcillnin te kompania. Kështu, në vitin 1810, Lloyd's kishte 1 600 anëtarë. Megjithatë, në vitin 1824, kompania hyri në një periudhë të vështirë, pasi, nga ana e qeverisë britanike, u miratua një ligj i ri, me anë të të cilit i jepej fund monopolit të kompanive, që mund të ofronin siguracione në fushën e tregtisë detare. Hapja e tregut të sigurimeve ndaj konkurrencës, bëri që Lloyd's të humbasë një pjesë të klientelës së saj (Bakraçi, 2007, fq. 35 – 39).

Për të rifituar prestigjin dhe klientelën e humbur, Lloyd's rriti numrin e agjencive në terren dhe shtoi botimet e “Listës së Lloyd”, e cila u bë një revistë e përditshme. Edhe disiplina ekonomike u përforcua. Tashmë, anëtarët e Lloyd's, të cilët gjendeshin në situatë falimentimi ose pamundësie për të paguar, detyroheshin të dilnin nga kompania. Prej vitit 1860, anëtarët e rinj, në momentin e aderimit në

kompani, duhej të nënshkruanin një garanci, e cila do të përdorej në rast se atyre u mungonin fondet për të paguar një detyrim.

Në vitin 1871, u miratua në Parlament “Akti Lloyd’s”, i cili përfshiu kompaninë Lloyd’s në kategorinë e organeve statusore, të cilat mund të merrnin vendime. Lloyd’s u formalizua juridikisht si shoqëri e posaçme në biznesin e sigurimeve (Bylykbashi, 2014, fq. 13). Ishte e ndaluar për çdo sigures, person privat, të firmoste angazhimet e tij me emrin Lloyd’s, nëse ai nuk ishte njohur, zyrtarisht, nga kompania si pjesë e saj.

Në fillim të shekullit të XX, Lloyd’s zgjeroi aktivitetin në zona të tjera të globit, por edhe në fusha të pambuluara deri në atë kohë, si tërmetet, uraganët etj. Lloyd’s filloi atëherë të mbledhë informacione të plota dhe t’i përpunojë ato, në mënyra të sofistikuara, për të arritur në caktimin e një primi. Këto veprime çuan në hapat e para të krijimit të strategjisë, që përdoret edhe sot, sipas së cilës caktimi i primit mbështetet në riskun e siguruar.

Në vitin 1902, Lloyd’s integron për herë të parë në aktivitetin e vet, auditimin e veprimtarisë së kompanisë. Marrja e kësaj mase, erdhi si pasojë e faktit, që shoqërisë iu desh të merrte përsipër pagimin e një detyrimi prej £ 100. 000, si pasojë e falimentimit të njërit prej pjesëtarëve të saj<sup>30</sup>. Verifikimi i parë i llogarive të anëtarëve të kompanisë Lloyd’s, nga një mision auditimi, është kryer në vitin 1908. Përveç kësaj, rreziku, që kompania të përgjigjet për detyrimet e kontratuara nga një apo disa anëtarë të saj, e shtyu atë të favorizojë krijimin e sindikatave të mëdha, me një numër më të madh pjesëtarësh. Anëtarët nuk përgjigjen kundrejt njëri-tjetrit për detyrimet, që kanë marrë përsipër. Ata përgjigjen tek të siguarit vetëm në masën e detyrimit, për të cilën janë angazhuar.

Në vitin 1903, aktiviteti i Lloyd’s u zgjerua edhe më shumë në aspektin ndërkombëtar, pasi, tashmë, përfaqësues të kompanisë mund të nënshkruanin polica sigurimi, në emër të Lloyd’s edhe në vende të ndryshme të botës, pra, jo vetëm në Mbretërinë e Bashkuar. Lloyd’s filloi të praktikojë risigurimin gjatë

---

<sup>30</sup> <https://www.lloyds.com/lloyds/about-us/history/corporate-history/1800s-to-modern-day> (15 gusht 2015).

viteve 1906-1907, pas tërmetit të madh të San Franciskos, të vitit 1906. Kompania vuri re se, në disa raste, kur ndodhnin ngjarje të paparashikuara dhe të paparashikueshme, si pasojë e të cilave, shuma të mëdha mund të kërkoheshin nga një apo disa subjekte të siguruara, shfaqej nevoja e ndarjes së peshës së sigurimit në disa operatorë, në mënyrë që, edhe të siguarit, të shpërbleheshin më mirë, edhe siguruesit të përballeshin me më pak vështirësi në respektimin e angazhimeve të marra. Zhvillimi i risigurimit në këtë periudhë të vonë, duke pasur parasysh faktin, që Kompania kishte më shumë se një shekull që vepronte në treg, ishte rrjedhojë e ndalimit, në Angli, të aktivitetit të risigurimit, nga vitet 1746 – 1864, si rezultat i keqpërdorimit të tij nga ana e disa siguruesve, për qëllime spekulative (Bakraçi, 2007, fq. 35 – 39). Pamundësia e risigurimit të një aktiviteti, për një kohë të gjërë, ka bërë që Lloyd's të praktikojë gjërësisht bashkësigurimin e një rreziku, ndërmjet anëtarëve të korporatës, metodë kjo, e cila ka vazhduar të ekzistojë edhe pas lejimit të risigurimit.

Në vitin 1911, “Akti Lloyd's” detajoi objektivat e kompanisë, të cilat përfshinin promovimin e interesave të anëtarëve të saj, si dhe grumbullimin dhe shpërndarjen e informacionit. Në vitin 1923, Lloyd's ndërmori hapat e para për krijimin e “Fondit qendror”, shumë, e cila do të përdorej nga kompania për të paguar detyrimet e anëtarëve të saj, në rast se, disa prej tyre, ndodheshin në pamundësi për të ekzekutuar, personalisht, detyrimet e marra përsipër. Krijimi i këtij fondi lindi si nevojë, pasi u bë i njohur fakti se, njëri prej anëtarëve të Kompanisë, Stanley Harrison, i cili përfaqësonte Sindikatën Harrison, kishte një detyrim prej £ 360 000, si pasojë e një sigurimi të lëshuar në fushën e mjeteve motorike dhe të kredive, të cilin ai nuk mundi ta shlyente. Mospagimi i kësaj shume, nga ana e njërit prej anëtarëve të Lloyd's, do të kërcënonte reputacionin dhe mbarëvajtjen e të gjithë kompanisë. Për të evituar një rrezik të tillë, anëtarët e Lloyd's ranë dakord për krijimin e fondit. Fondi u krijua në praktikë, 4 vjet më vonë. Ky njihet si rasti i parë, në të cilin u vu në zbatim parimi i

reciprocitetit, në aktivitetin e anëtarëve të kompanisë Lloyd's<sup>31</sup>. Lloyd's ka një strukturë specifike, e cila nuk ngjan me atë të kompanive tradicionale të sigurimit (Bakraçi, 2007, fq. 35 – 39). Ai funksionin në bazë të sindikatave. Funksionimi i Lloyd's me sindikata i ka ofruar shoqërisë një siguri dhe qëndrueshmëri të konsiderueshme, pasi ky sistem ka si qëllim ofrimin e sigurimit në lartësinë e angazhimeve të marra nga anëtarët e sindikatës dhe koordinimin, në mënyrë të tillë që, secili prej anëtarëve të përgjigjet për pjesën e tij të detyrimit, pa vënë në rrezik përmbushjen e angazhimeve të marra nga anëtarët e tjerë të sindikatës.

### **3.4. Zhvillimi i sigurimeve në Shqipëri pas Luftës së II<sup>të</sup> Botërore**

Kodi Civil, i miratuar gjatë periudhës midis dy luftërave botërore, në vitin 1929, nuk përmbante asnjë dispozitë specifike për kontratën e sigurimit. Rregulla bazë për sa i takon aktivitetin e sigurimit gjendeshin në Kodin Tregtar të vitit 1932. Shqipëria, e cila mori për shembull Kodet Civile dhe Tregtare të disa vendeve të Evropës Perëndimore, si Franca dhe Italia, ndoqi edhe në këtë drejtim të njëjtën rrugë duke integruar dispozitat për sigurimin në Kodin Tregtar dhe jo në atë Civil. Me mbarimin e Luftës së dytë Botërore dhe çlirimin e vendit, legjislacioni shqiptar pësoi ndryshime të rëndësishme.

Periudha e regjimit socialist në Shqipëri, karakterizohej nga një përqëndrim i fortë i pushtetit në nivel qendror dhe nga ndërhyrja e shtetit në shumë aspekte të jetës së njerëzve. Aktiviteti i sigurimit nuk lejohej të zhvillohej nga shoqëri private, ai ushtrohej vetëm nga Instituti Shtetëror i Sigurimeve, i cili ishte krijuar me dekret-ligjin nr. 628, dt. 04.06.1948. Sigurimi ishte i detyruar në disa raste, si për shembull në fushën e transportit dhe për godinat shtetërore. Në disa raste të tjera, ai ishte vullnetar, dhe shtetasve u njihej një liri më e madhe zgjedhjeje. Duke qënë se objekti i këtij disertacioni fokusohet së

---

<sup>31</sup> <https://www.lloyds.com/lloyds/about-us/history/corporate-history/1800s-to-modern-day> (15 gusht 2015).

pari në sigurimin vullnetar, trajtimi i rasteve të sigurimit të detyrueshëm do të bëhet vetëm për atë që është e nevojshme.

Kontrata e sigurimit, si institut juridik është parashikuar dhe trajtuar për herë të parë më ligjin nr. 2359, dt. 1956 “Mbi veprimet juridike dhe detyrimet”. Nëse krahasojmë dispozitat e këtij ligji me Kodin Civil aktualisht në fuqi, shohim që një pjesë e dispozitave, që trajtojnë kontratën e sigurimit janë identike (Hasneziri, 2011, fq. 6). Në periudhën e viteve 1945-1960, ekzekutivi shqiptar ka miratuar gjithashtu një sërë rregullimesh, në fushën e sigurimeve, në formën e akteve nënligjore. Më poshtë, do të bëjmë një paraqitje të rregullave, që ekzistonin në fusha të ndryshme të sigurimit.

### **3.4.1. Sigurimi i jetës<sup>32</sup>**

Instituti Shtetëror i Sigurimeve (Instituti) kryente sigurime mbi jetën, në formë të përzier pa vizitë mjekësore. Sigurimi, sipas kësaj forme, ishte i vlefshëm për rastet e jetës, të vdekjes dhe të invaliditetit. Instituti siguronte personat në moshën nga 16 deri në 55 vjeç. Përfshirje në sëmuret dhe invalidët. Një person nuk mund të lidhte më shumë se pesë kontrata<sup>33</sup>.

Dëmshpërblimi<sup>34</sup> paguhej në rast se vdekja ishte pasojë e një fatkeqësie apo sëmundjeje ngjitëse, por nuk paguhej në rast se vdekja vinte kur i siguruari ishte duke kryer një akt kriminal, apo si pasojë e veprimeve ushtarake<sup>35</sup>. Përgjegjësia ishte e plotë edhe në rast se ardhja e një fatkeqësie shkaktonte invaliditetin e të siguarit. Shuma e siguruar ndryshonte në varësi të kohës kur ishte lidhur kontrata<sup>36</sup>. Dëmshpërblimi nuk paguhej, gjithashtu, kur vdekja e të siguarit shkaktonte me paramendim nga

---

<sup>32</sup> Sigurimi i jetës rregullohej nga dispozitat e “Rregullores për sigurimin e jetës”, e datës 29 gusht 1949.

<sup>33</sup> Neni 2 i Rregullores.

<sup>34</sup> Autorë të ndryshëm janë të mendimit që, duke qënë se vlera ekonomike e jetës së njeriut nuk mund të vlerësohet saktë përpara vdekjes së tij, sigurimi i jetës nuk mund të cilësohet si kontratë dëmshpërblimi. Për këtë arsye, kontrata e sigurimit për jetën përbën një rast përjashtimor nga parimi i dëmshpërblimit, që karakterizon kontratat e sigurimit. - Rinald Guri, Elisabeta Gjoni, Anxhela Dervishi, “Bazat në sigurime”, Tiranë 2012, faqe 183.

<sup>35</sup> Neni 12 i Rregullores.

<sup>36</sup> Neni 6 i Rregullores.

përfituesi i sigurimit<sup>37</sup>. Në rast invaliditeti apo mbarimi të kontratës, ndërkohë, që i siguruari ishte ende gjallë, shuma e siguruar i paguhej të siguarit personalisht<sup>38</sup>.

Fatkeqësi, për të cilat Instituti merrte përgjegjësi të plotë, pas hyrjes në fuqi të kontratës së sigurimit, konsideroheshin ngjarjet e papritura, që vërtetoheshin, pavarësisht vullnetit të të siguarit dhe i shkaktonin atij vdekjen ose invaliditetin e përhershëm, të përgjithshëm ose pjesor në punë. Rregullorja përmendte disa shkaqe specifike si dhe listonte edhe një sërë sëmundjesh ngjitëse<sup>39</sup>.

Nëse invaliditeti ishte i përhershëm, i përgjithshëm ose i pjesëshëm, shuma e siguruar paguhej, kur invaliditeti shfaqej brenda një viti nga data e ngjarjes së fatkeqësisë. Instituti nuk përgjigjej nëse invaliditeti i shkaktuar e pengonte të siguarin të vazhdonte të ushtronte profesionin e deriatëhershëm, po nuk e pengonte të punonte, duke ushtruar një profesionin tjetër, të ndryshëm nga i pari<sup>40</sup>. Pagesa, që kryhej, nëse konstatohej invaliditeti, ishte në përpjestim me përqindjen e humbjes së përhershme të aftësisë për punë. I siguruari përfitonte gjithashtu edhe disa lehtësira të tjera, që kishin të bënin me pagimin e primeve për periudhën në vijim<sup>41</sup>.

Të njëjtat rregulla vlenin edhe kur ndodhte që, i njëjti person, të pësonte invaliditet më tepër sesa një herë. Megjithatë, shuma e paguar, për të gjitha rastet së bashku, nuk mund të tejkalonte shumën e siguruar<sup>42</sup>. Përqindja e humbjes së përhershme të aftësisë për punë, e shkaktuar nga fatkeqësitë, përcaktohej me vendim mjekësor<sup>43</sup>. Pavarësisht nga pagesat për raste invaliditeti, shuma e siguruar paguhej tërësisht me vdekjen e të siguarit, ose me mbarimin e afatit të kontratës, kur i siguruari ishte ende gjallë<sup>44</sup>.

---

<sup>37</sup> Neni 12 i Rregullores.

<sup>38</sup> Neni 5 i Rregullores.

<sup>39</sup> Neni 7 i Rregullores.

<sup>40</sup> Neni 8 i Rregullores.

<sup>41</sup> Neni 9 i Rregullores.

<sup>42</sup> Neni 11 i Rregullores.

<sup>43</sup> Neni 10 i Rregullores.

<sup>44</sup> Neni 11 i Rregullores.

Nëse gjatë kohës, që i siguruari ishte gjallë ose pas vdekjes së tij, vërtetohej që ai kishte lidhur më shumë se 5 kontrata, Instituti paguante vetëm ato 5 kontrata, të cilat paraqiteshin të parat. Nëse, kontratat paraqiteshin të gjitha së bashku, atëherë paguheshin vetëm 5 të parat, duke u marrë për bazë data e lidhjes së tyre. Kontratat e tjera mbeteshin pa fuqi dhe Instituti u kthente të interesuarve 75% të primeve të paguara<sup>45</sup>.

Në aspektin formal, Rregullorja parashikonte që, personi, i cili donte të sigurohej, duhej të paraqiste pranë Institutit një kërkesë, sipas modelit të përcaktuar nga vetë Instituti<sup>46</sup>. Personi, i cili kërkonte të lidhte kontratën e sigurimit të jetës, së bashku me kërkesën duhej të parapaguante primin për dy muaj. Kontrata hynte në fuqi në momentin, kur Instituti lëshonte policën<sup>47</sup>. Pra, lidhja e kontratës së sigurimit finalizohej me lëshimin e policës nga Instituti<sup>48</sup>. Kontrata hynte në fuqi në orën 24 të ditës së dorëzimit të policës te i siguruarit<sup>49</sup>. Primi i parapaguar konsiderohej si pagesë e dy kësteve të para. Kjo shumë rikthehej nga Instituti në rast se kërkesa për të lidhur kontratën nuk pranohej prej tij ose nëse personi, që kishte paraqitur kërkesën, vdiste para se të lidhej kontrata<sup>50</sup>.

Rregullorja i njihte të drejtën Institutit që, në rast se vërtetohej që, gjatë lidhjes së kontratës, i siguruari kishte dhënë informacione të pavërteta lidhur me gjendjen e tij shëndetësore, ai të anulonte kontratën dhe të mos i kthente primet e paguara të siguarit. Gjithsesi, kjo mundësi ishte e vlefshme vetëm për një periudhë prej dy vjetësh, që nga data e lidhjes së kontratës. Nëse fakti i dhënies së informacioneve të pavërteta nga i siguruari zbulohej më vonë se kjo datë, anulimi i kontratës, për këtë arsye, nuk ishte më i mundur<sup>51</sup>.

---

<sup>45</sup> Neni 13 i Rregullores.

<sup>46</sup> Neni 14 i Rregullores.

<sup>47</sup> Neni 15 i Rregullores.

<sup>48</sup> Të njëjtin rregull gjejmë edhe sot, pasi Kodi Civil parashikon që lidhja e kontratës bëhet nëpërmjet lëshimit të policës nga siguruari. (neni 1114 i Kodit Civil)

<sup>49</sup> Neni 17 i Rregullores.

<sup>50</sup> Neni 16 i Rregullores.

<sup>51</sup> Neni 18 i Rregullores.

Primet pagueshin në fillim të çdo muaji<sup>52</sup> dhe llogariteshin në bazë të rregullave dhe kufijve të caktuar nga Instituti. Shumat, që mund të përfitoheshin nga të siguruarit me moshë nga 16 deri në 30, vjet ishin të njëjta. Po ashtu, të siguruarit në moshën nga 31 deri në 40 vjeç përfitonin të njëjtin dëmshpërblim. Më pas, shumat, që mund të përfitoheshin nga të siguruarit, ndryshonin me pesëvjeçarë. Për llogaritjen e këtyre shumave merrej në konsideratë kohëzgjatja totale e kontratës së sigurimit, e cila mund të ishte 15 ose 20 vjet<sup>53</sup>. Në caktimin e moshës, koha më pak se gjashtë muaj nuk llogaritej dhe ajo mbi gjashtë muaj, konsiderohej vit i plotë<sup>54</sup>. I siguruari mundej të ndryshonte emrin e përfituesit të shpërblimit<sup>55</sup> si dhe të prishte kontratën e sigurimit para afatit e të kërkonte kthimin e shumës<sup>56</sup>.

Nëse i siguruari nuk e paguante primin e një muaji, kontrata nuk ndërpritej menjëherë. Ajo vazhdonte të ishte në fuqi edhe për dy muaj të tjerë. Gjatë kësaj periudhe, i siguruari kishte të drejtë të plotësonte pagesën. Kur primi nuk paguhej brenda 2 muajve nga mbarimi i afatit për pagimin e tij, sigurimi humbiste fuqinë 24 orë pas mbarimit të këtij afati<sup>57</sup>. Nëse paraqiste një kërkesë për këtë qëllim, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e humbjes së fuqisë së kontratës, i siguruari mundej të përtërinte sigurimin, që kishte humbur fuqinë, me pëlqim të Institutit dhe mbi bazën e kushteve të mëparshme, për shumën e plotë<sup>58</sup>.

Nëse rreziku realizohej, me paraqitjen e kërkesës për pagimin e shumës dhe të dokumentacionit të nevojshëm<sup>59</sup>, nga ana e të siguruarit, Instituti kishte dy muaj kohë për të kryer pagesën. Përgjegjësia e tij përfundonte 24 orë pas kalimit të këtij afati. Në rast se Instituti i kthente të siguruarit, shumën përkatëse,

---

<sup>52</sup> Neni 19 i Rregullores.

<sup>53</sup> Rregullorja përmbante një shtojcë në formën e tabelës, në të cilën ishin shënuar vlerat e primit dhe të dëmshpërblimit sipas moshave.

<sup>54</sup> Po aty.

<sup>55</sup> Ndryshimi i emrit të përfituesit bëhej me kërkesën me shkrim të të siguruarit (Neni 27 i Rregullores).

<sup>56</sup> Neni 23 i Rregullores.

<sup>57</sup> Neni 23 i Rregullores.

<sup>58</sup> Neni 26 i Rregullores.

<sup>59</sup> Neni 29 i Rregullores.



përpara mbarimit të dy muajve, atëherë, përgjegjësia e Institutit mbaronte në momentin e pagimit të shumës<sup>60</sup>. I siguruari duhej të njoftonte Institutin për çdo ndryshim të vendit të pagesës.

Në rast se, pas ngjarjes së fatkeqësisë, nuk mund të përcaktohej menjëherë përqindja e humbjes së përhershme të aftësisë për punë, Instituti, paguante mbi bazën e mendimit të mjekut dhe me kërkesën e të siguarit, përqindjen minimale. Përqindja përfundimtare përcaktohej pas mbarimit të mjekimeve. Në qoftë se mjekimet nuk përfundonin brenda një viti, atëherë pagesa bëhej ditën, që mbushej viti, duke marrë si pikënisje datën e ndodhjes së fatkeqësisë. Për pagimin e shumës përfundimtare, merreshin në konsideratë edhe shumat e paguara më herët<sup>61</sup>. Shuma e mbetur duhej të paguhej brenda një muaji, nga paraqitja e dokumentave pranë Institutit<sup>62</sup>.

Në pagimin e shumës së siguar, pas vdekjes së të siguarit, Instituti merrte në konsideratë edhe primet e papaguara, deri në përfundim të vitit, gjatë të cilit kishte vdekur i siguruari dhe zbriste këto shuma nga shpërblimi, që do t'i paguhej përfituesit<sup>63</sup>. Në rastet kur e drejta e personit, të caktuar për marrjen e shumës së siguar, kundërshtohej nga ndonjë person tjetër, Instituti kryente pagesën vetëm në bazë të vendimit gjyqësor, që kishte zgjidhur konfliktin<sup>64</sup>. Kërkesat për tërheqjen e shumës së siguar duhej t'i paraqiteshin Institutit jo më vonë se 2 vjet nga data e vdekjes së të siguarit ose nga data e ndodhjes së fatkeqësisë, që kishte shkaktuar invaliditetin ose nga data e mbarimit të kontratës, kur i siguruari ishte ende gjallë. Me kalimin e këtij afati, humbiste e drejta e tërheqjes së shumës së siguar<sup>65</sup>.

---

<sup>60</sup> Po aty.

<sup>61</sup> Neni 30 i Rregullores.

<sup>62</sup> Neni 32 i Rregullores.

<sup>63</sup> Neni 32 i Rregullores.

<sup>64</sup> Neni 33 i Rregullores.

<sup>65</sup> Neni 34 i Rregullores.

### 3.4.2. Sigurimi vullnetar i pasurisë private

Pavarësisht kufizimeve për ekzistencën dhe përdorimin e pronës private, regjimi socialist ndërmori disa nisma për rregullimin e problematikave, që lidhen me sigurimin vullnetar të pronës dhe sigurimin e pronës private. Përmendim këtu:

- Rregulloren për sigurimin vullnetar të pasurisë, të datës 5 Gusht 1948<sup>66</sup>.
- Rregulloren për sigurimin e pasurisë private, të datës 22 Gusht 1949<sup>67</sup>.

#### ➤ Rregullorja për sigurimin vullnetar të pasurisë

Instituti siguronte pasurinë e luajtshme<sup>68</sup> dhe të paluajtshme kundër zjarrit, rrufesë dhe shpërthimit të gazit. Sigurimi i kontratuar për një grumbull sendesh vlente edhe për sendet e anëtarëve të familjes dhe të personave, në ngarkim të të sigurvearit, që rronin në një ekonomi shtëpiake të përbashkët me të, ose shërbenin, sipas profesionit të tyre, në vendet ku gjendeshin sendet e siguruara.

Në sigurimin vullnetar kundër rreziqeve të përmendura më sipër, sendet siguroheshin për shumën, që dëshironte i siguruari, e cila nuk duhej, gjithsesi, të ishte më e lartë se vlera reale e këtyre sendeve, në datën e lidhjes së kontratës. Kur vlera e sendeve shtoej, i siguruari kishte mundësinë të shtonte edhe shumën e sigurvearit. Përfundimisht bënë vetëm sendet për të cilat, paraprakisht lidhjes së kontratës, bëhej vlerësimi i tyre. Kur sigurimi lidhej për arsye të një detyrimi ligjor, sendet siguroheshin për vlerën e tyre reale, në kohën e lidhjes së kontratës<sup>69</sup>. Rregullorja kishte përcaktuar, shprehimisht, kategoritë e dëmeve,

---

<sup>66</sup>Rregullorja është botuar në Gazetën Zyrtare nr. 83.

<sup>67</sup> Rregullorja është botuar në Gazetën Zyrtare nr. 61.

<sup>68</sup> Nuk mund të lidheshin kontrata sigurimi për disa kategori sendesh të luajtshme, si për shembull dokumentat, mjetet monetare gurët e çmuar dhe lulet. Sendet që bënin pjesë në kategoritë e përjashtuara nga sigurimi, siguroheshin nga Instituti, vetëm atëherë, kur diçka e tillë përmendej, specifikisht, në kontratë. Në këto raste, paraprakisht lidhjes së kontratës, duhej të bëhej vlerësimi i sendeve, që do të siguroheshin (Neni 6 i Rregullores – Objekti).

<sup>69</sup> Neni 2 i Rregullores, “Shuma dhe vlefë e sendit të sigurvearit”.

që shpërbleheshin nga Instituti<sup>70</sup>. Rregullat për mënyrën e lidhjes së kontratës, si dhe për fillimin dhe mbarimin e përgjegjësisë së Institutit ishin të njëjta me ato të caktuara për kontratat e sigurimit të jetës<sup>71</sup>.

Sigurimi vullnetar kontratohej për të paktën një vit dhe vazhdonte pa afat, nëse i siguruari nuk e denonconte me letër të porositur, drejtuar Institutit, 30 ditë para përfundimit. Për sendet e luajtshme, kontrata e sigurimit mund të lidhej për një periudhë më të shkurtër se një vit. Ripërtëritja e kontratës së sigurimit, për sendet e luajtshme, nuk ishte automatike. I siguruari duhet të bënte kërkesë për këtë qëllim. Mbi të siguarin rëndonte detyrimi për të dhënë informacion të plotë dhe të saktë, mbi bazën e pyetjeve të bëra nga Instituti. Dhënia e informacioneve të pavërteta, në rast se provohej, përbënte shkak që Instituti të anulonte kontratën ose të kërkonte rritjen e primit. Të njëjtat rregulla gjejmë edhe sot, pasi siguruesit, kur konstaton që i siguruari me vetëdije ka dhënë informacione të pasakta dhe jo të plota, i njihet e drejta që të anulojë kontratën ose të rritë çmimin e primit. Siguruesi, ka gjithashtu mundësinë të ndryshojë masën e shumës së sigurimit ose kohëzgjatjen e kontratës (Hasneziri, 2011, fq. 28).

Anullimi i kontratës mund të bëhej nga Instituti edhe nëse ai konstatonte, që i siguruari kishte fshehur me qëllim, një rrethanë të rëndësishme ose që, nga pakujdesia e rëndë, kishte dhënë informacione të paplota dhe të pasakta. Detyrimi i Institutit përfundonte në orën 24 të ditës, kur i siguruari merrte dijeni për njoftimin e anulimit<sup>72</sup>.

I siguruari duhej të njoftonte me shkrim Institutin për realizimin e rrezikut, në momentin kur ai merrte dijeni, duhet të merrte masa për shpëtimin e sendeve të siguruara dhe për kufizimin e dëmit, si dhe duhej të respektoje udhëzimet e dhëna nga Instituti në këtë drejtim. Në rast të kundërt, Instituti nuk

---

<sup>70</sup> Neni 3 i Rregullores, “Përgjegjësia e I.S.I.S.-it”.

<sup>71</sup> Neni 4 i Rregullores “Mënyra e lidhjes së kontratës”.

<sup>72</sup> Instituti nuk mund të anulonte kontratën, në rast se:

- Në kohën e lidhjes së saj, ai kishte dijeni, ose duhej të kishte dijeni, për faktin që informacioni i dhënë nga i siguruari, nuk ishte i saktë.
- I siguruari nuk ishte fajtor për dhënien e informacioneve të paplota dhe të pasakta.
- Fshehja e informacionit, apo dhënia e informacionit të pasaktë ose të paplotë, nuk ishin rezultat i një veprimi keqdashës dhe nuk kishin ndikuar në vendimmarrjen e Institutit për lidhjen e kontratës, nuk kishin pasur për pasojë shkaktimin e rrezikut dhe as kishin ndikuar në rëndimin e detyrimit të Institutit kundrejt të siguarit

përgjigjej për atë pjesë të dëmit, që kishte ardhur nga kjo pakujdesi<sup>73</sup>. Lëvizja e sendeve të siguruara mund të bëhej vetëm në rast se një veprim i tillë shërbente për zvogëlimin e dëmit.

Në rast se i siguruari nuk ishte dakord me vlerësimin e dëmit, ai kishte të drejtën t'u drejtohej organeve më të larta ose gjykatës. Shpenzimet e bëra për shpëtimin e sendeve të siguruara, paguheshin nga Instituti, deri në masën e shumës së siguar, ndërsa shpenzimet e bëra me urdhër të tij, paguheshin tërësisht, pavarësisht nëse ato, së bashku me dëmin, tejkalonin shumën e siguar.

Nëse, në ditën e ndodhjes së dëmit, vlera reale e sendeve të siguruara ishte më e vogël se shuma e siguar, Instituti paguante në masën e vlerës reale të sendit. Në të kundërt, në rast se, në ditën e rënies së zjarrit, vlera e sendeve të siguruara ishte më e madhe sesa shuma e siguar, Instituti paguante vetëm atë pjesë të dëmit real, që i korrespondonte raportit përpjestimor midis shumës së siguar dhe vlerës reale të sendeve të siguruara në ditën e dëmit<sup>74</sup>.

Instituti nuk shpërblente dëmet e shkaktuara nga ngjarjet e luftës. Gjithashtu, përjashtoheshin nga shpërblimi dëmet e shkaktuara me qëllim, nga pakujdesia e madhe e të siguarit ose e familjes së tij. Shpërblimi duhej t'i kthehej Institutit, nëse, pas pagimit të dëmit, rezultonte se ai ishte shkaktuar me qëllim. Përgjegjësia për pakujdesi të rëndë ose për faj, në shkaktimin e dëmit, caktohej nga organet gjyqësore<sup>75</sup>.

I siguruari ishte i detyruar të njoftonte institutin brenda 5 ditëve, në rast se kryente transferimin e sendeve të siguruara nga një vend në një tjetër. Në qoftë se afati nuk respektohej, Instituti nuk përgjigjej për dëmin, që mund të pësonin sendet e siguruara. Instituti paguante shpërblim për dëmin vetëm në rast se e kishte pranuar transferimin, shprehimisht ose në heshtje<sup>76</sup>. Detyrimi për informim ekzistonte edhe për rastet kur i siguruari ndërmernte një veprim, që rriste rrezikun për sendet e siguruara<sup>77</sup>, përndryshe

---

<sup>73</sup> Neni 5 i Rregullores, “Detyrimi i të siguarit gjatë dhe mbas kontratës”.

<sup>74</sup> Po aty.

<sup>75</sup> Neni 7 i Rregullores, “Dëmet që I.S.I.S.-i nuk shpërblen”.

<sup>76</sup> Neni 8 i Rregullores, “Lajmërimi i transferimit të sendeve të siguruara”.

<sup>77</sup> Afati për njoftim në këtë rast ishte prej 15 ditësh.

Instituti nuk ishte përgjegjës për shpërblimin e dëmit. Instituti detyrohej gjithsesi të shpërblente dëmin, në rast se i siguruari nuk ishte fajtor për moslajmërimin ose vonesën e lajmërimit. Shpërblimi paguhej, gjithashtu, edhe në rast se zmadhimi i rrezikut nuk kishte ndikuar as në provokimin e zjarrit dhe as në rëndimin e detyrimit të Institutit<sup>78</sup>.

Në rast se Instituti vendoste anullimin e kontratës<sup>79</sup> dhe zmadhimi i rrezikut ndodhte pa dëshirën e të siguarit, anullimi kishte fuqi 30 ditë pas lajmërimit të të interesuarit. Anullimi i kontratës nuk mund të bëhej për shkak të zmadhimit të rrezikut, në rast se Instituti ishte informuar për këtë fakt dhe nuk e kishte denoncuar kontratën në një afat prej 30 ditësh, që nga marrja e njoftimit për zmadhimin e rrezikut, ose kishte vazhduar të arkëtonte primin, apo të paguante për dëmin, që ishte shkaktuar<sup>80</sup>. Në rast anullimi të kontratës, i siguruari humbiste të drejtën e dëmshpërblimit. Gjithsesi, i siguruari ruante të drejtën për dëmshpërblim, në rast se shkelja e rregullave nuk ishte bërë me qëllim të keq apo nga pakujdesia, si dhe në rast se shkelja nuk kishte ndikuar as në rënien e zjarrit dhe as në rëndimin e detyrimit, që duhej të paguante Instituti<sup>81</sup>.

Në rast se dëmi realizohej, pas pagimit të dëmshpërblimit, sendet e mbetura konsideroheshin të siguruara për diferencën, që rezultonte midis shumës së siguruar në fillim dhe asaj të paguar. Në të njëjtën masë, pakësohej edhe primi për vitet e mbetura nga kontrata e sigurimit. Pas pagimit të dëmit, Instituti kishte mundësinë të denonconte sigurimin vullnetar kundër zjarrit, duke e njoftuar të siguarin 30 ditë para prishjes së kontratës<sup>82</sup>.

Kur përmbajtja e policës, ndryshonte nga ajo e propozimit, konsiderohej që propozuesi e kishte pranuar në heshtje përmbajtjen e policës, në qoftë se brenda 30 ditëve, pas marrjes së saj, nuk i kundërshtonte ndryshimet. Kur zvogëlohej rreziku, për të cilin ishte lidhur kontrata dhe për të cilin ishte

---

<sup>78</sup> Neni 9 i Rregullores, “Lajmërimi i zmadhimit të rrezikut”.

<sup>79</sup> Anullimi i kontratës mund të ishte pasojë e mosrespektimit nga ana e të siguarit e urdhërimeve të Institutit për mbrojtjen nga zjarri.

<sup>80</sup> Po aty.

<sup>81</sup> Neni 10 i Rregullores, “Respektimi i dispozitave për masa mbrojtëse”.

<sup>82</sup> Neni 12 i Rregullores, “Vazhdimi i sigurimit mbas zjarrit”.

caktuar një prim më i madh, të siguruarit i lindte e drejta të kërkonte pakësimin e primit, duke filluar nga viti pasardhës. E drejta për ngritjen e padisë, në lidhje me kontratën e sigurimit, i nënshtrohej afatit të parashkrimit prej një viti, që nga dita kur palëve u kishte lindur kjo e drejtë<sup>83</sup>.

### ➤ **Rregullorja për sigurimin e pasurisë private**

Nëse krahasojmë Rregulloren e vitit 1948 me atë të miratuar në vitin 1949, vemë re se, rregullat bazë, për sa u takon detyrimeve dhe të drejtave të palëve si dhe procedurave, që duheshin ndjekur për lidhjen e kontratës dhe për shpërblimin e dëmit, ishin thuajse të njëjtat. Rregullorja e vitit 1949 paraqitet me e plotë, për sa i takon llojit të rrezikut, që mbulohet nga Instituti. Ky element tregon rëndësinë në rritje, të sigurimit dhe përpjekjet e ligjvënësit për të krijuar rregulla sa më të qarta dhe më të plota për zbatim, duke lehtësuar kështu zgjidhjen e situatave në praktikë. Në ndryshim nga Rregullorja për sigurimin vullnetar të pasurisë, Rregullorja për sigurimin e pasurisë private, përmbante një listë të tarifave për sigurimin e pronave, të cilat ndryshonin në varësi të vendndodhjes së pronës dhe të karakteristikave të saj, nëse pronat ishin lehtësisht të dëmtueshme nga zjarri apo jo. Rregullorja parashikonte, gjithashtu, edhe tarifa primesh, në funksion të kohëzgjatjes së kontratës së sigurimit<sup>84</sup>.

### **3.4.3. Rregullorja për sigurimin vullnetar të sendeve shtëpiake<sup>85</sup>**

Arkat e Kursimeve dhe Sigurimeve Shtetërore (AKSSH), të cilat kishin zëvendësuar drejtoritë e Institutit, siguronin, në mënyrë vullnetare, sendet shtëpiake, pronë e qytetarëve, shtetas shqiptarë, ose të huaj, që banonin në Shqipëri. Gjithashtu, mund të siguroheshin edhe aktivitetet tregtare, të cilat pranonin

---

<sup>83</sup> Neni 13 i Rregullores, “Ndryshime në mes përmbajtjes së policës dhe të propozimit”.

<sup>84</sup> Rregullorja shoqërohej nga një shtojcë, e cila përmbante tarifat e aplikueshme.

<sup>85</sup> Më 12 prill 1955, është miratuar një rregullore specifike, “Mbi sigurimin vullnetar të sendeve shtëpiake”.

për ruajtje sende të shtetasve të ndryshëm<sup>86</sup>. Rregullorja përjashtonte sigurimin e dokumentave, akteve, dorëshkrimeve, letrave me vlerë, gurëve dhe stolive të çmuara, kartëmonedhave, orëve të dorës dhe të xhepit, fotografive dhe luleve dekorative<sup>87</sup>.

Rreziqet, për të cilat mund të lidhej kontrata, ishin po të njëjtat me ato, që parashikonte Rregullorja e vitit 1949, për sigurimin e pasurisë private. Rregullorja parashikonte që sigurimi i sendeve bëhej si rregull pas këqyrjes së tyre dhe mbas kontrollit preventiv të punonjësve të AKSSH. Megjithatë, ekzistonin disa përjashtime, në qoftë se vlera e kontratës nuk tejkalonte disa kufij, të përcaktuar nga Rregullorja. Kufijtë ishin të ndryshëm, në varësi të vendndodhjes së pronës (në fshat, apo në qytet) dhe në varësi të numrit të anëtarëve të familjes, që kërkonte sigurimin, (nëse ishte një familje me disa anëtarë, apo nëse i siguruari ishte i pamartuar)<sup>88</sup>.

Në mënyrë klasike, Rregullorja parashikonte që kontrata lidhej me shkrim, mbi kërkesën e të sigurvearit dhe që ajo përtërihej automatikisht, në qoftë se i siguruari nuk e denonconte, me shkrim, 30 ditë para mbarimit të afatit. Rregullorja parashikonte, gjithashtu, një vlerë minimale primi, nën të cilën nuk lejohej të lidhej kontrata. Nëse sendet nuk ishin siguruar për vlerën e tyre të plotë, ose, nëse, pas lidhjes së kontratës, ishin blerë sende të tjera, i siguruari mund të lidhte një kontratë të re, për të zëvendësuar të parën duke paguar edhe diferencën e primit<sup>89</sup>.

Sigurimi i sendeve mund të bëhej në mënyrë individuale ose kolektivisht. Rregullorja parashikonte të drejtat dhe detyrimet e palëve, për sa i përket marrjes së masave si për shmangien dhe zvogëlimin e dëmit, ashtu edhe për pjesën e pagimit të dëmshpërblimit, në rast të plotësimit të kriterëve. Ajo parashikonte përjashtimin nga pagimi i dëmshpërblimit, nëse rezultonte se dëmi ishte shkaktuar me faj nga i siguruari ose një anëtar i familjes së tij, në moshë madhore (mbi 14 vjeç), ose nëse dëmi ishte

---

<sup>86</sup> Neni 1 i Rregullores.

<sup>87</sup> Neni 2 i Rregullores.

<sup>88</sup> Nenet 3 – 5 të Rregullores.

<sup>89</sup> Nenet 6 – 7 të Rregullores.

rezultat i veprimeve të pakujdesshme të njërit prej tyre. Pakujdesia dhe veprimi me paramendim përcaktoheshin nga organet gjyqësore<sup>90</sup>. Gjithashtu, nuk paguhej dëmi i shkaktuar, në rast se vërtetohej, që i siguruari kishte dhënë informacione të pasakta, për sendet e dëmtuara, ose kishte rritur, artificialisht, vlerën e dëmit. Pagesa e dëmit mund të vonohej, derisa policia të mbyllte kërkimet e saj për sendet e zhdukura, por, në çdo rast, jo më shumë se 6 muaj. Mosrespektimi i detyrimeve, që rëndonin mbi të siguruarin, përbënte shkak për mospagimin e shumës së siguruar nga struktura përkatëse<sup>91</sup>.

Ankimet kundër vendimeve të AKSSH, për të mos dëmshpërblyer një të siguruar ose për vlerën e shpërblimit të paguar, u drejtoheshin së pari organeve administrative eprore dhe më pas organeve gjyqësore<sup>92</sup>.

#### **3.4.4. Sigurimi i gjësë së gjallë**

Regjimi socialist i ka kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes së kulturave bujqësore. Paralelisht, edhe mbrojtja e kafshëve, që shërbenin për prodhimin e ushqimit, u bë objekti i dispozitave të ndryshme nënligjore, të cilat parashikonin rregulla specifike për mënyrën e shpërblimit të tyre. Kujdesi i treguar për këto fusha shpjegohet lehtë me rëndësinë, që iu dha punimit të tokës dhe shfrytëzimit të kafshëve, në këtë periudhë, kur një ndër synimet kryesore të organeve qeveritare ishte prodhimi në vend i ushqimeve të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e popullsisë. Krijimi i kooperativave ishte një faktor tjetër, i cili bëri tejet të nevojshme ekzistencën e sigurimeve në këto fusha, pasi, në këtë mënyrë, sigurohej vazhdimësia e aktivitetit të tyre dhe kontrolli mbi personat, që merrnin pjesë në funksionimin e këtyre strukturave.

Në fushën e sigurimit të kafshëve gjejmë dy akte shumë të rëndësishme:

- Urdhëresën e Qeverisë nr. 14, dt. 05.04.1951 “Mbi sigurimin e gjësë së gjallë”;

---

<sup>90</sup> Neni 27 i Rregullores.

<sup>91</sup> Nenet 28 – 29 të Rregullores.

<sup>92</sup> Nenet 31 – 34 të Rregullores.



- Urdhëresën e Qeverisë nr. 1, dt. 12.01.1955, me të njëjtin titull.

Qëllimi i këtyre Urdhëresave, të nxjerra në zbatim të Dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor, nr. 1146, dt. 11.09.1950, i cili trajtonte organizimin e Institutit, ishte ndihma në zhvillimin e gjësë së gjallë, duke kompensuar humbjet, që pësonin ndërmarrjet, institucionet, kooperativat, organizatat dhe ekonomitë bujqësore individuale, nga ngordhja e kafshëve të tyre prej sëmundjeve ose fakeqësive.

Urdhëresat parashikonin kategoritë e kafshëve, që mund të siguroheshin, të cilat ndaheshin në varësi të përdorimit që u bëhej, nëse ishin kafshë për punë, kafshë race, apo kafshë për mish. Udhëresa e vitit 1955 zgjeronte kategoritë e kafshëve, që mund të siguroheshin, duke përfshirë edhe gjedhët<sup>93</sup>. Kafshët siguroheshin në varësi të moshës. Kooperativat mund të siguronin, jo vetëm kafshët e tyre, por edhe ato, që u ishin dhënë në përdorim përkohësisht<sup>94</sup>.

Ajo që bie në sy, duke krahasuar këto dy urdhëresa është që, Urdhëresa nr. 14, e vitit 1951, parashikonte rregulla të ndryshme sigurimi, në varësi të subjekteve, që kërkonin të lidhnin kontratë. Përveç dallimeve, midis shtetasve dhe strukturave shtetërore, kjo urdhëresë parashikonte rregulla të ndryshme edhe për vetë organizmat shtetërore, të cilat ndaheshin në kategorinë e kooperativave bujqësore dhe në atë të ndërmarrjeve, instituteve dhe organizatave<sup>95</sup>. Në mënyrë të përgjithshme, për kafshët e mbajtura nga organizma shtetërore, sigurimi lejohej për afate më të gjata, pra edhe për kafshë, që ishin më të vjetra në moshë, ndërkohë që, për subjektet private, rregullat ishin më strikte<sup>96</sup>. Urdhëresa nr. 1, e vitit 1955, nuk bënte më dallime midis llojeve të ndryshme të strukturave shtetërore, por vetëm për personat fizikë, të cilët vazhdonin t'u nënshtroheshin të njëjtave kufizime, për sa i takon moshës së kafshëve të siguruara<sup>97</sup>.

---

<sup>93</sup> Neni 1 i Urdhëresës nr. 1, dt. 12.01.1955.

<sup>94</sup> Neni 1 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>95</sup> Neni 2 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>96</sup> Nenet 2 – 3 e Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>97</sup> Neni 2 i Urdhëresës.

Strukturat shtetërore mund të siguronin kafshë të ndryshme, edhe pse, në momentin e lidhjes së kontratës, ato u ishin dhënë në përdorim të tretëve, me kusht që vlera e siguruar të mos ishte më e lartë se 85% e shumës, për të cilën personi i tretë ishte përgjegjës përpara pronarit<sup>98</sup>. Urdhëresat parashikonin të njëjtat përjashtime nga sigurimi<sup>99</sup>. Kafshët siguroheshin kundër ngordhjes, e cila mund të ishte pasojë e sëmundjeve ose e fatkeqësive. Rastet e fatkeqësive nuk jepeshin nga asnjëra prej urdhëresave, por përcaktoheshin me akt të Ministrit të Financave. Instituti ose AKSSH shpërblenin dëmet e shkaktuara, nëse therja e kafshëve ishte urdhëruar nga veterineri për arsye fatkeqësie apo sëmundjeje të pashërueshme, ose për të evituar përhapjen e një sëmundjeje ngjitëse<sup>100</sup>.

Në Urdhëresën e vitit 1951 parashikohej që kafshët e punës siguroheshin për një shumë, e cila përcaktohej duke mbajtur parasysh çmimet e tregut<sup>101</sup>, ndërkohë që Urdhëresa e vitit 1955 parashikonte që, shumat për të cilat mund të siguroheshin këto kafshë, përcaktoheshin nga Ministri i Financave<sup>102</sup>. Ndërkohë që, përcaktimi i vlerës, për të cilën mund të sigurohej një kafshë, që përdorej për ushqim, bëhej duke pasur parasysh moshën e saj dhe sasinë e ushqimit të përfutur<sup>103</sup>.

Në Urdhëresën e vitit 1951 parashikohej që, kur një kontratë sigurimi lidhej për herë të parë, qoftë kjo për kafshët e punës, qoftë për kafshët, që shërbenin për ushqim, shuma e sigurimit caktohej, në të njëjtën përqindje të vleftës së kafshëve, me të cilën ishin siguruar kafshët e tjera të të njëjtit lloj<sup>104</sup>. Të dyja Urdhëresat parashikonin që, kur përsëritej kontrata e sigurimit, në një kohë që kafshët ishin në karantinë, shuma e sigurimit për çdo kafshë, nuk mund të caktohej në një shifër më të madhe, se sa ajo me të cilën kafshët ishin siguruar në kontratën e mëparshme<sup>105</sup>. Instituti dhe, më vonë, AKSSH, mund të kufizonin shumën e sigurimit nën vlerën e caktuar të gjësë së gjallë, në mënyrë që një pjesë e rrezikut

---

<sup>98</sup> Neni 7 i Urdhëresës dt. 12.01.1955.

<sup>99</sup> Neni 7 i Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 6 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>100</sup> Neni 4 i Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 5 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>101</sup> Neni 6.

<sup>102</sup> Neni 5.

<sup>103</sup> Neni 6 i Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 7 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>104</sup> Neni 9.

<sup>105</sup> Neni 8 i Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 10 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

të mbetej në përgjegjësinë e subjektit, që lidhte kontratën<sup>106</sup>. Urdhëresat nuk jepnin asnjë detaj apo kriter, për mënyrën se si duhej të llogaritej pjesa e rrezikut, që mbetej në përgjegjësinë e të siguruarit.

Kontratat e sigurimit të kafshëve lidheshin për një periudhë njëvjeçare. Afati i kohëzgjatjes së kontratës mund të ishte më i shkurtër se një vit, në rast se objekt sigurimi ishin kafshët, pronë e ndërmarrjeve, instituteve dhe organizatave kooperativiste dhe shoqërore, që, përkohësisht, ndodheshin pranë të tretëve. Në këto raste, kohëzgjatja e kontratës duhej të përputhej me kohën e marrjes së kafshëve nga personat e tretë<sup>107</sup>.

Kontratat mund të lidheshin me afat më të shkurtër edhe nëse ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat kërkonin të siguronin kafshë, të cilat ato i merrnin për herë të parë në pronësi. I njëjti rregull vlente edhe kur kafsha, pronë e ndërmarrjes, institucionit apo organizatës, mbushte moshën për t'u siguruar. Duhet pasur parasysh që sigurimi i kafshëve, në varësi të llojit të tyre, nuk mund të bëhej para moshës 6 muaj, për kafshët e racës dhe ato që shërbenin për ushqim, ose para moshës 1 vit, për kafshët e punës. Së fundi, kontratat mund të lidheshin me afat më të shkurtër se 1 vit për kafshë, të cilat, më përpara, nuk kishin qënë të siguruara, për arsye se vuanin nga ndonjë sëmundje dhe, më pas, ishin shëruar<sup>108</sup>.

Përgjegjësia e Insitutit ose e AKSSH, në sigurimin e gjësë së gjallë, fillonte pas 21 ditëve, nga data e pagimit të primit dhe mbaronte në orën 24 të ditës, kur plotësohej viti<sup>109</sup>. Ndërsa, në sigurimin e gjësë së gjallë për rastet e fatkeqësive, përgjegjësia e AKSSH fillonte në orën 24 të ditës së pagimit të primit dhe mbaronte në orën 24 të ditës, kur plotësohej viti i lidhjes së kontratës. Ky parashikim ishte një risi e Urdhëresës së vitit 1955<sup>110</sup>. Nga përmbajtja e këtij rregulli, kuptohej se qëllimi i ligjvënësit ishte të

---

<sup>106</sup> Neni 9 i Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 11 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>107</sup> Neni 10 i Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 12 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>108</sup> Po aty.

<sup>109</sup> Neni 11 i Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 13 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>110</sup> Neni 11 i Urdhëresës.

ndihmonte subjektet private apo shtetërore, të cilat humbisnin kafshët e siguruara, si pasojë e fatkeqësive.

Nëse kafsha e siguruar kalonte në pronësinë e një të treti, përpara mbarimit të afatit të kontratës, përgjegjësia e siguresit merrte fund dhe primi nuk kthehej. Sigurimi ishte i vlefshëm edhe kur kafshët e siguruara zëvendësoheshin, me kusht që i siguruari të lajmëronte Institutin ose AKSSH, për këtë fakt<sup>111</sup>. Rregullat për ndryshimin e primit dhe të shumës së siguar, në varësi të ndryshimit të vlerës së kafshëve kishin mbetur të pandryshuara<sup>112</sup>. Kur gjëja e gjallë ngordhte ose largohej përpara se të fillonte përgjegjësia e Institutit ose AKSSH, primi i paguar i kthehej të siguarit në rast se ai lajmëronte brenda 10 ditëve nga fillimi i përgjegjësisë<sup>113</sup>.

Kontrata e sigurimit lidhej pas një kontrolli preventiv të kafshëve dhe vlerësimit nga ana e punonjësit të Institutit ose AKSSH. Kur gjendja shëndetësore e kafshëve rezultonte e dyshimtë, punonjësi i ngarkuar me vlerësimin refuzonte sigurimin në rast se pronari i kafshëve nuk paraqiste vërtetim zyrtar nga veterineri ose ndihmësveterineri, me të cilin të provohej se kafshët ishin të shëndosha<sup>114</sup>. Polica u dorëzohej ndërmarrjeve, institucioneve, kooperativave dhe organizatave të tjera, brenda 5 ditëve nga data e pagimit të primit ose nga data e pagimit të 50% të primit, kur pagesa bëhej me këste. Për personat fizikë, pagesa e primit me këste nuk lejohej. Anëtarët e kooperativave bujqësore, punëtorët, nëpunësit dhe shtetasit e tjerë, me banim në fshat ose në qytet, mund të lidhnin kontrata individuale ose kolektive. Sigurimi konsiderohej kolektiv kur, të paktën 20 vetë, siguronin së bashku

---

<sup>111</sup> Nenet 12-13 e Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 14 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951. Në këtë drejtim, Urdhëresa e vitit 1951 dhe ajo e vitit 1955 ndryshonin, pasi afatet për kryerjen e njoftimit nuk ishin të njëjtat. Urdhëresa e vitit 1951 parashikonte që afati i njoftimit ishte prej 5 ditësh ndërkohë që Urdhëresa e vitit 1955 parashikonte një afat prej 15 ditësh. Ky afat fillonte nga dita, kur kafshët, ishin marrë në pronësi për herë të parë.

<sup>112</sup> Po aty.

<sup>113</sup> Neni 14 i Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 16 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>114</sup> Neni 15 i Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 17 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

kafshët e tyre të një lloji<sup>115</sup>. Në qoftë se primi nuk derdhej në kohë, kontrata nuk mund të lidhej veçse pas një kontrolli të ri të kafshëve<sup>116</sup>.

Për të caktuar primin e aplikueshëm, Instituti ose Arka e Kursimeve duhej të merrte në konsideratë primet, të cilat ishin aprovuar paraprakisht nga organet përkatëse. Kështu, Urdhëresa e vitit 1951 parashikonte disa tarifa, në formën e shtojcës. Tarifat ndryshonin në varësi të moshës së kafshës së siguruar. Ndërsa, në Urdhëresën e vitit 1955 parashikohej që tarifat e sigurimit aprovoreshin nga Ministri i Financave<sup>117</sup>. Subjektet e siguruara mund, gjithsesi, të përfitonin ulje të tarifave të sigurimit, në varësi të numrit të kafshëve të siguruara ose të kujdesit, që tregohej për to<sup>118</sup>.

Organizmat shtetërorë, që kërkonin të siguroheshin, mund të paguanin primin në dy këste, në qoftë se masa totale e primit kapte disa vlera të caktuara nga Urdhëresat. Nëse pagesa kryhej me këste, kësti i parë duhej të ishte të paktën sa 50% e shumës totale të primit. Kësti i dytë duhej paguar në një afat prej 2 muajsh, që nga data e pagesës së këstit të parë. Kur kësti i dytë nuk paguhej brenda afatit të caktuar, afati i kontratës shkurtohej në përpjesëtim me shumën e paguar. Urdhëresat përmbanin parashikime të detajuara në muaj. Kur i siguruari paguante më pak se 50% të primit në këstin e parë, sigurimi nuk hynte në fuqi dhe primi kthehej. Kthehej gjithashtu edhe kësti i dytë i primit, që nuk ishte paguar në afatin e caktuar<sup>119</sup>.

Urdhëresat përmbanin të njëjtat parashikime mbi detyrimet e të siguarit për t'u kujdesur për kafshët e siguruara, për të njoftuar strukturën siguroese në rast rreziku si dhe për të zvogëluar dëmet, që mund të shkaktoheshin nga realizimi i rrezikut. Në rast ngordhjeje ose therjeje të detyrueshme të kafshëve, i siguruari duhej të lajmëronte brenda 24 orëve strukturat, që merreshin me rrijten e

---

<sup>115</sup> Nenet 16 – 18 e Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Nenet 19 – 20 e Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>116</sup> Neni 23 i Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 25 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>117</sup> Neni 20.

<sup>118</sup> Nenet 21 dhe 22 të Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 23 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>119</sup> Neni 24 i Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 26 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

kafshëve, në zonën ku ai banonte si dhe strukturën siguruese<sup>120</sup>. Pasojat në rast mosrespektimi të këtyre detyrimeve ishin të njëjtat, ndërprerje e kontratës dhe pamundësi për të rimarrë primin e paguar. Urdhëresat parashikonin gjithashtu mundësinë për të ripërtërirë kontratën në kushtet e mëparshme dhe procedurën që duhej ndjekur për këtë qëllim.

Urdhëresa e vitit 1951 përmbante një dispozitë përmbledhëse, sipas së cilës, në rast se, në momentin e ngordhjes ose therjes së detyrueshme të gjësë së gjallë, vlera e kafshëve të shëndosha të të njëjtit lloj, në bazë të çmimeve të tregut të lirë, ishte më e ulët se shuma e siguruar, atëherë kjo vlerë do të merrej si bazë për shpërblimin<sup>121</sup>. Kjo dispozitë nuk ekzistonte më në Urdhëresën e vitit 1955. Dëmi, për kafshën e punës së ngordhur, të therur për arsye sëmundjeje, apo që nuk mund të shërbente më për punë, shpërblehej në masën e shumës së siguruar. Ndërsa dëmi për kafshën, që shërbente për ushqim, shpërblehej në shumën e masës së siguruar, nga e cila zbritej vlera e ushqimit të prodhuar<sup>122</sup>.

Shpërblimi i dëmit duhej të bëhej në afate shumë të shkurtra<sup>123</sup>. Në rast refuzimi të pagimit të dëmit, siguruesi duhej të njoftonte të siguruarin për arsyen e refuzimit. Nga shuma e shpërblimit nuk mund të bëhej asnjë ndalesë, me përjashtim të kështit të dytë të primit, që nuk ishte paguar<sup>124</sup>.

Në mënyrë të përgjithshme, të dyja Urdhëresat përjashtonin nga shpërblimi rastet, kur dëmet, që i shkaktoheshin kafshës, ishin pasojë e veprimeve të të siguruarit, (pra, pasojë e veprimeve të kryera prej tij me faj). Gjithashtu, përjashtoheshin nga shpërblimi kafshët e ngrodhura, si pasojë e veprimeve luftarake. Instituti dhe AKSSH kishin të drejtën të refuzonin shpërblimin e dëmit, në rast se i siguruari, duke pasur mundësi, nuk lajmëronte për dëmin e ndodhur brenda afatit prej 24 orësh<sup>125</sup>.

---

<sup>120</sup> Neni 28 i Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 30 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>121</sup> Neni 31.

<sup>122</sup> Nenet 29 – 30 e Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Nenet 32 – 33 e Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>123</sup> Urdhëresa e vitit 1951 parashikonte një afat 8 ditor<sup>123</sup>, ndërsa ajo e vitit 1955 një afat prej 15 ditësh. Ky afat fillonte nga dita e arritjes së dokumentave të humbjes së gjësë së gjallë në Institut ose në AKSSH.

<sup>124</sup> Urdhëresa e vitit 1951 parashikonte që ky njoftim duhej të bëhej brenda një afati prej 3 ditësh, që nga data e marrjes së vendimit. Ndërsa Urdhëresa e vitit 1955 nuk parashikonte asnjë afat për këtë qëllim. (Neni 33 i Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 32 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951)

<sup>125</sup> Nenet 34 – 36 e Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Nenet 37 – 39 e Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

Zgjidhja e konflikteve, që mund të lindnin midis të siguruarve dhe Intitutit ose AKSSH, bëhej sipas rastit nga organet administrative ose ato gjyqësore, dhe iu nënshtrohej afateve specifike<sup>126</sup>.

### **3.4.5. Sigurimi i kulturave bujqësore**

Sigurimi i kulturave bujqësore është rregulluar, së pari, me një Vendim të Këshillit të Ministrave, VKM nr. 662, dt. 21.08.1950, me të cilin vendosej aprovimi i rregullores “Mbi sigurimin vullnetar të kulturave bujqësore”. Ky vendim është ndryshuar, më pas, me VKM nr. 14, dt. 12.01.1955.

Ndërmarrjet, institutet, organizatat, kooperativat bujqësore dhe ekonomitë bujqësore individuale mund të siguronin, në mënyrë vullnetare, pranë Institutit, lloje të ndryshme kulturash bujqësore. Përgjegjësia e Institutit fillonte në momentin, kur kulturat bujqësore kishin çelur. Mbarimi i përgjegjësisë i korrespondonte mbledhjes së prodhimit. Instituti shpërblente vetëm sasinë e humbur ose të prishur të prodhimit, kurse, për disa kultura specifike, shpërblehej edhe ulja e cilësisë së prodhimit<sup>127</sup>.

Shuma e sigurimit caktohej sipas normave të llogaritura për çdo kulturë. Kontratat e sigurimit, kundër rreziqeve të siguruara, lidheshin brenda afateve specifike, të cilat ndryshonin në funksion të rrezikut të siguruar. Kontrata nuk mund të lidhej në momentin, kur kulturat bujqësore, që kërkohej të siguroheshin, rrezikoheshin nga një rrezik natyror, pavarësisht se afati brenda të cilit mund të lidhej kontrata, ende nuk kishte përfunduar<sup>128</sup>.

Rregullorja parashikonte edhe një listë primesh, mbi bazën e të cilave duhej të lidheshin kontratat. Primet ishin të ndryshme për kategori të ndryshme kulturash bujqësore. Në rast se sipërfaqja e mbjellë me një kulturë, rezultonte më e vogël se ajo e siguruar, mbi kërkesën e të interesuarit, Instituti duhej të kthente pjesën përpjesëtimore të primit, të paguar më tepër, bazuar në provat që i siguruari paraqiste, për të llogaritur diferencën midis dy sipërfaqeve, të cilat duhej të ishin të vërtetuara nga organet shtetërore.

---

<sup>126</sup> Neni 37 i Urdhëresës dt. 12.01.1955 dhe Neni 30 i Urdhëresës nr. 14, dt. 05.04.1951.

<sup>127</sup> Nenet 1 – 7 të Rregullores

<sup>128</sup> Nenet 8 – 9 dhe 15 të Rregullores

Në rast se sipërfaqja e mbjellë me një kulturë, rezultonte më e madhe nga ajo që ishte siguruar, i siguruari kishte të drejtën që të kërkonte shtimin e shumës së siguruar, duke paguar diferencën e primit<sup>129</sup>.

I siguruari kishte detyrimin të zbatonte rregullat agroteknike dhe të merrte masa parandaluese, për të shmangur dëmin ose shfarosjen e kulturave të siguruara, si dhe të njoftonte Institutin në rast se dëmi realizohej. Në qoftë se i siguruari nuk merrte masat e nevojshme, atëherë Instituti nuk përgjigjej për zmadhimin e dëmit<sup>130</sup>. Për humbjen e plotë të kulturave bujqësore, dëmi shpërblehej në masën e shumës së siguruar, por jo më tepër se vlera e prodhimit, që mendohej se do të realizohej. Vlera e prodhimit caktohej në bazë të të njëjtave çmime të shitjes me pakicë, të blerjes dhe të grumbullimit, sipas të cilave ishte caktuar shuma e siguruar<sup>131</sup>. Në raste dëmi pjesor, dëmi shpërblehej në përpjesëtim me prodhimin e humbur. Gjithashtu, kur dëmi shkaktohej, pjesërisht, nga rreziqet, për të cilat ishte kryer sigurimi dhe, pjesërisht, nga rreziqe, që nuk përfshiheshin në sigurim, dëmi shpërblehej vetëm për atë pjesë, që ishte shkaktuar nga rreziqet e siguruara. Ndërsa, kur shuma e siguruar rezultonte më e madhe se sa vlera e prodhimit, që do të nxirrej nga sipërfaqja e dëmtuar, po të mos kishte ndodhur dëmi, shpërblimi llogaritej sipas vlerës së pritshme të prodhimit. Llogaritja kryhej mbi bazën e të njëjtave kritere, si në rastet, kur sipërfaqja e dëmtuar mund të mbillej sërish<sup>132</sup>. Kulturat e mbjella pas dëmtimit mund të siguroheshin përsëri<sup>133</sup>.

Në rast refuzimi të shpërblimit, Instituti duhej të njoftonte me shkrim të sigruarin, brenda afatit prej 3 ditësh, për arsyet e refuzimit. Likuidimi i dëmit, për kulturat, që duhej të mbilleshin rishtas, kryhej në

---

<sup>129</sup> Nenet 11 – 12 dhe 20 të Rregullores

<sup>130</sup> Nenet 21 – 22 të Rregullores

<sup>131</sup> Neni 25 i Rregullores

<sup>132</sup> Nenet 26 – 28 të Rregullores

<sup>133</sup> Neni 31 i Rregullores



bazë të dëshmisë që vërtetonte sipërfaqen, që ishte mbjellë. Ekzistonin edhe dëme, të cilat nuk shpërbleheshin nga Instituti<sup>134</sup>.

Instituti nuk shpërblente dëmet e shkaktuara nga thatësira ose në tokat, që mbuloheshin nga uji, kur përmytja ishte rezultat i keqpërdorimit të ujit gjatë ujitjeve. Përveç kësaj, Instituti nuk ishte përgjegjës për zmadhimin e dëmit, kur i siguruari nuk merrte masa për kufizimin e tij, duke kryer punime plotësuese në sipërfaqet e dëmtuara. Së fundi, Instituti kishte të drejtën të refuzonte shpërblimin, në rast se i siguruari, duke patur mundësi, nuk lajmëronte për dëmin, që i kishte ndodhur brenda afatit prej 5 ditësh, që nga momenti i konstatimit të tij. Konfliktet midis të siguruarve dhe Institutit zgjidheshin, së pari, në rrugë administrative dhe më pas në rrugë gjyqësore<sup>135</sup>.

Rregullorja është ndryshuar më vonë, nëpërmjet VKM, nr. 14, dt. 12.01.1955, për t'iu përshtatur ndryshimeve të ndodhura me Institutin, përgjegjësitë e të cilit iu kaluan Arkave të Kursimeve dhe Sigurimeve Shtetërore. Ky Vendim parashikonte edhe një ndryshim tjetër të rëndësishëm, i cili kishte të bënte me tagrat, që i njiheshin Ministrit të Financave, të caktonte shumat e sigurimit, në bazë të normave të përlogaritura, për çdo lloj kulture, sipas çmimeve të tregut. Për sa u takon elementëve të tjerë, VKM i vitit 1955, nuk përmbante ndryshime të rregullave të miratuara me Vendimin e vitit 1951.

Në mënyrë të përgjithshme, vihet re se, urdhëresat dhe rregulloret e miratuara, për të rregulluar sektorë të ndryshëm të sigurimeve, përmbanin rregulla të ngjashme, për sa u takonte formaliteteve, procedurave dhe afateve për lidhjen e kontratës dhe pagimin e shpërblimit. Vihet re, gjithashtu, tendenca për t'i lënë më shumë kompetencë Ministrit të Financave, në përcaktimin e disa tarifave bazë, që

---

<sup>134</sup> Në kategorinë e dëmeve që nuk siguroheshin bënë pjesë:

- Dëmet, që ishin shkaktuar nga veprimet e të siguruarit.
- Dëmet, që ishin shkaktuar nga punimi i tokës, apo mbledhja e prodhimeve, ndërkohë që organet e Institutit nuk kishin bërë ende verifikimet e nevojshme pas realizimit të rrezikut. Në rast se organet e Institutit nuk kryenin vlerësimin e dëmit brenda afatit të caktuar prej 5 ditësh, që nga momenti i marrjes së lajmërimit nga i siguruari, i siguruari kishte mundësinë, që të mbledhte prodhimin ose të mbillte tokën, pa humbur të drejtën e shpërblimit.
- Dëmet, që vinin si pasojë e mosveprimit të të siguruarit për të mbjellë kulturat e dëmtuara, që mund të mbilleshin përsëri.
- Dëmet, që shkaktoheshin në toka, në të cilat kulturat nuk ishin mbjellë sipas llojit, vitit dhe zonës që u korrespondonte.
- Dëmet, që ishin pasojë e operacioneve ushtarake. (Nenet 32 – 34 të VKM)

<sup>135</sup> Nenet 35 – 38 të VKM.

shërbenin për llogaritjen e primeve apo të shumave të siguruara. Nëpërmjet këtij veprimi, Këshilli i Ministrave mundësonte përshtatjen më të shpejtë të rregullave të zbatueshme, me situatat e krijuara në praktikë, pasi përcaktimi i tarifave me akt të një Ministri të vetëm, mund të bëhej më shpejt dhe më thjesht, se sa nëpërmjet një akti nënligjor, i cili duhet të miratohej nga vetë Këshilli. Megjithatë, veprimet, që lidheshin me sigurimin, ishin nën kontrollin e plotë të pushtetit qendror, duke qënë se Instituti Shtetëror i Sigurimeve ishte i vetmi organ i autorizuar për lidhjen e kontratave të sigurimit dhe se mënyra e veprimit të Institutit ishte e përcaktuar në detaje, nga aktet nënligjore.

### **3.4.6. Sigurimet sipas Kodit Civil të vitit 1981**

Kodi Civil, i miratuar në vitin 1981, përmbante një kapitull të veçantë për sigurimin e pasurisë, (nenet 259 e vijues). Ai e përkufizonte kontratën e sigurimit të pasurisë, si kontratën, me të cilën njëra palë (siguruesi), në qoftë se vërtetohej ngjarja e parashikuar në kontratë (rasti i sigurimit), detyrohej t'i paguante palës tjetër, (të siguruarit) ose një personi të tretë, në dobi të të cilit ishte lidhur kontrata, shpërblimin e sigurimit brenda kufijve të shumës, që ishte parashikuar në kontratë. I siguruari detyrohej të paguante primin (çmimin e sigurimit), në afatin e caktuar në kontratë. Sigurues mund të ishte vetëm institucioni shtetëror i caktuar me dispozita të veçanta. Ky institucion kishte mundësinë, gjithashtu, të lidhte kontrata risigurimi. Kontrata e sigurimit mund të ishte vullnetare, ose e detyrueshme, kur kjo gjë parashikohej në ligj. Kontrata e sigurimit bëhej me shkresë, me anë të dëshmisë së sigurimit (policës së sigurimit), që siguruesi i lëshonte të siguruarit, përndryshe ajo ishte e pavlefshme.

Kodi Civil i vitit 1981, në nenin 260 të tij, parashikonte që, i siguruari kishte këto detyrime:

- T'i njoftonte siguruesit, në kohën e lidhjes së kontratës, të gjitha rrethanat për të cilat kishte dijeni dhe që kishin rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës e të masës së rrezikut.

- T'i njoftonte siguruesit, gjatë kohës, që kontrata ishte në fuqi, të gjitha ndryshimet e rrethanave, për të cilat kishte marrë dijeni pas lidhjes së kontratës dhe që mund të ndihmonin për shtimin e rrezikut.

- T'i njoftonte siguruesit, brenda afatit të caktuar në dispozita të veçanta, rastin e realizimit të rrezikut të siguruar dhe të merrte masat e nevojshme, që vareshin prej tij, me qëllim që të ndalohej ose të pakësohej dëmi.

- Të ruante me kujdes pasurinë e siguruar, sipas dispozitave kundër zjarrit, dispozitave agronomike dhe zooveterinare.

Në qoftë se i siguruari nuk bënte njoftimet e nevojshme, në kohën e lidhjes së kontratës, ose për ndryshimet e kushteve, mbi bazën e të cilave ishte lidhur kontrata, siguruesi kishte të drejtë të ndryshonte ose të zgjidhte kontratën e sigurimit. Në qoftë se i siguruari nuk përmbushte detyrimet e tij për informacion, pasi kishte ndodhur rreziku, siguruesi kishte të drejtë të mos paguante shpërblimin e sigurimit.

Kontrata e sigurimit të pasurisë mund të bëhej, si për sigurimin e sendeve të paluajtshme, ashtu dhe për sigurimin e sendeve të luajtshme, ose për sigurimin e përgjegjësisë për dëmet. Shuma e sigurimit nuk mund të ishte më e madhe se vlera e pasurisë. Kur shuma e sigurimit ishte më e vogël se vlera e pasurisë së siguruar, shpërblimi i dëmit caktohej në përpjesëtim me raportin ndërmjet shumës së sigurimit dhe vlerës së pasurisë së siguruar, përveç rasteve, kur me dispozita të veçanta parashikoheshin mënyra të tjera për shpërblimin e dëmeve.

Siguruesi shkarkohej nga detyrimi për të paguar shpërblimin, në qoftë se rasti i sigurimit ishte shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e të siguarit, ose e personit, në dobinë e të cilit ishte lidhur kontrata e sigurimit. Siguruesi, që kishte paguar shpërblimin e sigurimit, kishte të drejtë të kërkonte kthimin e shumës së paguar nga personat përgjegjës për shkaktimin e dëmit. Kontrata e sigurimit hynte në fuqi në orën 24 të ditës së pagimit të primit të sigurimit dhe, në rastet e pagimit të

primit me këste, në orën 24 të ditës së pagimit të këstit të parë. Kur pasuria e siguruar kalonte në pronësinë e një personi tjetër, kontrata e sigurimit quhej e zgjidhur. Në këtë rast, primi i paguar për ndërtesat i kthehej të sigurvearit, në përpjesëtim me kohën, që mbetej, gjer në mbarimin e afatit të kontratës së sigurimit, kurse primi i paguar për sendet e luajtshme nuk kthehej. Kushtet për sigurimin vullnetar ose të detyrueshëm të pasurisë caktoheshin me dispozita të veçanta nga Ministri i Financave.

## KAPITULLI IV: FINANCIMI I TERRORIZMIT DHE PASTRIMI I PARAVE

### NË FUSHËN E SIGURIMEVE VULLNETARE

#### 4.1. Ekzistenca e rrezikut dhe përkufizimi i tij

Rritja e aktivitetit të sigurimit dhe risigurimit, në vendin tonë, ka sjellë si pasojë rritjen e të ardhurave, që qarkullojnë në këtë fushë, pasi është rritur njëherazi numri i klientëve dhe primet e paguara. Masa e fondeve, që qarkullojnë në fushën e sigurimeve, është rritur gjithashtu sepse është rritur shuma, që shoqëritë siguruese dhe risiguruese duhet të kenë në dispozicion, me qëllim ushtrimin e këtij aktiviteti. Kapitali minimal fillestar i shoqërisë së sigurimit nuk mund të jetë më i vogël se shuma minimale e fondit të garancisë. Fondi i garancisë nuk mund të jetë më i ulët se 260 – 370 million lekë, në varësi të klasave të sigurimit për të cilat është liçensuar kompania<sup>136</sup>. Ky fond miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Ai përbëhet nga kapitali bazë dhe kapitali shtesë. Kapitali i regjistruar i shoqërisë shërben për dy qëllime (Malltezi, 2011, fq. 12):

- tregon vlerën minimale ligjore të kapitalit të shoqërisë.
- i korrespondon kufirit të përgjegjësisë personale të ortakëve në detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve.

Përveç kapitalit minimal fillestar, shoqëria e sigurimit duhet të ketë edhe një fond shtesë, të quajtur fond për shpenzime nisjeje, për të mbuluar shpenzimet e themelimit, funksionimit dhe administrimit. Ky fond, në asnjë rast, nuk duhet të jetë më i vogël se 5% e kapitalit minimal fillestar<sup>137</sup>.

Aksionarët depozitojnë për llogari të shoqërisë së sigurimit vlerën përkatëse të kapitalit minimal fillestar dhe fondit për shpenzime nisjeje. Shuma duhet të derdhet vetëm në lekë, në një llogari të veçantë garancie, në një nga bankat e nivelit të dytë ose në një nga degët e bankave të huaja në

---

<sup>136</sup> Neni 81 i ligjit nr. 52/2014 “Fondi i garancisë”

<sup>137</sup> Neni 13 i ligjit nr. 52/2014 “Kapitali minimal fillestar”

Republikën e Shqipërisë. Kapitali duhet të paguhet plotësisht përpara datës së depozitimit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të kërkesës për liçencim.

Fondi i garancisë së një shoqërie sigurimi joqë nuk mund të jetë më i ulët se 260 milion lekë. Në rastin kur një ose disa rreziqe përfshihen në klasat 10 deri në 15 të seksionit A, të aneksit I, që i bashkëlidhet ligjit, fondi i garancisë nuk mund të jetë më i ulët se 370 milion lekë<sup>138</sup>.

Fondi i garancisë së një shoqërie sigurimi nuk mund të jetë më i ulët se 370 milionë lekë, nëse shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari sigurimi të jetës, sipas klasifikimit të seksionit B, të aneksit I, të ligjit<sup>139</sup>. Edhe fondi i garancisë së një shoqërie risigurimi nuk mund të jetë më i ulët se 370 milionë lekë. Ndërkohë, kufiri minimal i fondit të garancisë së shoqërisë së sigurimit, që mbulon rreziqet e disa klasave të

---

<sup>138</sup> Në klasat 10 deri 15 të seksionit A të aneksit I të ligjit bëjnë pjesë këto rreziqe:

- Sigurimi i përgjegjësisë nga përdorimi i automjeteve, përfshi edhe sigurimin e detyrueshëm në fushën e transportit (Klasa 10).
- Sigurimi i përgjegjësisë nga përdorimi i avionëve, përfshi edhe përgjegjësitë e transportuesit (Klasa 11).
- Sigurimi i përgjegjësisë për anijet, cilado qoftë madhësia e tyre, që lundrojnë në sipërfaqet ujore, përfshi edhe përgjegjësinë e transportuesit (Klasa 12).
- Sigurimi i përgjegjësisë të përgjithshme, i cili mbulon të gjitha përgjegjësitë, përveç atyre të përmendura në klasat 10, 11 dhe 12 (Klasa 13).
- Sigurimi i kreditit (Klasa 14). Në këtë klasë përfshihen lloje të ndryshme kredish, kreditë e shlyera me këste, kreditë hipotekore, kreditë bujqësore, si dhe të gjitha kreditë e tjera, të cilat jepen për qëllime të ndryshme, por që preken nga rreziku i mospagesës, veçanërisht për shkak të paafëtisë së paguese të kredimarrësit.
- Sigurimi i garancive (Klasa 15). Në këtë klasë bëjnë pjesë si garancitë e drejtpërdrejta ashtu edhe garancitë e tërthorta.

<sup>139</sup> Në seksionin B të aneksit I të ligjit bëjnë pjesë këto klasa rreziqesh:

- a) Klasa 19 – Sigurimi i jetës, i cili mbulon:
  - sigurimin për vdekjen;
  - sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar;
  - sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar ose për vdekje të parakohshme;
  - sigurimin e jetës me kthim të primeve.
- b) Klasa 20 – Sigurimi martesë – lindje. Kjo klasë mbulon:
  - shpenzimet, që shoqërojnë martesën ose lindjen e fëmijëve;
  - përfundimin e kushteve të sigurimit, që ka lidhje me arritjen e një moshe të caktuar të fëmijës.
- c) Klasa 21 – Sigurimi i jetës i lidhur me sipërmarrjet e investimeve kolektive. Kjo klasë mbulon, sigurimin e jetës, në rastet kur pagesa e sigurimit lidhet në mënyrë të plotë apo të pjesshme me vlerën e aksioneve apo kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, ose me vlerën e aktiveve të mbajtura në një fond të brendshëm nga siguroesi.
- ç) Klasa 22 – Anuitetet. Në këtë klasë bëjnë pjesë anuitetet e shtyra dhe ato të menjëhershme. Bëjnë pjesë gjithashtu edhe sigurimi i jetës me afat të përcaktuar dhe ai me elemente kursimi.
- d) Klasa 23 – Sigurimi shtesë. Ky lloj sigurimi lidhet me kontratën e sigurimit të jetës dhe përfshin një ose më shumë nga kombinimet e mëposhtme:
  - vdekje si rezultat i aksidentit;
  - paafësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti;
  - paafësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një sëmundjeje;
  - paafësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti;
  - paafësi e përkohshme si rezultat i një sëmundjeje;
  - paafësi për të kryer profesionin apo punën si rrjedhojë e dëmtimeve trupore;
  - shërbimet spitalore;
  - sëmundjet e pashërueshme;
  - shërbimet mjekësore.

sigurimit të jojetës, duhet të jetë i barabartë me vlerën e kufirit minimal të fondit të garancisë të klasës së sigurimeve, për të cilin është parashikuar kufiri më i lartë<sup>140</sup>.

Kufiri minimal i fondit të garancisë së shoqërisë së sigurimit, që mbulon më shumë se një nga veprimtaritë e sipërpërmendura, në përputhje me dispozitat e ligjit, është sa shuma e kufijve minimalë që i korrespondojnë çdonjëres prej këtyre veprimtarive, në përputhje me klasat, për të cilat shoqëria është e autorizuar. Fondi i garancisë mbahet në një llogari bankare të veçantë, të emërtuar “Llogaria e fondit të garancisë”, në njërin nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë<sup>141</sup>.

Fondi i garancisë investohet vetëm në bono thesari dhe/ose depozita bankare, me afat maturimi jo më të vogël se 1 vit dhe ka përshkrimin, që nuk mund të preket pa miratimin paraprak të Autoritetit. Çdo transaksion, që ka të bëjë me fondin e garancisë, nuk kryhet pa marrë miratimin paraprak të Autoritetit. Me qëllim marrjen e këtij miratimi, shoqëria e sigurimit duhet të ketë paraqitur të gjitha informacionet e nevojshme të kërkuara nga Autoriteti. Transaksionet kryhen vetëm nëpërmjet transfertave bankare.

Ligji ka përcaktuar elementët kryesorë, që bëjnë pjesë në kapitalin bazë:

- a) kapitali aksionar i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme të emetuara;
- b) rezervat e kapitalit, të cilat nuk u korrespondojnë detyrimeve, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit;
- c) fitimi i pashpërndarë, i mbartur pas zbritjes së dividendëve të pagueshëm.

Shoqëria duhet të ketë një nivel aftësie paguese, të tillë, që të mund t’u përgjigjet kërkesave për pagesa, që lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit si dhe të përmbushë kriteret e vëna nga ligji nr. 52/2014.

Kapitali i shoqërisë së sigurimit, që ushtron veprimtari sigurimi dhe risigurimi, gjatë gjithë veprimtarisë së shoqërisë, nuk duhet të jetë më i ulët se niveli i kërkuar i aftësisë paguese të shoqërisë. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit është vlera më e lartë midis fondit të garancisë dhe 150 për qind të kufirit minimal të aftësisë paguese, të llogaritur sipas parashikimeve të

---

<sup>140</sup> Neni 81 i ligjit nr. 52/2014 “Fondi i garancisë”

<sup>141</sup> Po aty

ligjit nr. 52/2014 dhe akteve të Autoritetit<sup>142</sup>. Kufiri minimal i aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit, që ushtron veprimtari në klasat e jetës dhe/ose të jojetës, llogaritet sipas metodave të përcaktuara me rregullore nga Autoriteti.

Në këtë drejtim, mund të themi se AMF ka arritur një prej objektivave të saj, që është rritja e qëndrueshmërisë së tregut të sigurimeve dhe shmangia e vështirësive ekonomike të kompanive nëpërmjet rritjes së kapitalit. Gjithsesi, rritja e kapitalit në këto masa, nuk është një risi e mirëfilltë e ligjit nr. 52/2014, por është një proces i filluar që në vitin 2007. Ligji nr. 9267, është ndryshuar në drejtim të rritjes së masave të fondit të garancisë, në varësi të llojeve të sigurimeve të ofruara nga kompanitë. AMF ka mbikëqyrur marrjen e masave nga kompanitë e sigurimit, sipas fazave dhe afateve të përcaktuara në ligj<sup>143</sup>.

Duke u nisur nga fakti që, shoqëritë, të cilat ushtrojnë aktivitet sigurimi dhe risigurimi, janë të detyruara të kenë në dispozicion shuma të mëdha fondesh, ligjvënësi ka menduar që, këto shuma, ose investimet në kapitalin e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, mund të përdoren nga individë të ndryshëm për veprimtari kriminale, kryesisht për pastrim parash dhe për financim të aktiviteteve terroriste. Përdorimi i sipërmarrjeve, që kanë qarkullim të madh të parave, për të përzier paratë me origjinë të ligjshme, me ato të fituara si pasojë e ushtrimit të një aktiviteti kriminal, është një prej mënyrave, që ndiqen për të futur në qarkullim paratë e pista (Gjonça, Dhjetor 2009, fq. 29).

Pastrimi i parave është procesi i lëvizjes së fondeve të gjeneruara në mënyrë ilegale në një rreth transformimesh, për të krijuar një aparençë legale të këtyre fondeve dhe duke fshehur origjinën e tyre ilegale (Subashi, 2015, fq. 12).

---

<sup>142</sup> Neni 80 i ligjit nr. 52/2014 “Niveli i kërkuar i aftësisë paguese”

<sup>143</sup> Masa e fondit të garancisë përcaktohet nga neni 98 i ligjit nr. 9267.



FATF (Financial Action Task Force) do ta përkufizonte pastrimin e parave si përpunimin e të ardhurave kriminale, me qëllim fshehjen e origjinës së tyre të paligjshme (Mëçalla, Pranverë 2011, fq. 183).

Me qëllim parandalimin e pastrimit të parave dhe të produkteve, që burojnë nga veprat penale, si dhe parandalimin e financimit të terrorizmit, legjislacioni shqiptar ka parashikuar krijimin e një strukture të posaçme, konkretisht Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, institucion varësie i Ministrisë të Financave të Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 9917, dt. 19.05.2008, që rregullon krijimin dhe funksionimin e DPPP<sup>144</sup>, ka parashikuar në nenin 3 të tij subjektet, që i nënshtrohen këtij ligji, midis tyre edhe shoqëritë, që merren me sigurimin e jetës ose risigurimin, agjentët apo ndërmjetësit e tyre, si dhe fondet e pensionit.

Pra, shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit i nënshtrohen kontrollit të AMF edhe atij të DPPP. Ligji nr. 9917/2008, ka parashikuar që, subjektet, të cilat i nënshtrohen zbatimit të këtij ligji, kanë detyrimet e mëposhtme<sup>145</sup>:

“a) të hartojnë dhe të zbatojnë rregulloret dhe udhëzimet e brendshme, të cilat marrin parasysh rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që mund të lindë nga klientë ose biznese, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në:

- i) një politikë për pranimin e klientit;
- ii) një politikë për zbatimin e procedurave për vigjilencën e zgjeruar në rastin e klientëve dhe transaksioneve të kategorive, që paraqesin rrezik të lartë;

b) të emërojnë një person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, në nivele administrimi/drejtimi në zyrën qendrore dhe në çdo zyrë përfaqësimi<sup>146</sup>, filial<sup>147</sup>,

---

<sup>144</sup> Ligji nr. 9917, dt. 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, Fletore Zyrtare nr. 83, Faqe 3645

<sup>145</sup> Neni 11 i ligjit nr. 9917/2008 “Masat parandaluese të ndëmarra nga subjektet”

<sup>146</sup> Zyra e përfaqësimit është një entitet pa personalitet juridik të sajën, e cila vepron nëpërmjet personalitet të shoqërisë që përfaqëson dhe që nuk mund të zhvillojë aktivitet tregtar në mënyrë të pavarur. - Argita Malltezi, “E drejta shqiptare e shoqërive tregtare”, Tiranë 2011, faqe 265 - 266;

degë<sup>148</sup> ose agjenci, tek të cilat të gjithë punonjësit raportojnë çdo fakt, që mund të përbëjë dyshim për pastrim parash ose financim terrorizmi dhe të përcaktojnë procedura të përshtatshme menaxhimi e përputhshmërie, brenda subjektit dhe degëve. Personat përgjegjës kanë akses të vazhdueshëm ndaj të gjitha të dhënave, të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji<sup>149</sup>, dhe në çdo lloj informacioni, që disponohet nga subjekti, i cili është i nevojshëm për përmbushjen e detyrave;

c) të krijojnë një sistem të centralizuar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave;

ç) të zbatojnë procedurat përzgjedhëse për punonjës të rinj, për t'u siguruar për integritetin e tyre;

d) të trajnojnë punonjësit për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit përmes organizimit periodik të programeve të kualifikimit;

dh) të ngarkojnë kontrollin e brendshëm për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet e këtij ligji dhe të akteve përkatëse nënligjore;

e) të sigurohen se filialet, degët dhe nëndegët, si dhe agjencitë e tyre, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe, në veçanti, në vende dhe territore, të cilat nuk zbatojnë apo zbatojnë pjesërisht standardet ndërkombëtare, veprojnë në përputhje me masat parandaluese të parashikuara në këtë ligj. Në qoftë se masat parandaluese në dy vendet ndryshojnë, atëherë subjektet duhet të sigurohen, që kanë përparësi detyrimet më të larta. Nëse ligjet e vendit, ku janë vendosur filialet, degët, nëndegët ose agjencitë, parashikojnë pengesa për zbatimin e detyrimeve, subjekti duhet t'i raportojë për këto pengesa autoritetit përgjegjës dhe, sipas rastit, autoritetit mbikëqyrës;

ë) t'i paraqesin informacion, të dhëna dhe dokumente shtesë, autoritetit përgjegjës, në përputhje me kërkesat dhe afatet kohore për rastet e parashikuara në këtë ligj. Autoriteti përgjegjës mund ta zgjasë këtë afat, me kërkesë të subjektit, për një periudhë jo më shumë se 15 ditë.

2. Në rast se numri i punonjësve të subjekteve të përcaktuara në këtë ligj është më pak se 3

---

<sup>147</sup> Filial quhet një shoqëri e krijuar nga një shoqëri tjetër e cila kontrollon vendimarrjen e filialit. – Po aty

<sup>148</sup> Dega është një entitet i krijuar nga shoqëria mëmë, që nuk ka personalitet të vetin juridik dhe as kapital të vetin. – Idem

<sup>149</sup> Neni 16 i ligjit parashikon ruajtjen e informacioneve, që lidhen me transaksionet e kryera nga shoqëria me çdo klient të saj.

persona, detyrimet e këtij neni përmbushen nga administratori ose nga një punonjës i autorizuar i subjektit.”

Walker Unger, do të thoshte në punimet e tij se pastrimi i parave mund të bëhet vetëm kur ekziston një krim themelor, i cili rrit të ardhurat e paligjshme, të cilat pastrohen më vonë, duke u futur në qarkullim në ekonominë e ligjshme (Subashi, 2015, fq. 18). Duke zbatuar këtë postulat të tijin në aktivitetin e sigurimit dhe risigurimit arrijmë në konkluzionin se pastrimi i parave mund të paraqitet në dy forma:

- Së pari: investimi në një kompani sigurimi. Pra, një subjekt i cili ka fituar një shumë në caktuar, në mënyrë të paligjshme, mund ta investojë atë për të marrë pjesë në kapitalin e një kompanie sigurimi gjatë krijimit të saj, ose nëpërmjet blerjes së një pakete aksionesh të një shoqërie ekzistuese.
- Së dyti: deklarimi i një shume të ardhurash si dëmshpërblim i paguar në kuadër të një kontrate sigurimi. Pra, një subjekt mund të deklarojë që një shumë e caktuar i është derdhur atij si dëmshpërblim, mbi bazën e një kontrate sigurimi, si pasojë e realizimit të një rreziku, ndërkohë që rreziku nuk është realizuar ose shuma e derdhur si dëmshpërblim ka pasur vlerë më të vogël.

Në mënyrë të përmbledhur pastrimi i parave realizohet nëpërmjet një procesi të përbërë nga 4 etapa (Gjonça, Dhjetor 2009, fq. 29):

1. Futjen dhe qarkullimin e ligjshëm të parave dhe kapitaleve me origjinë kriminale;
2. Largimin e të ardhurave me prejardhje kriminale nga burimet e tyre.
3. Krijimin e kushteve dhe të legjendave përkatëse për origjinën e ligjshme të parave, që kanë ardhur nga krimi.
4. Investimin e tyre në ekonominë e ligjshme.

Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 9917/2008, “financimi i terrorizmit”, ka të njëjtin kuptim si në

nenet 230/a deri në 230/ç të Kodit Penal.

Neni 230/a i Kodit Penal, jep këtë përkufizim:

“Financimi i terrorizmit është dhënia ose grumbullimi i fondeve, me çdo mjet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me qëllimin që ato të përdoren, ose duke ditur se ato do të përdoren, plotësisht ose pjesërisht:

- a) për të kryer vepra me qëllime terroriste;
- b) nga një organizatë terroriste;
- c) nga një terrorist i vetëm”.

Ndërkohë që, edhe pastrimi i parave bën pjesë në kategorinë e pastrimit të produkteve të veprës penale dhe ka të njëjtin kuptim si ai, që jepet nga neni 287 i Kodit Penal, i cili parashikon që, pastrimi i produkteve të veprës penale kryhet nëpërmjet:

- a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, që dihet se është produkt i veprës penale, për fshehjen ose zhdukjen e origjinës së paligjshme të pasurisë ose dhënien e ndihmës për të shmangur pasojat juridike, që lidhen me kryerjen e veprës penale;
- b) fshehjes ose mbulimit të natyrës, burimit, vendndodhjes, vendosjes, zhvendosjes së pronësisë ose të të drejtave të tjera, që lidhen me pasurinë, që është produkt i veprës penale;
- c) kryerjes së veprimeve financiare dhe transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas ligjit për pastrimin e parave;
- ç) fitimit, zotërimit ose përdorimit të pasurisë, kur dihet që është produkt i veprës penale;
- d) këshillimit, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër.

Nëse analizojmë veprën penale të pastrimit të parave sipas nenit 287 të Kodit Penal, nga ana subjektive krimi kryhet me dashje. Neni 287 kërkon që personi të ketë qënë në dijeni të karakterit të

paligjshëm të veprimit të kryer dhe të ketë pasur për qëllim fshehjen e të ardhurave të paligjshme (Sinani, Shkurt 2016, fq. 5). Pastrimi i parave është gjithmonë i lidhur me veprën penale kryesore, realizimi i së cilës ka sjellë përfitimin, që kërkohet të futet në qarkullim në mënyrë të ligjshme.

Në nivelin e Bashkimit Evropian “financimi i terrorizmit” përkufizohet si dhënia ose mbledhja e fondeve në çdo mënyrë, të drejtpërdrejtë ose jo, me qëllimin që ato të përdoren ose duke pasur dijeni se do të përdoren pjesërisht ose tërësisht, për të kryer aktivitete kriminale të llojit, vrasje/dhunim ose rrëmbim personi, shkatërrim i të mirave publike/ndërprerje e shërbimeve publike, blerje e armëve të lehta ose të shkatërrimit në masë, rrëmbim i mjeteve fluturuese/lundruese/të transportit rrugor, lëshim i substancave të rrezikshme për shëndetin e njeriut. Konsiderohet si terrorizëm edhe kërcënimi për të kryer një prej veprimeve të përmendura më sipër pa e realizuar atë<sup>150</sup>.

Ndërsa “pastrimi i parave”, përkufizohet nga Konventa e Bashkimit Evropian për Parandalimin e pastrimit të parave si “konvertimi ose transferimi i pasurisë, duke ditur se kjo pasuri rrjedh nga krimet e rënda me qëllim fshehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të pasurisë ose ndihma e dhënë çdo personi, që është i përfshirë në kryerjen e një veprë të tillë ose vepra për të shmangur pasojat juridike të veprimit të tij, si dhe fshehja ose maskimi i natyrës së vërtetë, burimit vendndodhjes, disponimit, lëvizjes, të drejtat në lidhje me pronësinë, duke e ditur se kjo pasuri rrjedh nga krimet e rënda.”<sup>151</sup>

Me miratimin e ligjit nr. 52/2014, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka marrë një rëndësi të veçantë, pasi tashmë kontrollet e tij mund të prekin edhe veprimet, që lidhen me marrjen e masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Përveç kësaj, AMF mund të ndërhyjë për marrjen e masave jo vetëm në momentin kur shoqëria e sigurimit është në vështirësi, por edhe me përpara, për të parandaluar krijimin e vështirësive. Vlen të theksohet se, sipas Kodit Penal shqiptar

---

<sup>150</sup> Përkufizimi që përdoret sot si referencë është ai që jepet nga neni 1 i Direktivës nr. 2015/849, datë 20 maj 2015, “On the prevention of the use of the financial system for the purposes of money laundering or terrorist financing”, ndërkohë që vetë kjo Direktivë referon tek rastet e listuara si aktivitete terroriste në Vendimin kuadër nr. 2002/475/JHA të miratuar nga Këshilli Evropian në datën 13 qershor 2002, për luftën kundër terrorizmit.

<sup>151</sup> Convention du Conseil de l'Europe relative au blanchiment, au dépistage, à la saisie et à la confiscation des produits du crime et au financement du terrorisme, 2005

përgjegjësia për veprën penale të pastrimit të parave, nuk është e lidhur me përgjegjësinë penale të personit, që ka kryer veprën kryesore, nga e cila kanë ardhur produktet kriminale, vepër e cila mund të jetë kryer si brenda ashtu edhe jashtë vendit (Sinani, Shkurt 2016, fq. 13). Ky fakt ndihmon AMF në ushtrimin e funksioneve të tij, pasi atij nuk i nevojitet të kërkojë veprën penale të origjinës, që ka shërbyer për përfitimin e shumave të investuara në aktivitetin e sigurimit, gjë të cilën nuk mund të realizojë, për shkak se nuk gëzon kompetenca hetimore të karakterit penal.

Autoriteti bashkëpunon me DPPP, sipas modaliteteve dhe rregullave të përcaktuara në një marrëveshje të përbashkët ndërmjet dy institucioneve<sup>152</sup>. Marrëveshja<sup>153</sup> e nënshkruar midis dy institucioneve ka për qëllim bashkëpunimin nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, kryerjes së inspektimeve dhe trajnimeve të përbashkëta. Bashkëpunimi midis dy strukturave udhëhiqet nga disa parime<sup>154</sup>:

- Identifikimi në kohën e duhur të rasteve dhe situatave, të cilat kanë lidhje me pastrimin e parave. Respektimi i këtij parimi realizohet nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm dhe të plotë të mbikëqyrjes së shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, qoftë nga secili prej institucioneve veçmas, qoftë nga të dyja së bashku.
- Përcaktimi i saktë i përgjegjësive. Ky parim ka për qëllim rritjen e eficiencës dhe të përgjegjshmërisë së palëve për veprimet e kryera, për sa u takon çështjeve që trajtohen.
- Shkëmbimi i rregullt i informacionit dhe zhvillimi i takimeve periodike. Shkëmbimi i informacionit bëhet me shkrim dhe iu nënshtrohet rregullave të konfidencialitetit, pasi informacionet dhe dokumentet nuk mund t'u shpërndahen palëve të treta, pa miratimin paraprak me shkrim, të palëve në marrëveshje, përveç se kur në ligj parashikohet ndryshe. DPPP dhe

---

<sup>152</sup> Neni 16 i ligjit nr. 52/2014 “Burimi i kapitalit”

<sup>153</sup> “Marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni”, datë 28.05.2015, midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave

<sup>154</sup> Neni 4 “Parimet e marrëveshjes”

AMF nuk lejon përdorimin ose dhënien e çdo informacioni apo dokumentacioni, të marrë nga njëra-tjetra, për qëllime të tjera nga ato të përmendura në marrëveshje, përveç se kur në ligj parashikohet ndryshe.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në rast se, gjatë kontrolleve që ushtron në shoqëritë e licensuara, konstaton parregullsi, që lidhen me pastrimin e parave apo me financimin e aktiviteteve terroriste, duhet të raportojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Nga ana e saj, edhe DPPP duhet të raportojë pranë AMF, në disa raste. Konkretisht, palët shkëmbejnë çdo vit, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, informacion të shkruar mbi:

- a) Rezultatet e inspektimeve në vend, të kryera nga secili autoritet më vete, në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.
- b) Masat administrative dhe mbikëqyrëse, që janë marrë ndaj subjekteve<sup>155</sup>.

Për arsye se, aktiviteti në fushën e sigurimeve, si në çdo fushë tjetër të biznesit, nuk organizohet vetëm nga shoqëri vendase, por edhe nga kompani të huaja, kontrolli i të cilave mbështetet në informacione që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk i disponon detyrimisht, Autoriteti mund të lidhë marrëveshje apo memorandume bashkëpunimi me autoritete të tjera mbikëqyrëse, vendase apo të huaja, me autoritete mbikëqyrëse në sektorin financiar, agjenci ose institucione të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, apo institucione të tjera, të njohura me ligj, për të bashkëpunuar ose shkëmbyer informacione<sup>156</sup>.

Autoriteti mund të shkëmbejë me institucionet e huaja edhe informacione, të cilat lidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, kontrollon faza të ndryshme të zhvillimit të aktivitetit, nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit, në të

---

<sup>155</sup> Neni 5 i Marrëveshjes “Angazhime të përbashkëta të palëve”

<sup>156</sup> Kjo mundësi parashikohet nga neni 236 i ligjit nr. 52/2014 “Shkëmbimi i informacionit dhe përpunimi i të dhënave”

cilat verifikohet përmbushja e detyrimeve, që shoqëritë kanë, në fushën e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

#### **4.2. Lufta kundër pastrimit të parave në dhënien dhe revokimin e liçencës**

Kontrolli me qëllim shmangien e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ushtrohet në hapat e para të krijimit të shoqërisë, kur aksionerët veprojnë për të bërë të mundur ekzistencën e saj, por edhe në vazhdim. Ai luan një rol të rëndësishëm për dhënien e liçencës dhe mund të çojë edhe në revokimin e saj.

##### **4.2.1. Dhënia e liçencës:**

Pajisja e shoqërisë me liçencë, për ushtrimin e aktivitetit në fushën e sigurimit dhe risigurimit bëhet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe kalon nëpërmjet një procedure të përbërë nga dy etapa.

- a) miratimi paraprak;
- b) dhënia e liçencës.

Kërkesa për marrjen e miratimit paraprak, për ushtrim veprimtarie në sigurime, depozitohet me shkrim dhe shoqërohet nga një serë dokumentash<sup>157</sup>. Pjesë e dokumentave, që shoqërojnë kërkesën për

---

<sup>157</sup> Sipas nenit 30 “Kërkesa për marrjen e miratimit paraprak”, shoqërohet nga këto dokumenta:

“- Akti i themelimit dhe projektstatuti i shoqërisë aksionere.

- Emri i propozuar dhe adresa e selisë qendrore.
- Lista e aksionerëve, të dhëna për llojin e aksioneve, të dhëna për vlerën nominale të aksioneve, përqindja e pjesëmarrjes në kapitalin për çdo aksioner dhe personat apo palët e mundshme të lidhura.
- Vërtetimi, që kapitali minimal fillestar është paguar në para, në një llogari të veçantë garancie, në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Informacioni për burimin e kapitalit të aksionerëve.
- Politikat e brendshme, që do të zbatohen, për qeverisjen e mirë të shoqërisë.
- Plani i biznesit (dokument i detajuar, i cili tregon objektivat e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit, aftësinë e shoqërisë për të përmbushur parashikimet dhe përgjegjësitë, për të paktën tri vitet e para të veprimtarisë.)
- Propozimet për anëtarë të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administrator/anëtar të bordit të drejtorëve, si dhe funksionarë kryesorë, shoqëruar me informacionin përkatës, në përputhje me kërkesat e neneve 17 (kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi) dhe 20 (kriteret, që duhet të plotësojë personi, i cili propozohet të emërohet në një pozicion drejtues të shoqërisë), të ligjit.
- Struktura organizative e shoqërisë dhe, në mënyrë të veçantë, funksionimi i auditimit të brendshëm, funksionimi i sistemit të administrimit të rrezikut, sistemet e brendshme të kontrollit, sistemet e teknologjisë së informacionit.
- Politikat dhe procedurat e brendshme të shoqërisë për mënyrën e trajtimit të drejtë të konsumatorit.



marrjen e miratimit paraprak është edhe programi për zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Nëse shoqëria përmbush me sukses fazën e miratimit paraprak, atëherë mund të vijohet me atë të dhënies së licencës.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare duhet të raportojë pranë DPPP, çdo dyshim, informacion ose të dhënë, që lidhet me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, për institucionet, që ai mbikëqyr dhe që janë konstatuar gjatë procedurave të licënsimit të shoqërive. Një herë në vit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare duhet të raportojë pranë Drejtorisë, të dhëna statistikore, për sa i takon numrit të shoqërive, që janë licënsuar gjatë kësaj periudhe.

Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit gjen zbatim edhe në procedurat për licënsimin e brokerave<sup>158</sup>. Veprimtaria e brokerit në sigurime mund të kryhet vetëm nga personat fizikë, të cilët kanë marrë një licencë për të ushtruar këtë veprimtari. Autoriteti përcakton me rregullore kriteret, procedurat dhe afatet e licëncimit për të ushtruar veprimtari brokerimi si broker, si dhe rastet e refuzimit. Vendimi për miratimin ose refuzimin e licencës duhet të jetë i arsyetuar dhe t'i bëhet i njohur, me shkrim, personit, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes nga Autoriteti.

---

- Projekt-kontratat për delegimin e funksioneve të veçanta të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, në qoftë se shoqëria ka planifikuar delegime të tilla.  
1. Projekt-kontratat, duke përfshirë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit, në përputhje me klasën e sigurimit, për të cilën shoqëria ka kërkuar të licëncohet.

2. Të dhëna për produktet, primet dhe llogaritjen e primeve:

a) të dhëna për produkte, që mbulojnë rreziqe në klasat e jetës, si:

i) tabelat e vdekshmërisë;

ii) metodologjia për llogaritjen e primeve, tabelave të primeve;

iii) metodologjia për llogaritjen e provigjoneve të primeve të sigurimit të jetës;

iv) metodologjia e llogaritjes së vlerës monetare të dorëzimit të kontratës së sigurimit;

v) metodologjia e llogaritjes së reduktimit të primit në rastet, kur kontrata e parashikon një opsion të tillë;

vi) llogaritja e kthimit nga investimi, kthimit nga teprica, masa dhe mënyra e rimbursimit;

b) të dhëna për produkte, që mbulojnë rreziqe për klasat e jojetës, si:

i) raporti dëme/prime dhe indikatorë të tjerë të rrezikut, të cilët tregojnë të dhënat, që do të përdoren për kontrollin e mëtejshëm të llogaritjeve;

ii) përshkrimi i bazave teknike të të dhënave të përdorura për llogaritjen e primit;

iii) përshkrimi i elementeve dhe parametrave të planifikuar për llogaritjen e primit, duke përfshirë tabelat e primit;

3. Program për zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

II. Kërkesa për licëncim, për të ushtruar veprimtari në sigurime, shoqërohet edhe nga opinionin e një aktuari të autorizuar, në lidhje me të dhënat dhe llogaritjet e parashikuara në pikën 13, të paragrafit I, të këtij neni.

III. Përveç sa parashikohet më sipër, Autoriteti ka të drejtë të kërkojë dokumentacione dhe informacione të tjera shtesë. Autoriteti miraton rregulla në lidhje me dokumentacionin dhe informacionet shtesë, që i kërkojnë shoqërisë së sigurimit për licëncim, përfshirë edhe dokumentacionin e kërkuar për aksionerët themelues të shoqërisë së sigurimit. Mosdhënia e këtij dokumentacioni dhe informacioni përbën shkak për refuzimin e miratimit paraprak të licencës.”

<sup>158</sup> Neni 209 i ligjit nr. 52/2014 “Licenca e brokerit në sigurime dhe revokimi i saj”

Autoriteti revokon licencën e brokerit nëse:

- a) licenca është dhënë mbi bazën e të dhënave jo të vërteta;
- b) personi dënohet me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare, veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet dhe vepra penale të tjera;
- c) kërkuesi nuk disponon policën e përgjegjësisë profesionale, sipas dispozitave të nenit 205 të ligjit<sup>159</sup>;
- ç) ka shkelje të rënda të kodit të etikës dhe rregullave profesionale;
- d) ndaj tij merren masa administrative ose dënohet me vendim të formës së prerë për shkelje të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- dh) shkel dispozitat e ligjit nr. 52/2014 dhe ligjeve të tjera të fushës së sigurimeve.

Autoriteti, për shkelje të dispozitave të ligjit nr. 52/2014, mund të vendosë të pezullojë licencën për një periudhë deri në 6 muaj. Brokeri në sigurime duhet të përmbushë në mënyrë të vazhdueshme kushtet dhe procedurat e përcaktuara në nenin 209 të ligjit.

Në zbatim të nenit të sipërcituar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar një rregullore specifike, në datën 30 qershor 2015<sup>160</sup>. Rregullorja përcakton kriteret për licensimin e brokerit në sigurime<sup>161</sup>. Në mënyrë që, një person fizik të pajiset me licencë për të kryer veprimtarinë e brokerimit, ai duhet, ndër të tjera, të mos jetë dënuar për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese e piramidale të huamarrjes, për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. I njëjti kriter zbatohet edhe për

---

<sup>159</sup> Neni 205 “Sigurimi i përgjegjësisë profesionale dhe garancia financiare e brokerit/shoqërisë së brokerimit në sigurime” i ligjit parashikon:

1. Brokeri/shoqëria e brokerimit siguron në një shoqëri sigurimi përgjegjësitë profesionale të tij/të saj ndaj palëve të treta, në një shumë jo më të vogël se 30 000 000 lekë, për çdo dëm të shkaktuar si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së brokerimit dhe jo më të vogël se 100 000 000 lekë, për të gjitha dëmet në një vit kalendarik.

2. Brokeri/shoqëria e brokerimit ka të drejtë të grumbullojë prime nga i siguruari dhe t’i arkëtojë ato për llogari të shoqërisë së sigurimit. Brokeri/shoqëria e brokerimit përdor një llogari bankare të veçantë, të hapur për këtë qëllim dhe të ndarë veçmas nga llogaria e tij e biznesit.

3. Brokeri/shoqëria e brokerimit në sigurime detyrohet të ketë, në mënyrë të vazhdueshme, një garanci financiare në masën 4 për qind të shumës të primeve vjetore të mbledhura, e cila nuk duhet të jetë më e vogël se 1 000 000 lekë. Garancia financiare depozitohet në një llogari qëllimore në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja, që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

<sup>160</sup> Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 48 datë 30.06.2015 e Bordit të AMF, “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licensimit si dhe rastet e refuzimit të licensës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”.

<sup>161</sup> Neni 3 i Rregullores “Kriteret e licensimit të brokerit në sigurime”.

Administratorët, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe anëtarët e Këshillit të Administrimit të personit juridik, i cili aplikon për të marrë liçencë, me qëllim ushtrimin e aktivitetit të brokerimit.

Rregullorja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare trajton edhe rastin kur, liçenca për ushtrimin e aktivitetit të brokerimit kërkohet nga një bankë ose degë e një banke të huaj. Kërkesës me shkrim për marrjen e liçencës, subjekti aplikues duhet t'i bashkëngjitë një sërë dokumentash, midis të cilëve edhe rregullat e brendshme, që duhet të përmbajnë politikat dhe/ose procedurat për mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi<sup>162</sup>. Rregullorja parashikon në mënyrë të shprehur se, mospërmbushja e kriterit, që ka të bëjë me mospërfshirjen e subjekteve në aktivitete, të cilat kanë për qëllim pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, përbën shkak për refuzimin e liçencës subjekteve, që paraqesin kërkesë për këtë qëllim<sup>163</sup>.

Ligji<sup>164</sup>, ka shtrirë fushën e zbatimit të kërkesave, për sa i takon mosorganizimit të mëparshëm të aktiviteteve të pastrimit të parave edhe tek vlerësuesit e dëmeve, duke e përfshirë këtë kriter në listën e kushteve, që duhet të përmbushë subjekti, që kërkon të pajiset me liçencë për ushtrimin e këtij aktiviteti.

---

<sup>162</sup> Neni 10 “Dokumentacioni për licencimin e bankës dhe/ose degës së bankës së huaj për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime”, e Rregullores nr. 48, dt. 30.06.2015. “ Kërkesa me shkrim, sipas formës të paraqitur në aneksin 3 të kësaj rregullore, e paraqitur nga Banka dhe/ose dega e bankës së huaj, për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime, shoqërohet me:

- a) Miratimin nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime;
- b) Të dhëna për strukturën/njësine e brokerimit;
- c) Plani i biznesit për tre vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së brokerimit;
- d) Rregullat e brendshme që duhet të përmbajnë politikat dhe/ose procedurat për:
  - i. Njohjen e konsumatorit;
  - ii. Mënyrën e trajtimit të ankesave;
  - iii. Mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
  - iv. Trajtimin e konfliktit të interesit;
  - v. Funksionin e përputhshmërisë që siguron përputhjen e aktivitetit të shoqërisë së brokerimit me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- e) Listën e brokerave të licencuar.

2. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqëruar duhet të jenë në gjuhën shqipe, origjinale ose kopje të noterizuara, jo më të hershme se tre muaj nga data e aplikimit.

3. Autoriteti, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse e çmon të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.”

<sup>163</sup> Neni 15 i Rregullores “Rastet e refuzimit të liçencës”

<sup>164</sup> Neni 227 i ligjit nr. 52/2014 “Liçensimi i vlerësuesit të dëmeve”.

#### 4.2.2. Revokimi i licencës

Shoqërisë së sigurimit dhe risigurimit mund t'i revokohet licenca për arsye, që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, në kuadër të ushtrimit të aktivitetit. Rastet e revokimit të licencës janë parashikuar në mënyrë shteruese në ligj<sup>165</sup>. Një prej këtyre rasteve është ai i marrjes, në mënyrë të përsëritur, të masave administrative ose dënimit të shoqërisë, me vendim të formës së prerë, për shkelje të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Ligji ka parashikuar gjithashtu që, të gjitha rregullat, që zbatohen për shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit, për sa u takon kontrolleve të ushtruara përpara marrjes së licencës dhe në kuadër të revokimit të saj, zbatohen edhe për agjentët në sigurime<sup>166</sup>. Kështu, Autoriteti ndalon ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime dhe e çregjistron atë nga regjistri, nëse ndaj tij merren masa administrative ose dënohet, me vendim të formës së prerë, për shkelje të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Licenca e shoqërisë së agjentëve mund të revokohet po për këtë arsye<sup>167</sup>.

Ashtu sikurse ndodh me agjentin e sigurimeve, edhe brokeri mund të humbasë licencën, nëse ndaj tij merren masa administrative ose dënohet, me vendim të formës së prerë, për shkelje të legjislacionit për

---

<sup>165</sup> Neni 155 i ligjit nr. 52/2014 “Rastet e revokimit të licencës”. Autoriteti i revokon licencën për të ushtruar veprimtari sigurimi, një shoqërie në rast se:

- a) licenca është bazuar në të dhëna jo të vërteta;
- b) shoqëria e sigurimit nuk ka arritur të korrigjojë rrethanat e përmendura në nenin 150, të ligjit, brenda afateve të përcaktuara nga Autoriteti në urdhrin përkatës (Neni 150 i ligjit trajton rrethanat, në të cilat nga AMF merren masa mbikëqyrjeje kundrejt një shoqërie sigurimi);
- c) shoqëria e sigurimit kryen veprimtari të tjera tregtare, përveç veprimtarisë për të cilën është licencuar;
- ç) shoqëria e sigurimit nuk përmbush më kushtet, për të cilat është licencuar;
- d) shuma totale e përgjegjësisë të shoqërisë së sigurimit, përfshirë provigjonet teknike ose matematike, të llogaritura në përputhje me ligjin nr. 52/2014 dhe aktet e Autoritetit, tejkalojnë shumën totale të aktiveve të saj;
- dh) anëtarët e Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës dhe Administratori/anëtari i Bordit të drejtorëve janë deklaruar fajtorë, me vendim të formës së prerë, për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike dhe vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare;
- e) ka prova të besueshme dhe konstaton, që anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Administratori janë përfshirë në transaksione, të cilat nuk janë në përputhje me ligjin, kur veprimet dhe/ose mosveprimet e tyre nuk përbëjnë veprë penale;
- ë) kur ndaj shoqërisë së sigurimit merren, në mënyrë të përsëritur, masa administrative ose shoqëria dënohet, me vendim të formës së prerë, për shkelje të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- f) kur shoqëria dënohet, me vendim të formës së prerë, për vepra penale të kryera në sferën ekonomike dhe vepra penale në shoqëritë tregtare;
- g) ndaj shoqërisë së sigurimit janë hapur procedurat e falimentimit ose shoqëria e sigurimit prishet;
- gj) shoqëria e sigurimit zbaton praktika të brendshme tregtare, që çenojnë në mënyrë të kundërligjshme të drejtat e të siguruarve.

<sup>166</sup> Neni 199 i ligjit nr. 52/2014 “Miratimi/ndalimi i agjentëve në sigurime”.

<sup>167</sup> Neni 201 i ligjit nr. 52/2014 “Licenca e shoqërisë së agjentëve dhe revokimi i saj”.

parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit<sup>168</sup>. Marrja e masave administrative ose dënimi, me vendim të formës së prerë, për shkelje të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit është, gjithashtu, një nga shkaqet për të cilat shoqërisë së brokerimit mund t'i revokohet liçenca<sup>169</sup>.

Përveç sa u përmend më sipër, ligji nr. 52/2014 “Për sigurimin dhe risigurimin”, përmban një dispozitë të veçantë<sup>170</sup>, e cila parashikon disa detyrime të operatorëve, që veprojnë në fushën e sigurimit dhe risigurimit. Në mënyrë përgjithësuese, ky nen parashikon, që shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit marrin, ndër të tjera, të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit". Gjithashtu, shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit marrin të gjitha masat e nevojshme për zbulimin, parandalimin dhe ndreqjen e rasteve të mashtrimit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e sigurimeve. Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit raportojnë menjëherë në Autoritet çdo fakt, që përbën mashtrim gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e sigurimeve.

DPPPP dhe AMF publikojnë rregullisht të dhëna, për ushtrimin e aktivitetit të tyre, pjesë e të cilit është edhe kontrolli i veprimeve të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, të cilat mund të bëhen me qëllim të pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit.

Ligji nr. 9917, ka parashikuar gjithashtu që, DPPPP mund t'i kërkojë autoritetit liçencues dhe/ose mbikëqyrës, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në rastin e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, të kufizojë, të pezullojë ose të revokojë liçencën e një subjekti<sup>171</sup>:

a) kur konstaton ose ka fakte për të besuar se subjekti është përfshirë në pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit;

---

<sup>168</sup> Neni 209 “Liçenca e brokerit në sigurime dhe revokimi i saj”.

<sup>169</sup> Neni 211 “Liçenca e shoqërisë së brokerimit dhe revokimi i saj”.

<sup>170</sup> Neni 240 i ligjit nr. 52/2014 “Parandalimi i pastrimit të parave dhe mashtrimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e sigurimeve”.

<sup>171</sup> Neni 26 “Revokimi i liçencës” i ligjit nr. 9917/2008.

b) kur subjekti, në mënyrë të përsëritur, kryen njërën ose disa nga kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 27 të këtij ligji<sup>172</sup>.

AMF shqyrton kërkesën e DPPPP, bazuar në dokumentacionin shoqërues të saj, i cili paraqet të dhëna ose dyshime, të mbështetura në rrethana dhe fakte konkrete. Autoriteti liçencues dhe/ose mbikëqyrës vendos për pranimin ose refuzimin e saj, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9917/2008 dhe dispozitat ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e tij dhe të subjekteve të liçencuara dhe mbikëqyrura prej tij.

#### **4.3. Përzgjedhja e personave në funksione drejtuese dhe vendimmarrëse**

Autoriteti i ka dhënë një rëndësi të veçantë mbikëqyrjes me bazë risku, e cila ka për qëllim të përqëndrojë përgjegjësinë për ruajtjen e sigurisë dhe fuqisë financiare tek menaxhimi i kompanisë dhe Këshilli Mbikëqyrës (Guri dhe Dervishi, Pranverë 2010, fq. 154).

Ligji<sup>173</sup> ka parashikuar kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi, që Autoriteti duhet të vlerësojë gjatë procedurës së analizimit të dosjes së çdo personi, që është ose do të jetë aksioner influencues, anëtar i Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administrator/anëtar i Bordit të drejtorëve, kontrollues kryesor ose funksionar kryesor i shoqërisë së sigurimit. Konkretisht, këto kërkesa janë:

- a) të zotërojë cilësitë e nevojshme për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e pozicionit përkatës në shoqërinë e sigurimit;
- b) të ketë integritet, ndershmëri dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave të tij;
- c) të zotërojë kualifikimin e nevojshëm dhe të ketë eksperiencën profesionale, në përputhje me përgjegjësitë e pozicionit përkatës;

---

<sup>172</sup> Neni 27 i ligjit nr. 9917/2008 flet për kundërvajtjet administrative, shkeljet e kryera nga subjektet e mbikëqyrura, midis të cilave edhe shoqëritë e sigurimit, të cilat nuk përbëjnë vepër penale, por klasifikohen si kundërvajtje penale.

<sup>173</sup> Neni 17 i ligjit nr. 52/2014 “Kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi”

ç) të ruajë pavarësinë, në mënyrë që të mos cënohen interesat e shoqërisë nga konflikti i interesit, që mund të krijohet gjatë ushtrimit të detyrës.

Autoriteti vlerëson nëse aksioneri influencues është i përshtatshëm për të mbajtur pozicionin e tij, në qoftë se ai zotëron një gjendje financiare të shëndetshme dhe ka integritet. Përveç sa më sipër, Autoriteti vlerëson sjelljen dhe veprimtaritë e mëparshme në biznes ose në çështje financiare të këtyre personave. Në mënyrë të veçantë, shqyrton nëse ka të dhëna, që tregojnë se ky person është:

a) i dënuar me vendim të formës së prerë për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes, për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

b) i përfshirë ose i lidhur me humbje financiare, të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme ose neglizhente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe administrimin e shoqërive të tjera;

c) i angazhuar në praktika tregtare, të cilat Autoriteti i gjykon si praktika mashtruese, kërcënuese ose të papërshtatshme, ose që, në një farë mënyre, pasqyrojnë mangësi vlerash të një personi në kryerjen e shërbimeve financiare dhe veprimeve të tjera tregtare;

ç) i padënuar në 5 vitet e fundit për vepër tjetër penale.

Kujdes të veçantë Autoriteti duhet të tregojë në shqyrtimin e të dhënave, nga të cilat rezulton/mund të rezultojë se personat e mësipërm janë të dënuar me vendim të formës së prerë për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes, për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit<sup>174</sup>.

Kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi, duhet të përmbushen nga personat e mësipërm gjatë gjithë kohës, që janë në detyrë. Autoriteti ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë së sigurimit të vërtetojë përshtatshmërinë dhe aftësinë e tyre sa herë e vlerëson të arsyeshme. Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit, që ka nënshkruar me DPPP, AMF duhet të marrë masat e nevojshme, për të raportuar

---

<sup>174</sup> Po aty.

pranë Drejtorisë, me qëllim që, një person, i dyshuar për kryerjen e veprimtarisë së pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të mos zotërojë, kontrollojë apo marrë pjesë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në pronësinë e aksioneve, drejtimin, administrimin ose veprimtarinë e një subjekti nën mbikëqyrjen e AMF<sup>175</sup>.

#### **4.4. Zgjerimi i aktivitetit në një shoqëri jashtë territorit shqiptar**

Shoqëria e sigurimit, përpara zotërimit të pjesëmarrjes influencuese në një tjetër shoqëri siguri, ose institucion financiar, në një vend të huaj/vend anëtar, njofton me shkrim Autoritetin. Shoqëria e sigurimit njofton paraprakisht me shkrim Autoritetin edhe për çdo pjesëmarrje të mëtejshme, që arrin ose tejkalon 20 për qind, 30 për qind, 50 për qind ose 75 për qind të të drejtave të votës ose pjesëmarrjes në kapitalin e një institucioni financiar të huaj<sup>176</sup>.

Gjithashtu, shoqëria e sigurimit njofton paraprakisht me shkrim Autoritetin, nëse kërkon zvogëlimin e pjesëmarrjes së saj në nivelet e parashikuara më sipër. Autoriteti, me qëllim që të garantohet veprimtaria e shoqërisë së sigurimit, sipas parimeve dhe praktikave më të mira tregtare, si dhe qëndrueshmëria e saj financiare, gjatë marrjes në zotërim të pjesëmarrjes influencuese, merr parasysh edhe kriteret e mëposhtme:

- a) reputacionin e biznesit të shoqërisë së sigurimit, ku shoqëria e sigurimit kërkon të ketë pjesëmarrje influencuese;
- b) reputacionin e biznesit dhe përvojën e personave, që do të administrojnë veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit, që kërkon të ketë pjesëmarrje;

---

<sup>175</sup> Neni 6 “Të drejtat dhe detyrimet e AMF-së” i Marrëveshjes së bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit, të lidhur midis AMF dhe DPPPP.

<sup>176</sup> Neni 50 “Njoftimi paraprak i pjesëmarrjes influencuese jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”



- c) qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë së sigurimit, ku shoqëria e sigurimit kërkon të ketë pjesëmarrje;
- ç) aftësinë e shoqërisë së sigurimit, që kërkon të ketë pjesëmarrje influencuese në një tjetër shoqëri sigurimi, për të vazhduar veprimtarinë e saj, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014. Nëse shoqëria do të bëjë pjesë në një grup sigurimi, grupi i sigurimit duhet të ketë strukturën e duhur, që mundëson ushtrimin e përshtatshëm të mbikëqyrjes, shkëmbimin e përshtatshëm të informacionit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse përgjegjëse, si dhe shpërndarjen e përgjegjësisë ndërmjet këtyre autoriteteve;
- d) parandalimin e rasteve të mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që kanë të bëjnë me marrjen në zotërim të pjesëmarrjes influencuese<sup>177</sup>.

Shoqëria duhet të tregohet e kujdesshme në veprimet e saj dhe në marrjen e autorizimit të AMF për zgjerimin e aktivitetit dhe realizimin e një operacioni, që do të lejonte pjesëmarrjen influencuese, në një shoqëri tjetër, pasi mosrespektimi i procedurave, mund të sjellë si rezultat pavlefshmërinë e veprimit<sup>178</sup>. Verifikimi i masave të ndërmarra nga shoqëria për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit prek edhe veprimet për zgjerimin e aktivitetit në një shoqëri të huaj.

#### **4.5. Auditimi i shoqërisë së sigurimit**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare bashkëpunon edhe me strukturat audituese të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit. Shoqëria audituese e dërgon raportin e auditimit në asamblenë e përgjithshme dhe komitetin e auditimit të shoqërisë së sigurimit ose autoritetin përkatës mbikëqyrës të shoqërisë së huaj, në rastet e degës së shoqërisë së sigurimit të huaj/vendit anëtar<sup>179</sup>.

---

<sup>177</sup> Po aty.

<sup>178</sup> Neni 51 “Pasojat ligjore të pjesëmarrjes influencuese pa miratim”.

<sup>179</sup> Neni 125 “Raporti i shoqërisë audituese”

Shoqëria audituese jep opinionin e saj nëse llogaritë vjetore të shoqërisë së sigurimit, të konsoliduara dhe të pakonsoliduara, janë në përputhje me standardet dhe rregullat profesionale në fuqi. Ajo raporton menjëherë në Autoritet çdo fakt, që lidhet me shoqërinë e sigurimit, për të cilin është vënë në dijeni gjatë kryerjes së detyrave në lidhje me:

- a) shkelje të ligjeve, akteve nënligjore në fuqi, akteve të Autoritetit ose akteve administrative, që kanë të bëjnë me kushtet, në bazë të të cilave i është dhënë licenca për të ushtruar veprimtari sigurimi;
  - b) mashtrim ose përvetësim, vjedhje, pastrim parash apo financim të terrorizmit;
  - c) shkelje të rregullave të brendshme të shoqërisë së sigurimit;
  - ç) ndryshim të rëndësishëm të rezultatit financiar të paraqitur në llogaritë vjetore të paaudituar;
  - d) fakte dhe rrethana të tjera shtesë, të cilat mund të kenë ndikim mbi veprimtarinë e mëtejshme të shoqërisë së sigurimit;
- dh) çdo transaksion të shoqërisë së sigurimit me palë të lidhura, që përbën rrezik për likuiditetin dhe për rregullat e administrimit të rrezikut.

Raporti i auditimit, që përmban opinionin për pasqyrat financiare, shoqërohet nga raporti i aktuarit të shoqërisë audituese.

Raportimi, informimi dhe dhënia e çdo fakti, sipas pikave, që kanë të bëjnë me shkelje të dispozitave ligjore, nga ana e shoqërisë, në veçanti të dispozitave, që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave, apo financimin e terrorizmit, nga shoqëria audituese pranë autoriteteve mbikëqyrëse, nuk përbën shkelje të kufizimeve për dhënie të informacionit, të përcaktuara në kontratë ose në legjislacionin në fuqi dhe personat janë të çliruar nga çdo lloj përgjegjësie<sup>180</sup>.

Autoriteti mund t'i kërkojë shoqërisë audituese shpjegime shtesë për auditimin e kryer dhe raportin e auditimit, si dhe çdo informacion tjetër, që ai e gjykon të nevojshëm, në funksion të ushtrimit të mbikëqyrjes. Nëse gjatë kryerjes së detyrave shoqëria audituese konstaton se shoqëria e sigurimit ka

---

<sup>180</sup> Po aty.

shkelur rregullat e administrimit të rrezikut dhe si pasojë çënohen interesat e të siguruarve, si dhe rrezikohen likuiditeti apo vijueshmëria e veprimtarisë së saj, informon menjëherë Autoritetin.

#### **4.6. Përdorimi i informacionit personal të klientit**

Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të aktiviteteve terroriste përbën shkak që të kushtëzohet, në njëfarë mënyre, një nga garancitë më të rëndësishme, që u ofrohet konsumatorëve, që lidhin një kontratë sigurimi dhe që ka të bëjë me ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit personal, të dhënë në kuadër të lidhjes dhe zbatimit të kontratës së sigurimit.

“E dhënë personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social<sup>181</sup>.

Privatësia është pikërisht e drejta për të ruajtur kontrollin mbi informacionin që na përket, të jemi të vetëdijshëm se shumë nga veprimet tona të përditshme lenë gjurmë, në atë mënyrë që zbulojnë detajet e personalitetit tonë, besimit tonë të brendshëm, që jo gjithmonë duam që të tjerët ta njohin<sup>182</sup>.

Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, fakteve dhe rrethanave, që kanë të bëjnë me të siguruarit, me të cilat njihen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre<sup>183</sup>.

Anëtarët e Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administratori/anëtari i Bordit të drejtorëve, funksionarët kryesorë, drejtorët, aksionarët, të punësuarit dhe çdo person tjetër i shoqërisë së sigurimit dhe ndërmjetësit, të cilët, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, përdorin të dhëna personale të

---

<sup>181</sup> Përkufizimi jepet në nenin 3 të ligjit nr. 9887, dt. “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 dt. 26.04.2012.

<sup>182</sup> Roland Subashi, “Parandalimi i pastrimit të parave”, faqe 42, sipas përkufizimit të dhënë nga Mauro Paissan.

<sup>183</sup> Neni 71 i ligjit nr. 52/2014, “Konfidencialiteti”.

policëmbajtësve, nuk duhet t'ua japin ato palëve të treta, t'i përdorin kundër interesave të shoqërisë së sigurimit dhe konsumatorëve të saj, apo të mundësojnë përdorimin e tyre nga palë të treta.

Parimi i konfidencialitetit njeh shumë pak përjashtime. Janë konkretisht 7 raste gjithsej<sup>184</sup>. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit nuk zbatohet nëse:

- a) i siguruari miraton shprehimisht me shkrim nxjerrjen e informacioneve personale;
- b) të dhënat kërkohen në procese gjyqësore dhe një kërkesë e tillë është bërë me shkrim nga gjykata kompetente;
- c) të dhënat kërkohen në procese hetimore nga organi i prokurorisë;
- ç) në rastet e parashikuara në ligjin nr. 9917, dt. 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- d) informacioni kërkohet nga Autoriteti ose nga autoritetet e tjera mbikëqyrëse, me qëllim ushtrimin e mbikëqyrjes brenda kompetencave të tyre;
- dh) informacioni kërkohet nga organet tatimore;
- e) informacioni kërkohet sipas dispozitave të ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të ndryshuar.

Duket qartë se, në dilemën, që mund të ekzistojë midis mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit, nëpërmjet kufizimit të përdorimit të informacionit të dhënë prej tij dhe ruajtjes së interesit publik, ligjvënësi shqiptar i ka dhënë përparësi, ruajtjes së interesit publik. Interesi publik, për të cilin është shumë e vështirë të jepet një përkufizim shterues, interpretohet nga ligjvënësi shqiptar gjerësisht, pasi siç shihet, rastet në të cilat lejohet dhënia e informacionit personal prekin çështjet fiskale, çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, çështjet për të cilat është duke u hetuar

---

<sup>184</sup> Neni 72 i ligjit nr. 52/2014 “Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit”.

nga prokuroria ose duke u zhvilluar një gjykim, si dhe rastet kur informacioni kërkohet nga AMF ose organe të tjera, për ushtrimin e veprimtarive të tyre mbikëqyrëse.

Për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, kërkon çdo lloj informacioni nga subjektet, që i nënshtrohen këtij ligji. Nga ana tjetër, DPPPP, mund të përdorë informacionin e marrë dhe, që përmban të dhëna private për të siguruarin, vetëm për qëllime të parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave e financimit të terrorizmit dhe jo për arsye të tjera<sup>185</sup>.

Për zbatimin e ligjit nr. 9917/2008, pavarësisht nga parashikimet e ligjeve të tjera, AMF, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës të shoqërive të sigurimit, mund të kërkojë nga subjektet akses dhe vënien në dispozicion të çdo lloj informacioni dhe dokumenti, që lidhet me përputhshmërinë e detyrimeve të subjekteve në zbatim të ligjit nr. 9917/2008. Autoriteti mbikëqyrës, AMF duhet t'i raportojë menjëherë autoritetit përgjegjës<sup>186</sup> çdo dyshim, informacion ose të dhënë, që lidhet me pastrim parash ose financim terrorizmi, për veprimtaritë nën juridiksionin e tij. Ligji<sup>187</sup> nr. 9917 ka parashikuar që Autoritetet mbikëqyrëse, midis të cilave edhe AMF, kryejnë edhe këto detyra:

a) kontrollojnë zbatimin e programeve të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga subjektet dhe sigurohen që këto programe janë të përshtatshme;

b) informojnë në kohë dhe bashkëpunojnë me autoritetin përgjegjës, për çështjet e mospërputhshmërisë, rezultatet e inspektimeve të tyre, masat përmirësuese, që do të merren dhe masat administrative, nëse ka pasur;

c) ndërmarrin masat e nevojshme për të parandaluar, që një person i papërshtatshëm të zotërojë, të kontrollojë ose të marrë pjesë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në drejtimin, administrimin

---

<sup>185</sup> Ky qëndrim rrjedh nga dispozitat e ligjit nr. 9917/2008, në veçanti nga leximi i kombinuar i neneve 21 dhe 22 të këtij ligji.

<sup>186</sup> Neni 12 i ligjit nr. 9917 ka përcaktuar që, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ushtron funksionet e autoritetit të përgjegjës, sipas këtij ligji, si një institucion në varësi të Ministrit të Financave. Kjo drejtori, brenda fushës së veprimtarisë së vet, ka të drejtë të vendosë për mënyrën e ndjekjes dhe të zgjidhjes së çështjeve të trajtuara për pastrimin e mundshëm të parave dhe financimin e veprimtarive të mundshme terroriste.

<sup>187</sup> Neni 24 i ligjit nr. 9917/2008 “Funksionet e autoriteteve mbikëqyrëse”.

ose veprimtarinë e një subjekti;

ç) bashkëpunojnë dhe ofrojnë asistencë të specializuar, sipas veprimtarisë së tyre, në fushën e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, në përputhje me kërkesat e autoritetit përgjegjës;

d) bashkëpunojnë për përgatitjen dhe shpërndarjen e programeve të trajnimit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

dh) mbajnë statistika për veprimet e ndërmarra, si dhe për sanksionet e vendosura në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Subjektet e ligjit nr. 9917/2008, duhet të sigurohen, që të gjitha të dhënat për klientin dhe transaksionin dhe informacioni i mbajtur nga shoqëria, të vihen menjëherë në dispozicion me kërkesën e autoritetit përgjegjës<sup>188</sup>.

Ligji nr. 9917, ka parashikuar që, subjektet, e këtij ligji, i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, në rastin konkret, DPPP, ku parashtrojnë dyshimet, që kanë, për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet, pastrimi i produkteve të veprës penale, financimi i terrorizmit, apo kur fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë<sup>189</sup>.

Ligji nr. 9917 ka parashikuar gjithashtu që, subjektet ose autoritetet mbikëqyrëse, drejtuesit, zyrtarët ose punonjësit e tyre, të cilët në mirëbesim raportojnë ose japin informacion, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pranë autoritetit përgjegjës, janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale, civile ose

---

<sup>188</sup> Në bazë të neni 16 të ligjit nr. 9917/2008 “Detyrimi për ruajtjen e të dhënave”, Subjekti duhet të ruajë këto informacione:

- dokumentacionin për identifikimin, llogaritë, si dhe korrespondencën me klientin, për 5 vjet nga data e mbylljes së llogarisë apo përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit e subjektit. Me kërkesën e autoritetit përgjegjës, dokumentacioni ruhet për më shumë se 5 vjet.

- regjistra për të dhënat, raportimet dhe dokumentacionin për transaksionet financiare, kombëtare dhe ndërkombëtare, pavarësisht nëse transaksioni është kryer në emër të klientit ose në emër të palëve të treta, së bashku me të gjithë dokumentacionin mbështetës, përfshirë dosjet e llogarive dhe korrespondencën e biznesit, për 5 vjet, që nga data e kryerjes së transaksionit financiar. Me kërkesë të autoritetit përgjegjës, informacioni ruhet për më shumë se 5 vjet, edhe nëse llogaria ose marrëdhënia e biznesit ka përfunduar.

- të dhëna për transaksionet, me të gjitha hollësitë, që lejojnë rindërtimin e ciklit të plotë të transaksioneve, me qëllim sigurimin e informacionit për autoritetin përgjegjës. Ky informacion ruhet për 5 vjet nga data e kryerjes së transaksionit të fundit financiar. Me kërkesë të autoritetit përgjegjës, informacioni ruhet për më shumë se 5 vjet, edhe nëse llogaria ose marrëdhënia e biznesit ka përfunduar.

<sup>189</sup> Neni 12 i ligjit, “Raportimi tek autoriteti përgjegjës”.

administrative për nxjerrjen e sekretit profesional ose bankar<sup>190</sup>.

Së fundi, ligji nr. 9917 ka parashikuar që, drejtuesve, zyrtarëve dhe punonjësve, të përkohshëm apo të përhershëm, të subjekteve, autoriteteve mbikëqyrëse apo institucioneve, që u kërkohet të raportojnë pranë autoritetit përgjegjës, sipas këtij ligji, u ndalohet të informojnë klientin ose çdo person tjetër, për dërgimin apo përgatitjen për dërgim të informacionit për autoritetin përgjegjës, për raportimin e aktivitetit të dyshimtë, si dhe për çdo informacion, që kërkohet nga ky i fundit apo për hetimet, që janë duke u kryer<sup>191</sup>.

Nga ana tjetër, çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga DPPPP për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe nuk përbën provë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale<sup>192</sup>.

#### **4.7. Marrja e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit**

Ligji nr. 9917/2008 e përkufizon vigjilencën e duhur si tërësinë e masave, që duhet të aplikojnë subjektet, që i nënshtrohen këtij ligji, me qëllim identifikimin dhe verifikimin e plotë dhe të saktë të klientëve, pronarit përfitues përfundimtar, strukturës së pronësisë dhe të kontrollit, për personat juridikë dhe organizimet ligjore, natyrën dhe qëllimin e transaksionit apo marrëdhënies, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit dhe të shqyrtimit të vazhdueshëm të transaksioneve, për të siguruar, që janë në përputhje me natyrën e biznesit të klientit dhe profilet e rrezikut, duke përfshirë, kur është e nevojshme, burimin e fondeve.”<sup>193</sup>.

Ligji parashikon gjithashtu edhe “vigjilencën e zgjeruar ndaj klientit”, i cili është një proces më i thellë kontrolli, përtej procedurave “njihe klientin tënd”, që synon të krijojë sigurinë e mjaftueshme për

---

<sup>190</sup> Neni 14 i ligjit, “Përfundimi nga përgjegjësit ligjorë për raportim pranë autoritetit përgjegjës”.

<sup>191</sup> Neni 15 i ligjit, “Kërkesa për mosdeklarim”.

<sup>192</sup> Neni 22/1 i ligjit, “Përdorimi i të dhënave”.

<sup>193</sup> Përkufizimi jepet në nenin 2 të ligjit.

të verifikuar dhe vlerësuar identitetin e klientit, për të kuptuar dhe testuar profilin e tij, të biznesit dhe veprimtarisë së llogarive të tij bankare, për të identifikuar informacionet me rëndësi dhe për të vlerësuar rrezikun e mundshëm për pastrim parash/financim terrorizmi, në mbështetje të vendimeve, që synojnë mbrojtjen nga rreziqet financiare, rregullatore apo reputacionale, si dhe përshtatjen ndaj kërkesave ligjore<sup>194</sup>.

Procedura “njihe klientin tënd” sipas ligjit nr. 9917/2008 nënkupton një sërë rregullash, të përdoruara nga institucionet financiare dhe siguruese, që kanë të bëjnë me politikat e pranimi e të identifikimit të klientit dhe administrimit të riskut të tyre.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, nga ana e tij ka miratuar një rregullore<sup>195</sup>, mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar që duhet të merren nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Kjo Rregullore, është miratuar mbi bazën e pikës 2 nenit 14 të ligjit nr. 9572, dt. 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, mbi bazën e nenit 24 të ligjit nr. 9917, dt. 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” dhe mbi bazën e nenit 7 të ligjit nr. 157, dt. 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Pika 2 e nenit 14 të ligjit nr. 9572/2006, i jep Bordit të AMF, kompetenca për të miratuar rregullat, rregulloret, vendimet dhe udhëzimet për mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve e personave, që ushtrojnë veprimtari në tregjet financiare, që mbikëqyren nga Autoriteti, si dhe udhëzues për interpretimin dhe zbatimin e ligjeve, që rregullojnë këto veprimtari. Neni 24 i ligjit nr. 9917/2008, i njeh AMF, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, kompetencën për të kontrolluar nëse subjektet e ligjit i zbatojnë me korrektësi detyrimet ligjore, që kanë të bëjnë me marrjen e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit. Së fundi, neni 7 i ligjit nr. 157/2013, përcakton

---

<sup>194</sup> Po aty.

<sup>195</sup> Rregullorja është miratuar me vendimin nr. 58 të Bordit të AMF, dt. 30.06.2015.



Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare si një ndër organet përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e masave kundër financimit të terrorizmit, të marra, në zbatim të këtij ligji.

Vëmë re që, në përkufizimet e dhëna, në Rregulloren e miratuar me vendimin e Bordit nr. 58 të datës 30 qershor 2015, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka referuar tërësisht në përkufizimet e dhëna nga ligji nr. 9917, të cituara më sipër. Rregullorja e miratuar nga AMF dhe ligji nr. 9917, japin të njëjtin përkufizim edhe përsa i përket termit “subjekt”. Subjekt, është personi fizik ose juridik, që vendos marrëdhënie biznesi me klientë, gjatë veprimtarisë së tij normale apo si pjesë të veprimtarisë tregtare ose profesionale të tij. Gjithashtu, Rregullorja përcakton në mënyrë të shprehur, që termat e përdorur në të, kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin nr. 9917/2008<sup>196</sup>.

Ekzistojnë disa raste, kur subjektet duhet të marrin masat e vigjilencës së duhur. Një pjesë gjejnë zbatim vetëm për sektorin bankar, disa të tjera prekin edhe shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit<sup>197</sup>.

- Në mënyrë të përgjithshme, subjektet duhet të marrin masat e vigjilencës së duhur sa herë janë gati të hyjnë në një marrëdhënie biznesi, përpara se të krijohet marrëdhënia e biznesit.
- Subjektet duhet të marrin masat e vigjilencës së duhur sa herë kanë dyshime për vërtetësinë e të dhënave të identifikimit të marra më parë, gjatë ekzekutimit të marrëdhënies kontratore me konsumatorin.
- Së fundi, subjektet duhet të marrin masat e vigjilencës së duhur në të gjitha rastet, kur kanë dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Subjektet duhet të identifikojnë në mënyrë të plotë dhe të saktë klientët e tyre dhe personat përfitues dhe të kërkojnë informacione shtesë, në rastet kur e gjejnë të nevojshme. Rregullorja u ka lënë subjekteve një hapësirë vlerësimi relativisht të gjerë për sa u takon rasteve të vigjilencës së zgjeruar. Ndërkohë që, ligji nr. 9917/2008 ka parashikuar në detaje hapat e njëpasnjëshme, që duhet të ndërmarrin

---

<sup>196</sup> Neni 5, “Përkufizime” i Rregullores.

<sup>197</sup> Neni 4 i ligjit nr. 9917/2008 “Rastet kur kërkohet vigjilenca e duhur”

subjektet, në kuadër të vigjilencës së duhur<sup>198</sup>.

Së pari, subjekti duhet të identifikojë klientin (e përhershëm apo rastësor, person fizik, juridik apo organizim ligjor) dhe të verifikojë identitetin e tij nëpërmjet dokumenteve, të dhënave apo informacioneve të marra nga burime të besueshme dhe të pavarura. Nëse klienti është një person juridik ose organizim ligjor, atëherë subjekti duhet të verifikojë nëse çdo person, që vepron në emër të klientit, është i autorizuar, si dhe duhet të përcaktojë dhe të verifikojë identitetin e tij;

Subjekti duhet, gjithashtu, të verifikojë statusin ligjor të klientit, nëpërmjet dokumenteve të themelimit, të regjistrimit ose fakteve që lidhen me ekzistencën e tij, si dhe të sigurojë informacion për emrin e klientit, emrat e të mirëbesuarve (për organizimet ligjore), formën ligjore, adresën, drejtuesit dhe/ose përfaqësuesit ligjorë (për personat juridikë) dhe dispozitat, që rregullojnë marrëdhëniet juridike.

Së dyti, subjekti duhet, në çdo rast, të identifikojë pronarin përfitues dhe të marrë masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e tij, nëpërmjet informacioneve ose të dhënave të siguruara nga burime të besueshme.

Së treti, subjekti duhet të përcaktojë për të gjithë klientët, para vendosjes së marrëdhënieve të biznesit, nëse ata janë duke vepruar në emër të një personi tjetër. Nëse po, atëherë subjekti duhet të marrë masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin dhe verifikimin e atij personi.

Së katërti, subjekti duhet të kuptojë strukturën e pronësisë dhe kontrollit për klientët, që janë persona juridikë apo organizime ligjore.

Së pesti, subjekti duhet të përcaktojë se cilët janë individët, që zotërojnë apo kontrollojnë klientin, përfshirë personat, që ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik apo organizimin ligjor.

---

<sup>198</sup> Neni 4/1 ligjit nr. 9917/2008 “Masat e vigjilencës së duhur”

Së gjashti, subjekti duhet të mbledhë informacion për qëllimin dhe natyrën e marrëdhënies së biznesit dhe të zhvillojë profilin e riskut gjatë monitorimit të vazhdueshëm.

Së shtati, subjekti duhet të kryejë monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me klientin, përfshirë analizimin e transaksioneve të kryera gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëdhënieje, për t'u siguruar se ato janë në përputhje me njohuritë, që subjekti ka për klientin, natyrën e biznesit të tij, profilin e riskut, si dhe burimin e fondeve.

Së teti, subjekti duhet të sigurohet, nëpërmjet rishikimit të dosjeve të klientëve, që dokumentet, të dhënat dhe informacioni i mbledhur gjatë procesit të vigjilencës së duhur janë përditësuar, janë të vlefshme dhe të përshtatshme, veçanërisht për klientët apo marrëdhëniet e biznesit, që kategorizohen me risk të lartë.

Së nënti, për klientët rastësorë, subjekti duhet të verifikojë identitetin e klientit dhe pronarit përfitues, përpara ose gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit ose kryerjes së një transaksioni. Verifikimi i identitetit të klientit dhe pronarit përfitues mund të kryhet pas vendosjes së marrëdhënies së biznesit, me kusht që:

- i) të realizohet sa më shpejt, që të jetë praktikisht e mundur;
- ii) të mos ndërpritet zhvillimi normal i aktivitetit të biznesit;
- iii) rreziqet e pastrimit të parave të menaxhohen në mënyrë efektive nga subjekti.

Së dhjeti, subjekti duhet të përcaktojë procedurat e menaxhimit të riskut, që do të zbatohen për rastet kur, një klient mund të lejohet të përdorë marrëdhënien e biznesit përpara ose gjatë plotësimit të procesit të verifikimit. Këto procedura, ndër të tjera, duhet të përfshijnë masa për kufizimin e numrit, të llojit dhe/ose të shumës së transaksioneve, që mund të kryhen, si dhe monitorimin e transaksioneve, në vlera të larta apo komplekse, të kryera jashtë profilit të pritshëm për veçoritë e kësaj marrëdhënieje.

Së fundi, subjekti duhet të plotësojë detyrimet e sipërpërmendura edhe për klientët ekzistues, duke u bazuar në prova, fakte dhe rrezikun e ekspozimit ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ligji ka parashikuar edhe qëndrimin, që duhet të mbajnë subjektet, në rast se janë të paafta, që të plotësojnë detyrimet për vigjilencën e duhur ndaj klientit. Subjektet duhet:

- a) të mos hapin llogari, të mos kryejnë transaksione dhe të mos fillojnë marrëdhënie biznesi;
- b) nëse ka filluar marrëdhëniet e biznesit, ta ndërpresin atë;
- c) t'i dërgojnë raport për aktivitet të dyshimtë Autoritetit përgjegjës;

ç) të mos hapin apo të mos mbajnë llogari anonime, me emra fiktivë ose të identifikuar vetëm nëpërmjet një numri apo kodi, përfshirë depozitat apo instrumentet e tjera të mbajtësit. Nëse ka llogari të tilla, klientët e tyre duhet të identifikohen dhe të verifikohen. Nëse kjo nuk arrihet, llogaria duhet të mbyllet dhe t'i dërgohet raport për aktivitet të dyshimtë Autoritetit përgjegjës.

Autoriteti në Rregulloren nr. 58 ka parashikuar që, subjektet bëjnë verifikimin e identitetit të klientit, nëpërmjet dokumenteve ligjërish të vlefshme. Dokumentet, që paraqiten nga klienti pranë subjektit duhet të jenë origjinale ose të noteruara. Subjektet, në momentin e vendosjes së marrëdhënieve të biznesit ose të kryerjes së transaksioneve, mbajnë në dosjen e klientit kopje të dokumenteve të paraqitura nga ky i fundit. Kopjet e këtyre dokumenteve duhet të jenë të vulosura me vulën e subjektit, brenda afatit të vlefshmërisë së tyre<sup>199</sup>. Në rastin e përfaqësimit të klientit nga një person i tretë, nëpërmjet një akti përfaqësimi, subjektet kërkojnë të dhëna për identifikimin e klientit dhe të përfaqësuesit të tij, si dhe mbajnë, në dosjen e klientit, të gjithë dokumentacionin e paraqitur prej personit të tretë, duke përfshirë edhe origjinalin ose kopjen e notëruar të aktit të përfaqësimit. Ligji nr. 9917 përcakton dokumentacionin, që mund të kërkohej nga subjektet për identifikimin e klientit<sup>200</sup>.

---

<sup>199</sup> Neni 6 i Rregullores “Masat parandaluese të ndërmarra nga subjektet”

<sup>200</sup> Neni 5 i ligjit “Dokumentacioni i kërkuar për identifikimin e klientit”, Subjektet duhet të regjistrojnë e të mbajnë të dhënat si më poshtë:

Subjektet, kur e gjykojnë të nevojshme, kërkojnë paraqitjen nga klienti të dokumenteve të tjera identifikuese, për verifikimin e të dhënave të paraqitura prej këtij të fundit. Subjektet duhet të zbatojnë procedura specifike dhe të marrin masat e duhura e të efektshme për të parandaluar rrezikun, që lidhet me transaksionet apo marrëdhëniet e biznesit, të kryera pa praninë fizike të klientit. Masat e vigjilencës së duhur duhet të zbatohen nga vetë subjektet e ligjit nr. 9917/2008, ndërsa mbështetja në palë të treta nuk është e lejuar<sup>201</sup>.

Subjektet, përpara se të vendosin marrëdhënie biznesi dhe/ose të kryejnë transaksione në emër dhe për llogari të klientit, konsultojnë listën e përditësuar të personave të shpallur si financues të terrorizmit, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, sipas ligjit nr. 157/2013<sup>202</sup>. Në rast se, subjektet, në çdo kohë dyshojnë për identitetin e klientit, ato pezullojnë menjëherë çdo veprim me të dhe njoftojnë autoritetin përgjegjës, në përputhje me rregullat e përcaktuara në rregullore. Subjektet duhet të refuzojnë kryerjen e transaksioneve, në rast se nuk plotësohen kërkesat për identifikimin e klientit dhe për vigjilencën e duhur dhe atë të zgjeruar, të parashikuara në ligjin nr. 9917/2008<sup>203</sup>. Ligji nr. 9917 ka parashikuar edhe masat, që subjekti duhet të marrë në kuadër të vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit.

Vigjilenca e zgjeruar duhet të përfshijë masa shtesë, përveç atyre të parashikuara për vigjilencën

---

a) për personat fizikë: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin e përkohshëm dhe të përhershëm, punësimin, llojin dhe numrin e dokumentit të identifikimit, autoritetin që e ka lëshuar, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra në çastin e kryerjes së veprimit financiar;

b) për personat fizikë, që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse: emrin, mbiemrin, datën e vendimit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dokumentin që vërteton objektin e veprimtarisë, NIPT-in, adresën dhe të gjitha ndryshimet e bëra në çastin e kryerjes së veprimit financiar;

c) për personat juridikë privatë, që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse: emrin, datën e vendimit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dokumentin që vërteton objektin e veprimtarisë, NIPT-in, adresën dhe të gjitha ndryshimet e bëra në çastin e kryerjes së veprimit financiar;

ç) për personat juridikë privatë, që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse: emrin, numrin dhe datën e vendimit të gjykatës për regjistrimin si person juridik, statutin dhe aktin e themelimit, numrin dhe datën e lejes së ushtrimit të veprimtarisë nga organet tatimore, selinë e përhershme dhe natyrën e veprimtarisë;

d) për përfaqësuesit ligjorë të klientit: emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin e përkohshëm dhe të përhershëm, llojin dhe numrin e dokumentit të identifikimit, autoritetin që e ka lëshuar dhe kopjen e aktit të përfaqësimit.

<sup>201</sup> Neni 6 i ligjit nr. 9917/2008 “Zhvillimet teknologjike dhe palët e treta”

<sup>202</sup> Bëhet fjalë për Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 718, dt. 29.10.2004 « Për listën e personave të shpallur financues të terrorizmit », i cili përditësohet rregullisht, mbi bazën e informacioneve të marra nga njësia e inteligjencës financiare (Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave) dhe nëpërmjet transpozimit të Rezolutave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të miratuara për këtë qëllim.

<sup>203</sup> Po aty

e duhur, për marrëdhëniet e biznesit, klientët apo transaksionet me rrezik të lartë. Për zvogëlimin e rrezikut të pastrimit të parave, krahas kategorive të përcaktuara në ligjin nr. 9917 dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, subjektet përcaktojnë kategori të tjera marrëdhëniesh biznesi, klientësh dhe transaksionesh, të vlerësuara me rrezik të lartë dhe ndaj të cilave duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar<sup>204</sup>. Për zbatimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientëve, subjektet duhet të kërkojnë praninë fizike të klientëve dhe të përfaqësuesve të tyre:

- a) para se të vendosin një marrëdhënie biznesi;
- b) para së të kryejnë transaksione në emër dhe për llogari të tyre.

Në kategorinë e personave ndaj të cilëve duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar bëjnë pjesë personat e ekspozuar politikisht. Për të përcaktuar nëse një klient, ekzistues ose i mundshëm, ose nëse pronari përfitues, është një person i ekspozuar politikisht, subjektet duhet të hartojnë dhe të zbatojnë sisteme efektive të menaxhimit të riskut. Subjekteve mund t'u lindë nevoja të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen e marrëdhënies të biznesit me personat e ekspozuar politikisht. Gjithashtu, subjekteve mund t'u nevojitet të kërkojnë dhe të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vazhdimin e marrëdhënies së biznesit, në rastet kur marrëdhënia e biznesit me klientin është vendosur dhe subjekti konstaton, që klienti apo pronari përfitues është bërë ose bëhet, më pas, person i ekspozuar politikisht<sup>205</sup>.

Në kategorinë e personave ndaj të cilëve duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar, bëjnë pjesë edhe organizatat jofitimprurëse. Në prani të organizatave jofitimprurëse, subjektet duhet të:

- a) mbledhin informacione të mjaftueshme për to, për të kuptuar plotësisht burimet e financimit, natyrën e veprimtarisë dhe mënyrën e administrimit dhe drejtimit të tyre;
- b) përcaktojnë, nëpërmjet informacionit publik, ose me mjete të tjera, reputacionin e tyre;

---

<sup>204</sup> Neni 7 i ligjit nr. 9917/2008 “Vigjilenca e zgjeruar ndaj klientit”

<sup>205</sup> Neni 8 i ligjit nr. 9917/2008 “Kategoritë e klientëve, ndaj të cilëve zbatohet vigjilenca e zgjeruar”

c) marrin miratimin nga instancat më të larta të administrimit/drejtimit, përpara vendosjes së një marrëdhënieje biznesi me to;

ç) ofrojnë monitorim të zgjeruar të marrëdhënies së biznesit.

Subjektet duhet t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me klientët jorezidentë, veçanërisht, kur këto transaksione kryhen pa praninë fizike të klientit. Ato duhet të verifikojnë dhe t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me të gjithë klientët, të cilët banojnë ose ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vende, që nuk zbatojnë ose që zbatojnë pjesërisht standardet përkatëse ndërkombëtare, për të parandaluar e luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Subjektet duhet të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla dhe të mbajnë të dhëna me shkrim për konkluzionet, për një periudhë 5-vjeçare. Këto të dhëna duhet t'u vihen në dispozicion audituesve dhe autoritetit përgjegjës, nëse kërkohen<sup>206</sup>.

Aktualisht, DPPPP realizon publikimin e të dhënave në faqen e saj të internetit, në lidhje me emrat e personave, që shpallen si financues të terrorizmit, nëpërmjet vendosjes së emrit të tyre në listën e përmbajtur në VKM nr. 718/2004. Bërja e një veprimi të tillë ndihmon kompanitë e sigurimit në mënyrë të konsiderueshme. Por, DPPPP nuk publikon një listë të personave të ekspozuar politikisht, çka bën që shoqëritë siguroese ta vlerësojnë vetë nëse një subjekt duhet t'iu nënshtrohet apo jo masave të vigjilencës së zgjeruar. Pozita e kompanive është edhe më delikate sepse nuk ekzistojnë kritere të qarta për të përcaktuar se cili subjekt konsiderohet i ekspozuar politikisht, as në ligj dhe as në rregullore.

Subjektet regjistrojnë në bazën e tyre të të dhënave çdo informacion, që ka lidhje me identifikimin e klientit dhe për çdo transaksion financiar të kryer, në emër ose për llogari të tij. Ruajtja e këtij informacioni, se bashku me dokumentacionin mbështetës, bëhet sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 9917/2008. Në zbatim të Rregullores së Autoritetit, subjektet duhet të krijojnë

---

<sup>206</sup> Po aty.

strukturën ose strukturat e nevojshme, në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit<sup>207</sup>.

Parashikimin, e bërë nga ligji nr. 9917, për të caktuar një person përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të cituara më sipër, Autoriteti e ka plotësuar me rregullën sipas së cilës strukturat përkatëse të subjektit, duhet t'i vënë në dispozicion personit përgjegjës, mjetet dhe burimet e mjaftueshme për përmbushjen e funksionit. Rregullorja specifikon që këto mjete mund të jenë të natyrave të ndryshme, si për shembull teknikë e përshtatshme, personel i mjaftueshëm, buxhet i arsyeshëm etj.

Subjektet kanë detyrimin, që të njoftojnë Autoritetin për emrin e personit përgjegjës të zgjedhur dhe për çdo ndryshim, që mund të bëhet, nëpërmjet caktimit të një personi tjetër. Përveç kësaj, subjektet i venë në dispozicion Autoritetit, menjëherë pas miratimit të tyre, kopje të procedurave të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit<sup>208</sup>.

Subjektet hartojnë dhe miratojnë rregullore dhe/ose procedura për kategorizimin e klientëve dhe transaksioneve sipas shkallës së rrezikut, që ata paraqesin, duke pasur parasysh kategoritë e klientëve, ndaj të cilëve zbatohen rregullat e vigjilencës së zgjeruar, sipas ndarjes së parashikuar në ligjin nr. 9917/2008. Personat përgjegjës të subjekteve, hartojnë dhe zbatojnë një program vjetor të trajnimit të punonjësve të subjekteve, lidhur me rregulloret dhe procedurat e brendshme të miratuara për qëllim të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ata informojnë periodikisht punonjësit e subjektit, lidhur me ndryshimin e dispozitave ligjore në fuqi, për parandalimin dhe dënimin e veprave penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe për detyrimet e tyre lidhur me zbatimin e këtyre ndryshimeve. Punonjësit e subjektit duhet të ruajnë konfidencialitetin për procesin e raportimit

---

<sup>207</sup> Neni 7 i Rregullores “Regjistrimi dhe ruajtja e të dhënave”

<sup>208</sup> Neni 8 i Rregullores “Strukturat përgjegjëse të subjekteve”



lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe të mos njoftojnë klientin nëse kryejnë verifikime për dyshimet e lindura apo raportime pranë DPPP<sup>209</sup>.

Në zbatim të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, subjektet apo institucionet raportuese, janë të detyruara të raportojnë menjëherë në DPPP, kur kanë të dhëna ose dyshime për veprime financiare, transaksione, fonde ose veprime të tjera, të kryera apo, që tentohet të kryhen dhe që kanë për qëllim realizimin apo financimin e veprave terroriste, pavarësisht nga vlera e tyre. Si rregull, subjektet i raportojnë autoritetit përgjegjës sipas formularëve të raportimit dhe afateve të përcaktuara, nga autoriteti përgjegjës, për të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 lekë ose kundërvleftën në monedha ta huaja<sup>210</sup>.

Subjektet, kur kanë arsye të besojnë ose të dyshojnë se transaksioni i kërkuar për t’u kryer nga një klient ose nga një person tjetër, për llogari të klientit, mund të përfshijë pastrim të produkteve të veprës penale, financim terrorizmi apo fonde, që rrjedhin nga veprimtari kriminale, ia raportojnë menjëherë çështjen autoritetit përgjegjës. Në këto raste, subjektet presin deri në 48 orë, pas raportimit në autoritetin përgjegjës për udhëzimet e këtij të fundit, nëse duhet ta kryejnë apo jo transaksionin.

Njoftimi dhe raportimi duhet të përmbajnë të dhëna për identifikimin e fondeve dhe të pasurive të tjera, të dhëna për pronësinë dhe interesa të tjerë rreth tyre, si dhe shpjegime për motivet ku mbështeten dyshimet e arsyeshme për financim të terrorizmit. Subjektet paraqesin një raport, ku parashtrojnë detyrimet, që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale, financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë<sup>211</sup>.

---

<sup>209</sup> Po aty.

<sup>210</sup> Neni 12 i ligjit “Raportimi tek autoriteti përgjegjës”

<sup>211</sup> Po aty.

Çdo person, që ka dijeni për veprime financiare, transaksione, fonde ose veprime të tjera, të kryera apo që tentohen të kryhen, që kanë për qëllim realizimin apo financimin e veprave terroriste, është i detyruar të njoftojë menjëherë organet e zbatimit të ligjit ose Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. DPPP, kur ka arsye të bazuara në fakte apo rrethana konkrete për financim terrorizmi, i propozon menjëherë Ministrit të Financave bllokimin e përkohshëm për fondet dhe pasuritë e tjera. AMF mbikëqyr zbatimin e dispozitave të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave, të akteve nënligjore në zbatim të tij dhe të rregullores së miratuar më 30 qershor 2016<sup>212</sup>.

Autoriteti raporton tek Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave çdo dyshim, çdo informacion ose të dhënë, që vlerëson se mund të lidhet me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit. Autoriteti vlerëson mjaftueshmërinë e programeve dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit, në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Autoriteti, për të gjitha shkeljet e konstatuara, të cilat mund të klasifikohen si kundërvajtje administrative, në bazë të ligjeve nr. 157/2013 dhe nr. 9917/2008, informon autoritetin përgjegjës, duke i vënë në dispozicion dokumentacionin e plotë, që ka lidhje me konstatimin e shkeljes dhe bashkëpunon me të. Ai mund të kërkojë nga subjektet, të verifikojë dhe t'i vihet në dispozicion çdo lloj informacioni dhe dokumenti, që lidhet me përputhshmërinë e detyrimeve të subjekteve, në zbatim të Ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

Rregullorja ka parashikuar që subjektet duhej, brenda një afati prej 3 muajsh, që nga hyrja e saj në fuqi, që i korrespondon datës së miratimit të rregullores, të kryenin rishikimin dhe/ose miratimin e rregulloreve dhe procedurave të brendshme, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit<sup>213</sup>.

---

<sup>212</sup> Neni 10 i Rregullores “Kërkesa mbikëqyrëse”

<sup>213</sup> Neni 11 i Rregullores

#### **4.8. Sanksionet, që mund të merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, kundrejt subjekteve**

Ligji nr. 9917/2008 i njeh Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave të drejtën të vendosë gjopa ndaj subjekteve, që i nënshtrohen këtij ligji dhe që kryejnë kundërvajtje administrative, në fushën e marrjes së masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kur nuk përbëjnë veprë penale, shkeljet e kryera nga subjektet klasifikohen si kundërvajtje administrative. Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ligji parashikon dënim administrativ<sup>214</sup>.

Përgjegjësia për kundërvajtjen administrative zbatohet për personin fizik dhe për personin juridik. Kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm. Kur ligji i posaçëm parashikon një organ administrativ, në rastin konkret Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, që mbikëqyr zbatimin e tij, por që ka të drejtë vetëm të rekomandojë masa apo dënime administrative, ky organ ia përcjell, pa vonesë, rastin Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, që ka të drejtën e shqyrtimit të kundërvajtjes dhe të nxjerrjes së vendimit përkatës<sup>215</sup>.

Masa e gjobës, që mund të vendoset nga DPPPP, ndryshon në varësi të dispozitave të shkelura, të faktit nëse shkelja kryhet nga një person fizik apo juridik, apo të karakterit përsëritës të shkeljes<sup>216</sup>.

---

<sup>214</sup> Përkufizimi jepet nga neni 4 i ligjit nr. 10279, dt. 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

<sup>215</sup> Neni 24 i ligjit nr. 9917/2008 “Funksionet e autoriteteve mbikëqyrëse”

<sup>216</sup> Kështu, për shkeljet, që kanë të bëjnë me marrjen e masave parandaluese, të masave për vigjilencën e duhur ndaj klientit, si dhe me procedurat për verifikimin e dokumentacionit, që shërben për identifikimin e klientit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave mund të vendosë këto gjopa:

a) për personat fizikë: nga 100 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;  
b) për personat juridikë: nga 300 000 lekë deri në 3 000 000 lekë.

Për shkeljet, që kanë të bëjnë me masat e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit, përcaktimin e kategorive të klientëve apo të transaksioneve, ndaj të cilat duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave mund të vendosë këto gjopa:

a) për personat fizikë: nga 200 000 lekë deri në 2 000 000 lekë;  
b) për personat juridikë: nga 400 000 lekë deri në 4 000 000 lekë.

Për rastet kur nuk zbatohen kërkesat dhe afatet e parashikuara në aktet nënligjore, dalë në zbatim të ligjit nr. 9917/2008, për raportim të transaksioneve mbi prag apo për raportim të aktivitetit të dyshimtë, të cilat lidhen me marrjen e masave të vigjilencës së duhur dhe të

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave informon Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për çdo sanksion të vendosur, ndaj subjekteve, që ushtrojnë aktivitet në fushën e sigurimit dhe risigurimit. E drejta për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, nuk mund të ushtrohet kur kanë kaluar 2 vjet nga çasti i kryerjes së saj. Pra, DPPP, nuk mund të gjobisë një subjekt, nëse, gjatë një kontrolli, konstaton që ky subjekt ka kryer një prej kundërvajtjeve administrative, të cituara më sipër, në rast se, prej datës kur është kryer kundërvajtja, deri në datën e kontrollit, kanë kaluar më shumë se dy vjet. Nëse një subjekt ka kryer disa shkelje, në të njëjtën kohë, DPPP cakton një gjobë, e cila përmbledh të gjitha gjobat, që vendosen për çdo shkelje të analizuar veç e veç<sup>217</sup>.

Për të kuptuar mënyrën se si veprohet nga Autoriteti përgjegjës dhe nga subjektet, në rast kontrolli, mund t'i referohemi jurisprudencës, duke marrë një shqyrtim një rast konkret për të cilin, Gjykata e Apelit Tiranë është shprehur me një vendim të formës së prerë. Në rastin në shqyrtim, subjekti i kontrolluar ka qënë një subjekt bankar, dhe jo shoqëri sigurimi, megjithatë arsyetimi i Gjykatës së Apelit është i vlefshëm<sup>218</sup>.

Subjekti bankar është gjobitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, në masën 4 500 000 lekë, për mosrespektim të detyrimeve, që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 9917/2008.

---

zgjeruar ndaj klientit si dhe me raportimin pranë autoritetit përgjegjës, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave mund të vendosë këto gjoba:

- a) për personat fizikë: nga 300 000 lekë deri në 3 000 000 lekë;
- b) për personat juridikë: nga 500 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.

Për rastet kur subjektet nuk zbatojnë detyrimet që kanë të bëjnë me ruajtjen e informacionit personal të klientit dhe mosnjohimin e tij, për verifikimet e kryera dhe raportimet pranë autoritetit përgjegjës, në rast dyshimi për veprimtari terroriste apo pastrim parash, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave mund të vendosë këto gjoba:

- a) për personat fizikë: nga 200 000 lekë deri në 1 500 000 lekë;
- b) për personat juridikë: nga 1 000 000 lekë deri në 4 000 000 lekë.

Për rastet kur subjektet nuk zbatojnë urdhrin e autoritetit përgjegjës, për bllokimin ose ngrirjen e përkohshme të transaksionit ose të veprimit financiar, për një periudhë jo më shumë se 72 orë, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave mund të vendosë këto gjoba:

- a) personat fizikë: nga 300 000 lekë deri në 2 000 000 lekë;
- b) personat juridikë: nga 2 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.

Lënia e këtij afati, i shërben autoritetit përgjegjës që, në qoftë se vëren elemente të veprës penale, të bëjë kallëzim në prokurori, duke dorëzuar edhe një kopje të urdhrin për pezullimin e përkohshëm të transaksionit, ose për ngrirjen e llogarisë, si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës. Përveç sa më sipër, kur subjekti është një person juridik dhe kundërvajtja administrative është kryer:

- a) nga një punonjës i subjektit, personi që ka kryer shkeljen gjobitet nga 20 000 lekë deri në 200 000 lekë;
- b) nga një administrator ose drejtues i subjektit, personi që ka kryer shkeljen gjobitet nga 50 000 lekë deri në 500 000 lekë.

<sup>217</sup> Neni 27 i ligjit “Kundërvajtjet administrative”

<sup>218</sup> Analizimi i rasteve, që lidhen me gjoba të vendosura ndaj subjekteve siguroese dhe risiguroese, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 52/2014, nuk është i mundur për shkak se nuk ka ende vendime gjyqësore të formës së prerë.

Në analizën e saj, Gjykata e Apelit konstaton së pari se, DPPP ka njoftuar paraprakisht subjektin financiar, se ai do t'i nënshtrohej një kontrolli në datat 15-18 qershor 2010, për veprimtarinë e ushtruar në periudhën 1 korrik 2009 – 31 maj 2010. Objekti i kontrollit do të ishte respektimi i kuadrit ligjor për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit. Në fund të kontrollit, është përpiluar Aktinspektimi, në të cilin janë konstatuar shkelje, që kanë të bëjnë me :

- Mosrespektimin e procedurave identifikuese, monitoruese si dhe të kujdesit ndaj klientit dhe transaksioneve, që kanë të bëjnë me zbatimin e masave për vigjilencën e duhur dhe të zgjeruar.
- Mosrespektimin e masave parandaluese, që lidhen me krijimin dhe funksionimin e strukturave parandaluese, brenda subjektit të kontrolluar.

Gjykata ka konstatuar se Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka njoftuar subjektin për ditën, kur do të shqyrtoheshin kundërvajtjet administrative të konstatuara dhe pas këtij shqyrtimi i ka komunikuar asaj vendimin për masën administrative të marrë. Gjykata ka konsideruar që DPPP ka vlerësuar saktë, ekzistencën e kundërvajtjeve pasi:

- Subjekti financiar nuk ka verifikuar drejt dokumentacionin e paraqitur nga klienti dhe burimin e të ardhurave të arkëtuara prej tij, të cilat kapnin vlerën prej rreth 300 000 \$ në total, ndërkohë që rezultonte se klienti nuk ishte në marrëdhënie pune.
- Subjekti nuk kishte marrë masat e vigjilencës së zgjeruar ndaj një klienti tjetër, i cili ishte person me shtetësi të huaj.
- Subjekti, edhe pse kishte ngritur strukturën parandaluese, nuk kishte pëmbushur të gjitha detyrimet, që rrjedhin nga ligji nr. 9917/2008 pasi, nuk kishte proceduar me emërimin e të gjithë personave, që do të ishin pjesë e strukturës.

Megjithatë, gjykata shprehet se Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, nuk kishte vepruar drejt, në caktimin e masës së gjobës, pasi ajo kishte caktuar gjobë, në kufirin maksimal të

parashikuar nga ligji. Kështu, Gjykata shprehet se në caktimin e masës së gjobës, Autoriteti përgjegjës duhet të kishte pasur parasysh:

- Rëndësinë e shkeljes;
- Bërjen e përpjekjeve, për të përmbushur detyrimet ligjore.

Gjykata vlerëson se subjekti financiar ka marrë masat e nevojshme për ngritjen e strukturës parandaluese. Ajo konstaton se, mosplotësimi i të gjitha pozicioneve të parashikuara në strukturën parandaluese, pavarësisht se ka ekzistuar në momentin e kontrollit, ka qënë një vakancë e përkohshme, pasi para periudhës së kontrolluar, struktura në vazhdimësi ka qënë e plotësuar tërësisht dhe ka ushtruar funksionet e saj në përputhje me ligjin.

Për sa u përket, kontrolleve të transfertave në drejtim të shtetasit shqiptar, i cili nuk mund të justifikonte arkëtimin e shumave të konsiderueshme, Gjykata ka konstatuar se, shumat e arkëtuara nga klienti i subjektit të kontrolluar, janë dërguar nëpërmjet transfertave ndërkombëtare, të realizuara nga njëra prej bankave angleze, më të vjetra dhe më të njohura në botë, e cila hyn në kategorinë e subjekteve, që respekton rregullimet e vendosura në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në vendin e saj të origjinës. Përveç kësaj, subjekti i kontrolluar ka aplikuar kriteret e vendosura në nenin 10 të ligjit nr. 9917/2008 dhe ka marrë të gjitha informacionet e nevojshme për identifikimin e klientit përfitues të shumave.

Së fundi, për rastin e klientit, i cili duhet t'i nënshtrohej zbatimit të rregullave mbi vigjilencën e zgjeruar, për shkak të mospasjes së shtetësisë shqiptare, Gjykata konstaton se ky klient është i njohur prej Bankës prej shumë vitesh, pasi ka ushtruar funksione drejtuese në një prej fondeve të investimit në vendin tonë, të organizuar nga USAID. Klienti ka banuar për një periudhë disavjeçarë në Shqipëri dhe, pavarësisht se, në momentin e kryejës së transaksionit bankar, nuk ka pasur shtetësinë shqiptare, ai ka pasur një vendbanim të njohur në Shqipëri dhe një leje qëndrimi të vlefshme.

Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, Gjykata ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesë-padisë duke shfuqizuar pjesërisht vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe duke e ulur masën e gjobës nga 4 500 000 lekë në 2 000 000 lekë.

Në analizë të këtij vendimi, mund të themi se me të drejtë Gjykata ka konsideruar që DPPP është treguar shumë strikte në vlerësimin e saj, përse u takon verifikimeve të kryera nga Banka në lidhje me transfertën e realizuar nga jashtë vendit. Kryerja e veprimeve nëpërmjet një strukture të njohur, për respektimin me korrektësi të rregullave të mbikëqyrjes, është një faktor shumë i rëndësishëm, i cili nuk duhet të neglizhohet, kjo edhe për vetë faktin që klasifikimi i institucioneve në kategori, shërben pikërisht për këtë qëllim, që të krijohet një situatë e qëndrueshme besimi, nëpërmjet subjekteve, që ushtrojnë të njëjtin aktivitet në vende të ndryshme dhe të evitohet kryeja e një sërë formalitetesh për të gjitha veprimet, pasi kjo do të sillte si pasojë krijimin e një situate shumë të rënduar për t'u menaxhuar nga Bankat dhe nga strukturat e kontrollit, për shkak të numrit gjithmonë e më të madh të transaksioneve të kësaj natyre.

Nga ana tjetër, qëndrimi i mbajtur nga Gjykata përse i takon verifikimeve dhe grumbullimit të informacioneve lidhur me shtetasin e huaj është i kritikueshëm. Mungesa e marrjes së masave të nevojshme për verifikimin e klientëve dhe të origjinës së fondeve të qarkulluara, për shkak se ata konsiderohen si subjekte të njohura prej Bankës, përbën një faktor për rritjen e rrezikut të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit. Përveç kësaj, mospasja e shtetësisë shqiptare e bën më të lehtë largimin e shtetasit nga Shqipëria në një vend të huaj, çka do të thotë që pasja e një informacioni të plotë do t'i japë mundësinë Bankës, por edhe shtetit shqiptar të ndërveprojë më me lehtësi me institucionet e shtetit të origjinës së klientit, në rast se një problem konstatohet pasi ai është larguar.

Si përfundim, mund të themi se një sërë faktorësh ndikojnë respektivisht në rritjen apo zvogëlimin e shanseve, që aktiviteti i sigurimit të përdoret për pastrim parash apo për financim terrorizmi.

Ndër faktorët, që rritin riskun përmendim:

- Mungesën e analizave të riskut, që shoqëritë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit duhet të bëjnë në veprimtarinë, që ushtrojnë, lidhur me mundësinë e përdorimit të shërbimeve të ofruara prej tyre për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.
- Dobësinë e kontrollit të brendshëm të këtyre subjekteve për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kontroll i cili shpeshherë është elementar.
- Rritjen e vazhdueshme të përdorimit të instrumenteve financiare në aktivitetin e sigurimit.
- Mungesën e raportimit të rregullt të subjekteve, pranë strukturave mbikëqyrëse, për paraqitjen e individëve apo të kërkesave për kryerjen e veprimeve, të cilat mund të shërbejnë për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.
- Në momentin kur, do të lejohet kryerja e transaksioneve nëpërmjet rrugëve elektronike, ndërmarrja e veprimeve pa praninë fizike të klientit ose të përfaqësuesit të tij ligjor, do të jetë gjithashtu një faktor që do të ndikojë në rritjen e riskut.

Ndër faktorët kryesorë, që e ulin riskun përmendim:

- Kryerjen e transaksioneve me klientët nëpërmjet sistemit bankar.
- Pagimin e primeve relativisht të ulëta, për një pjesë të mirë të kontratave.
- Ekzistencën e një aktiviteti të kufizuar, përse u takon sigurimeve të ofruara. Në mjaft raste, ofertat nuk janë tërheqëse, pasi nuk u përshtaten plotësisht nevojave të klientëve dhe nuk janë të konsoliduara, në tërësinë e aktivitetit të ushtruar.



- Kontrollin e detajuar të reputacionit të zotëruesve të kompanive, që veprojnë në treg dhe të burimit të fondeve të investuara.
- Mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave dhe mundësinë për të bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.
- Kryerjen e mbikëqyrjes, në vend apo në distancë, në përputhje me riskun e paraqitur nga çdo kompani.
- Dhënien e kompetencave të nevojshme DPPPP dhe AMF për realizimin e mbikëqyrjes. Në këtë drejtim, ligji nr. 52/2014 ka sjellë një ndryshim pozitiv, duke zgjeruar ndjeshëm kompetencat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, për sa u takon masave që mund të marrë dhe kontrolleve, që mund të ushtrojë.

Subjektet, që ushtrojnë veprimtari në fushën e sigurimeve, jo gjithmonë janë të vetëdijshme se aktiviteti i tyre mund të përdoret për pastrim parash apo për financim të terrorizmit. Ky fakt përbën një kërcënim për respektimin e detyrimeve ligjore. Tjetër element, që mund të përbëjë kërcënim, është fakti që, për shkak të popullsisë së vogël në Shqipëri dhe shtrirjes së gjerë në territor të subjekteve, klientët shpeshherë kanë njohje personale me agjentët apo punonjësit e kompanive të sigurimit, që gjë i bën ata të tregohen më pak të vëmendshëm. Nga verifikimet e kryera deri tani, DPPPP ka vlerësuar që risku për pastrim parash dhe financim të terrorizmit në sigurime, në gjendjen aktuale të tregut është i ulët, ndërkohë që pasojat e kryerjes së këtyre aktiviteteve kriminale paraqesin një risk mesatar<sup>219</sup>.

---

<sup>219</sup> Nxjerrja e këtyre konkluzioneve është bërë duke analizuar raportet vjetore të aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

## KAPITULLI V: MBROJTJA DHE TË DREJTAT E KONSUMATORIT

### 5.1. Aspekte të mbrojtjes së konsumatorit

Mbrojtja e konsumatorit, i cilësuar si palë e dobët, në një marrëdhënie biznesi, është një objektiv, që qëndron në qendër të vëmendjes së mjaft autoriteteve rregullatore, qofshin këto në rang kombëtar apo ndërkombëtar, si në nivelin e Bashkimit Evropian ashtu edhe me gjerë<sup>220</sup>. Sjellja e konsumatorit, përsa i takon perceptimit dhe mënyrës së përballimit të rreziqeve ndikohet nga disa faktorë, të cilët mund të jenë të brendshëm ose të jashtëm. Ndër faktorët e brendshëm përmendim: njohuritë rreth faktorëve të riskut dhe minimizimit të tij, sjelljet, besimet dhe vlerat, aftësitë sociale dhe të përshtatjes si dhe predispozitat psikologjike. Ndërsa, si faktorë të jashtëm mund të përmendim: mbështetjen sociale, median, sistemin e kujdesit shëndetësor, elementët mjedisorë si dhe rregullimet dhe ligjet e shoqërisë (Zeneli, 2015, fq. 231). Nëse interesat e konsumatorit mbrohen mirë apo jo, kjo gjë mund të vihet re në disa aspekte të aktivitetit të sigurimit si për shembull:

- Redaktimi i kontratës në një gjuhë, që është e njohur për të siguruarin.
- Ofrimi i shërbimit në pika të shumta, sa më pranë vendndodhjes së të siguruarit apo nëpërmjet shërbimit të internetit.
- Lënia e një afati për të hequr dorë nga kontrata e sapolidhur, pa pasur penalizime për klientin.
- Paraqitja e ofertave të ndryshme, të shumëllojshme dhe të përshtatura me nevojat specifike të çdo klienti të marrë veçmas.
- Garantimi i pavarësisë së ndërmjetësve dhe brokerave, të cilët nuk duhet të varen nga siguruesit në aspektin financiar, në mënyrë që propozimi i ofertave të ndryshme, nga ana e

---

<sup>220</sup> Përmendin këtu Republikën Kineze, e cila e ka konsideruar mbrojtjen e konsumatorit si një objektiv thelbësor në kuadër të përpilimit të legjislacionit në fushën e sigurimeve, pas viteve '90. – Yanmiao Tian, “Les principes fondamentaux de la loi sur les assurances”, Revue Internationale de Droit Comparé, Paris 1998, faqe 889.

tyre, të bëhet duke pasur parasysh interesat e konsumatorit dhe jo ato të kompanive të sigurimit.

- Formulimi i kontratës në terma të qartë, të cilët nuk lenë vend për keqinterpretime, në rast se lind një mosmarrëveshje midis palëve. Përdorimi i kontratave të shkruara dhe me një formulim të ngjashëm është një mënyrë për të standardizuar këtë marrëdhënie juridike, e cila i ofron sigurimit qëndrueshmëri dhe të siguarit më tepër garanci (Hasneziri, 2011, fq. 10 – 11).
- Pagimi i dëmshpërblimeve të caktuara me kontratë, në afate të shkurtra edhe pa qënë e nevojshme të kryhen shumë formalitete.
- Krijimi i strukturave brenda shoqërisë, të cilat kanë për funksion mirëmenaxhimin e riskut, duke shmangur kështu vështirësitë ekonomike për shoqërinë dhe mosekzekutimin e detyrimeve ndaj klientëve.
- Ekzistenca e organeve kontrolluese të aktivitetit të shoqërive siguroese, të ligjshmërisë së veprimeve të tyre dhe të respektimit të të drejtave të klientëve.
- Garantimi i të drejtës për t'u ankuar në rrugë administrative dhe gjyqësore, në mënyrë efektive, kundër veprimeve dhe vendimeve të siguroesit, si dhe i mundësisë për të ekzekutuar efektivisht vendimet e marra për zgjidhjen e konflikteve.
- Parashikimi i të drejtës për të përfituar nga kontrata e sigurimit të lidhur në një vend, edhe në vende të tjera, ku i siguruari mund të zhvendoset.
- Përcaktimi i primeve në mënyrë të drejtë, krahasuar me shërbimin e ofruar dhe duke mbajtur në konsideratë sjelljen e të siguarve (duke kompensuar ata, që janë sjellë mirë, nëpërmjet uljes së primit dhe duke penalizuar ata, që janë treguar të pakujdesshëm, nëpërmjet rritjes së primit). Në trajtimin e problematikave, që lidhen me caktimin e primit, që duhet të paguajë i

siguruari, autorë të ndryshëm anglezë kanë shtruar për diskutim çështjen e ndikimit, që mund të ketë mundësia e siguruesit për t'u rimbursuar nga personi, i cili, me qëllim, ka shkaktuar dëm në pasurinë ose personin e të siguarit, në uljen e masës së primit, që duhet të paguajë i siguruari. Doktrina ka menduar që, mundësia e siguruesit për të marrë nga shkaktari i dëmit shumën, që i ka paguar të siguarit, do të ndikonte në uljen e masës së primeve, pasi rikthimi i shumave ul masën e rrezikut, që merret përsipër nga siguruesi. Në praktikë, ndikimi i këtyre përpjekjeve për arkëtimin e shumave të paguara në caktimin e masës së primeve, ka rezultuar shumë i vogël (Hasson, Dhjetor 1985, fq. 421 – 422)<sup>221</sup>.

Thérond (Qershor 2007, fq. 5), do të shprehej se kujdesi dhe rëndësia, që një vend i jep veprimtarisë së sigurimit organizohet në dy nivele:

- Në nivelin e kontratave, nëpërmjet përcaktimit të rregullave formale, përsa i takon hartimit të kontratës dhe përfshirjes në të të klauzolave, që parashikojnë mbrojtjen e të siguarve.
- Në nivelin e qëndrueshmërisë financiare të kompanive të sigurimit, e cila lejon respektimin e të drejtave të të siguarve, nëpërmjet pëmbushjes së angazhimeve, që siguruesi ka marrë ndaj tij.

Legjislacioni shqiptar, është plotësuar mjaftueshëm, me ligjin nr. 52/2014 “Për sigurimin dhe risigurimin”, edhe pse ende ka nevojë për përmirësime. Ndryshimet në legjislacionin vendas në drejtim të parashikimit të një mbrojtjeje më efektive të të drejtave të klientëve, i vemë re nëse krahasojnë ligjin nr. 52/2014, të miratuar së fundmi, me ligjin nr. 9267, dt. 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, që ka gjetur zbatim për një periudhë dhjetë vjeçare, përpara shfuqizimit të tij nga ligji nr. 52/2014. Ligji nr. 9267 përkufizonte objektin e tij në vendosjen e parimeve dhe rregullave të përgjithshme për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të

---

<sup>221</sup> Mungesa e ndikimit të arkëtimin të shumave të paguara nga siguruesit, shpjegohet kryesisht me faktin se përqindja e shumave të arkëtuara ka qënë më pak se 1% e shumave të paguara.

ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime dhe në mbikëqyrjen nga shteti të subjekteve, që marrin përsipër të ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj<sup>222</sup>. Pra, mbrojtja e konsumatorit nuk parashikohej si një objektiv specifik, në ligjin e miratuar në vitin 2004.

Ndërsa ligji nr. 52/2014 përcakton shprehimisht që mbrojtja e konsumatorit dhe krijimi i kushteve favorizuese për të është një ndër objektivat kryesorë, që kërkohen të arrihen<sup>223</sup>, pasi ligji rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit. Konsumatori konceptohet gjerësisht, si çdo person, i cili përdor ose përfiton nga shërbimet e ofruara nga siguruesi ose nga shërbimet e ndërmjetësimit<sup>224</sup>.

Ligji nr. 9267 e trajtonte mbrojtjen e konsumatorit në Kreun 10, i cili përbëhej nga 4 nene gjithsej. Fillimisht ligji vendoste disa rregulla të përgjithshme për mënyrën se si duhet të silleshin kompania e sigurimit dhe ndërmjetësi kundrejt klientit. Shoqëria e sigurimit, dega e shoqërisë se huaj dhe ndërmjetësit detyroheshin<sup>225</sup>:

- a) të ushtronin veprimtarinë e tyre me profesionalizëm, kujdes dhe përkushtim ndaj të siguruarve;
- b) të vepronin me mirëbesim dhe ndershmëri për respektimin e të drejtave të të siguruarve;
- c) të informonin të siguruarin për produktet e sigurimit, kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratave të sigurimit, përfitimet që rridhnin nga këto kontrata, tarifat dhe primet, që i siguruari duhej të paguante;
- ç) të mundësonin kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit në masën dhe në afatin e duhur.

Shoqëria e sigurimit, dega e shoqërisë se huaj dhe ndërmjetësit nuk duhej të jepnin informata ose të bënin prezantime, të cilat keqinformonin ose mashtronin konsumatorin. Ligji parashikonte gjithashtu,

---

<sup>222</sup> Neni 1 i ligjit nr. 9267/2004 “Objekti”.

<sup>223</sup> Neni 1 i ligjit nr. 52/2014 “Objekti”.

<sup>224</sup> Neni 4 i ligjit nr. 52/2014 “Përkufizime”.

<sup>225</sup> Neni 156 i ligjit nr. 9267/2004 “Detyrimet e shoqërisë së sigurimit dhe të ndërmjetësit”

që kontrata e sigurimit duhej të përmbante në tekstin e saj disa elementë. Qënia e këtyre elementëve në kontratë, bëhej e nevojshme për shkak të karakteristikave specifike të kontratës së sigurimit dhe mbante parasysh përcaktimet e dispozitave të nenit 659 e vijues të Kodit civil, të cilat venë theksin, përmbi të gjitha, në faktin që janë palët në kontratë ato, të cilat përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi<sup>226</sup>.

Kontrata e sigurimit, që ishte lidhur për sigurimin e rreziqeve, që kishin të bënin me mbrojtjen ligjore, duhej të përfshinte mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit ligjor. Në mënyrë klasike, ligji nr. 9267 parashikonte detyrimin që kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës të përpiloheshin në gjuhën shqipe, të shpreheshin qartë dhe të ishin lehtësisht të kuptueshme nga palët<sup>227</sup>.

Shoqëria e sigurimit, dega e shoqërisë së huaj dhe shoqëritë e brokerimit detyroheshin që, gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, të njoftonin të siguruanin për çdo ndryshim, si më poshtë:

a) të emrit, adresës së selisë së saj dhe degëve, nëpërmjet të cilave ishin përfunduar kontratat e sigurimit;

b) të kushteve të përgjithshme, periudhës së vlefshmërisë, shumës së primit, në qoftë se ndryshimet vinin si rezultat i ndryshimeve të akteve të shoqërisë.

---

<sup>226</sup> Në zbatim të nenit 157 të ligjit nr. 9267, “Kushtet e kontratës së sigurimit”, kontrata e sigurimit, e lidhur dhe e zbatueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç sa është parashikuar në Kodin Civil, duhet të përmbante të dhënat e mëposhtme:

a) ngjarjet e përjashtuara;

b) pasojat juridike në rastet e mospagesës së primit;

c) periudhën e vlefshmërisë së kontratës, e cila duhet të përfshinte :

- mënyrën e rinovimit të kontratës;

- mënyrën e anulimit pjesor apo tërësor;

- përgjegjësitë e shoqërisë së sigurimit ose degës së shoqërisë së huaj në të tilla raste;

ç) pasojat e mospërmbushjes së detyrimeve, sipas kritereve të përcaktuara në kontratat e sigurimit të jetës, si afatet, kushtet, shumën e pagesave paraprake, mënyrat e llogaritjes dhe pagesës së vlerës së përfituar nga anulimi i kontratës;

d) trajtimin e shërbimeve të siguruesit;

dh) rregulla të detajuara për llogaritjen e primit;

e) rregulla në rast kthimi të investimeve në fushën e sigurimit të jetës;

ë) rregulla për kapitalizimin e anuiteteve në rastin e sigurimit të sëmundjeve, aksidenteve dhe palëve të treta, nëse ato shoqëroheshin me pagesa anuitetesh.

<sup>227</sup> Neni 159 i ligjit nr. 9267/2004 “Përmbajtja e kushteve të kontratës”.

Çdo ndryshim në kushtet e kontratës së sigurimit gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj duhej të bëhej vetëm me shkrim dhe të nënshkruhej nga palët<sup>228</sup>.

Së fundi, ligji i shfuqizuar parashikonte që, shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë se huaj detyroheshin të paguanin interesa mbi dëmshpërblimet e llogaritura, të barabarta me normat e interesit të depozitave bankare, në rast të tejkalimit të afatit të parashikuar dhe nënshkruar në kontratën e sigurimit për pagimin e dëmit. Llogaritja e interesit mbi dëmshpërblimin, kur tejkalohet afati i pagimit të dëmit, bëhej duke iu referuar normave të interesit të depozitave të shpallura nga Banka e Shqipërisë, në raport me periudhën e vonesës dhe llojin e monedhës<sup>229</sup>.

## **5.2. Risitë e ligjit nr. 52/2014**

Ligji nr. 52/2014, nga ana e tij trajton problematikën, që lidhen me pozicionin dhe të drejtat e konsumatorëve në mënyrë më të plotë dhe më të detajuar<sup>230</sup>. Përforsimi i mbrojtjes së konsumatorëve bëhet i nevojshëm nga rritja e sjelljeve me risk të tyre. Një gjë e tillë është vënë re në kushtet e sigurimit të detyruar, pasi sjelljet me risk manifestohen më shumë kur ekziston siguria e mbrojtjes nga pasojat e tyre (Zeneli, 2015, fq. 239). Përfshirja e dispozitave të reja, të cilat vendosin klientin në qendër të vëmendjes, në ligjin nr. 52/2014 është përmbi të gjitha rrjedhoja e hapave të ndërmarra nga ligjvënësi shqiptar, për të përafruar legjislacionin vendas me *acquis communautaire*, në kuadër të përpjekjeve të Shqipërisë për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian.

Ligji i ri ka ruajtur të pandryshuara parimet e përgjithshme, për sa u takon detyrimeve, që rëndojnë mbi kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësit, në marrëdhëniet e tyre me klientët<sup>231</sup>. Por, në ndryshim nga ligji i mëparshëm, ligji nr. 52/2014 ka parashikuar një sërë rregullash për trajtimin e kërkesave për

---

<sup>228</sup> Neni 158 i ligjit nr. 9267/2004 “Njoftimi i të siguruarit gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së sigurimit”

<sup>229</sup> Neni 160 i ligjit “Interesi mbi dëmshpërblimet”.

<sup>230</sup> Trajtimi i problematikave, që lidhen me konsumatorin bëhet në Kreun IV të ligjit “Mbrojtja e konsumatorit”.

<sup>231</sup> Neni 58 “Detyrimet e shoqërisë së sigurimit dhe ndërmjetësit”

dëmshpërblim dhe pagimin e dëmshpërblimit. Parimi bazë, mbi të cilin mbështeten rregullimet e ligjit është se, i siguruari, me ndodhjen e ngjarjes së siguruar, gëzon të drejtën për dëmshpërblim. Në rast se ndodh ngjarja e siguruar, siguruesi është i detyruar t'i japë të siguarit dëmshpërblimin apo shumën e sigurimit, sipas kontratës së sigurimit. Megjithatë, siguruesi nuk është i detyruar të paguajë shumën, e cila tejkalon kufirin e shumës së sigurimit, përveçse kur parashikohet ndryshe nga palët në kontratë. Kompania e sigurimit duhet të trajtojë çdo kërkesë për dëmshpërblim si dhe të kryejë pagesën brenda afatit të përcaktuar në kontratën e sigurimit. Trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim, nga ana e shoqërisë së sigurimit përfshin edhe vlerësimin e dëmeve nga vetë shoqëria. Kërkesa për dëmshpërblim trajtohet nga siguruesi në kohë e përputhshmëri me kriteret e miratuara për këtë qëllim. Siguruesi duhet të krijojë një sistem të brendshëm për trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim, si dhe të hartojë e miratojë procedura të brendshme për trajtimin dhe zgjidhjen e këtyre kërkesave<sup>232</sup>.

Një ndër kushtet paraprake, që një shoqëri duhet të përmbushë, në mënyrë që t'i jepet licenca e kërkuar, për të ushtruar aktivitetin e sigurimit, qoftë të jetës, qoftë të jojetës dhe që përbën risi të ligjit nr. 52/2014, është paraqitja e një dokumenti, që përmban politikat dhe procedurat e brendshme të shoqërisë për mënyrën e trajtimit të drejtë të konsumatorit<sup>233</sup>. Shoqëritë e sigurimit kanë detyrimin të informojnë të siguarin përpara nënshkrimit të kontratës, në lidhje me subjektin e sigurimit, mbulimin dhe çështje të tjera. Detyrimi për informim fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës<sup>234</sup>. Siguruesi duhet t'u nënshtrohet disa parimeve të përgjithshme, në zbatim të detyrimit, që rëndon mbi të, për të informuar klientin<sup>235</sup>. Përmendim këtu:

- Informimin para nënshkrimit të kontratës, i cili duhet të jetë i qartë dhe i mjaftueshëm.

---

<sup>232</sup> Neni 59 i ligjit nr. 52/2014 "Trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim dhe pagesa e dëmshpërblimit"

<sup>233</sup> Neni 30 "Kërkesa për marrjen e miratimit paraprak"

<sup>234</sup> Neni 61 "Detyrimi për informim"

<sup>235</sup> Neni 62 "Parimet e përgjithshme të detyrimit për informim"



- Informimin e vazhdueshëm, gjatë kohës që kontrata është e vlefshme, për çdo aspekt të saj si dhe në çdo moment, që konsumatori do ta vlerësojë të nevojshëm. Ky informacion mund të jepet me shkrim ose me gojë.
- Informimin në vijimësi, për çdo konflikt interesi, që siguruesi mund të ketë me një palë tjetër, duke përfshirë të gjitha lidhjet ekonomike dhe juridike, të cilat ndikojnë në përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj konsumatorit.
- Informimin e personave të tjerë, që përfitojnë nga kontrata e sigurimit, në rast se kërkohet nga këta persona.

Këto detyrime për informim zbatohen jo vetëm për siguruesin, por edhe për ndërmjetësin.

Në nivelin e Bashkimit Evropian, është direktiva 92/49/EEC<sup>236</sup>, e cila ka parashikuar detyrimet, që rëndojnë mbi siguruesin në lidhje me informacionin, që duhet t'i transmetojë klientit, para dhe pas lidhjes së kontratës. Kështu, në zbatim të nenit 31 të direktivës, siguruesi duhet të njoftojë klientin për:

- Legjislacionin, të cilit i nënshtrohet kontrata, kur palët nuk mund ta zgjedhin lirisht atë, ose për faktin se palët mund ta zgjedhin lirisht legjislacionin e zbatueshëm dhe, nëse kjo është e mundur, për legjislacionin që propozon siguruesi.

- Masat organizative për trajtimin e ankesave të policëmbajtësve duke përfshirë, sipas rastit, ekzistencën e një organi, pa cënuar të drejtën e policëmbajtësve për t'iu drejtuar gjykatës.

Nëse krahasojmë ligjin nr. 52/2014 me përmbajtjen e nenit 31 të direktivës 92/49/EEC, mund të themi, që ligjvënësi është përpjekur të realizojë një përafrim të plotë në këtë pikë.

Përveç kësaj direktive, në formulimin e dispozitave të ligjit nr. 52/2014, në veçanti të nenit 61 të këtij ligji, ligjvënësi shqiptar ka pasur parasysh edhe nenin 36 të direktivës 2002/83/EEC<sup>237</sup>, i cili

<sup>236</sup> Bëhet fjalë për Direktivën e datës 18 qershor 1992 “Për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës, dhe për ndryshimin e Direktivës 73/239/KEE dhe Direktivës 88/357/KEE” .

<sup>237</sup> Direktiva e datës 05 nëntor 2002, “Për sigurimin e jetës”

parashikon se informacionet duhet t'i jepen klientit ose përpara lidhjes së kontratës, ose gjatë ekzekutimit të saj, me shkrim, në njërën prej gjuhëve zyrtare të vendit ku lidhet kontrata. Informacionet mund të jepen edhe në një gjuhë tjetër, në rast se kjo kërkohet nga klienti dhe ligji i vendit ku është lidhur kontrata e lejon, ose në rast se është klienti, që ka zgjedhur ligjin, të cilit do t'i nënshtrohet kontrata.

Është e kuptueshme, që përputhshmëria me rregullimet e përcaktuara nga direktivat, bëhet duke pasur në konsideratë specifikat e tregut vendas. Kështu për shembull, Shqipëria ka vetëm një gjuhë zyrtare, gjuhën shqipe, dhe zbatimi i parimit të dhënies së informacionit në një gjuhë tjetër, do të çonte detyrimisht në zgjedhjen e një gjuhe të huaj, e cila mund të jetë për shembull gjuha amtare e të siguruarit, në rast se bëhet fjalë për një shtetas të huaj. Në këtë rast, siguruesi duhet të japë miratimin e tij, mbi kërkesën e paraqitur nga klienti, për t'u informuar në një gjuhë të ndryshme nga gjuha shqipe<sup>238</sup>.

Për sa u takon pasojave, që rrjedhin nga moszbatimi i detyrimit për të dhënë informacion, ligjvënësi shqiptar, i ka njohur të drejtën klientit, që të kërkojë prishjen e kontratës dhe pagimin e dëmit, në rast se:

- siguruesi ose ndërmjetësit nuk përmbushin detyrimin për informim;
- japin informacion të natyrës mashtruese dhe çorientuese;
- nuk japin informacionin e duhur, në përputhje me ligjin;
- informacioni i dhënë është në kundërshtim me faktet e ndodhura përpara nënshkrimit apo gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës;
- dhënia e këtij informacioni ndikon në vendimmarrjen e të siguruarit<sup>239</sup>.

Ky rregull nuk ka një normë specifike ekuivalence në direktivat e Bashkimit Evropian, për vetë faktin se zgjidhja e pasojave është ndër ato aspekte, që u janë lënë në menaxhim shteteve anëtare dhe për të cilat direktivat kanë parashikuar rregullimin nëpërmjet dispozitave kombëtare, të çdo shteti anëtar.

---

<sup>238</sup> Neni 65 i ligjit nr. 52/2014 “Përmbajtja e njoftimit”

<sup>239</sup> Neni 62 “Pasojat juridike në rast të mospërmbushjes së detyrimit për informim”

Për të vijuar përputhshmërinë e rregullave vendase me ato të përcaktuara nga direktivat 92/49/ECC dhe 2002/83/ECC, ligjvënësi shqiptar ka shtuar në ligjin nr. 52/2014 një nen specifik, në të cilin parashikohet në mënyrë të detajuar informacioni, që siguruesi dhe ndërmjetësit detyrohen t'i japin me shkrim çdo konsumatori, përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit<sup>240</sup>.

Ligji ka parashikuar, gjithashtu, një përjashtim, i cili gjen zbatim, nëse konsumatori kërkon mbulim të menjëhershëm. Në këtë rast, informacioni në fjalë mund të jepet verbalisht. Megjithatë, nëse një situatë e tillë paraqitet, pas nënshkrimit të kontratës, siguruesi i jep konsumatorit edhe informacionin me shkrim. Nënshkrimi i kontratës së sigurimit, kushteve apo anekseve të saj nënkupton rënien dakord me informacionin e dhënë verbalisht dhe pranimin e kushteve të kontratës<sup>241</sup>.

Siguruesi dhe ndërmjetësi kanë detyrimin të informojnë të siguruan për çdo ndryshim të legjislacionit të sigurimeve, falimentimit, bashkimit, zotërimit, likuidimit apo mbylljes së shoqërisë në çdo lloj mënyre, revokimit të licencës për një klasë të caktuar apo të gjitha klasat e sigurimit, si dhe për çdo ndryshim apo ngjarje tjetër, e cila ndikon në të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e ndodhjes së ngjarjes. Siguruesi dhe ndërmjetësi përmbushin detyrimin për informim gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, nëpërmjet faqes zyrtare, postës, faksit, telegrafit,

---

<sup>240</sup> Neni 63 “Detyrimi për informim përpara nënshkrimit të kontratës”. Informacioni që duhet t'i jepet konsumatorit është si më poshtë:

“Siguruesi dhe ndërmjetësit detyrohen t'i japin me shkrim çdo konsumatori, përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me llojin përkatës të sigurimit. Ky informacion përmban:

- a) emrin e shoqërisë, formën juridike dhe strukturore të saj, si dhe adresën e selisë qendrore të shoqërisë;
- b) adresën e selisë qendrore të degës, nëpërmjet së cilës bëhet nënshkrimi i kontratës së sigurimit;
- c) procedurat e brendshme të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, si dhe strukturën përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- ç) rreziqet e mbuluara dhe të përjashtuara, si dhe mundësitë për ndryshimin e kontratës, në përputhje me kushtet e përgjithshme;
- d) afatet dhe mënyrat e përfundimit të kontratës;
- dh) metodën e llogaritjes të primit, afatet dhe mënyrat e pagesës së tij, pasojat e mospagesës së primit, si dhe pjesën e primit që i korrespondon mbulimit bazë dhe shtesë;
- e) kërkesat dhe afatet për pagesën e dëmshpërblimit apo shumës së sigurimit;
- ë) metodat e llogaritjes dhe shpërndarjes së bonuseve;
- f) metodat e llogaritjes së vlerës së kompensueshme dhe reduktimin e shumës së sigurimit, në rastin e përfundimit të parakohshëm të pagesave, si dhe shumën deri ku këto janë garantuar nga kontrata e sigurimit;
- g) në rastet e kontratës që lidhet me kuotat/aksionet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, listën e plotë të sipërmarrjeve të caktuara të investimeve kolektive, në të cilat fondet e kontratës së jetës mund të investohen, si dhe karakteristikat e aktiveve, nga të cilat përbëhen fondet e këtyre sipërmarrjeve;
- gj) procedurat jashtëgjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, në lidhje me kontratën e sigurimit, në përputhje me rregullat e brendshme të siguruesit pa ndikuar në të drejtën e ankimimit në gjykatë;
- h) kushtet e përfundimit të njëanshëm të kontratës;
- i) të dhëna të përgjithshme për taksat/tatimet dhe komisionet në lidhje me kontratën e sigurimit.”

<sup>241</sup> Po aty.

postës elektronike, si dhe nënshkrimit elektronik të sigurt. Detyrimi për informim i kryer nëpërmjet telefonit ose shërbimit të qendrës së komunikimit, quhet i përmbushur nëse biseda telefonike regjistrohet nga një mjet magnetik apo digjital, si dhe nëse siguruesi mund ta vërtetojë këtë gjë<sup>242</sup>.

Këto rregulla përafrojnë të drejtën shqiptare me rregullat e vendosura nga direktivat 2002/83/CEE dhe 88/357/CEE<sup>243</sup>. Edhe në këtë rast, për të kompletuar të drejtat, që i garantohen të sigurvearit, lidhur me informacionin e vënë në dispozicion, ligjvënësi shqiptar, ka parashikuar që informacioni duhet të jepet në gjuhën shqipe dhe duhet të formulohet në mënyrë të qartë dhe të saktë. Përgjatimisht, informacioni mund të jepet në një gjuhë tjetër, përveç gjuhës shqipe, kur një gjë e tillë kërkohet nga klienti dhe pranohet nga siguruesi<sup>244</sup>.

### **5.3. Situata e konsumatorit përballë zhvillimit të teknologjive të reja të informacionit**

Përafrimi me rregullat e vendosura në nivel komunitar, konkretisht me direktivën 92/49/EEC dhe përshtatja me zhvillimet e tregtisë nëpërmjet shërbimeve elektronike, kanë çuar ligjvënësin shqiptar të përfshijë në ligjin nr. 52/2014 një dispozitë, e cila parashikon që shoqëria e sigurimit duhet të marrë të gjitha masat teknike dhe administrative për të krijuar infrastrukturën e teknologjisë së informacionit në përputhje me rregullat e miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për informimin e të sigurvearit apo personave të tjerë të interesuar, për sa u përket zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore në sektorin e sigurimeve. Shoqëria e sigurimit duhet të krijojë dhe mbajë faqe zyrtare interneti për të përmbushur në mënyrë efikase detyrimin për informim. Ajo duhet gjithashtu të përgatitë formate lehtësisht të lexueshme të një sërë informacionesh, që lidhen me aktivitetin e shoqërisë, vendndodhjen dhe organet e saj, mbulimet e ofruara dhe kushtet në të cilat ofrohen këto mbulime, të drejtat dhe

---

<sup>242</sup> Neni 64 “Informacioni i detyrueshëm në kushtet e kontratës”

<sup>243</sup> Direktiva e dytë e Këshillit 88/357/KEE, datë 22 qershor 1988, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës, ku parashikohen dispozitat për mundësimin e ushtrimit të efektshëm të lirisë për të ofruar shërbime dhe ku ndryshohet direktiva 73/239/KEE

<sup>244</sup> Neni 65 “Përmbajtja e njoftimit”

detyrimet e palëve, procedurat për trajtimin e kërkesës për dëshmipërblim, statistika si dhe pasqyrat financiare më të fundit të audituara, së bashku me opinionin e audituesit. Kompania duhet të krijojë një link të veçantë, të ndarë nga faqja kryesore e internetit, tek i cili personat e interesuar mund të futen dhe të marrin gjithë informacionin e nevojshëm, të përmendur më sipër. Përveç këtyre informacioneve, kompania e sigurimit duhet të verë në dispozicion të të interesuarve, nëpërmjet linkut të krijuar, formularët elektronikë, që i lejojnë të siguruarit dhe palëve të tjera të interesuara, të depozitojnë kërkesa për informacion dhe dëshmipërblim nëpërmjet internetit<sup>245</sup>.

Shoqëria e sigurimit ka gjithashtu detyrimin të krijojë infrastrukturën teknologjike të informacionit, që t'i mundësojë të siguruarit dhe palëve të tjera të interesuara, në mënyrë të përditësuar nëpërmjet internetit, informacion për kontratën e sigurimit. Për kontratat e sigurimit të jetës, shoqëria e sigurimit duhet të japë informacion, nëpërmjet faqes së internetit, për primet e llogaritura dhe të akumuluar, mbulimet e ofruara dhe shumat e tyre, zbritjet e mundshme duke përfshirë këtu edhe komisionet, shpenzimet administrative dhe shpenzime të tjera, shumat e akumuluar dhe bonuset nëse ka, shumën e dorëzimit të kontratës së sigurimit, bonuset dhe rabatet, statusin e kontratës objekt bonusi dhe rabati. Ligji i njeh të drejtën Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare që, nëpërmjet rregulloreve, të miratuara nga bordi i tij, të përcaktojë informacione të tjera shtesë, të cilat kompanitë e sigurimit, duhet, detyrimisht, t'i prezantojnë në faqen e tyre të internetit<sup>246</sup>.

Mbi bazën e këtij delegimi, AMF ka miratuar një rregullore të re, në datën 28.05.2015<sup>247</sup>. Nëpërmjet kësaj rregulloreje, janë përcaktuar rregullat për informimin e të siguruarit dhe personave të tjerë të interesuar, për sa u përket zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore, sipas të cilave shoqëria e sigurimit merr masat teknike dhe administrative për krijimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

---

<sup>245</sup> Neni 66 “Informimi i publikut”

<sup>246</sup> Po aty.

<sup>247</sup> Bëhet fjalë për rregulloren “Për informimin e të siguruarit apo personave të tjerë, të interesuar për sa u përket zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore në sektorin e sigurimeve”, të miratuar me vendimin e Bordit nr. 36.

Autoriteti përkufizon informacionin si çdo të dhënë, që është regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, pavarësisht nëse është përpiluar apo jo nga shoqëria<sup>248</sup>. Ndërkohë që personi, i cili përfiton nga e drejta për informim, është çdo person fizik apo juridik, i siguruar, apo person tjetër i interesuar, për sa u përket zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore në sektorin e sigurimeve<sup>249</sup>. Informimi i personave, që preken nga zbatimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore, të cilat parashikojnë këtë detyrim, mbështetet në disa parime themelore<sup>250</sup>:

1. Parimi i transparencës;
  2. Parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit;
  3. Parimi i bashkëpunimit të ngushtë dhe i besimit reciprok;
  4. Parimi i përgjegjshmërisë;
  5. Parimi i ruajtjes së konfidencialitetit;
  6. Parimi i ruajtjes së të dhënave personale.
- Parimi i transparencës nënkupton që shoqëritë e sigurimit të jenë të hapura ndaj publikut (të siguruarve dhe personave të interesuar). Shoqëritë duhet që, në zbatim të detyrimeve të tyre ligjore, të publikojnë, të informojnë dhe të shpjegojnë politikat, objektivat dhe procedurat e tyre.
  - Parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit nënkupton që shoqëritë e sigurimit nuk duhet të diskriminojnë apo privilegjojnë asnjë person, që kërkon informacion prej tyre, për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore.
  - Parimi i bashkëpunimit të ngushtë dhe besimit reciprok nënkupton që të gjitha njësitë organizative dhe personeli i shoqërive të sigurimit, duhet të bashkëpunojnë, për të garantuar të drejtën e informimit ndaj publikut dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të informacionit. Detyrimi për të

---

<sup>248</sup> Neni 4 i Rregullores “Përkufizime”.

<sup>249</sup> Po aty.

<sup>250</sup> Neni 5 i Rregullores “Parime themelore”.

informuar të siguruarit dhe për të dhënë shpjegimet e nevojshme shihet si konfirmimi i rolit të parimit të bashkëpunimit të ngushtë dhe besimit reciprok edhe në legjislacionin e vendeve të tjera (Tian, Korrik – Shtator 1998, fq. 890).

- Parimi i përgjegjshmërisë nënkupton që shoqëritë e sigurimit duhet të sillen me korrektësi ndaj të siguruarve dhe personave të tjerë të interesuar dhe nëpërmjet publikimit të informacionit, të tregojnë gatishmërinë e tyre për të qënë transparentë me subjektet e siguruara dhe çdo person të interesuar.
- Parimi i ruajtjes së konfidencialitetit nënkupton që shoqëritë e sigurimit duhet të ruajnë konfidencialitetin e çdo informacioni të klasifikuar si jopublik sipas përcaktimeve të ligjit nr. 52/2014 dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij.
- Parimi i ruajtjes së të dhënave personale plotëson parimin e ruajtjes së konfidencialitetit dhe nënkupton që përdorimi i të dhënave personale, nga shoqëritë e sigurimit, duhet të bëhet duke respektuar detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale<sup>251</sup>.

Shoqëria e sigurimit duhet të përmbushë detyrimin për informim, të parashikuar nga ligji nr. 52/2014, gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së kontratës<sup>252</sup>. Krijimi i infrastrukturës dhe teknologjisë së informacionit, që mundëson përmbushjen e këtij detyrimi, bëhet nga njësia e teknologjisë së informacionit, të cilën çdo shoqëri duhet ta ngrejë brenda saj. Njësia e teknologjisë së informacionit duhet të jetë në përputhje me përmasat e shoqërisë së sigurimit. Në krijimin e njësisë, shoqëria e sigurimit duhet të mbajë në konsideratë edhe cilësinë dhe kompleksitetin e produkteve që ajo ofron, faktorë të cilët ndikojnë në përcaktimin e madhësisë dhe përbërjes së kësaj njësie. Është detyrim i shoqërisë së sigurimit të garantojë ruajtjen e sigurisë së infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

---

<sup>251</sup> Bëhet fjalë për ligjin nr. 9887, dt. 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar me ligjin nr. 48/2012.

<sup>252</sup> Neni 6 i Rregullores “E drejta për informim”

Shoqëria e sigurimit garanton vazhdimësinë e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit nëpërmjet përditësimeve të rregullta dhe mirëmbajtjes së nevojshme<sup>253</sup>.

Infrastruktura e teknologjisë së informacionit duhet të mundësojë minimalisht:

- Ruajtjen e sigurt, përdorimin dhe mbajtjen rezervë të të gjithë informacionit, që ka lidhje me veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit.
- Bashkëveprimin e të dhënave në bazë të produkteve, llojeve të veprimtarisë, gjeografisë dhe klasifikimit të rrezikut<sup>254</sup>.

Shoqëria e sigurimit duhet të krijojë kanale të përshtatshme komunikimi brenda strukturës së saj organizative, në mënyrë që informacioni të jepet dhe të merret pa vështirësi dhe të jetë lehtësisht i raportueshëm<sup>255</sup>. Ajo është përgjegjëse për mundësimin e dërgimit të informacionit, brenda saj, te personat përkatës, që përpunojnë, ruajnë dhe shpërndajnë informacionin. Shoqëria e sigurimit informon publikun, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të tij, garantimin e njohjes maksimale me informacionin dhe vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve. Informacioni i dhënë në zbatim të rregullave të cituara më sipër duhet të jetë<sup>256</sup>:

- i plotë;
- i saktë;
- i përditësuar;
- i thjeshtë në konsultim;
- i kuptueshëm;
- lehtësisht i arritshëm;
- i pajtueshëm me dokumentet origjinale, që disponon shoqëria e sigurimit.

---

<sup>253</sup> Neni 7 “Krijimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit”

<sup>254</sup> Po aty.

<sup>255</sup> Neni 8 i Rregullores “Kanalet e përshtatshme të komunikimit”

<sup>256</sup> Neni 9 “Informimi i publikut”



Ajo që bie në sy nga analiza e dispozitave ligjore dhe të rregullores së AMF, në lidhje me përdorimin e teknologjive të informacionit në veprimtarinë e sigurimit, është që në asnjë moment nuk është parashikuar mundësia e lidhjes së kontratave nëpërmjet internetit. Lidhja e kontratave nëpërmjet shërbimeve elektronike nuk praktikohet shpesh në vendin tonë. Edhe kuadri ligjor në fuqi, për nga vetë boshllëqet që ka në këtë drejtim, nuk e favorizon përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit nga konsumatorët. Krijimi i një kuadri ligjor të favorshëm mund të shërbejë si shtysë për zhvillimin e metëjshëm të veprimeve, nëpërmjet rrugëve elektronike, gjë e cila lehtëson edhe pozitën e konsumatorit, i cili mund të marrë informacion dhe shërbim në çdo vend që ndodhet. Në këtë drejtim mund të themi se ligjvënësi shqiptar nuk e shfrytëzoi mjaftueshëm rastin e miratimit të një ligji të ri, në vitin 2014, për të rregulluar në mënyrën më të plotë këtë problematikë.

#### **5.4. Veprimtaria promionale e kompanive të sigurimit**

Ligji nr. 52/2014 përmban edhe disa rregulla për sa i takon veprimtarisë promionale, të ushtruar nga shoqëria e sigurimit. Së pari, ai parashikon një parim të përgjithshëm të dhënies së një informacioni të qartë, të vërtetë edhe të plotë. Shoqëria e sigurimit mban përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni<sup>257</sup>.

Ai jep më pas një përkufizim të informacionit promional, i cili përfshin të gjithë informacionin, që u jepet palëve të treta apo të siguruarve të mundshëm, nëpërmjet publicitetit në median e shkruar dhe vizive, takimeve, telefonatave, internetit dhe medias elektronike, televizionit interaktiv, si dhe çdo mjet tjetër nëpërmjet të cilit arrihet qëllimi i promicionit. Ligjvënësi ka dhënë një përkufizim shumë të gjerë, në mënyrë që të mbulohen të gjitha mjetet e komunikimit, të cilat mund të përdoren nga kompanitë e sigurimit për të bërë promocion pranë klientëve. Këto rregulla vlejné për kompanitë e sigurimit dhe për

---

<sup>257</sup> Neni 37 “Informacioni promional”

ndërmjetësit<sup>258</sup>. Në këtë drejtim, ligjvënësi shqiptar ka arritur të përafrojë legjislacionin vendas me Direktivën 2002/83/EEC (neni 47) dhe Direktivën 92/49/EEC (neni 41)<sup>259</sup>.

Ligjvënësi shqiptar ka plotësuar kuadrin ligjor vendas edhe me disa rregulla të tjera të cilat, pavarësisht se nuk mbështeten në një direktivë të vetme, ofrojnë garanci shtesë për konsumatorin, që kërkon të lidhë një kontratë sigurimi në territorin shqiptar. Kështu, kur shoqëria e sigurimit jep informacion promociional rreth saj dhe produkteve të ofruara në treg, ajo nuk duhet të fshehë apo të tregojë në mënyrë mashtruese e çorientuese qëllimin e promocionit dhe të informacionit. Përveç kësaj, shoqëria duhet të japë një përshkrim të plotë, të saktë, të qartë dhe të vërtetë të produktit të sigurimit, të detyrimeve ligjore, të kthimeve të vlerësuar, si dhe një përshkrim të rrezikut, që rrjedh nga këto produkte. Kompania ka detyrimin të mbështesë faktet e dhëna me dokumente origjinale. Ajo nuk duhet të deklarojë tregues të rremë apo të pavërtetë për shoqërinë e sigurimit, pozicionin që ajo zë në treg dhe produktet e saj. Së fundi, siguruesi duhet të garantojë se informacioni është i njëjtë dhe konsekuent për nga pamja, përmbajtja dhe forma. Çdo informacion promociional i njoftohet Autoritetit përpara publikimit të tij. Autoriteti mund të hartojë rregulla për procedurën e njoftimit, korrigjimit apo ndalimit të informacionit promociional<sup>260</sup>.

Direktiva 2002/83/EEC lejon gjithashtu, që klientit t'i jepen të dhëna lidhur me ecurinë e përgjithshme të aktivitetit të shoqërisë siguruese, mënyrën e përlllogaritjes së provigjoneve dhe masave, që merr kompania, për të pasur mjaftueshëm të ardhura për të përballuar pagesat, që mund të kryhen në rast se përmbushen kriteret. Direktiva parashikon detyrimin për kompaninë e sigurimit, që të njoftojë të sigurvearët për çdo ndryshim, që mund të pësojë mënyra e përlllogaritjes së provigjoneve dhe pasojat, që sjell ky ndryshim për klientin.

---

<sup>258</sup> Po aty.

<sup>259</sup> Neni 47 i direktivës 2002/83/EEC parashikon që nuk ekziston asnjë pengesë për kompanitë e sigurimeve me zyra qendrore në shtete anëtare të tjera, që të bëjnë publicitet për shërbimet e tyre, përmes të gjitha mjeteve të mundshme të komunikimit, në shtetin anëtar të degës ose në shtetin anëtar, ku ofrohen shërbimet, në varësi të normave, që rregullojnë formën dhe përmbajtjen e një publiciteti të tillë të miratuar në interesin e së mirës së përgjithshme. Të njëjtin parashikim përmban edhe neni 41 i direktivës 92/49/EEC.

<sup>260</sup> Neni 68 i ligjit "Detyrimi i shoqërisë së sigurimit"

Nga ana e tij, ligjvënësi shqiptar në nenin 128 të ligjit, ka parashikuar detyrimin për kompanitë e sigurimit që të publikojë raportin vjetor, i cili duhet të përmbajë pasqyrat financiare të audituara dhe opinionin e audituesit. Ky raport duhet të vendoset në faqen zyrtare të internetit jo më vonë se 6 muaj nga përfundimi i vitit kalendarik. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, bazuar në nenin 128 të ligjit, nëpërmjet një rregulloreje, ka përcaktuar kërkesat minimale për përmbajtjen e raportit vjetor, që publikohet nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit<sup>261</sup>.

Rregullorja shpreh qartë qëllimin e saj, i cili është mbrojtja e të drejtave dhe interesave të konsumatorit dhe palëve të tjera të interesuara, nëpërmjet rritjes së transparencës në tregun e sigurimeve, si dhe nxitja e qëndrueshmërisë dhe besueshmërisë në tregun e sigurimeve. Ajo përcakton gjithashtu se me termin “publikim” nënkuptohet vënia në dispozicion e informacionit për të gjitha kategoritë e përdoruesve, si për shembull: publikun, pjesëmarrësit e tregut, investitorët, punonjësit, përfituesit, të siguruarit, qeveritë dhe organizmat e tjera, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga vetë rregullorja<sup>262</sup>.

Raporti vjetor, që publikohet nga shoqëria e sigurimit dhe e risigurimit, duhet të përmbajë informacion, i cili hartohet duke u bazuar në disa parime<sup>263</sup>, konkretisht:

- në parimin e plotësisë;
- në parimin e materialitetit;
- në parimin e qartësisë në shprehje;
- në parimin e thjeshtësisë;
- në parimin e përshtatshmërisë lidhur me vënien në dispozicion dhe përdorimin e raportit.

---

<sup>261</sup> Bëhet fjalë për rregulloren e datës 26.10.2015 “Për përmbajtjen e raportit vjetor, që publikohet nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”, të miratuar me vendimin e Bordit nr. 110.

<sup>262</sup> Neni 4 i Rregullores “Publikimi”

<sup>263</sup> Neni 5 i Rregullores “Parimet e publikimit të raportit vjetor”

Raporti vjetor i shoqërisë së sigurimit dhe risigurimit duhet të përmbajë një analizë të veprimtarisë së shoqërisë, për sa i takon përmbushjes së detyrave dhe funksioneve të saj ligjore, gjatë vitit të kaluar. Shoqëria e sigurimit duhet të publikojë në mënyrë të përshtatshme, informacion të detajuar, i cili duhet të jetë i kuptueshëm për pjesëmarrësit e tregut, në lidhje me profilin e shoqërisë, qeverisjen dhe kontrollet, pozicionin financiar, performancën teknike dhe rreziqet ndaj të cilave shoqëria ekspozohet<sup>264</sup>.

Raporti vjetor publikohet në formë të printuar dhe elektronike. Raporti i publikuar në formë të printuar duhet të jetë i disponueshëm në mjedise të përdorshme nga publiku, në zyrat qendrore dhe në të gjitha degët dhe agjencitë e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit. Ndërsa raporti vjetor në formë elektronike, publikohet në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë së sigurimit, që në faqen e parë të saj, e cila punon jo më pak se 90% të vitit<sup>265</sup>.

Shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit publikojnë informacionin në gjuhën shqipe dhe, mbi baza vullnetare, edhe në gjuhë të huaj. Ato shënojnë datën kur publikojnë raportin dhe datën kur plotësojnë dhe/ose korrigjojnë informacionin e publikuar më parë, në rastin e publikimit të një informacioni shtesë apo plotësues, që i referohet të njëjtit informacion. Ndërkohë, edhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare publikon në linke të veçanta, raporte vjetore të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit si edhe linkun që lejon hyrjen në faqen e Qendrës Kombëtare të Biznesit<sup>266</sup>.

---

<sup>264</sup> Neni 6 i Rregullores “Përmbajtja dhe publikimi i raportit vjetor”. Raporti vjetor i përgatitur dhe publikuar nga shoqëria e sigurimit, duhet të përmbajë minimalisht këto informacione:

- a) strukturën qeverisëse të shoqërisë së sigurimit dhe risigurimit;
- b) pasqyrat financiare, të përgatitura sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
- c) opinionin e shoqërisë audituese;
- d) pjesëmarrjet e shoqërisë në kapitalin e shoqërive të tjera;
- e) listën e aksionarëve të shoqërisë së sigurimit, me pjesëmarrje influencuese të kapitalit dhe të dhëna për pjesëmarrjen e tyre;
- f) listën e administratorëve të shoqërisë së sigurimit, si dhe të atyre, që kanë pjesëmarrje influencuese në kapitalin e shoqërisë së sigurimit dhe të dhëna mbi pjesëmarrjet e tyre;
- g) përshkrimin e përmbledhur të parimeve të monitorimit, administrimit dhe kontrollit të rrezikut, që ndërmerr shoqëria e sigurimit dhe risigurimit, si dhe instrumentet e përdorura për kufizimin e tij, sipas Rregullores nr. 18, të Autoritetit, të miratuar në datën 28 prill 2015 “Për rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqëritë e sigurimit”.
- h) objektivat e shoqërisë së sigurimit dhe risigurimit për vitin pasardhës.

<sup>265</sup> Neni 7 i Rregullores “Forma e publikimit të raportit vjetor”

<sup>266</sup> Po aty.

Nga përmbajtja e dispozitave të sipërcituara, të Rregullores së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, duket qartë që nga ligjvënësi shqiptar janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të favorizuar konsumatorin, si në marrjen e informacionit ashtu edhe në deshifrimin e tij. Në këtë mënyrë, konsumatori jo vetëm që mund të marrë informacione nëpërmjet mjeteve elektronike, pa qënë e nevojshme të kalojë në një prej zyrave të kompanisë së sigurimit, por edhe mund të marrë informacione, të vëna në dispozicion nga struktura të tjera (si psh. QKB) nëpërmjet faqes së internetit të shoqërisë së sigurimit.

### **5.5. Trajtimi i ankesave të paraqitura nga konsumatorët**

Në mënyrë që mbrojtja e konsumatorit të jetë efektive, ligji nr. 52/2014 ka parashikuar që klienti ka të drejtën të ankohet pranë shoqërisë, në rast se ai gjykon që siguruesi nuk u përmbahet kushteve të kontratës. Shoqëria e sigurimit duhet t'i përgjigjet çdo ankese të depozituar, me shkrim apo në formë elektronike dhe të japë çdo informacion të kërkuar, që ka lidhje me kontratën e sigurimit, brenda 15 ditëve pune, që nga data e marrjes së kërkesës. Shoqëria duhet të krijojë një sistem të brendshëm për trajtimin, me paanshmëri të ankesave dhe zgjidhjen e tyre<sup>267</sup>.

I siguruari, ose çdo person tjetër i interesuar, ka të drejtë t'i drejtohet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për çdo pakënaqësi në trajtimin e ankesës së tij nga shoqëria e sigurimit. Ky rregull vlen edhe për ankesat, që kanë të bëjnë me ndërmjetësit në sigurime dhe vlerësuesit e dëmeve. Autoriteti, kur e gjykon të nevojshme, i kthen për rishqyrtim shoqërisë së sigurimit çështjen e ankimuar. Autoriteti, mund, gjithashtu, brenda kompetencave të tij mbikëqyrëse, të kontrollojë, nëse shoqëria e sigurimit zbaton kërkesat e ligjit dhe kushtet e kontratës së sigurimit.

---

<sup>267</sup> Neni 69 i ligjit “Ankimi”

Ligji ka parashikuar që, është Autoriteti, i cili parashikon procedurat dhe shqyrtimin e ankimit nëpërmjet një rregulloreje.<sup>268</sup> Për këtë qëllim, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar, Rregulloren “Për procedurat dhe shqyrtimin e ankesave”<sup>269</sup>. Në përcaktimin e këtyre rregullave, ligjvënësi shqiptar i është referuar nenit 10, të Direktivës 2002/92/EEC, me të cilin është realizuar një përputhshmëri e plotë<sup>270</sup>.

Ligji ka parashikuar gjithashtu edhe një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve<sup>271</sup>. Shoqëria e sigurimit duhet të hartojë dhe miratojë procedura të brendshme të përshtatshme, që do të zbatohen prej saj në rastet kur palët bien dakord, që mosmarrëveshjet ndërmjet të siguarve apo konsumatorëve me shoqërinë e sigurimit apo ndërmjetësit të zgjidhen në rrugë jashtëgjyqësore. Shoqëria e sigurimit publikon informacionin për rregullat e zgjidhjes në rrugë jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, si pjesë e kushteve të kontratës së sigurimit. Në rastet e lindjes së mosmarrëveshjeve për shkak të paqartësive të krijuara nga gjuha e përdorur në hartimin e kushteve të kontratës së sigurimit, nga ana e siguresit, zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhet duke interpretuar kushtet në favor të të siguarit. I siguruari, përfituesi ose ndonjë palë tjetër e dëmtuar nuk ka të drejtë të ngrejë padi civile ndaj siguresit, nëse ai ka rënë dakord më parë me masën e dëmshpërblimit<sup>272</sup>. Kjo procedurë është përcaktuar duke mbajtur parasysh rregullat e parashikuara nga nenet 6 dhe 7 të Direktivës 87/344/EEC si dhe nga neni 11 i Direktivës 2002/92/EEC, me të cilën është realizuar një përputhshmëri e plotë<sup>273</sup>.

---

<sup>268</sup> Po aty.

<sup>269</sup> Rregullorja është miratuar me vendimin e Bordit nr. 35, dt. 28.05.2015.

<sup>270</sup> Neni 10 i direktivës parashikon që shtetet anëtare duhet të bëjnë të mundur ekzistencën e procedurave, të cilat t'u lejojnë klientëve dhe palëve të tjera të interesuara, sidomos shoqatave të konsumatorëve, të regjistrojnë ankesa për ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime. Në të gjitha rastet, ankesat duhet të marrin përgjigje.

<sup>271</sup> Neni 70 i ligjit “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve”

<sup>272</sup> Nenet 69 “Ankimi” dhe 70 “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve” të ligjit

<sup>273</sup> Direktiva 87/344/KEE Neni 6

“Shtetet Anëtare miratojnë të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar që, pa cenuar të drejtën e ankimit tek një organ gjyqësor që mund të parashikohet nga legjislacioni kombëtar, të parashikohet një procedurë arbitrazhi ose një procedurë tjetër që ofron garanci të ngjashme objektiviteti ku, në rastin e mospërputhjes së mendimit ndërmjet siguresit të shpenzimeve ligjore dhe të siguarit, të mund të merret një vendim mbi qëndrimin që duhet të zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Kontrata e sigurimit duhet të përmendë të drejtën e personit të siguar për të përdorur një procedurë të tillë.”

Direktiva 87/344/KEE Neni 7

Ankimi pranë shoqërisë së sigurimit, në rast se një i siguruar ka pretendime për mënyrën e ekzekutimit të kontratës, është një kusht paraprak, që duhet përmbushur përpara se subjekti të ankohet pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Thënë ndryshe, një i siguruar nuk mund të ankohet pranë Autoritetit, në rast se ai nuk është ankuar paraprakisht pranë kompanisë së sigurimit<sup>274</sup>. Ankimi mund të bëhet me shkrim, me rrugë elektronike ose nëpërmjet telefonit<sup>275</sup>.

Pas marrjes së ankimit, Autoriteti verifikon përmbushjen e kërkesave, që lidhen me formën e paraqitjes së ankimit dhe elementët, që përmban ai. Në rast se kërkesat nuk janë përmbushur, Autoriteti i kthen subjektit ankimin për plotësim. Ankimi, që është paraqitur anonimisht, nuk merret në shqyrtim nga Autoriteti. Përveç kësaj, Autoriteti nuk merr në shqyrtim ankimet, për çështje të cilat janë në shqyrtim përpara gjykatës në të njëjtën kohë, ose për të cilat është dhënë një vendim gjyqësor. Nëse gjatë shqyrtimit të ankimit, Autoriteti konstaton se çështja, për të cilën është paraqitur ankimi, është në shqyrtim pranë organeve të prokurorisë, ai ndërpret shqyrtimin. Autoriteti ka 30 ditë kalendarike afat për të shqyrtuar ankimin dhe për të njoftuar ankimuesin<sup>276</sup>.

Rregullorja për procedurat dhe shqyrtimin e ankesave ka parashikuar që, Autoriteti, gjatë shqyrtimit të ankimit, mund të kryejë një ose disa prej këtyre veprimeve<sup>277</sup>:

---

“Nëse lind një konflikt interesash apo nëse ka mungesë mirëkuptimi në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes, sigurosi i shpenzimeve ligjore ose, sipas rastit, zyra e shlyerjes së kërkesave për dëmshpërblim njofton personin e siguruar për:

- të drejtën e përmendur në nenin 4,
- mundësinë e ushtrimit të procedurës së parashikuar në nenin 6.”

Direktiva 2002/92/KE Neni 11 “Zgjidhja jashtë gjykatës e mosmarrëveshjeve”

“1. Shtetet Anëtare nxisin vendosjen e procedurave të duhura dhe të efektshme të ankimit për zgjidhjen jashtë gjykatës të mosmarrëveshjeve midis ndërmjetësve në sigurime dhe klientëve, duke përdorur, sipas rastit, organet ekzistuese.

2. Shtetet Anëtare i nxisin këto organe që të bashkëpunojnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkufitare.”

<sup>274</sup> Neni 3 i Rregullores së datës 28.05.2015 “Depozitimi i ankimit”

<sup>275</sup> Cilado qoftë rruga e paraqitjes së ankimit, në zbatim të nenit 4 të Rregullores, ai duhet të përmbajë:

- emrin dhe kopje të dokumentit identifikues të ankimuesit;
- adresën e ankimuesit;
- emrin e shoqërisë së sigurimit ndaj së cilës paraqitet ankimi;
- të dhënat për ngjarjen e sigurimit;
- kopje të kontratës/policës së sigurimit;
- ankesën e depozituar pranë shoqërisë së sigurimit;
- shkaqet e ankimit;
- çdo dokument tjetër, që vlerësohet i nevojshëm nga ankimuesi.

<sup>276</sup> Neni 5 i Rregullores “Shqyrtimi i ankimit”

<sup>277</sup> Neni 6 i Rregullores “Procedurat dhe afatet e shqyrtimit të ankimit”

- t'i kërkojë shoqërisë së sigurimit informacion dhe/ose dokumentacion, nëse e vlerëson të nevojshme;
- t'i kërkojë ankuesit informacion shtesë. Në këtë rast, subjekti ka pesë ditë kalendarike kohë, që nga data e marrjes së njoftimit të Autoritetit, për të depozituar informacionin pranë zyrave të tij;
- të organizojë takime të përbashkëta, me ankimuesin dhe kompaninë e sigurimit, me qëllim sqarimin e rrethanave të çështjes objekt ankimi;
- të bëjë verifikime pranë operatorit sigurues për çështjen e ankimuar.

Autoriteti, pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit, nëse konstaton që shoqëria e sigurimit nuk ka respektuar kërkesat e ligjit apo kushtet e kontratës së sigurimit, i kthen çështjen e ankimuar kompanisë së sigurimit dhe ve në dijeni ankimuesin<sup>278</sup>. Informacioni dhe dokumentacioni, që Autoriteti ka marrë në kuadër të shqyrtimit të një ankimi, nuk mund të përdoren për qëllime të tjera, por vetëm për aq sa është e nevojshme për shqyrtimin e ankimit<sup>279</sup>. Autoriteti zbaton të njëjtat rregulla edhe për shqyrtimin e ankimeve të depozituara pranë tij dhe që lidhen me veprimet e ndërmjetësve apo të vlerësuesve të dëmeve. Ai mban një regjistër të veçantë, mbi ankesat, në të cilin evidentohen trajtimi dhe zgjidhja e tyre<sup>280</sup>.

Për të bërë të mundur trajtimin me korrektësi të informacionit të mbledhur nga klientët, ligji ka parashikuar që shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, fakteve dhe rrethanave, që kanë të bëjnë me të siguruarin dhe që ata i mbledhin gjatë ushtrimit të aktivitetit<sup>281</sup>. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit është një parim, i cili nuk gjen zbatim vetëm në rast se klienti jep miratimin e tij me shkrim, për nxjerrjen e informacionit, ose në rast se

---

<sup>278</sup> Po aty.

<sup>279</sup> Neni 7 “Ruajtja e konfidencialitetit”

<sup>280</sup> Neni 8 i Rregullores “Ankesat ndaj ndërmjetësve në sigurime dhe vlerësuesve të dëmeve”

<sup>281</sup> Neni 71 i ligjit nr. 52/2014 “Konfidencialiteti”



ky informacion nevojitet në kuadër të kryerjes së hetimeve, nga ana e organeve policore dhe gjyqësore, apo nga organe administrative<sup>282</sup>. Në këtë pikë, legjislacioni vendas është përafruar me rregullimet e parashikuara në nenin 24 të Direktivës 2005/68/EEC, në nenin 29 të Direktivës 2001/17/EEC, në nenin 16 të Direktivës 2002/83/EEC dhe në nenin 16 të Direktivës 92/49/EEC. Përputhshmëria është realizuar plotësisht<sup>283</sup>. Për të koordinuar këto rregulla të reja me kuadrin ligjor ekzistues në vend, ligji nr. 52/2014 ka parashikuar që shoqëria e sigurimit mbledh, ruan, depoziton dhe përdor të dhënat personale, të cilat janë të nevojshme për nënshkrimin e policave të sigurimit dhe për zgjidhjen e ankesave, që rrjedhin nga çdo çështje sigurimi, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra në zbatim të tij<sup>284</sup>.

Në analizë të rregullave të vendosura nga ligji nr. 52/2014 dhe Rregullorja e AMF mund të themi ligjvënësi shqiptar është pozicionuar dukshëm në favor të konsumatorit, duke u shprehur qartë, që në rast mosmarrëveshjeje për interpretimin e një dispozite të kontratës, interpretimi duhet të bëhet në favor të policëmbajtësit, si pala e cila nuk e ka draftuar kontratën. Nuk bëhet asnjë dallim, në funksion të pozitës së konsumatorit, nëse bëhet fjalë për një shoqëri apo për një person, që nuk ka dije specifike në fushën e sigurimeve.

Ligjvënësi është treguar gjithsesi shumë strikt në parashikimet e tij për sa i takon pamundësisë për t’iu drejtuar gjykatës me padi, në rast se i siguruari ka rënë dakord me siguruesin për të pranuar shumën e propozuar të dëmshpërblimit. I siguruari mund të pranojë një shumë të caktuar në momentin e marrjes së propozimit nga kompania, për shkak të vështirësive ekonomike dhe nevojës për të gjetur një zgjidhje të shpejtë (në rast të djegies së banesës ose të nevojës për ndërhyrje mjekësore të kushtueshme), ndërkohë që dëmi mund të jetë më i madh ose të rëndohet në një moment më të vonë.

---

<sup>282</sup> Neni 72 i ligjit “Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit”

<sup>283</sup> Këto nene trajtojnë problematika, që lidhen me konfidencialitetin e informacionit dhe ruajtjen e sekretit.

<sup>284</sup> Neni 73 i ligjit “Përdorimi i të dhënave personale”

## 5.6. Zhvillimet e reja në nivelin e Bashkimit Evropian

Rregullat e zbatueshme në nivelin e Bashkimit Evropian, janë plotësuar së fundmi me Direktivën Insurance Distribution Directive, të miratuar më 14 dhjetor 2015<sup>285</sup>. Ligjvënësi evropian (Parlamenti dhe Këshilli i Bashkimit Evropian) kanë vendosur të vazhdojnë rregullimet nëpërmjet direktivave, të cilat lejojnë njëherazi vendosjen e rregullave detyruese dhe respektimin e veçorive të tregjeve të brendshme të vendeve anëtare, në fushën e sigurimit.

Miratimi i rregullave të reja është bërë duke mbajtur në konsideratë disa faktorë<sup>286</sup>:

- Roli i ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime është rritur ndjeshëm.
- Produktet e sigurimit mund të ofrohen nga struktura të llojeve të ndryshme: shoqëritë e sigurimit, ndërmjetësit, organizmat bankarë, agjensitë e udhëtimit, shoqëritë të cilat japin makina me qira etj.
- Produktet e sigurimit mund të jenë objekti kryesor i kontratës së lidhur midis palëve, ose aksesori i një shërbimi të ofruar, për shembull sigurimi i ofruar në kuadër të blerjes së një pakete turistike. Në këto raste, konsumatorit i duhet ofruar një mbrojtje e efektshme, pa qënë e nevojshme që operatori t'iu nënshtrohet të gjitha detyrimeve, të cilave iu nënshtrohet kompania, që ka si objekt të aktivitetit të saj veprimtarinë e sigurimit.
- Mbrojtja e konsumatorëve duhet të jetë e njëjtë dhe konkurrenca e drejtë, pavarësisht se cili është operatori me të cilin është lidhur kontrata e sigurimit. Të gjitha llojet e sigurimeve, që propozohen në treg, duhet t'u nënshtrohen të njëjtave rregulla dhe të gjitha veprimet e zhvilluara, në kuadër të lidhjes dhe zbatimit të një kontrate sigurimi, duhet të bazohen në të njëjtat parime, për t'u ofruar konsumatorëve mbrojtje në kushte të barabarta.

---

<sup>285</sup> Kjo direktivë ka ndryshuar dhe saktësuar disa prej dispozitave të Direktivës 2002/92/EEC.

<sup>286</sup> Këta elementë janë trajtuar gjerësisht në pjesën hyrëse (Preambulën) e Direktivës.

- Direktiva 2002/92/EEC le një hapësirë veprimi të konsiderueshme për shtetet anëtare, hapësirë e cila ka sjellë si pasojë krijimin e rregullave të ndryshme nga njëri vend në tjetrin. Kjo gjë vështirëson mbrojtjen efektive të të drejtave të klientëve si dhe ushtrimin e lirë të aktivitetit nga shoqëritë, në disa vende paralelisht.
- Veprimtaria e sigurimeve është prekur ndjeshëm nga kriza ekonomike, në veçanti kontratat që parashikojnë investimet në fonde të ndryshme spekulative, gjë e cila ka bërë që specifikat e kontratave të sigurimit dhe të aktivitetit të investimeve të merren më shumë në konsideratë, për të përmirësuar pozitën dhe të drejtat e konsumatorëve, në krahasim me garancitë e ofruara nga Direktiva 2002/92/EEC.
- Zhvillimi i teknologjive të informacionit ka bërë të mundur që nëpërmjet shërbimeve elektronike dhe informatike, klienti të marrë jo vetëm informacione për çmimet e ndryshme që ofrojnë operatorët, që veprojnë në fushën e sigurimeve, por edhe propozime për kontrata, që mund të lidhen mbi bazën e kriterëve të seleksionuara nga konsumatori në programet e kërkimit. Si rrjedhojë, ka lindur nevoja e përforsimit të rregullave dhe ofrimit të garancive të nevojshme për konsumatorin, në kuadër të marrëdhënieve të krijuara nëpërmjet rrugëve elektronike.
- Konsumatorët në mjaft raste, përpara lidhjes së një kontrate sigurimi, kërkojnë këshilla nga profesionistë të ndryshëm, si për shembull, juristë, ekspertë kontabël, fiskalistë etj., të cilët pavarësisht këshillimit nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në lidhjen e kontratës dhe nuk kanë si aktivitet parësor ofrimin e shërbimit të sigurimit. Rregullimi i këtyre aspekteve nuk mund t'u nënshtrohet ngushtësisht të njëjtave rregulla si procesi i mirëfilltë i lidhjes së kontratës. Ky qëndrim vlen edhe për strukturat të cilat ofrojnë vetëm të dhëna, informacione apo statistika për kontratat dhe kompanitë që gjenden në treg, por nuk luajnë rol në blerjen e shërbimit.

- Adoptimi i rregullave, të cilat krijojnë kushte për mbrojtjen efikase të konsumatorëve, duhet të bëhet duke mbajtur parasysh edhe faktin që krijimi i detyrimeve të shumta për kompanitë e sigurimit, mund të bëhet pengesë për zhvillimin e këtij aktiviteti. Megjithatë, krijimi i kushteve të favorshme për zhvillimin e aktivitetit të sigurimit nuk duhet të bëhet pengesë, që rregullat të cilave iu nënshtrohen kompanitë e sigurimit, të gjejnë zbatim edhe për personat fizikë, të cilët edhe pse nuk janë të organizuar në të njëjtën formë, janë të specializuar në ofrimin e shërbimeve të sigurimit dhe mund të veprojnë në disa shtete. Këta persona duhet të regjistrohen pranë autoriteteve kompetente përkatëse<sup>287</sup>, të shtetit të tyre të origjinës dhe të jenë objekt kontrolli nga këto autoritete.
- Në mënyrë që kontrolli i aktivitetit të sigurimit, në nivel komunitar, të jetë efektiv, autoritetet, që e ushtrojnë atë, duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe të këmbëjnë informacion rregullisht. Informacioni i këmbyer duhet të prekë jo vetëm gjendjen juridike të subjektit, që ushtron aktivitetin e sigurimit, por edhe shkeljet e rregullave të një shteti, që një operator mund të ketë kryer, në veçanti shkeljet që kanë të bëjnë me mungesën e njohurive të mjaftueshme dhe sjelljen joprofesionale. Ky detyrim vlen edhe në rastet kur autoritetet ushtrojnë një mbikëqyrje të përbashkët mbi shoqëritë, për arsye se selia e tyre ndodhet në një shtet ndërkohë që zyrat ose degët ndodhen në shtete të tjera.
- Brokerat dhe ndërmjetësit në sigurime duhet të përfitojnë nga të drejtat dhe garancitë, që u ofrohen siguruesve për sa i takon ushtrimin të lirë të aktivitetit dhe moskrijimit të pengesave të panevojshme për zhvillimin e veprimtarisë në disa shtete të Bashkimit Evropian. Caktimi i rregullave, të cilave iu nënshtrohen brokerat dhe ndërmjetësit, duhet bërë duke pasur

---

<sup>287</sup> Autoritetet kompetente përcaktohen nga Shtetet Anëtare, të cilat i komunikojnë Komisionit emrat e tyre dhe kompetencat, që u kanë caktuar. Një shtet anëtar mund të zgjedhë organin kompetent midis autoriteteve publike kombëtare ose midis organizmave, të njohura nga ligjet vendase apo nga struktura të posaçme, të cilat janë krijuar dhe veprojnë në fushën e sigurimeve, në zbatim të rregullave kombëtare në fuqi. Autoritet kompetent nuk mund të jetë asnjë shoqëri sigurimi apo risigurimi, apo ndërmjetësimi. Një shtet anëtar mund të përcaktojë më shumë se një autoritet kompetent. Në këtë rast, ai duhet të vendosë edhe rregulla për bashkëpunimin midis këtyre organeve.

parasysh që, për nga roli i rëndësishëm që ata luajnë, krijimi i pengesave për ta sjell pasoja për të gjithë aktivitetin e sigurimit dhe për të gjithë aktorët, që ndërhyjnë në këtë veprimtari, duke përfshirë jo vetëm kompanitë e sigurimit por edhe konsumatorët.

Direktiva jep një përkufizim të gjerë të aktivitetit të shpërndarjes së sigurimeve, në të cilin përfshihen<sup>288</sup>:

- Dhënia e këshillave në lidhje me kontratat e sigurimit. Këshillë konsiderohet çdo rekomandim i personalizuar, që i jepet një klienti, me kërkesën e tij ose me iniciativën e shpërndarësit të produkteve të sigurimit, në lidhje me një ose disa kontrata sigurimi;
- Propozimi për të lidhur kontrata;
- Propozimi për të realizuar procedurat, që i paraprijnë lidhjes së një kontrate sigurimi;
- Dhënia e asistencës për menaxhimin dhe ekzekutimin e kontratës, veçanërisht kur realizohet rreziku i siguruar;
- Dhënia e informacioneve për një ose disa kontrata sigurimi sipas kriterëve të përzgjedhura nga klienti nëpërmjet faqes së internetit ose mënyrave të tjera të komunikimit;
- Përpilimi i një klasifikimi të produkteve të sigurimit, përfshirë edhe tabelën krahasimore të çmimeve dhe produkteve;
- Ofrimi i uljeve të tarifave të primeve, në rast se klienti mund të lidhë kontratën drejtpërsëdrejti, nëpërmjet një faqeje interneti ose mjeteve të tjera të komunikimit.

Nuk konsiderohet si shpërndarje ose shitje e produkteve të sigurimit<sup>289</sup>:

- Dhënia e informacioneve, në mënyrë të rastësishme, në kuadër të një aktiviteti tjetër profesional, në rast se ofruesi i shërbimit nuk ndërmerr asnjë veprim për lidhjen dhe ekzekutimin e kontratës si dhe në qoftë se veprimet e ofruesit të shërbimit nuk kanë si qëllim lidhjen apo ekzekutimin e një kontrate sigurimi.

---

<sup>288</sup> Neni 2 i Direktivës “Përkufizime”

<sup>289</sup> Pika 2 e nenit 2 të Direktivës.

- Menaxhimi profesional i aksidenteve, që mund t'i ndodhin një kompanie sigurimi ose risigurimi dhe i aktiviteteve të vlerësimit dhe rregullimit të pasojave të këtyre aksidenteve.
- Dhënia e informacioneve për produktet e sigurimit dhe risigurimit për klientët dhe për strukturat, që ushtrojnë funksionet e ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime, për sa kohë që subjekti, i cili jep këto informacione, nuk merr masa të tjera për ta ndihmuar klientin të lidhë një kontratë sigurimi ose risigurimi.

Ndërkohë që ndërmjetësi përkufizohet si çdo person fizik ose juridik, i ndryshëm nga kompania e sigurimit, ose personeli i saj, i cili vepron në fushën e shpërndarjes së sigurimit ose ushtron këtë lloj aktiviteti. Personi, i cili nuk e ushtron aktivitetin e ndërmjetësimit si aktivitet parësor, por propozon vetëm disa lloje produktesh sigurimi, të cilat plotësojnë një të mirë apo një shërbim të ofruar, në kuadër të ushtrimit të aktivitetit parësor, cilësohet si ndërmjetës dytësor.

Edhe përkufizimi i të ardhurave, që përfitojnë ndërmjetësit, është shumë i gjerë, pasi në të përfshihen të gjitha komisionet, avantazhet ekonomike, në natyrë, ose joekonomike, si dhe të gjitha pagesat për shpenzimet, që rëndojnë mbi ndërmjetësin, të propozuara ose të ofruara nga subjektet, që kanë lidhje me aktivitetin e sigurimit<sup>290</sup>.

Ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime, së bashku me ndërmjetësit dytësorë, duhet të regjistrohen nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës<sup>291</sup>. Në rast se ndërmjetësi është një person fizik, vend i origjinës quhet vendi në të cilin subjekti ka residencën e tij. Ndërsa, në rast se bëhet fjalë për një person juridik, vend i rezidencës është vendi në të cilin ndodhet selia ose administrata qendrore e shoqërisë. Ndërmjetësit mund të regjistrohen edhe pranë një shoqërie, e cila mund të jetë shoqëri sigurimesh ose shoqëri ndërmjetësish. Detyrimi për regjistrim nuk është i vlefshëm për personat të cilët punojnë për një ndërmjetës, që është i regjistruar në emër të tij.

---

<sup>290</sup> Pika 1 e nenit 2 të Direktivës.

<sup>291</sup> Neni 3 “Regjistrimi” i Direktivës.

Regjistri duhet të përmbajë informacione në lidhje me vendet e tjera anëtare, në të cilat ushtron aktivitetin një ndërmjetës i regjistruar në vendin e origjinës. Një shtet anëtar mund të vendosë krijimin e disa regjistrave, mbi bazën e kriterëve të ndryshme. Sistemi i regjistrimit duhet të ekzistojë edhe në formë elektronike. Në rast se në një shtet anëtar ekzistojnë disa regjistra, atëherë autoritetet kompetente duhet të krijojnë struktura, që lejojnë konsultimin e të gjithë regjistrave në një pikë të vetme shërbimi. Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale krijon, publikon dhe përditëson në faqen e tij të internetit regjistrin e ndërmjetësve dhe ndërmjetësve dytësorë, të cilët në momentin e regjistrimit kanë deklaruar qëllimin e tyre për të ushtruar aktivitetin në vende të tjera përveç vendit të origjinës. Personat e regjistruar kanë të drejtën të konsultojnë lirisht këto informacione, ndërkohë që përditësimi i tyre mund të bëhet vetëm nga Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale<sup>292</sup> dhe autoritetet kombëtare.

Vlefshmëria e regjistrimit verifikohet nga autoritetet rregullisht. Në rast se ndërmjetësi nuk i plotëson më kushtet, autoritetet heqin emrin e tij nga regjistri. Gjithashtu, autoriteti i vendit të origjinës merr masat për të njoftuar autoritetet e vendeve të tjera, ku ndërmjetësi ushtron aktivitetin, për këtë ndryshim. Kërkesa e një ndërmjetësi për regjistrim duhet të trajtohet brenda tre muajve nga data e paraqitjes pranë autoritetit kompetent. Në mënyrë që të kryhet regjistrimi, ndërmjetësi duhet të informojë autoritetin kompetent përkatës për:

- Identitetin e aksionarëve ose të pjesëtarëve të tij, qofshin këta persona fizikë apo juridikë, të cilët zotërojnë më tepër se 10% të aktivitetit të ndërmjetësit si dhe shifrën e saktë të zotërimit të cilit prej tyre.
- Identitetin e personave, që kanë lidhje të ngushta me ndërmjetësin.

---

<sup>292</sup> Autoriteti Evropian për Sigurimet dhe Pensionet Profesionale është një organizëm konsultativ, i cili vepron pranë Parlamentit Evropian, Komisionit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian. Ai është një prej organeve mbikëqyrëse të cilat kanë për funksion të mbikëqyrin tregun e sigurimeve, tregun bankar dhe atë të investimeve.

- Faktin që këto pjesëmarrje dhe lidhje të ngushta nuk pengojnë ushtrimin e misioneve të kontrollit të autoritetit kompetent.

Autoriteti kompetent refuzon regjistrimin e ndërmjetësit në rast se dispozitat ligjore, rregullative dhe administrative të një vendi të tretë, të cilave iu nënshtrohet njëri ose disa prej anëtarëve të personit fizik ose juridik, me të cilin ndërmjetësi ka lidhje të ngushta, pengojnë ushtrimin e rregullt të misionit të kontrollit<sup>293</sup>.

Direktiva përmban një sërë dispozitash, të cilat parashikojnë të drejtën për ndërmjetësit dhe ndërmjetësit dytësorë të ushtrojnë lirisht aktivitetin e tyre për ofrimin e shërbimeve brenda territorit të Bashkimit Evropian. Por, ajo parashikon edhe që shtetet anëtare mund të marrin masat e nevojshme për të parandaluar ose sanksionuar parregullsitë, që mund të jenë kryer nga ndërmjetësit ose ndërmjetësit dytësorë, në rast se një ndërhyrje e menjëhershme është e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e konsumatorëve. Ndërhyrja mund të realizohet nëpërmjet pengimit të ndërmjetësve ose ndërmjetësve dytësorë të ushtrojnë sërish aktivitetin e tyre në territorin e shtetit anëtar<sup>294</sup>.

Direktiva parashikon që ndërmjetësit përfitojnë edhe nga e drejta për të krijuar lirisht degë ose zyra për ushtrimin e aktivitetit, në çdo vend anëtar, me kusht që autoriteteve kompetente t'u jepen informacionet e nevojshme për identifikimin dhe regjistrimin e strukturës. Vendi i origjinës i transmeton informacionet e marra te autoritetet kompetente të vendeve të tjera anëtare. Në rast se konstatohen shkelje të kryera në vendin e origjinës, autoriteti kompetent i këtij vendi mund t'u refuzojë dhënien e këtij informacioni autoriteteve të vendeve të tjera. Për këtë refuzim, autoriteti kompetent duhet të informojë me shkrim ndërmjetësin, i cili ka të drejtën të ankohet në gjykatë<sup>295</sup>.

Autoriteti kompetent i vendit, në të cilin është regjistruar dega apo zyra e përfaqësimit duhet të informojë autoritetin kompetent të vendit të origjinës, për çdo shkelje të konstatuar prej tij, për

---

<sup>293</sup> Neni 3 “Regjistrimi” i Direktivës.

<sup>294</sup> Nenet 4 dhe 5 të Direktivës

<sup>295</sup> Po aty



kontrollin e së cilës autoriteti i vendit të origjinës është përgjegjës, në mënyrë që ky i fundit të marrë të gjitha masat dhe sanksionet e nevojshme. Në rast se masat e marra nga autoriteti i vendit të origjinës nuk mjaftojnë dhe ndërmjetësi vazhdon të shkelë rregullat në ushtrimin e aktivitetit të tij, atëherë autoriteti i vendit në të cilën ai kryen këto shkelje, mund të ndërhyjë duke marrë masa të tjera, për sa kohë që këto masa janë të nevojshme për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe garantimin e qëndrueshmërisë së tregut. Përpara marrjes së këtyre masave, autoriteti që i merr, duhet të njoftojë autoritetin kompetent në vendin e origjinës. Në rast se shkeljet e kryera janë shumë të rënda, autoriteti mund të marrë masa që kanë për synim pengimin e ushtrimit të aktivitetit nga ndërmjetësi në shtetin anëtar pritës. Autoriteti kompetent i shtetit pritës duhet të njoftojë me shkrim ndërmjetësin për masat e marra. Gjithashtu, ai duhet të njoftojë edhe autoritetin kompetent të vendit të origjinës, Autoritetin Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale si dhe Komisionin Evropian<sup>296</sup>.

Direktiva nuk i pengon shtetet anëtare që të marrin masat e nevojshme, për të sanksionuar parregullsitë e kryera në territorin e tyre dhe që vijnë në kundërshtim me rregullat e brendshme të interesit të përgjithshëm (publik). Këto masa duhet të mos jenë diskriminuese dhe të merren vetëm në rast se janë absolutisht të nevojshme, pasi ato mund të sjellin si pasojë pengimin e ndërmjetësit për të ushtruar aktivitetin e tij në territorin e një shteti. Shtetet anëtare duhet të publikojnë rregullat e interesit publik<sup>297</sup>, që gjejnë zbatim në vendin e tyre, në mënyrë që ato të mund të konsultohen lehtësisht nga personat e interesuar. Në rast se shtetet anëtare vendosin të zbatojnë rregulla të tjera shtesë, përveç atyre të parashikuara nga Direktiva, ato duhet të kujdesen, që detyrimet, që rrjedhin nga këto rregulla, të jenë

---

<sup>296</sup> Neni 5 i Direktivës

<sup>297</sup> Rregullat e interesit të përgjithshëm/publik lidhen me informacionin që ndërmjetësit në sigurime/risigurime dhe ndërmjetësit dytësorë duhet t'u japin klientëve ose klientëve të mundshëm përpara lidhjes së kontratës, përsa i takon shpërndarjes së produkteve të investimit, që mbështeten në aktivitetin e sigurimit si dhe shpenzimet që lidhen me to.

të përshtatshme për të siguruar mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe të marrin masa në vijimësi që zbatimi i tyre të bëhet komform dispozitave të Direktivës<sup>298</sup>.

Direktiva ka vendosur një sërë rregullash përsa i takon formimit profesional dhe organizimit të ndërmjetësve dhe kompanive të sigurimit. Personat, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, duhet të kenë formim të përshtatshëm në këtë fushë. Shtetet anëtare duhet të bëjnë të mundur që shoqëritë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit të marrin masat e nevojshme për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të tyre në fushën e sigurimit, në varësi të funksioneve që ata ushtrojnë në shoqëri. Për këtë qëllim, shtetet krijojnë dhe publikojnë mekanizmat, që u lejojnë atyre të kontrollojnë me efikasitet dhe të vlerësojnë njohuritë e ndërmjetësve dhe të personelit të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit<sup>299</sup>.

Shoqëritë duhet të sigurojnë se paku 15 orë trajnim për çdo punonjës. Shtetet mund të kërkojnë, që personat e trajnuar në vendin e tyre të origjinës, të paraqesin një certifikatë për të provuar realizimin e trajnimit të detyruar. Shtetet mund të parashikojnë gjithashtu që, në rast se një ndërmjetës është i regjistruar pranë një shoqërie sigurimi, verifikimi i njohurive të tij dhe i trajnimeve profesionale të organizuara, të kryhet nga shoqëria e sigurimit, pranë së cilës ndërmjetësi është regjistruar. Vendet anëtare mund të përjashtojnë nga formimi i detyruar prej 15 orësh, punonjës të shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, të cilët në kuadër të punës së tyre nuk ndërhyjnë në shpërndarjen e produkteve të sigurimit, por kryejnë funksione të tjera administrative, të cilat nuk i vendosin në kontakt të drejtpërdrejtë me klientin<sup>300</sup>.

Direktiva ka parashikuar që shtetet anëtare duhet të krijojnë procedurat e nevojshme, që u lejojnë klientëve dhe personave të interesuar, në veçanti shoqatave të konsumatorëve, të ankohen kundër

---

<sup>298</sup> Neni 7 i Direktivës trajton ndarjen e kompetencave midis shtetit anëtar të origjinës së kompanisë dhe shtetit tjetër, ku ajo ushtron aktivitetin.

<sup>299</sup> Neni 10 i Direktivës

<sup>300</sup> Po aty

veprimeve të shpërndarësve të sigurimit dhe të marrin një përgjigje. Shtetet duhet të sigurohen që, mosmarrëveshjet që lindin midis klientëve dhe aktorëve, që veprojnë në fushën e sigurimit, të merren në shqyrtim nga organizma administrativë të përshtatshëm, të cilët kanë kompetencat e nevojshme. Shtetet duhet gjithashtu të marrin masa për të penguar ofrimin e shërbimeve të sigurimit, nga ndërmjetës të cilët nuk janë regjistruar pranë organeve përkatëse<sup>301</sup>.

Në zbatim të Direktivës, operatorët që veprojnë në fushën e sigurimit, duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të ndershme, të paanshme dhe profesionale si dhe duke mbajtur gjithmonë në konsideratë atë, që është më e mirë për klientin. Reklamat e mundshme, që operatorët u drejtojnë klientëve, duhet të jenë korrekte, të qarta dhe të mos përmbajnë elementë mashtrues. Klienti duhet të informohet për qëllimin publicitar të informacionit që i jepet. Shtetet anëtare duhet të marrin masa, në mënyrë që të sigurohet pavarësia financiare e shpërndarësve të produkteve të sigurimit, me qëllim që klientëve t'u propozohen ato shërbime, që janë më të mira për interesat e tyre dhe jo ato që u lejojnë operatorëve të paguhen më tepër<sup>302</sup>.

Direktiva parashikon që, çdo ndërmjetës në sigurime duhet që, përpara lidhjes së një kontrate, të informojë klientin për<sup>303</sup>:

- Identitetin e tij, adresën dhe faktin që është i regjistruar si ndërmjetës në sigurime;
- Mundësinë që ai t'u japë klientëve këshilla, lidhur me produktet e sigurimit që ofron;
- Procedurat, që u lejojnë klientëve të ankohen në rrugë gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, kundër produkteve dhe shërbimeve të ofruara prej tij;
- Regjistrin në të cilin ndërmjetësi është regjistruar dhe mënyrën se si duhet vepruar për të verifikuar të dhënat e këtij regjistrimi;

---

<sup>301</sup> Nenet 14 – 16 të Direktivës

<sup>302</sup> Neni 17 i Direktivës

<sup>303</sup> Neni 18 i Direktivës

- Lidhjet, që ekzistojnë midis ndërmjetësit dhe kompanisë së sigurimit, nëse ndërmjetësi vepron në emër të klientit apo të shoqërisë së sigurimit.

Detyrimi për informim rëndon edhe mbi kompaninë e sigurimit. Ndërmjetësi duhet gjithashtu, të njoftojë klientët për<sup>304</sup>:

- Çdo pjesëmarrje, të drejtpërdrejtë ose jo, në aksionet, kapitalin ose të drejtat e votës, që ai zotëron në një kompani sigurimi, në rast se kjo pjesëmarrje është e barabartë ose më e madhe se 10%.
- Çdo pjesëmarrje, të drejtpërdrejtë ose jo, të barabartë ose më të madhe se 10%, që një kompani sigurimi ose kompania mëmë e saj, mund të ketë në aksionet, kapitalin ose të drejtat e votës, në shoqërinë e ndërmjetësimit që ai përfaqëson.
- Faktin nëse ndërmjetësi është ose jo i lidhur, nëpërmjet një kontrate, me një ose disa kompani sigurimi, për të cilat ai duhet të ofrojë produktet te klientët si dhe të bëjë të ditur emrat e këtyre shoqërive. Informacioni prek edhe kompanitë, për të cilat kontrata ka ekzistuar në të kaluarën dhe ka përfunduar në momentin e komunikimit me klientin. Ndërmjetësi duhet të garantojë pavarësinë dhe paanshmërinë e tij, në dhënien e këshillave pavarësisht lidhjeve me një shoqëri sigurimi.
- Llojin e pagesës së përfituar për çdo shërbim të ofruar në lidhje me kontratën e sigurimit si dhe subjektin të cilin e paguan (pagesa për shërbimin e ofruar mund të kryhet nga klienti, mund të jetë e përfshirë në primin e kontratës, mund të jetë një avantazh ekonomik i ofruar nga shoqëria e sigurimit ose një kombinim e këtyre mënyrave).
- Në rast se tarifa për shërbimin e ofruar paguhet nga klienti, ndërmjetësi duhet t'i shpjegojë atij mënyrën sesi llogaritet kjo tarifë.

---

<sup>304</sup> Neni 19 i Direktivës, i cili trajton konfliktet e interesit dhe problemet e transparencës.

Pas lidhjes së kontratës së sigurimit, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë klientin për çdo pagesë të përfituar nga personeli i saj dhe që ka lidhje me kontratën e sigurimit. Në rast se përveç primit, klienti paguan edhe shuma të tjera në favor të shoqërisë së sigurimit, shoqëria duhet të informojë klientin për mënyrën se si përdoret kjo shumë, pra se cilat janë pagesat e përfituara nga punonjësit e shoqërisë dhe që lidhen me shumatat e paguara nga klienti<sup>305</sup>.

Kur ndërmjetësi i ofron klientit informacion me shkrim, në lidhje me një kontratë sigurimi jojete, dokumenti i informimit duhet të përmbushë këto kriterë<sup>306</sup>:

- Duhet të jetë një dokument përmbledhës dhe i plotë njëkohësisht.
- Të jetë i qartë, i lehtë për t'u lexuar dhe kuptuar dhe të jetë shkruar me shkronja të lexueshme.
- Të jetë redaktuar në njërën prej gjuhëve zyrtare të Bashkimit Evropian, ose në njërën prej gjuhëve që përdoren në atë pjesë të shtetit anëtar, në të cilin produkti i sigurimit propozohet. Nëse klienti dhe ofruesi i shërbimit bien dakord, informacioni mund të jepet në gjuhë tjetër.
- Informacioni i dhënë duhet të jetë ekzakt dhe jo mashtrues.
- Dokumenti i informimit duhet të përmbajë në mënyrë lehtësisht të dallueshme shënimin “Dokument informues për produktet e sigurimit”.
- Ai duhet të përmbajë nënshkrimin, që njofton klientin se informacionet parakontratore dhe kontratore, lidhur me produktin, gjenden edhe në dokumenta të tjera, që mund t'i vihen klientit në dispozicion.

Shtetet anëtare mund të parashikojnë që ndërmjetësit duhet të përmbledhin në një dokument të vetëm, që i vihet në dispozicion klientit, informacionin e parashikuar në Direktivë së bashku me informacione të tjera, të parashikuara nga legjislacioni vendas.

Dokument i informues për produktet e sigurimit, përmban këto informacione<sup>307</sup>:

---

<sup>305</sup> Po aty

<sup>306</sup> Neni 20 i Direktivës

- Të dhëna në lidhje me llojin e sigurimit;
- Një përmbledhje të mbulimit që ofron siguri, përfshirë edhe kufirin maksimal të siguruar, në rast se nevojitet, hapësirën që mbulon siguri, si dhe rreziqet që nuk mbulohen;
- Mënyrën e pagimit të primeve dhe kohëzgjatjen e pagesave;
- Shkaqet kryesore, për të cilat klienti përjashtohet nga marrja e një dëmshpërblimi;
- Detyrimet e klientit në momentin e lidhjes së kontratës, gjatë zbatimit të saj dhe në rast se ndodh rreziku i siguruar;
- Kohëzgjatjen e kontratës, përfshi edhe datën e fillimit dhe atë të mbarimit të saj;
- Procedurat për ndërprerjen e kontratës.

Shtetet anëtare mund të caktojnë rregulla më strikte, në nivel kombëtar, përsa i takon detyrimit për informim, pagesave të marra nga ndërmjetësit apo shmangies së konfliktit të interesit.

Insurance Distribution Directive ka parashikuar gjithashtu shfuqizimin e Direktivës 2002/92/EEC, në një datë më të vonë, pas kalimit të një afati prej 24 muajsh, që nga data e hyrjes në fuqi të Direktivës së miratuar në dhjetor 2015.

Mund të themi se Direktiva e miratuar në dhjetor të vitit 2015 është e paplotë, pasi ajo parashikon që personat fizikë, të cilët punojnë për një kompani siguri, risiguri apo ndërmjetësimi nuk duhet të jenë dënuar për një shkelje penale të rëndë, çka nënkupton a contrario, që ata mund të jenë dënuar për shkelje të lehta. Përveç kësaj, në Direktivë nuk gjejmë asnjë shpjegim për mënyrën sesi duhet të vlerësohet rëndësia e shkeljes, në varësi të dënimit, me burg ose jo, në varësi të kategorisë në të cilën ajo bën pjesë, kundërvajtje, delikt apo krim.

Për të plotësuar analizën e qëndrimit të mbajtur në nivelin e Bashkimit Evropian, është me interes studimi i vendimit të dhënë nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në datën 17 mars 2016, në

---

<sup>307</sup> Po aty

çështjen Ministër Financoë kundër Aspiro S.A. Ky vendim është dhënë mbi bazën e kërkesës së Shtetit Polonez për interpretimin e nenit 135, paragrafi 1/a, të Direktivës nr. 2006/112/EEC, të datës 28 nëntor 2006, që ka lidhje me sistemin e përbashkët të Bashkimit Evropian në fushën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Neni 135 i Direktivës parashikon që veprimet e sigurimit dhe të risigurimit, përfshirë edhe dhënien e shërbimeve, që lidhet me këto veprime, të kryera nga brokerat dhe ndërmjetësit në sigurime, janë të përjashtuara nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar.

Ligji me të cilin ishte transpozuar Direktiva në të drejtën poloneze, parashikonte që, përjashtoheshin nga TVSH, shërbimet e sigurimit dhe risigurimit, dhe shërbimet e ofruara nga ndërmjetësit në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve si dhe të gjitha shërbimet e ofruara nga siguruesi në kuadër të kontratave të sigurimit, të lidhura prej tij, për llogari të të tretëve, me përjashtim të transferimit të të drejtave të fituara në kuadër të një kontrate sigurimi dhe risigurimi.

Mosmarrëveshja, që kishte lindur midis dy palëve, lidhej me faktin nëse Aspiro duhej t'i nënshtrohej apo jo Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, duke qënë se ajo nuk ishte një kompani sigurimi, e regjistruar si e tillë, por kryente disa veprime të lidhura me sigurimet, konkretisht:

- Mbledhjen e deklaratave mbi rreziqet e realizuara;
- Regjistrimin e rreziqeve të realizuara në një sistem të informatizuar dhe përditësimin e tij;
- Përcaktimin e shkaqeve dhe rrethanave në të cilat kishte ndodhur ngjarja, përfshi dhe inspektimin e vendit, përgatitjen e dokumentacionit me qëllim gjetjen e përgjegjësit të dëmit, caktimin e dëmshpërblimit dhe të avantazheve të tjera, nga të cilat mund të përfitonte klienti;
- Shkëmbimin e korrespondencës me personat e prekur (të dëmtuar, përfitues, palë të treta);
- Marrjen e vendimeve lidhur me kryerjen ose jo të një pagese për dëmshpërblim;
- Vlerësimet teknike dhe marrjen e provave fotografike, në fushën e sigurimeve motorike;

- Plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e një pagese dhe arkivimin e dosjeve të trajtuara;
- Dhënien e informacionit të kërkuar nga klientët;
- Përgatitjen, në rast se klienti e kërkonte, të një dokumenti shpjegues për mënyrën se si ishte trajtuar një dosje.
- Çdo veprim tjetër, që ishte i nevojshëm për zgjidhjen e pasojave, në rast të realizimit të dëmit dhe që kishte lidhje me veprimet e kryera më sipër.

Gjykata e Lartë e Polonisë i është drejtuar Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në mënyrë që ajo të shprehej nëse neni 135 i Direktivës 2006/112/EEC duhet apo jo të interpretohet në mënyrë të tillë, që të bëjnë pjesë në veprimet e përjashtuara nga TVSH edhe shërbimet e ofruara në emër të një kompanie sigurimi, nga një strukturë e tretë, që nuk ka asnjë lidhje juridike me kompaninë e sigurimit.

Për të bërë interpretimin e kërkuar, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ndjek një arsyetim të përbërë nga disa etapa:

- Së pari, ajo rikujton se përjashtimet nga një rregull e përgjithshme nuk mund të supozohen. Ato janë shteruese dhe duhet të jenë përmendur në mënyrë specifike në Direktivë.
- Së dyti, Gjykata analizon llojin dhe natyrën e shërbimeve të ofruara nga Aspiro, nëse janë apo jo veprime sigurimi ose që lidhen me sigurimin. Gjykata jep përkufizimin e sigurimit në thelb të të cilit qëndron pagimi i një primi nga klienti, në mënyrë që kompania t'i japë atij shpërblimin e dakordësuar, në rast të realizimit të rrezikut. Ajo shprehet se veprimet e sigurimit përfshijnë edhe ofrimin e mbulimit të një rreziku nga një subjekt, që nuk është kompani sigurimesh, por që në kuadër të një kontrate kolektive, ofron një lloj mbulimi, i cili në fund merret përsipër nga një kompani sigurimesh. Edhe në këtë rast, midis palës siguruese dhe asaj të siguruar duhet të lidhet një kontratë. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se Aspiro nuk lidh



kontrata me klientët. Pavarësisht se shoqëria kryen një sërë veprimesh, të cilat çojnë edhe në vendimmarrje për pagesën ose jo të shumës së parashikuar në kontratë, shërbimet i ofrohen kompanisë së sigurimit dhe jo klientit drejtpërdrejt.

- Në vijim, Gjykata rrëzon arsyetimin e palëve në proces, të cilat bëjnë një analogji midis veprimeve financiare dhe atyre të sigurimit. Veprimet financiare, por edhe veprimet, që lidhen me to, janë të përjashtuara nga TVSH. Në këtë rast, veprimet e lidhura me veprimet financiare përfshijnë një kategori joshteruese veprimesh. Gjykata ve në dukje faktin që, në rastin e shërbimeve financiare, përjashtimi nga TVSH është rregull, në ndryshim nga veprimet e sigurimit. Kjo duket edhe në mënyrën e formulimit të nenit 135 të Direktivës.

- Më pas, Gjykata analizon konkretisht veprimet e kryera nga kompania Aspiro. Sipas saj, kryerja e veprimeve, që kanë për qëllim realizimin e pagesave në kuadër të kontratave të sigurimit, bën pjesë në shërbimet, që lidhen me sigurimet.

- Arsyetimi plotësohet me analizimin e subjektit, që ofron shërbimet, duke parë nëse Aspiro hyn në kategorinë e brokerave ose të ndërmjetësve. Gjykata nuk mjaftohet me sqarimin e dhënë nga Gjykata e Lartë e Polonisë, sipas të cilit shoqëria nuk figuron e regjistruar as si broker dhe as si ndërmjetës, por analizon konkretisht mënyrën sesi sillet shoqëria në treg dhe veprimet që kryen ajo<sup>308</sup>. Sipas Gjykatës, kushti i parë plotësohet pasi Aspiro ka lidhje juridike me kompaninë e sigurimit, pasi ajo ushtron aktivitetin në emër të shoqërisë së sigurimit dhe ka lidhje indirekte me klientët. Kushti i dytë, që i përket procesit të kërkimeve për klientë dhe hyrjes në kontakt me ta, për të lidhur kontrata sigurimi, nuk plotësohet pasi, shoqëria Aspiro, nuk ndërhyr në fazën parakontratore, por vetëm pasi dëmi ka ardhur. Veprimet e kryera nga Aspiro nuk bëjnë pjesë në shërbimet e ofruara nga brokerat dhe ndërmjetësit.

---

<sup>308</sup> Janë dy kushte që përcaktojnë nëse një shërbim është i lidhur ose jo me sigurimet dhe ato janë përcaktuar në vendimin Arthur Andersen me numër çështjeje C 472/03.

- Në përfundim të këtij arsyetimi, Gjykata shprehet se neni 135 i Direktivës 2006/112/EEC duhet të interpretohet në mënyrë që, shërbimet, që lidhen me zgjidhjen e pasojave në rast të realizimit të dëmit, të ofruara nga një palë e tretë, në emër dhe për llogari të një kompanie sigurimi, nuk bëjnë pjesë në përjashtimet e parashikuara nga kjo dispozitë.

Në analizë të këtij vendimi të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, mund të themi se qëndrimi i mbajtur nga Gjykata është vazhdim i një jurisprudence të konsoliduar në fusha të ndryshme sipas së cilës, përjashtimet nga zbatimi i një rregulli, qoftë në fushën e tatim-taksave, qoftë në fusha të tjera, duhet të lexohen dhe të zbatohen në mënyrë strikte dhe shteruese. Gjithsesi, ky interpretim është i kritikueshëm dhe i paplotë për dy arsye:

- Së pari: shpërblimi i dëmit në rast të realizimit të rrezikut është qëllimi për të cilin një konsumator lidh një kontratë, pra është thelbi i kontratës. Veprimet, që lidhen me kryerjen e pagesës nuk mund të përjashtohen nga tërësia e veprimeve, që lidhen me marrëdhënien e sigurimit, e cila e ka zanafillën e vet te kërkimet e brokerave dhe ndërmjetësve dhe përfundon me realizimin e rrezikut dhe shpërblimin e dëmit. Përjashtimi nga TVSH, i veprimeve, që kryhen pas realizimit të dëmit, krijon një ndarje artificiale, përsa kohë këto veprime janë pjesë e detyrimeve, për të cilat brokeri apo ndërmjetësi angazhohen kundrejt klientit, kur ata përfaqësojnë kompaninë.
- Së dyti: veprimet e kryera nga Aspiro, në rastin konkret, një pjesë e kompanive të sigurimit nuk i delegojnë, por i kryejnë vetë. Duke qënë se, veprimtaria e sigurimit, që kryhet nga kompanitë e sigurimit, është e përjashtuar nga TVSH, zbatimi i këtij interpretimi ka për pasojë përjashtimin e këtyre veprimtarive nga TVSH, nëse ato kryhen drejtpërdrejt nga kompania (neni 135 i Direktivës ka një formulim të përgjithshëm, përsa u takon veprimeve të kryera nga kompanitë e sigurimit, pa bërë dallime). Rrjedhimisht, kompanitë do të kishin tendencën t'i realizonin vetë

këto veprime dhe jo t'i delegonin. Një qëndrim i tillë mund të krijojë pabarazi midis kompanive, që kanë mundësitë t'i kryejnë vetë të gjitha veprimet dhe atyre, që duhet të delegojnë pjesën e zgjidhjes së pasojave, pas realizimit të dëmit.

## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ky punim për vepritarinë e sigurimit vullnetar nuk është i pari në këtë fushë. Të tjerë autorë, të cilët janë referuar vazhdimisht, kanë trajtuar në disertacionet e tyre problematika, që lidhen me sigurimin vullnetar apo me pastrimin e parave. Qëllimi i punimit është të thellojë më tepër analizën në aspekte të trajtuara më parë (mbrojtja e konsumatorit) dhe të përgatitë terrenin e analizës për aspekte të tjera, më pak të njohura ose të trajtuara në këndvështrime të tjera (lufta kundër parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit). Analizimi i problematikave aktuale është bërë duke mbajtur parasysh zhvillimin e të drejtës së sigurimeve në Shqipëri në periudha më të hershme, gjë e cila lejon të kuptohen më mirë ndryshimet, që janë kryer dhe hapat që janë hedhur, për të arritur deri në situatën aktuale. Nëpërmjet këtij punimi, kam synuar gjithashtu të pasuroj, në mënyrë modeste, fondin e studimeve dhe punimeve, për të drejtën e sigurimeve vullnetare në Shqipëri, i cili mbetet deri më sot shumë i varfër. Sigurimi vullnetar në vendin tonë është një fushë, që meriton të trajtohet më gjerësisht nga studiuesit vendas, për vetë rëndësinë, që ky aktivitet ka marrë në Shqipëri, pas viteve '90. Ndërkohë që, në fillim të viteve '90 në Shqipëri vepronte vetëm një kompani sigurimi, e cila kishte kapital tërësisht shtetëror, sot, në tregun shqiptar veprojnë 11 kompani sigurimi, të gjitha me kapital privat, vendas ose të huaj, të cilat ofrojnë lloje të larmishme sigurimesh. Pas realizimit të këtij studimi, arrihet në disa konkluzione, të cilat nga ana e tyre sjellin nevojën e dhënies së rekomandimeve, me qëllim realizimin e përmirësimeve në kuadrin ligjor, që rregullon fushën e sigurimeve vullnetare në vendin tonë, por edhe në mënyrën sesi zbatohet ky kuadër.

Së pari: krahasimi i Kodit Civil të miratuar në vitin 1981 me Kodin Civil të miratuar në vitin 1994, nxjerr në pah faktin që, Kodi Civil i vitit 1994 përmban rregullime më specifike dhe më të detajuara, për

sa u përket kontratave të sigurimit, kushteve për lidhjen e tyre, detyrimeve të palëve si dhe problematikave, që mund të hasen në lidhje me ekzekutimin e kontratave të sigurimit.

Përfshirja e dispozitave për sigurimin në Kodin Civil, është një nga hapat e para të ndërmarra nga ligjvënësi shqiptar, së bashku me dekretin nr. 295, dt. 01.12.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”, në fushën e sigurimit, në fillimet e demokracisë. Në këtë periudhë, aktet ligjore dhe nënligjore, të miratuara gjatë regjimit socialist, u shfuqizuan gradualisht, për të shmangur krijimin e boshllëqeve në fusha të ndryshme të së drejtës. Miratimi i dekretit, të vitit 1992, ishte i nevojshëm për t’i bërë ballë një situatë të re, të krijuar nga zhvillimi i transportit me mjete personale. Ndërkohë që, vendosja e rregullave të reja më të detajuara, për sa i përket aktivitetit të sigurimit, në Kodin Civil, i parapriu shfuqizimit të akteve ligjore dhe nënligjore, që zbatoheshin deri atëherë në sektorë të ndryshëm të sigurimit, duke mundësuar, kështu, zbatimin e rregullave të njëjta nga operatorët, që vepronin në tregun shqiptar, të cilët ishin, jo vetëm vendas, si për shembull Instituti i Sigurimeve (INSIG), por edhe të huaj.

Ekzistenca e rregullave të detyrueshme, në nivel Kodi, u jep atyre një fuqi të konsiderueshme dhe një garanci më tepër për zbatimin, në mënyrë të vazhdueshme, kjo për faktin se Kodi Civil përveç fuqisë që ka si një ligj i miratuar me 3/5 e anëtarëve të Parlamentit, ndryshohet më rrallë. Përveç kësaj, zbatimi për një periudhë prej më shumë se 20 vitesh, e ka bërë atë të jetë relativisht i njohur për konsumatorët, që bëhen pjesë e një marrëdhënieje sigurimi. Vendosja e rregullave bazë në Kodin Civil ka qënë një veprim efikas, me ardhjen e sistemit pluralist, por, ai element që përbënte përparësi, në fillimin e viteve ’90, përbën sot një pengesë, pasi nevoja për të votuar ndryshimet në Kod me shumicë të cilësuar, bën që ndryshimet, të jenë shumë të vështira për t’u kryer, ndërkohë që ato janë të nevojshme.

Zhvillimi i teknologjive të informacionit lejon sot për shembull, lidhjen e kontratave nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të kompanive apo marrjen e propozimeve konkrete, mbi bazën e kritereve, të

përzgjedhura nga klientët. Në këtë drejtim, parashikimet e ligjit nr. 52/2014, por edhe të rregulloreve të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk i trajtojnë mjaftueshëm këto çështje. Pavarësisht se lidhja e kontratave nëpërmjet shërbimeve elektronike nuk praktikohet shpesh në vendin tonë, legjislacioni vendas do të ishte më i plotë nëse do të rregullonte edhe këto aspekte. Krijimi i një kuadri ligjor të favorshëm mund të shërbejë si shtysë për zhvillimin e metëjshëm të veprimeve, nëpërmjet rrugëve elektronike, gjë që lehtëson edhe pozitën e konsumatorit, i cili mund të marrë informacion dhe shërbim në çdo vend që ndodhet. Në këtë drejtim, miratimi i ligjit nr. 52/2014 ishte një rast tepër i mirë për të realizuar disa ndryshime në Kodin Civil, rast i cili nuk u shfrytëzua nga ligjvënësi.

Së dyti: ligji nr. 52/2014, ka realizuar një përafrim të konsiderueshëm me rregullat e Bashkimit Evropian. Në disa raste, madje, përputhshmëria me dispozitat e Direktivave ka qënë e plotë. Të drejtat e konsumatorëve janë trajtuar më gjerësisht, në krahasim me ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

Megjithatë, edhe në këtë drejtim ka ende mundësi përmirësimi. Disa ndryshime të tjera mund të ishin bërë në Kodin Civil, në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit. Dispozitat, që ekzistojnë aktualisht në këtë Kod (nenet 1113-1161), vendosin theksin më tepër të detyrimet, që rëndojnë mbi të siguarin (dhënia e informacionit të saktë në mënyrë të vazhdueshme, marrja e masave për ruajtjen e pasurisë dhe njoftimi i siguruesit në rast se rreziku realizohet, pagimi i primeve në kohë), sesa të drejtat, që ai gëzon. Pavarësisht se të drejtat e konsumatorit trajtohen nga dispozita të tjera ligjore<sup>309</sup>, përshtirja e tyre në Kodin Civil do të përbënte një hap përpara, jo vetëm në ofrimin e garancive për mbrojtjen e tyre, në një periudhë vështirësish ekonomike, si ajo që po jetojmë aktualisht, por edhe në përafrimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, në një kohë kur parimet e *acquis communautaire*, po përqëndrohen gjithmonë e më tepër në pozitën dhe të drejtat e konsumatorit.

---

<sup>309</sup> Ligji nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 9135 datë 11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”

Së treti: Ligji nr. 52/2014 le vend për interpretim, përse u takon dispozitave, që trajtojnë integritetin, ndershmërinë dhe përkushtimin në ushtrimin e funksioneve nga aksionari influencues, administratori dhe anëtari i bordit. Cilat janë kriteret, mbi bazën e të cilave duhet të vlerësohen integriteti dhe ndershmëria? Në qoftë se një individ dënohet me vendim penal të formës së prerë, atëherë nuk ka dyshime për mungesën e integritetit të tij, por a mund të thuhet që një individ është i ndershëm apo me integritet, ndërkohë që vendimi i dënimit penal nuk është marrë, për shkak të parashkrimit të fakteve dhe jo për arsye të konstatimit të pafajësisë? A mund të konsiderohet i ndershëm një subjekt, i cili përfiton nga pozita dominuese në treg (i vetmi që ofron një lloj sigurimi ose i vetmi që mbulon me sigurim një zonë të caktuar), për të vendosur prime dhe tarifa, të cilat nuk u korrespondojnë risqeve të mbuluara, por janë shumë më të larta?

Në këtë drejtim, edhe Direktiva e miratuar në dhjetor të vitit 2015 është e paplotë, pasi ajo parashikon që personat fizikë, të cilët punojnë për një kompani sigurimi, risigurimi apo ndërmjetësimi nuk duhet të jenë dënuar për një shkelje penale të rëndë, çka nënkupton a contrario, që ata mund të jenë dënuar për shkelje të lehta. Direktiva nuk jep asnjë shpjegim për mënyrën sesi duhet të vlerësohet rëndësia e shkeljes, në varësi të dënimit, me burg ose jo, në varësi të kategorisë në të cilën ajo bën pjesë, kundërvajtje, delikt apo krim. Është e kuptueshme që direktiva nuk mund të përcaktojë në mënyrë shteruese shkeljet e rënda, pasi ato varen nga specifikat e dispozitave kombëtare të vendeve anëtare. Megjithatë, mospërcaktimi i asnjë kriteri, vështirëson vlerësimin e shkeljeve nga autoritetet kombëtare të shteteve anëtare, të cilat nuk kanë detyrimisht të njëjtat klasifikime përse u takon shkeljeve të kryera.

Së katërti: një aspekt tjetër, në të cilin legjislacioni për sigurimet mund të ishte më i plotë, është ai i sigurimit të ndërtesave shtetërore. Sikundër u sqarua edhe më sipër, legjislacioni aktual në fuqi nuk parashikon asnjë detyrim për organet e administratës shtetërore të sigurojnë godinat, që kanë në përgjegjësi administrimi, apo pasuritë e tjera të luajtshme ose të paluajtshme, ndryshe nga legjislacioni i

periudhës së regjimit socialist. Megjithatë, institucione të ndryshme të administratës shtetërore zgjedhin të lidhin një kontratë sigurimi me një operator sigurues. Kontrata lidhet nëpërmjet një procedure prokurimi, të quajtur blerje me vlerë të vogël, nëpërmjet së cilës institucioni bën publike nevojën për të lidhur një kontratë sigurimi, me vlerë maksimale deri në 800 000 lekë dhe pret ofertat e operatorëve të ndryshëm sigurues, të cilët veprojnë në treg. Me përfundimin e afatit për pranimin e ofertave, përzgjidhet operatori, i cili ka propozuar primin më të ulët, brenda fondit limit prej 800 000 lekësh.

Duke pasur parasysh vlerën e materialeve në ngarkim të një institucioni publik, jo rrallëherë, në veçanti për strukturat qendrore, që veprojnë në kryeqytet, ndodh që sigurimi të mos mbulojë të gjithë elementët e disponuar nga Institucioni, por vetëm atë pjesë, të cilën operatori sigurues ka marrë në konsideratë, për të përcaktuar primin, që nuk e tejkalon vlerën e fondit limit. Mungesa e një rregulli detyrues në këtë drejtim ka bërë që, vendimmarrja për sigurimin të jetë e veçantë për çdo institucion dhe të kufizohet ndjeshëm nga fondet e disponuara nga secili prej tyre. Rrjedhimisht, jo të gjitha institucionet vendosin të lidhin një kontratë sigurimi dhe ato të cilat preken më tepër janë institucionet, të cilave iu caktohet një fond i vogël në buxhetin e çdo viti dhe që nuk kanë mundësi të gjenerojnë të ardhura nëpërmjet aktivitetit që ushtrojnë. Ndërsa për institucionet, të cilat nuk kanë probleme fondesh, marrja e vendimit për të mos lidhur një kontratë sigurimi, mund të jetë rrjedhojë e një llogaritjeje matematikore, nga e cila rezulton se probabiliteti i ulët për ardhjen e një rreziku, nuk justifikon derdhjen e një shume në formë primi, për çdo vit, ndërkohë, që institucioni do të jetë gjithsesi i detyruar të përballojë pjesërisht shpenzimet për rindërtim, pasi sigurimi mbulon vetëm një pjesë të dëmit.

Së pesti: Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave duhet të marrë masa për të publikuar në faqen e saj të internetit listën e personave të ekspozuar politikisht, ashtu siç edhe publikon listën e personave të shpallur financues të terrorizmit. Në këtë mënyrë, subjektet nuk do të kenë dyshime përse i takon përfshirjes ose jo të një individi në listën e personave të ekspozuar politikisht



dhe nuk do të përballen me rrezikun e vendosjes së sanksioneve nga ana e DPPP për shkak të mosrespektimit të detyrimit për raportim. Gjithashtu, DPPP duhet të ndjekë shembullin e Bashkimit Evropian duke interpretuar konceptin e personit të ekspozuar politikisht gjerësisht, me qëllim përfshirjen e një rrethi të gjerë personash në këtë kategori, pasi kryerja e veprimeve në emër apo për llogari të një afërmi është një prej metodave të përdorura nga individët të cilët duan të futin në qarkullin në treg, shuma parash të fituara nëpërmjet aktiviteteve kriminale<sup>310</sup>.

Së gjashti: duke përjashtuar të drejtën e personit të siguruar për t'iu drejtuar gjykatës, në rast se ai ka rënë dakord paraprakisht me shumën e ofruar si dëmshpërblim, ligjvënësi shqiptar ka mbajtur një qëndrim shumë strikt dhe të kritikueshëm, përse u takon të drejtave të konsumatorit. Përcaktimi i një këtij rregulli është bërë në kuadër të përafrimit të legjislacionit vendas me rregullat e Bashkimit Evropian. Megjithatë, parashikimi i një dispozite të tillë është bërë pa mbajtur në konsideratë situata që mund të krijohen në praktikë, siç është ajo e shtimit të masës së dëmit të shkaktuar, në një moment të dytë, pra pas nënshkrimit të marrëveshjes, ndërkohë që rëndesa e dëmit është e lidhur me shkaqe të mbuluara nga kontrata e sigurimit, të cilat nuk ishin të njohura për të siguruarin në momentin e pranimit të ofertës së siguresit. Ligjvënësi ka dashur në këtë mënyrë të thjeshtojë procedurat e zgjidhjes së pasojave, që rrjedhin nga realizimi i rrezikut të siguruar, duke fituar kohë për të siguruarin, i cili mund të paguhet më shpejt nga siguresi, por edhe për gjykatat, të cilat nuk do të gjykojnë çështjet e zgjidhura me marrëveshje. Por, duke mos parashikuar asnjë përjashtim nga ky rregull, ligjvënësi ka favorizuar në mënyrë të padrejtë shoqëritë e sigurimit, të cilat mund të përfitojnë nga situata e vështirë në të cilën ndodhet i siguruari (për shkak të problemeve shëndetësore, djegies së banesës apo shkatërrimit të

---

<sup>310</sup> Një opinion të tillë e ka mbështetur edhe qeveria franceze në momentin e miratimit të Direktivës “Insurance Distribution Directive”, në vitin 2015. – “Les principales innovations de la 4<sup>e</sup> Directive anti-blanchiment et financement du terrorisme dans 12 points”, Paris, Tetor 2015.

pasurisë), për t'i propozuar atij një vlerë shpërblimi shumë të ulët, të cilën i siguruari do të jetë i detyruar ta pranojë, për shkak të nevojës urgjente për të ardhura.

Së fundi, duke qënë se ligji shqiptar është miratuar përpara direktivës së dhjetorit 2015, do të jetë e nevojshme, në të ardhmen që të bëhen ndërhyrje në tekstin e tij, me qëllimin për të forcuar rregullat për pavarësinë financiare të brokerave dhe ndërmjetësve dhe për të parashikuar trajnime dhe formime të detyrueshme të punonjësve, që marrin pjesë në fazat e ndryshme të lidhjes dhe ekzekutimit të kontratave të sigurimit.

## BIBLIOGRAFI:

### ➤ Literaturë dhe punime shkencore

1. Alphonse Grun dhe Fraçois Joliat, "*Traité des assurances terrestres et de l'assurance sur la vie des homes*", Paris 1828 ;
2. Argita Malltezi, "*E drejta shqiptare e shoqërive tregtare*", Botimi i I<sup>ë</sup>, Mediaprint, 2011;
3. Artan Spahiu, "*Konventa e Nju Jorkut dhe instrumentet juridike të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar në Shqipëri*", Disertacion për marrjen e gradës shkencore "Doktor", Tiranë, 2015;
4. Benoît Moore, "*L'offre dans le contrat d'assurance: une divergence qui en appelle une autre*", Revue juridique Thémis, Janar 1998, fq. 361 - 441;
5. Didier Pouilloux, "*Mémoires d'assurances – Recueil des sources françaises sur l'histoire des assurances du XVI<sup>ème</sup> au XIX<sup>ème</sup> siècle*", Shkurt 2011 ;
6. Edvin Sinani, "*Pastrimi i parave*", punim dorëzuar Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Shkurt 2016;
7. Elisabeta Gjoni, Anxhela Dervishi, "*Roli dhe objektivat e AMF si rregullator i tregjeve financiare jobankare në Shqipëri*", Revista "Economicus", UET Press, 2010, fq. 47 - 53;
8. Elizur Wright, "*Life insurance*", The North American Review, University of North Iowa, Vol. 143, Nr. 357, Gusht 1886, fq. 142 - 150;
9. Ersida Teliti, "*Kontratat konsumatore*", Disertacion për mbrojtjen e gradës 'Doktor i Shkencave', Tiranë 2013;
10. Fjona Zeneli, "A manifestojnë sjellje të kontrollura ndaj riskut, në jetën e tyre të përditshme, qytetarët dhe familjarët në vendin tonë", Buletini Shkencor, Universiteti "Ismail Qemali", Numër 3, Vëllimi 1, Vlorë, 2015, fq. 228 - 239;
11. Francesco Galgano, "*E drejta private*", Luarasi University Press, Tiranë, 2006;
12. Frederick L. Hoffman, "*Industrial insurance*", The annals of the American Academy of Political and Social Science, Vol. 26, Shtator 1905, fq. 103 -119;
13. Gerdi Lito, "*Manaxhimi i riskut të katastrofave – Rasti i Shqipërisë*", Disertacion në kërkim të gradës shkencore "Doktor i Shkencave", Tiranë 2013;

14. Hicham Elhabbouli, *“Le contrat d’assurance vie en droit comparé franco-marocain”* Punim doktrature, Universiteti i Renës, 2015;
15. Jean – Marc Aubert, *“Fondement et développement de la gestion du risque”*, Revista “Regards”, Nr. 43, Janar 2013, fq. 60 – 66 ;
16. Juliana Bylykbashi, *“Aspekte juridike të biznesit të sigurimit vullnetar”*, Disertacion për mbrojtjen e gradës ‘Doktor i Shkencave’, Tiranë 2014.
17. Klodian Kodra, *“Sfidat me të cilat përballen shoqëritë e sigurimit në Shqipëri, në raportimin financiar”*, Botim i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, Tiranë 2009;
18. Letër aktualiteti e Ministrisë franceze të Ekonomisë, *“Les principales innovations de la 4<sup>e</sup> Directive anti-blanchiment et financement du terrorisme dans 12 points”*, Paris, Tetor 2015;
19. Luan Gjonça, *“Pastrimi i produkteve të veprës penale dhe krimi i organizuar”*, Revista “Justiniani i I<sup>ë</sup>”, Dhjetor 2009, fq. 25 - 48;
20. Luan Hasneziri, *“Kontrata e sigurimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë”*, Punim doktrature, Tiranë 2011.
21. Mariana Semini Tutulani, *“E drejta e detyrimeve – Pjesa e përgjithshme”*, Skanderbooks, Tiranë 2006;
22. Mariana Semini Tutulani, *“E drejta e detyrimeve – Pjesa e posaçme”*, Skanderbooks, Tiranë, 2006;
23. Michel Justancia, *“La requalification des contrats d’assurance vie”*, Punim doktrature, Universiteti i Lilës, 2005 ;
24. Naim Mëçalla, *“Pastrimi i parave dhe efektet negative në ekonomi”*, Revista “Economicus”, UET Press, Vjeshtë 2011, fq. 183 - 191;
25. Paul Govare, *“L’assurance maritime anglaise”*, Argus Editions, 1929;
26. Peter Nash Swicher, *“A realistic consensus approach to the insurance law doctrine of reasonable expectations”*, Tort & Insurance Law Journal, 2000, dq. 729-779;
27. Pierre-Emmanuel Thérond, *“Mesure et gestion des risques d’assurance: analyse critique des futurs référentiels prudentiel et d’information financière”*, punim doktrature, Universiteti i Lionit, Qershor 2007;
28. Rinald Guri, Anxhela Dervishi, *“Drejt një mbikëqyrjeje efektive të tregut të sigurimeve në Shqipëri”*, Revista “Economicus”, UET Press, Pranverë 2010, fq. 153 - 164;
29. Rinald Guri, Elisabeta Gjoni, Anxhela Dervishi, *“Bazat në sigurime”*, Albpaper, Tiranë 2012;

30. Roland Subashi, *"Parandalimi i pastrimit të parave"*, Disertacion për mbrojtjen e gradës 'Doktor i Shkencave', Tiranë 2015;
31. Reuben Hasson, *"Subrogation in insurance law – A critical evaluation"*, Oxford Journal of Legal Studies, Dhjetor 1985, faqe 416 – 428;
32. Rrustem Qehaja, *"Përgjegjësia juridike-civile e siguruesit në mbulimin e disa rreziqeve përkitasi me jetën dhe aksidentet personale"*, Revista "Centrum 2", Shkup, Dhjetor 2014, faqe 535 – 555;
33. W. S. Holdsworth, *"The Early History of the Contract of Insurance"*, Columbia Law Review, Shkurt 1917, faqe 85-113;
34. Xhevat Bakraçi, *"Menaxhmenti i rrezikut dhe sigurimet"*, Prishtinë 2007;
35. Yanmiao Tian, *"Les principes fondamentaux de la loi sur les assurances"*, Revue Internationale de Droit Comparé, Vol 50, Paris, Korrik – Shtator 1998, faqe 889 - 892 ;
36. Yves Lequette, *"Vers un Code Civil européen"*, Revista "Pouvoirs", Paris, Nëntor 2003, faqe 97 – 126 ;
37. Yvonne Lambert – Faivre, *"Droit des assurances"*, Botimi i 13<sup>të</sup>, Dalloz, 2011;

#### ➤ **Akte ligjore dhe nënligjore**

1. Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës të Shqipërisë", Fletorja Zyrtare nr. 11, i ndryshuar;
2. Ligj nr. 2022, datë 02.04.1955 "Ligj mbi pjesën e përgjithshme të Kodit Civil të Republikës Popullore të Shqipërisë", Gazeta Zyrtare nr. 4, 30 Prill 1955 ;
3. Ligj nr. 2023, datë 02.04.1955 "Ligj mbi zbatimin e pjesës së përgjithshme të Kodit Civil të Republikës Popullore të Shqipërisë", Gazeta Zyrtare Nr. 4, 30 Prill 1955,
4. Ligj nr. 6340, datë 26.06.1981 "Për Kodin Civil", Qendra e Botimeve Zyrtare, Tiranë, 2015;
5. Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", Fletorja Zyrtare nr. 93;
6. Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, Fletorja Zyrtare nr. 78;
7. Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", i ndryshuar, Fletorja Zyrtare nr. 60;
8. Ligji nr. 157, datë 10.10.2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", Fletorja Zyrtare nr. 172;

9. Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, Fletorja Zyrtare nr. 83,;
10. Ligji nr. 10 279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Fletorja Zyrtare nr. 73;
11. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 08.04.2009 “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse”, Fletorja Zyrtare 71;
12. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 18 datë 28.04.2015 e Bordit të AMF, “Për rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqëritë e sigurimit”;
13. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 20 datë 28.04.2015 e Bordit të AMF, “Për procedurat e ndalimit ose kufizimit të përdorimit të lirë të aktiveve të shoqërisë së sigurimit”;
14. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 34 datë 28.05.2015 e Bordit të AMF, “Për raportimin e detyruar dhe periodik të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit”;
15. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 35 datë 28.05.2015 e Bordit të AMF, “Për procedurat dhe shqyrtimin e ankesave”;
16. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 36 datë 28.05.2015 e Bordit të AMF, “Për informimin e të sigurve apo personave të tjerë të interesuar, për sa u përket zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore në sektorin e sigurimeve”;
17. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 37 datë 28.05.2015 e Bordit të AMF, “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”;
18. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 38 datë 28.05.2015 e Bordit të AMF, “Për formatimin e detajuar, minimumin e objektit dhe të përmbajtjes së raportit të auditimit, të shoqërisë së sigurimit”;
19. Rregullore e miratuar me vendimin nr. 45, dt. 30.06.2015 e Bordit të AMF, “Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve” ;
20. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 48 datë 30.06.2015 e Bordit të AMF, “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime” ;
21. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 58 datë 30.06.2015 e Bordit të AMF, “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;
22. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 85/1, dt. 30.09.2015 e Bordit të AMF, “Për kriteret e risigurimit”;

23. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 110, dt. 26.10.2015 e Bordit të AMF, “Për përmbajtjen e raportit vjetor që publikohet nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”;
24. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 120, dt. 26.11.2015 e Bordit të AMF, “Mbi kriteret, rregullat dhe procedurat për delegimin e disa funksioneve nga shoqëritë e sigurimit”;
25. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 135, dt. 31.10.2014 e Bordit të AMF, “Për procedurat dhe parimet minimale në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe aspekte të tjera të sistemit të informimit të shoqërisë së sigurimit”;
26. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 137, dt. 21.12.2015 e Bordit të AMF, “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorit/anëtarit” ;
27. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 138, dt. 21.11.2015 e Bordit të AMF, “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”;
28. Rregullore, e miratuar me vendimin nr. 153, dt. 23.12.2014 e Bordit të AMF, “Për veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm dhe komitetit të auditimit në shoqërinë e sigurimit”;
29. “Marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni”, datë 28.05.2015, midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave ;
30. Rregullore mbi sigurimin e detyrueshëm të pasagjerëve, Gazeta Zyrtare nr. 83, 1948;
31. Urdhëresë nr. 29, datë 15.07.1948, “Mbi llojet e sigurimit që do t’ushtrojë ISIS gjatë vitit 1948”, Gazeta Zyrtare nr. 85;
32. Rregullore, datë 29.08.1949 “Për Sigurimin e Jetës”, Gazeta Zyrtare nr. 68;
33. Rregullore për sigurimin e jetës nga fatkeqësitë, Gazeta Zyrtare nr. 9, 1954;
34. Urdhëresë nr. 29, datë 15.07.1948, “Mbi llojet e sigurimit që do t’ushtrojë ISIS gjatë vitit 1948”, Gazeta Zyrtare nr. 85;
35. Urdhëresë nr. 28, datë 05.08.1949 “Për sigurimin e detyrueshëm të ndërtesave shtetërore të dhëna me qira privatëve dhe kooperativave”, Gazeta Zyrtare nr. 61;
36. Rregullore, datë 05.08.1949, “Për sigurimin e detyrueshëm të ndërtesave shtetërore të dhëna me qira privatëve dhe kooperativave”, Gazeta Zyrtare nr. 61;
37. Rregullore, datë 17.07.1949, “Për sigurimin e pasurisë private”, Gazeta Zyrtare nr. 61;
38. Vendim nr. 724, datë 04.09.1950, “Mbi ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 291 datë 11.07.1949 për sigurimin e banesave të punëtorëve, që punojnë jashtë qytetit dhe larg familjeve në Ndërmarrjet shtetërore”, Gazeta Zyrtare nr. 60;

39. Rregullore, datë 17.07.1949, “Tarifa e primeve për sigurimin e pronave”, Gazeta Zyrtare nr. 61;
40. Rregullore për sigurimin vullnetar të pasurisë, Gazeta Zyrtare nr. 83, 1948;
41. Rregullore mbi sigurimin vullnetar të kulturave bujqësore, Gazeta Zyrtare nr. 58, 1950;
42. Urdhëresë nr. 14, datë 05.04.1951, “Mbi sigurimin vullnetar të gjësë së gjallë”, Gazeta Zyrtare nr. 33;
43. Rregullore për sigurimin vullnetar të pasurisë, Gazeta Zyrtare nr. 14, 1954;
44. Urdhëresë nr. 1, datë 12.01.1955, “Mbi sigurimin vullnetar të gjësë së gjallë”, Gazeta Zyrtare nr. 1;
45. Vendim nr. 14, datë 12.01.1955, “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren mbi sigurimin vullnetar të kulturave bujqësore t’aprovuar me vendimin e këshillit të Ministrave të RPSH nr. 662 datë 21.08.1950”, Gazeta Zyrtare nr. 1;
46. Rregullore, datë 12.04.1955, “Mbi sigurimin vullnetar të sendeve shtëpiake”, Gazeta Zyrtare nr. 5;

#### ➤ **Direktiva të Bashkimit Evropian**

1. Direktiva e parë e Këshillit 73/239/KEE, datë 24 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative, që kanë të bëjnë me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës, Numri CELEX: 31973L0239, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 228, datë 16.08.1973, faqe 3–19;
2. Direktiva e Këshillit 73/240/KEE, datë 24 korrik 1973, që heq kufizimet mbi lirinë e vendosjes në veprimtarinë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës, Numri CELEX: 31973L0240, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 228, datë 16.08.1973, faqe 20–22;
3. Direktiva e dytë e Këshillit 88/357/KEE, datë 22 qershor 1988, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës, ku parashikohen dispozitat për mundësimin e ushtrimit të efektshëm të lirisë për të ofruar shërbime dhe ku ndryshohet direktiva 73/239/KEE, Numri CELEX: 31988L0357, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 172, datë 04.07.1988, faqe 1–2;



4. Direktiva 2002/92/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 9 dhjetor 2002, për ndërmjetësimin në sigurime, Numri CELEX: 32002L0092, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 9, datë 15.01.2003, faqe 3–10;
5. Direktiva e Këshillit 92/49/KEE, datë 18 qershor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës, dhe për ndryshimin e Direktivës 73/239/KEE dhe Direktivës 88/357/KEE (Direktiva e tretë për sigurimet jojetë, Numri CELEX: 31992L0049, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 228, datë 11.08.1992, faqe 1–23;
6. Direktiva 2002/13/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 5 mars 2002, për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 73/239/KEE në lidhje me kërkesat për nivelin e aftësisë paguese për ndërmarrjet e sigurimeve jojetë, Numri CELEX: 32002L0013, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 77, datë 20.03.2002, faqe 17–22;
7. Direktiva 98/78/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 27 tetor 1998, për mbikëqyrjen shtesë të ndërmarrjeve të sigurimeve në grupin e sigurimeve, Numri CELEX: 31998L0078, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 330, datë 05.12.1998, faqe 1–12;
8. Direktiva 2005/68/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 16 nëntor 2005, për risigurimin dhe për ndryshimin e direktivave të Këshillit 73/239/KEE, 92/49/KEE, si dhe direktivave 98/78/KE dhe 2002/83/KE, Numri CELEX: 32005L0068 , Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 323, datë 09.12.2005, faqe 1–50;
9. Direktiva 2002/83/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 5 nëntor 2002, për sigurimin e jetës, Numri CELEX: 32002L0083, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 345, datë 19.12.2002, faqe 1–51;
10. Direktiva 2001/17/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 19 mars 2001, për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve të sigurimeve, Numri CELEX: 32001L0017, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 110, datë 20.04.2001, faqe 28–39;

#### ➤ **Vendime gjyqësore**

1. Gjykata Evropiane e Drejtësisë, çështja Jean-Claude Van Hove kundër “CNP Assurances SA”, datë 23 prill 2015, C-96/14;
2. Gjykata Evropiane e Drejtësisë, çështja “Litaksa” UAB kundër “BTA Insurance Company” SE, datë 26 mars 2015, C-556/13;

3. Gjykata Evropiane e Drejtësisë, çështja “Nationale-Nederlanden Levensverzekering Mij NV” kundër Hubertus Eilhelmus Van Leeuwen, datë 29 prill 2015, C-51/13;
4. Gjykata Evropiane e Drejtësisë, çështja Minister Financoë kundër “Aspiro SA”, datë 17 mars 2016, C-40/15;
5. Gjykata Evropiane e Drejtësisë, çështja Bashkimi Evropian kundër “AXA Belgium SA”, datë 15 tetor 2015, C-494/14;
6. Vendimi nr. 335, datë 01.07.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë;
7. Vendimi nr. 473, datë 18.09.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë;
8. Vendimi nr. 73, datë 17.01.2013 i Gjykatës së Apelit Tiranë ;
9. Vendimi nr. 2623, datë 08.11.2012 i Gjykatës së Apelit Tiranë ;
10. Vendimi nr. 1419, datë 24.03.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
11. Vendimi nr. 4418, datë 14.09.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
12. Vendim nr. 6, datë 17.02.2012, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

#### ➤ **Raporte institucionesh**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Raporti vjetor 2007;
2. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Raporti vjetor 2008;
3. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Raporti vjetor 2009;
4. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Raporti vjetor 2010;
5. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Raporti vjetor 2011;
6. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Raporti vjetor 2012;
7. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Raporti vjetor 2013;
8. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Raporti vjetor 2014;
9. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Raporti vjetor 2015;
10. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Raporti vjetor 2012;
11. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Raporti vjetor 2013;
12. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Raporti vjetor 2014;
13. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Raporti vjetor 2015.

➤ **Faqe interneti**

1. [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al);
2. [www1.fint.gov.al](http://www1.fint.gov.al);
3. [www.gjk.gov.al](http://www.gjk.gov.al);
4. [www.gjykataeapelittirane.al](http://www.gjykataeapelittirane.al);
5. <https://www.lloyds.com>;
6. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al>;
7. [www.europa.eu](http://www.europa.eu);
8. [www.jstor.org](http://www.jstor.org);
9. [www.credit-agricole.fr](http://www.credit-agricole.fr)